

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR MEDIAN

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë, 2020

ISBN: 978-9928-01-116-9

Adresa

Rruga: “Nikolla Jorga”

Tel/fax: +355 42 427005, 04 2427006

E-mail: info@qbz.gov.al,

Web: www.qbz.gov.al

PËRMBAJTJA

I. AKTE NDËRKOMBËTARE

Ligj nr.9851 datë 6.12.2007	Për ratifikimin e akteve finale të Konferencës Rajonale të Radiokomunikacioneve për planifikimin e shërbimit të transmetimit numerik tokësor në pjesë të rajoneve 1 dhe 3, në bandat e frekuencës 174-230 mhz dhe 470-862 mhz (rrc-06) dhe të akteve finale të Konferencës Rajonale të Radiokomunikacioneve për Rishikimin e Marrëveshjes së Stokholmit, 1961 (rrc-06 rev. st 61), të zhvilluar në Gjenevë, 15 maj – 16 qershor 2006	5
--------------------------------	--	---

II. MEDIA AUDIOVIZIVE

Ligj nr. 97/2013 datë 4.3.2013	Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë - <i>ndryshuar me ligjin nr. 22/2016 , datë 10.3.2016, vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 56, datë 27.7.2016 dhe ligjin nr. 91/2017, datë 22.5.2017</i>	6
Vendim i Kuvendit nr. 98/2016	Për miratimin e statutit të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)	74
Vendim i KM nr. 480, datë 3.6.2015	Për miratimin e rregullave teknike për aparatet marrëse televizive, që do të vendosen në treg	94
Vendim i KM nr. 690, datë 4.11.2018	Për prodhimin, transmetimin dhe financimin e emisioneve të posaçme televizive, arsimore dhe kulturore, të dedikuara për diasporën	110
Udhëzimi MMSR nr. 5, datë 19.2.2016	Mbi zbatimin e vendimit nr. 758, datë 16.9.2015, të Këshillit të Ministrave për ngarkimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për kryerjen e procedurave të prokurimit për pajisjen me dekodera të familjeve në nevojë, përfituese nga skema e ndihmës ekonomike, dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për këtë ministri - <i>ndryshuar me udhëzimin nr. 20, datë 3.10.2016</i>	111
Vendim i AMA nr. 220, datë 1.12.2017	Mbi përcaktimin e pagesave për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive	112
Ligj nr. 34/2017 datë	Për lirimin e frekuencave të dixhital - dividendit - <i>ndryshuar me ligjin nr. 28/2018, datë 24.5.2018</i>	118
Vendimi KM nr. 240, datë 4.4.2019	Për miratimin e kriterëve për ndarjen e kompensimit financiar të operatorëve me eksperiencë në transmetimet numerike dhe operatorëve privatë historikë kombëtarë	122
Vendim i KM nr. 521, datë 6.8.2014	Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekran shfaqës”	123

III. MEDIA E SHKRUAR

Ligj nr.7756, datë 1.10.1993	Për shtypin - <i>ndryshuar me ligjin nr.8239, datë 3.9.1997</i>	128
Udhëzim i KMDHP nr.9, datë 15.9.2010	Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive, të ndryshuar - <i>ndryshuar me udhëzimin nr. 32, datë 27.12.2012</i>	129
Vendim i KM nr.1195, datë .8.2008	Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore	135
Vendim i KM nr.358, datë 25.3.1996	Për rregullimin e kohës së punës dhe të pushimit për shtypin e shkruar dhe të folur	137
Vendim i KM nr.176, datë 9.3.2006	Për botimin e Buletinit të Njoftimeve Publike	138
Vendim i KM nr. 336, datë 6.5.2012	Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të Botimit të Njoftimeve Publike, për efekt të zbatimit të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”	140

I. AKTE NDËRKOMBËTARE

LIGJ

Nr.9851, datë 26.12.2007

**PËR RATIFIKIMIN E AKTEVE FINALE TË KONFERENCËS RAJONALE TË
RADIOKOMUNIKACIONEVE PËR PLANIFIKIMIN E SHËRBIMIT TË
TRANSMETIMIT NUMERIK TOKËSOR NË PJESË TË RAJONEVE 1 DHE 3, NË
BANDAT E FREKUENCËS 174-230 MHZ DHE 470-862 MHZ (RRC-06) DHE TË
AKTEVE FINALE TË KONFERENCËS RAJONALE TË
RADIOKOMUNIKACIONEVE PËR RISHIKIMIN E MARRËVESHJES SË
STOKHOLMIT, 1961 (RRC-06 REV. ST 61), TË ZHVILLUAR NË GJENEVË,
15 MAJ – 16 QERSHOR 2006¹**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohen aktet finale të Konferencës Rajonale të Radiokomunikacioneve për planifikimin e shërbimit të transmetimit numerik tokësor në pjesë të rajoneve 1 dhe 3, në bandat e frekuencës 174-230 MHZ dhe 470-862 MHZ (RRC-06) dhe aktet finale të Konferencës Rajonale të Radiokomunikacioneve për rishikimin e Marrëveshjes së Stokholmit, 1961 (RRC-06 REV. ST 61), të zhvilluar në Gjenevë, 15 maj – 16 qershor 2006.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5577, datë 17.1.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

¹ Për t'u njohur me përmbajtjen e akteve finale të Konferencës Rajonale të Radiokomunikacioneve mund të shfletoni Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 26.12.2007 ose <https://qbz.gov.al/share/VVcz93ZQQBq31B3wPRdqww>

LIGJ
Nr. 97/2013²

PËR MEDIAT AUDIOVIZIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË³
*(Ndryshuar me ligjin nr. 22/2016⁴, datë 10.3.2016, vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 56,
datë 27.7.2016 dhe ligjin nr. 91/2017, datë 22.5.2017)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, mbi bazën e parimit të asnjësisë teknologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Abonim” është kontrata e shërbimit, lidhur midis ofruesit të shërbimeve mediatike audiovizive me pagesë dhe marrësit të këtyre shërbimeve.
2. “Akses i kushtëzuar” është çdo masë dhe/ose rregullim teknik që mundëson marrjen në formë të kuptueshme të shërbimeve të mbrojtura, kundrejt një autorizimi individual paraprak.

² Ligji nr. 97/2013, datë 4.3.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 37, datë 19 mars 2013.

Ligji nr. 22/2016, datë 10.3.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 67, datë 21 prill 2016.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 56, datë 27.7.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.152, datë 12 gusht 2016.

Ligji nr. 91/2017, datë 22.5.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 118, datë 23 maj 2017.

³ Ky ligj është përafshuar plotësisht me direktivën 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010 “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë” (Direktiva për Shërbimin Mediatik me Zë dhe Figurë, versioni i kodifikuar), Numri CELEX: 32010L0013, Fletore Zyrtare e BE-së, Seria L 95, datë 15.4.2010.

⁴ Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për zgjedhjet që janë duke u zhvilluar në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji. (neni 5)

3. “AMA” është Autoriteti i Mediave Audiovizive.
4. “Aparat marrës” është bashkësia e pajisjeve elektronike, që realizon marrjen dhe shfaqjen e transmetimeve audiovizive për përdoruesit dhe çdo aparat tjetër apo program i lidhur me të për këtë qëllim.
5. “Autoritet i komunikimeve elektronike dhe postare ose AKEP” është autoriteti përgjegjës rregullator për komunikimet elektronike, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
6. “Dritare teleshitjesh” janë oferta të drejtpërdrejta për publikun gjatë transmetimit, të cilat zgjasin minimalisht 15 minuta, me qëllim shitjen e mallrave ose shërbimeve, përfshirë pasuri të paluajtshme, të luajtshme ose të drejta të tjera, kundrejt pagesës. Dritaret e teleshitjeve mund të përfshijnë ose jo mundësinë e pagesës së atypëratyshme përkundrejt ofrimit të mallrave, shërbimeve apo të drejtave të tjera reale e intelektuale subjekt i tyre.
7. “Komunikim i fshehtë audioviziv me natyrë tregtare” është paraqitja me fjalë ose figurë e mallrave, shërbimeve, emërimit, markës së prodhimit ose i veprimtarive të një prodhuesi mallrash ose ofruesi shërbimesh, në programe, kur një paraqitje e tillë, nga ofruesi i shërbimit të mediave, ka për qëllim të shërbejë si reklamë dhe mund të mashtrojë publikun mbi natyrën e tij. Një paraqitje e tillë konsiderohet se ka për qëllim të shërbejë si reklamë, kur bëhet kundrejt pagesës ose përfitimeve të tjera.
8. “Komunikimi tregtar audioviziv” është mesazhi me zë ose imazhi me ose pa zë që është krijuar për të promovuar, drejtpërdrejt ose jo, mallrat, shërbimet ose imazhin e subjekteve që kryejnë një aktivitet ekonomik. Ai shoqërohet ose përfshihet në një program kundrejt pagesës ose shpërblimit të ngjashëm përkatës, apo për qëllime vetëpromovuese. Format e komunikimeve audiovizive me natyrë tregtare janë:
 - a) reklamat në shërbimet audiovizive;
 - b) sponsorizimet;
 - c) shitjet e drejtpërdrejta;
 - ç) dritaret e teleshitjeve;
 - d) vendosja e produkteve në programe.
9. “Komunitet”, në kuptim të këtij ligji, është bashkësia e individëve në një vendndodhje gjeografike të caktuar, ose bashkësia e individëve që kanë një interes të veçantë të përbashkët.
10. “Komunitet me nevoja të veçanta shqisore” është komuniteti me mangësi të pjesshme ose të plotë shikimi ose dëgjimi, aftësia e të cilëve për të perceptuar sinjale audio apo audiovizive është e kufizuar në atë masë që bën të pamundur gëzimin e së drejtës së informimit.
11. “Mbulim i përgjithshëm” është mbulimi nga një shërbim pa pagesë i transmetimit për të paktën 95 për qind të popullsisë në Republikën e Shqipërisë.
12. “Ministri” është ministri që mbulon fushën e komunikimeve elektronike.
13. “Mjete tokësore për shpërndarjen e një shërbimi transmetimi audioviziv” janë mjetet për shpërndarjen e një shërbimi të tillë nëpërmjet valëve.
14. “Multipleks” është një pajisje teknike për vijimin e sinjaleve numerike dhe bashkimin e tyre në një fluks numerik të dhënash.
15. “Ndërfaqet e programeve aplikative” janë përshtatës programorë midis aplikimeve të vëna në dispozicion nga OSHMA-të dhe kapaciteteve të pajisjeve të përmirësuara të transmetimeve audiovizive numerike.
16. “Ngjarje me rëndësi të madhe” është një ngjarje me rëndësi publike në Shqipëri, ose në një pjesë të saj, me natyrë sportive ose josportive, e cila përmbush të paktën dy nga kushtet e mëposhtme:
 - a) për ngjarjen ka një interes të veçantë dhe të përhapur në vend, ku personat e interesuar janë edhe të tjerë, përveç atyre, të cilët zakonisht ndjekin ngjarje të tilla përmes televizionit;
 - b) ngjarja gëzon njohje të gjerë nga publiku i përgjithshëm, ka një ndikim kulturor të rëndësishëm, forcon identitetin kulturor dhe nuk ka përmbajtje partiake;

c) ngjarja përfshin pjesëmarrjen e skuadrës kombëtare të një disipline sportive të veçantë, në një ngjarje ose garë të rëndësishme ndërkombëtare;

ç) ngjarja historikisht është transmetuar pa pagesë përmes televizionit dhe ka pasur një shikueshmëri të lartë në vend.

17. “Ofrues shërbimi mediatik audioviziv (OSHMA)” është personi fizik ose juridik, që ka përgjegjësinë editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv dhe që vendos mënyrën e organizimit të saj.

18. “Operatori i rrjetit numerik” është personi juridik që ofron infrastrukturën teknike për shpërndarjen tokësore dhe bashkimin e programeve numerike dhe shërbimeve shtesë të përfshira në fluksin numerik të të dhënave.

19. “Organizues i ngjarjes” është personi fizik ose juridik, që ka të drejtën ligjore për shitjen dhe shpërndarjen e ngjarjes.

20. “Pajisje e aksesit të kushtëzuar” është çdo pajisje ose program i projektuar ose i përshtatur për dhënien e aksesit në një shërbim të mbrojtur në një formë të kuptueshme dhe të qartë.

21. “Pajisje e ndaluar” është çdo pajisje ose program i projektuar ose i përshtatur për dhënien e aksesit në një shërbim të mbrojtur në një formë të kuptueshme, të qartë, pa autorizimin e ofruesit të shërbimit.

22. “Përgjegjësi editoriale” është ushtrimi i kontrollit efektiv mbi përzgjedhjen e programeve dhe organizimin e tyre në:

a) një listë dhe orar, në rastin e shërbimeve të transmetimit të drejtpërdrejtë audioviziv;

b) një katalog, në rastin e shërbimeve të programit audioviziv, sipas kërkesës.

23. “Prodhime të pavarura” janë aktivitete të prodhimit të veprave audiovizive, të cilat plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:

a) kur nuk janë të kontrolluara ose të lidhura me transmetues me licencë ose me autorizim për transmetimin;

b) kur për një periudhë prej tre vitesh, të paktën 90 për qind e këtyre prodhimeve nuk janë të destinuara për një transmetues të vetëm.

24. “Prodhues i pavarur” është personi fizik a juridik, që nuk është i përfshirë në prodhimin e shërbimeve mediatike audiovizive, i cili prodhon filma, programe reklamash, transmetime ose programe me natyrë individuale audiovizive.

25. “Program radio” është tërësia e mesazheve audio që përbëjnë një element individual brenda një liste apo katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, forma dhe përmbajtja e të cilit janë të krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit radio.

26. “Program televiziv” është tërësia e imazheve lëvizëse, me ose pa zë, që përbëjnë një element individual brenda një liste apo katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, forma dhe përmbajtja e të cilit janë të krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit televiziv. Shembujt e programeve përfshijnë filma, ngjarje sportive, komedi, dokumentarë, programe për fëmijë dhe drama origjinale.

27. “Reklamë” është çdo formë e publikimit të transmetuar kundrejt pagesës ose përfitimeve të tjera nga një sipërmarrje publike ose private apo nga një person për qëllime vetëreklamuese, lidhur me veprimtari të veta tregtare e fitimprurëse, profesionale ose ekspertizë, si dhe për mbështetjen e pajisjes me mallra ose shërbime, përfshirë këtu pasuri të paluajtshme, të drejta e detyrime të tjera, përkundrejt pagesës.

28. “Reklama institucionale” janë reklamat e porositura nga një institucion shtetëror, për të promovuar veprimtarinë e institucionit, me qëllim që të nxisë, të përkrahë dhe mbrojë vlerat dhe qëndrimet që konsolidojnë demokracinë, mirëqenien, shëndetin publik dhe sigurinë kombëtare.

29. “Reklama ndërvepruese” janë reklamat, të cilat lejojnë përdoruesin të marrë përmbajtje më të detajuar të reklamës nga pjesa e publikuar e programit përkatës.

30. “Reklamat në ekran të ndarë” janë reklamat që shfaqen në kënd të ekranit në mënyrë të njëkohshme me transmetimin e programit, si logo, tekst i lëvizshëm, kënde reklamimi dhe forma të tjera reklame.

31. “Reklama politike” janë reklama me përmbajtje thelbësore politike, që kanë për qëllim të arrijnë objektiva politike.

32. “Reklamë virtuale” është reklama e krijuar përmes përpunimit grafik me teknologji digjitale për të futur imazhe në një program televiziv të transmetuar direkt ose me regjistrim.

33. “Reklamë e zakonshme” është transmetimi i reklamave, kohëzgjatja e të cilave nuk i kalon 90 sekonda.

34. “Reklamë e zgjeruar” është një transmetim për qëllim fitimi që i kalon 90 sekonda, e cila i jep publikut informacion të detajuar për mallrat, shërbimet, shoqëritë, individët dhe organizatat tregtare, veprimtarinë ose idetë e tyre.

35. “Reklamë në televizion” është çdo formë e publikimit, e transmetuar nga një transmetues televiziv, kundrejt pagesës ose përfitimeve të tjera ose transmetim për qëllime vetëreklamuese, nga një sipërmarrje publike apo private ose nga një person fizik, lidhur me veprimtari të veta tregtare e fitimprurëse, profesionale ose ekspertizë, me qëllim për të promovuar ofrimin e mallrave ose shërbimeve, përfshirë këtu pasuri të paluajtshme, të drejta dhe detyrime të tjera, kundrejt pagesës.

36. “Rrjetet e komunikimeve elektronike” janë sistemet e transmetimit dhe, nëse ekzistojnë, sistemet e komutimit ose rrugëzimit dhe burime të tjera, të cilat lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjetet satelitore, rrjetet fikse, me komutim të qarqeve ose me komutim të paketave, përfshirë internetin, rrjetet e lëvizshme tokësore, sistemet e kabllave elektrike në raste kur ato përdoren për transmetimin e sinjaleve, rrjetet e përdorura për transmetimet audiovizive dhe rrjetet kabllore televizive, pavarësisht nga tipi i informacionit të përcjellë.

37. “Sponsorizim” është çdo kontribut i bërë nga një person juridik publik ose privat ose nga një person fizik, i cili nuk është i përfshirë në ofrimin e shërbimeve audiovizive ose në prodhimin e veprave audiovizive, për të financuar shërbimet ose programet e medias audiovizive, me qëllim për të promovuar emrin, markën, imazhin, veprimtaritë ose prodhimet e atij personi juridik ose fizik.

38. “Shërbim i transmetimit audio” është një shërbim transmetimi, i cili përhap ose shpërndan lajme, audio, shenja ose sinjale, me qëllim marrjen e tyre të drejtpërdrejtë nga publiku i gjerë.

39. “Shërbim i transmetimit publik” përfshin shërbimet pa pagesë të transmetimit të RTSH-së.

40. “Shërbim programi audioviziv” është një tërësi programesh audiovizive të çdo lloji dhe që përhapet ose shpërndahet drejtpërsëdrejti ose jo për marrjen nga publiku i gjerë.

41. “Shërbime të mbrojtura” janë:

a) shërbime të transmetimit audio dhe/ose audiovizive dhe shërbime të shoqërisë së informacionit që ofrohen për qëllime fitimi mbi bazën e aksesit të kushtëzuar;

b) ofrimi i aksesit të kushtëzuar për shërbimet e cituara në shkronjën “a” të kësaj pike.

42. “Shërbimet audiovizive, sipas kërkesës” janë shërbimet jolineare mediatike audiovizive të ofruara nga ofruesi i shërbimit mediatik në momentin e zgjedhur nga përdoruesi, në bazë të kërkesës së tij, mbështetur në një katalog programi të ofruar për këtë qëllim nga ofruesi i shërbimit mediatik.

43. “Shërbimi mediatik audioviziv” është një shërbim nën përgjegjësinë editoriale të një operatori të shërbimit mediatik, qëllimi kryesor i të cilit është ofrimi i programeve informuese, argëtuese ose edukuese, për publikun e gjerë, nëpërmjet rrjeteve të komunikimit elektronik. Një shërbim i tillë mediatik audioviziv është ose një transmetim televiziv ose një shërbim mediatik audioviziv, sipas kërkesës dhe/ose një komunikim tregtar audioviziv, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

44. “Shërbimi televiziv me ekran të gjerë” është një shërbim televiziv që konsiston tërësisht ose pjesërisht në programe të prodhuara për t’u shfaqur në një format me ekran të gjerë. Format i referencë për shërbimin e televizionit me ekran të gjerë është formati 16:9.

45. “Teleshitje” janë programet e transmetuara, që përbëjnë një ofertë të drejtpërdrejtë për publikun për shitjen apo sigurimin e mallrave, shërbimeve ose pasurive të tjera të paluajtshme apo pronësisë intelektuale.

46. “Transmetim jolinear” është ofrimi i shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv për marrje, sipas kërkesës individuale dhe në momentin e zgjedhur nga përdoruesit.

47. “Transmetim linear” është ofrimi i shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv për marrje të njëkohshme të tyre nga dëgjuesit dhe/ose shikuesit.

48. “Transmetim pa pagesë” është transmetimi, për marrjen e të cilit nuk i paguhet tarifë subjektit që e siguron këtë shërbim.

49. “Transmetimet komunitare” janë transmetimet audio për komunitetin, të ofruara jo për qëllime fitimi, të veçanta nga shërbimi i transmetimit publik dhe privat, që ofrohen sipas përcaktimeve të këtij ligji, për zhvillimin social dhe përmbushjen e interesave të komunitetit.

Konsiderohen si transmetime komunitare transmetimet audio të posaçme, të dedikuara vetëm për personat me mangësi të pjesshme ose të plotë shikimi.

50. “Transmetimi televiziv” është transmetimi linear i një shërbimi audioviziv, i siguruar nga OSHMA për shikimin e njëkohshëm të programeve, mbi bazën e një skeme programesh.

51. “Vendosje e produktit” është çdo formë e komunikimeve me natyrë tregtare audio dhe/ose audiovizive, që përfshijnë ose i drejtohen një malli, shërbimi ose marke tregtare, që shfaqet ose përmendet në një transmetim, përkundrejt pagesës ose përfitimeve të tjera të ngjashme.

52. “Vepra europiane” janë:

a) veprat që e kanë origjinën në shtetet anëtare të Bashkimit Europian;

b) veprat që e kanë origjinën në shtete, të cilat janë palë në Konventën Europiane për Televizionin Ndërkufitar të Këshillit të Europës, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 8525, datë 9.9.1999 “Për ratifikimin e konventës europiane për televizionin ndërkufitar” dhe që plotësojnë kushtet e përcaktuara në shkronjën “c” të kësaj pike;

c) veprat e përmendura në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike janë vepra të prodhuara kryesisht nga autorë dhe me punonjës që e kanë rezidencën e tyre në një nga shtetet anëtare të përmendura në shkronjën “a” dhe “b” të kësaj pike dhe që plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:

i) janë prodhuar nga një ose më shumë prodhues të themeluar në një ose më shumë nga këto shtete;

ii) prodhimi i veprave mbikëqyret dhe kontrollohet efektivisht nga një ose më shumë prodhues të themeluar në një ose më shumë nga këto shtete;

iii) kontributi i bashkëprodhuesve të këtyre shteteve, në koston totale të prodhimit të përbashkët, është dominues dhe bashkëprodhimi kontrollohet nga një ose më shumë prodhues të themeluar në këto shtete;

ç) veprat e bashkëprodhuara në kuadër të marrëveshjeve që lidhen me sektorin e transmetimeve audio dhe/ose audiovizive, të përfunduara ndërmjet Bashkimit Europian dhe shteteve të treta dhe që plotësojnë kushtet e përcaktuara në këto marrëveshje;

d) veprat, të cilat nuk janë evropiane, në kuptimin e shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, por që janë prodhuar, në kuadër të marrëveshjeve dypalëshe për prodhim të përbashkët, të përfunduara ndërmjet shteteve anëtare të Bashkimit Europian dhe shteteve të treta, konsiderohen vepra europiane, kur bashkëprodhuesit nga Bashkimi Europian ofrojnë pjesën më të madhe të kostove të prodhimit dhe kur prodhimi nuk kontrollohet nga një ose më shumë prodhues të vendosur jashtë territorit të shteteve anëtare të Bashkimit Europian.

53. “Zonë mbulimi me transmetim radioteleviziv” është territori, në të cilin intensiteti i sinjalit përmbush kërkesat e cilësisë së marrjes së sinjalit, të përcaktuar në aktet ndërkombëtare mbi transmetimet radiotelevizive.

Neni 4

Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive

1. Transmetimet audiovizive zhvillohen mbi bazën e këtyre parimeve:
 - a) veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë;
 - b) veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut. Kjo veprimtari respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve;
 - c) veprimtaria e transmetimeve audiovizive nuk lejohet të cenojë rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin kombëtar;
 - ç) veprimtaria e transmetimeve audiovizive siguron informim objektiv dhe të paanshëm të publikut, duke paraqitur në mënyrë të saktë faktet dhe ngjarjet, si dhe duke respektuar formimin e lirë të opinionit;
 - d) veprimtaria e transmetimeve audiovizive garanton të drejtën e çdo shtetasi për të marrë shërbime të transmetimeve audio dhe/ose audiovizive, të ofruara për publikun nga operatorët e shërbimeve audiovizive, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Operatorët e shërbimit audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen edhe nga këto parime:
 - a) garantimi i lirisë së shprehjes;
 - b) garantimi i së drejtës së informimit;
 - c) ruajtja e sekretit të burimeve të informacionit;
 - ç) respektimi dhe garantimi i së drejtës së ruajtjes së jetës private.
 - d) moslejimi i transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve;
 - dh) moslejimi i transmetimeve që nxisin ose justifikojnë dhunën;
 - e) garantimi i së drejtës së përgjigjes;
 - ë) garantimi i së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të;
 - f) respektimi i fqinjësisë së mirë midis popujve;
 - g) respektimi i standardit letrar të gjuhës shqipe.

Neni 5

Liria e marrjes dhe e ritransmetimit

Shqipëria siguron lirinë e marrjes dhe të ritransmetimit nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian dhe të shteteve të treta europiane, palë të Konventës Europiane për Televizionin Ndërkufitar të Këshillit të Europës dhe, në raste të veçanta, mund të kufizojë lirinë e transmetimit të këtyre shërbimeve vetëm në bazë të kësaj marrëveshjeje ndërkombëtare dhe të këtij ligji.

KREU II

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE (AMA)

Neni 6

Statusi i AMA-s

1. AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. AMA është person juridik publik, i pavarur, me seli në Tiranë.
3. AMA vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 7

Papajtueshmëritë dhe konflikti i interesave

1. Anëtarë të AMA-s nuk mund të jenë individët që:

a) janë anëtarë të partive dhe shoqatave politike, kandidojnë për deputet apo janë zgjedhur të tillë gjatë 2 legjislativave të fundit, kanë konkurruar për kryetar të njësisë vendore në zgjedhjet e fundit të organizuara për to apo kanë ushtruar detyrën e kryetarit të bashkisë, anëtarit të Këshillit të Ministrave apo të prefektit gjatë 3 vjetëve të fundit, si dhe ata që janë anëtarë të Këshillit të Ankesave, AKEP-it apo punonjës të këtij të fundit;

b) janë persona të lidhur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” ose që kanë në pronësi pjesë kapitali apo aksione të shoqërive tregtare, si dhe të drejta të tjera në fushën e transmetimeve audiovizive, reklamës, prodhimeve të përmbajtjes së transmetimeve audiovizive, rrjeteve të komunikimit elektronik apo persona të punësuar gjatë vitit të fundit, anëtarë të organeve drejtuese apo këshilluese të këtyre subjekteve apo të lidhur me ndonjë licencë me këto subjekte.

2. Anëtarët e AMA-s duhet të deklarojnë:

a) çdo interes apo lidhje me ndonjë subjekt të licencuar nga AMA;

b) çdo interes të mundshëm në ndonjë licencë, që AMA ka dhënë ose synon të japë, si dhe nuk mund të marrin pjesë në diskutimin apo vendimmarrjen e çështjeve të lidhura me këta interesa apo lidhje, që përbëjnë raste për skualifikim, sipas nenit 37 të Kodit të Procedurave Administrative.

3. AMA harton dhe miraton një kod sjelljeje, lidhur me rregullimin e veprimtarisë së saj për çështjet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, si dhe miraton kodet e të njëjtit lloj për administratën e AMA-s dhe bordeve që mund të ngrejë.

4. Anëtarët e AMA-s nuk lejohet të shprehen ose të mbajnë qëndrime publike që cenojnë paanshmërinë e tyre, në raport me interesat e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

5. Anëtarët e AMA-s duhet të mos influencohen financiarisht apo politikisht dhe duhet të veprojnë gjatë gjithë kohës për të përmbushur dhe thelluar objektivat e AMA-s.

Neni 8

Përbërja e AMA-s

1. AMA përbëhet nga Kryetari, Zëvendëskryetari dhe 5 anëtarë.

2. Kandidat për t’u zgjedhur anëtar i AMA-s mund të jetë çdo person, i cili ka përvojë pune jo më pak se 10 vjet në fushat e:

a) medias në përgjithësi;

b) transmetimeve audiovizive të shërbimit publik, tregtar ose jotregtar;

c) prodhimit të përmbajtjes së transmetimeve audiovizive;

ç) teknologjive të medias;

d) ekonomisë, administrimit dhe rregullave të konkurrencës;

dh) çështjeve të zhvillimit të gjuhës shqipe;

e) çështjeve që lidhen me personat me aftësi të kufizuara e grupeve të tjera vulnerabël;

ë) artit, kulturës e muzikës;

f) drejtësisë, ligjit, administrimit publik;

g) shkencës, mjedisit dhe zhvillimit teknologjik;

gj) mbrojtjes së konsumatorit;

h) veprimtarive shoqërore, edukuese dhe zhvillimit të bashkësive lokale, publike e kombëtare, të cilat kanë lidhje ose ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi qëllimet e veprimtarisë audiovizive, siç përcaktohet në këtë ligj.

3. Kryetari dhe Zëvendëskryetari i AMA-s janë me kohë të plotë. Paga e Kryetarit, e Zëvendëskryetarit dhe shpërblimi i 5 anëtarëve të tjerë caktohet në përputhje me ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të pavarura të krijuara me ligj”.

Neni 9

Zgjedhja e anëtarëve të AMA-s

1. Anëtarët e AMA-s zgjidhen nga Kuvendi për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

2. Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, brenda 30 ditëve nga krijimi i një vendi vakant, fton, me anë të mjeteve të informimit publik, për paraqitjen e kandidaturave, subjektet e mëposhtme:

- a) shoqatat dhe grupimet e mediave elektronike;
- b) shoqatat e medias së shkruar;
- c) profesoratin dhe shoqatat e inxhinierisë elektrike dhe elektronike;
- ç) profesoratin e së drejtës, gazetari-komunikimit dhe ekonomisë, shoqatat e juristëve dhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë;
- d) organizatat jofitimprurëse që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të drejtave të fëmijëve ose kërkimeve në politikat publike, ose përfaqësues të shoqatave që veprojnë në fushën e mbrojtjes së personave me aftësi të kufizuara.

Subjektet e mësipërme propozojnë kandidaturat brenda 30 ditëve nga marrja e ftesës.

3. Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik bën përzgjedhjen, sipas përcaktimeve të neneve 7 dhe 8 të këtij ligji, mes të paktën 4 kandidaturave për çdo vend anëtar të AMA-s.

4. Për përzgjedhjen e kandidaturave alternative për çdo vend anëtar të AMA-s, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik zbaton procedurën e mëposhtme:

- a) shqyrton të gjitha kandidaturat e paraqitura nga subjektet propozuese;
- b) kandidaturat e administruara, në bazë të propozimeve të mësipërme, i nënshtrohen përjashtimit një nga një. Procedura e përjashtimit zbatohet sipas radhës: një nga përfaqësuesit e shumicës parlamentare dhe një nga përfaqësuesit e opozitës.

Në çdo rast komisioni mban parasysh ruajtjen e balancës, tre kandidatë të mbështetur nga shumica parlamentare, tre të mbështetur nga opozita. Kandidatët për anëtarë të AMA-s i propozohen për miratim seancës plenare.

Përjashtimi i çdo kandidature duhet të argumentohet duke garantuar respektimin e parimit të moscenimit të integritetit personal dhe profesional të kandidatëve.

5. Pas përfundimit të mandatit, anëtar i AMA-s, qëndron në detyrë deri në zgjedhjen e anëtarit të ri.

Neni 10

Zgjedhja e Kryetarit të AMA-s

1. Anëtar i shtatë dhe njëkohësisht Kryetari i AMA-s zgjidhet jo më vonë se 10 ditë pasi të ketë përfunduar procedura e zgjedhjes së anëtarëve të AMA-s, sipas nenit 9 të këtij ligji.

2. Jo më vonë se 30 ditë para datës së mbarimit të mandatit të Kryetarit të AMA-s, Kuvendi i Shqipërisë publikon shpalljen për vendin vakant të Kryetarit të AMA-s. Çdo shtetas që plotëson kushtet e nenit 7 dhe 8 të këtij ligji mund të paraqitet si kandidat për Kryetar të AMA-s. Kërkesa paraqitet e shoqëruar me dokumentacionin përkatës që provon përmbushjen e kriterëve ligjorë për anëtar të AMA-s.

3. Lista e kandidatëve i kalon Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik për të verifikuar përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në këtë ligj. Në këtë listë nuk mund të

përfshihen ose, nëse janë përfshirë, përjashtohen kandidatët e propozuar për anëtarë të AMA-s, sipas pikës 4 të nenit 9 të këtij ligji. Komisioni, pas verifikimit të kandidaturave, zbaton procedurën si më poshtë:

- a) komisioni identifikon katër kandidatët që kanë marrë mbështetjen më të madhe midis anëtarëve të komisionit. Çdo anëtar i komisionit mund të mbështesë deri në katër kandidatë;
- b) nëse dy apo më shumë kandidatë gëzojnë të njëjtën mbështetje, përzgjedhja e tyre bëhet me short;
- c) përfaqësuesit e pakicës parlamentare në komision përjashtojnë dy nga katër kandidatët e përzgjedhur. Kandidatët e mbetur i kalojnë Kuvendit për votim;
- ç) Kryetar i AMA-s zgjidhet kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të deputetëve të Kuvendit.

Neni 11

Zëvendëskryetari i AMA-s

1. AMA zgjedh si Zëvendëskryetar një nga anëtarët e AMA-s, të zgjedhur mbi bazën e mbështetjes së propozimit të opozitës, sipas pikës 4 të nenit 9 të këtij ligji.
2. Zgjedhja zhvillohet me votim të fshehtë, sipas procedurës së mëposhtme:
 - a) në një fletë votimi shkruhen emrat e tre anëtarëve të AMA-s, sipas pikës 1 të këtij neni;
 - b) secili prej anëtarëve voton, duke bërë shënimin përkatës, për një nga emrat që janë në fletëvotim;
 - c) anëtari që ka marrë 5 vota zgjidhet Zëvendëskryetar i AMA-s;
 - ç) në rast se asnjë prej kandidatëve nuk ka marrë numrin e kërkuar të votave bëhet një raund i dytë votimi. Anëtari që merr më shumë vota në raundin e dytë zgjidhet Zëvendëskryetar i AMA-s. Votimi zhvillohet brenda së njëjtës ditë.
3. Mbledhja për zgjedhjen e Zëvendëskryetarit, kur mungon Kryetari, drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë i AMA-s dhe procedura e zgjedhjes zhvillohet në prani të një noteri.

Neni 12

Lirimi nga detyra

1. Kryetari, Zëvendëskryetari dhe çdo anëtar i AMA-s lirohet nga detyra nga organi që e zgjedh kur:
 - a) dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - b) bëhet i paaftë përgjithmonë për kryerjen e detyrës për shkaqe shëndetësore;
 - c) mungon pa arsye në më shumë se një të tretën e mbledhjeve të AMA-s, brenda 1 viti;
 - ç) vërtetohet se janë shkelur detyrimet e nenit 7 të këtij ligji;
 - d) i hiqet zotësia për të vepruar;
 - dh) jep dorëheqjen.
2. Lirimi nga detyra i një anëtari të AMA-s mund të kërkojë nga Komisioni i Edukimit dhe Mjetet e Informimit Publik ose nga jo më pak se 5 anëtarë të AMA-s. Kuvendi e shqyrton kërkesën brenda 10 ditëve.
3. Para se të lirohet një anëtar i AMA-s, atij i jepet mundësia për të parashtruar pretendimet e tij para Komisionit të Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik. Vendimi për të liruar Kryetarin, Zëvendëskryetarin, një anëtar ose më shumë se një anëtar duhet të jetë i bazuar në ligji dhe i arsyetuar për shkaqet që çojnë në lirin e tyre. Vendimi i Kuvendit publikohet.
4. Kryetari, Zëvendëskryetari dhe çdo anëtar i AMA-s mund të japë dorëheqjen me shkrim në çdo kohë. Dorëheqja i paraqitet AMA-s në mbledhjen e radhës dhe i dërgohet Kuvendit sa më parë.
5. Kur konstatohet njëri nga rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, Kryetari i AMA-s njofton me shkrim brenda 5 ditëve Kuvendin.

6. Në çdo rast lirimi zgjidhet një zëvendësues, duke ndjekur procedurën e parashikuar për zgjedhjen dhe për një kohë të barabartë me kohën që i kishte mbetur pararendësit që u lirua.

Neni 13

Kuorumi dhe vendimmarrja

1. Mbledhjet e AMA-s janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se 4 anëtarë.
2. Vendimet e AMA-s merren kur për to votojnë pro shumica e anëtarëve të pranishëm, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj.
3. Mbledhjet e AMA-s mbahen sipas rregullores së brendshme dhe thirren në bazë të programit të miratuar paraprakisht nga Kryetari ose të paktën 3 anëtarë.
4. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë dhe votimi nuk ka qenë i fshehtë, vota e Kryetarit është vendimtare.
5. Procedurat e vendimmarrjes, zbatimi i tyre dhe thirrja e mbledhjeve jashtë radhe hartohen sipas dispozitave të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe janë pjesë e rregullores së brendshme. Rregullorja propozohet nga Kryetari dhe miratohet nga AMA me shumicë të cilësuar.

Neni 14

Kompetencat e Kryetarit të AMA-s

1. Kryetari është drejtues i AMA-s dhe ka përgjegjësi, sipas përcaktimeve të nenit 8 të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
2. Kryetari ushtron këto detyra kryesore:
 - a) organizon, bashkërendon e drejton mbledhjet dhe veprimtarinë e AMA-s. Në bashkëpunim me sekretarin e përgjithshëm, drejton veprimtarinë e administratës së AMA-s, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e AMA-s;
 - b) i propozon AMA-s tematikën e mbledhjeve, rendin e ditës, problemet që do të shqyrtohen së bashku me projektvendimet e relacionet përkatëse;
 - c) përfaqëson AMA-n në marrëdhëniet me të tretët dhe me organizatat ndërkombëtare;
 - ç) raporton në Kuvend për veprimtarinë vjetore të AMA-s.
3. Në zbatim të detyrave të veta, Kryetari nxjerr urdhra dhe udhëzime në përputhje me rregulloren e brendshme.
4. Në mungesë të Kryetarit ose në bazë të delegimit, funksionet e tij i kryen Zëvendëskryetari.

Neni 15

Organizimi dhe administrata e AMA-s

1. Pranë AMA-s vepron administrata e saj, e cila realizon të gjithë veprimtarinë e nevojshme, përgatitore e administrative. Kriteret e punësimit dhe ngritjes në detyrë bëhen nga AMA, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8549, dt. 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.
2. Struktura dhe organika e AMA-s propozohen nga ky institucion dhe miratohen nga Kuvendi.
3. Administrata e AMA-s drejtohet nga sekretari i përgjithshëm.
4. Sigurimet shoqërore, pensionet suplementare, si dhe privilegjet e tjera ligjore në fuqi për institucionet e të njëjtit nivel zbatohen edhe për administratën e AMA-s.

Neni 16

Sekretari i përgjithshëm i AMA-s

1. Sekretari i përgjithshëm i AMA-s është nëpunësi më i lartë civil në administratën e AMA-s, përgjigjet para tij për funksionimin e kësaj administrate dhe ka përgjegjësi menaxheriale të nëpunësit të autorizuar, sipas përcaktimeve të nenit 9 të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

2. Sekretari i përgjithshëm ushtron funksionet e tij sipas udhëzimeve dhe drejtimit të përcaktuar nga AMA dhe përgjigjet para tij për mënyrën e zbatimit të tyre.

3. Sekretari i përgjithshëm mund të delegojë disa nga funksionet e veta te ndonjë nëpunës i administratës, sipas nevojës dhe vlerësimit të tij, përveç kur kjo nuk është e mundur.

4. Sekretari i përgjithshëm për zgjidhet nga AMA në bazë të kandidaturave fituese të një kandidimi publik, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

Neni 17

Detyrat e sekretarit të përgjithshëm

Sekretari i përgjithshëm përgjigjet për:

a) mbarëvajtjen e menaxhimit të burimeve financiare të AMA-s, regjistrimin e llogarive dhe kontrollin dhe raportet e bëra në këtë drejtim nga Kontrolli i Lartë i Shtetit;

b) sistemin, procedurat dhe praktikatat e vlerësimit për realizimin e efikasitetit financiar të AMA-s në ushtrim të funksioneve të veta;

c) çdo çështje që lidhet apo prek veprimtarinë e AMA-s, e paraqitur në raportin vjetor të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që ky i fundit paraqet në Kuvend;

ç) çdo çështje, që lidhet me shpenzimin e fondeve të akorduara nga Buxheti i Shtetit për financimin e projekteve të veçanta;

d) çështjet e administrimit të burimeve njerëzore dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil.

Neni 18

Objektivat e veprimtarisë së AMA-s

1. AMA, në ushtrimin e funksioneve të veta, siguron:

a) që të gjitha shërbimet audiovizive të përmbushin sa më mirë nevojat e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar gjuhën dhe larminë e traditave, besimeve fetare, kulturës dhe moralit të qytetarëve;

b) ruajtjen dhe mbështetjen e vlerave demokratike të përcaktuara në Kushtetutë, veçanërisht lirinë e shprehjes dhe të medias;

c) ofrimin e shërbimeve të shumëllojshme dhe pa pagesë.

2. AMA nxit:

a) promovimin e programeve të shumëllojshme dhe pa pagesë;

b) sigurimin e shumëllojshmërisë dhe cilësisë së lartë të programeve dhe me risi nga OSHMA-të publike e private;

c) përmbushjen e objektivave nga transmetuesit e shërbimit publik, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

ç) rritjen e shumëllojshmërisë së shërbimeve audiovizive;

d) realizimin e një mjedisi rregullator, që lehtëson zhvillimin e sektorit të transmetimeve audiovizive në Shqipëri dhe që është i përgjegjshëm për nevojat e dëgjuesve e shikuesve dhe në veçanti për personat me nevoja të veçanta shqisore;

dh) zhvillimin e shërbimeve të transmetimit dhe programeve në gjuhën shqipe.

3. AMA, në ushtrimin e funksioneve të tij, siguron që marrja e masave përkatëse:

- a) të jetë në përpjesëtim me objektivat e përcaktuar në këtë nen;
- b) të miratojë rregullore që synojnë zhvillim të qëndrueshëm për OSHMA-të;
- c) të mundësojë dhe të nxisë zhvillimin teknologjik dhe zbatimin e tij në sektorin e transmetimit.

Neni 19

Funksionet e AMA-s

1. Funksionet kryesore të AMA-s janë:
 - a) shqyrtimi i propozimeve dhe aplikimeve për ushtrimin e shërbimeve të transmetimit, përfshirë aplikimet për transmetime numerike dhe dhënia e autorizimeve ose licencave përkatëse, në përputhje me këtë ligj, përfshirë shërbimet e ofruara nga RTSH-ja;
 - b) lëshon dhe heq licencat dhe/ose autorizimet me shumicë të cilësuar;
 - c) garantimi i konkurrencës së ndershme, duke siguruar njëkohësisht zhvillimin e mëtejshëm të RTSH-së;
 - ç) bashkëpunimi me Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorit për garantimin e mbrojtjes së konsumatorëve në fushën e mediave elektronike, në rastin e praktikave të pandershme të OSHMA-ve dhe të ofrimit të shërbimeve me çmime abuzive;
 - d) hartimi i strategjive për ofrimin e shërbimeve të transmetimit në Republikën e Shqipërisë;
 - dh) mbikëqyrja e zbatimit të kontratës së shërbimit të lidhur me RTSH-në;
 - e) hartimi dhe miratimi i kodit dhe rregulloreve të transmetimit audioviziv dhe akteve të tjera nënligjore, në zbatim të këtij ligji;
 - ë) hartimi dhe miratimi i rregulloreve për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencave dhe/ose autorizimeve, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
 - f) përcaktimi i pagesave për licencat;
 - g) përgatitja dhe nxjerrja e udhëzimeve për RTSH-në, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të tij;
 - gj) përcaktimi i kriterëve dhe masave rregulluese për bashkëpërdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH-së;
 - h) zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis ofruesve të shërbimeve të transmetimeve audio ose audiovizive, përfshirë mosmarrëveshjet me transmetuesin publik;
 - i) bashkëpunimi me ministrin për hartimin e Planit Kombëtar të Frekuencave;
 - j) bashkëpunimi dhe këshillimi me AKEP-in, Autoritetin e Konkurrencës, Zyrën e të Drejtave të Autorit dhe organet e tjera në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.
2. AMA, përveç funksioneve të mësipërme:
 - a) mbledh, administron dhe publikon informacion për sektorin e mediave audiovizive në Republikën e Shqipërisë, përfshirë teknologjinë e aplikuar;
 - b) ndjek zhvillimin e veprimtarisë së mediave audiovizive në nivel ndërkombëtar;
 - c) realizon, organizon, mbështet dhe promovon kërkimin, në lidhje me çështjet e mediave audiovizive;
 - ç) bashkëpunon me organet e tjera, përfshirë organet përfaqësuese brenda sektorit të mediave audiovizive, për të ndihmuar veprimtaritë trajnuese në sektorin e mediave audiovizive;
 - d) bashkëpunon me organet homologe të shteteve të tjera;
 - dh) ndërmer, nxit dhe kujdeset për kërkimin dhe veprimtaritë përkatëse, që kanë të bëjnë me rolin e medias, duke përfshirë bashkëpunimin me transmetuesit dhe subjektet e tjera të fushës;
 - e) përmbush me efektivitet objektivat e përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji.
3. AMA kontrollon zbatimin e këtij ligji nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën objekt të këtij ligji dhe, në rast shkeljesh, vendos sanksione.
4. AMA monitoron tërësinë e programeve të transmetuara nga OSHMA-të.
5. AMA udhëzon OSHMA-të shqiptare për transmetime nga Shqipëria në drejtim të vendeve të tjera, në zbatim të akteve ndërkombëtare apo rajonale, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

6. AMA, për zbatimin e sanksioneve të përcaktuara në këtë ligj, bashkëpunon me organet e tjera publike, sipas kompetencës së tyre.

7. AMA kërkon nga administrata shtetërore, gjykatat, bankat dhe organizma të tjerë përkatës, si dhe nga titullarët e subjekteve të licencuar informacione, që i gjykon të nevojshme për të kontrolluar vërtetësinë e të dhënave të paraqitura nga aplikuesit. Këto të dhëna përdoren vetëm për zbatimin e detyrave të ngarkuara nga ky ligj. Përhapja dhe botimi i tyre nuk lejohet.

8. AMA jep mendim për perspektivën e veprimtarisë së mediave audiovizive, në bazë të kërkesës apo kryesisht.

9. AMA shpreh zyrtarisht propozimet e veta për nënshkrimin dhe zbatimin korrekt të marrëveshjeve ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me mediat audiovizive.

10. AMA merr pjesë në veprimtari ndërkombëtare, në lidhje me strategjinë dhe perspektivat e zhvillimit të mediave audiovizive, duke përfaqësuar Republikën e Shqipërisë dhe mbështet pjesëmarrjen e bashkëpunimin e subjekteve publike e private me organizata homologe europiane e botërore në fushën e mediave audiovizive. AMA përgatit studime me rekomandime për qëndrimin e Republikës së Shqipërisë në bisedimet ndërkombëtare zyrtare mbi mediat audiovizive.

11. AMA sugjeron ndryshime të legjislacionit dhe të rregulloreve, të cilat diktohen nga zhvillimi teknologjik, ekonomik, social dhe kulturor në fushën e mediave audiovizive.

12. AMA harton dhe miraton rregulloren e brendshme të administratës së saj.

13. AMA miraton projektbuxhetin e saj vjetor, shqyrton dhe miraton bilancin vjetor, si dhe raportin vjetor mbi veprimtarinë e saj përpara se t'i paraqitet Kuvendit.

14. AMA raporton në fillim të çdo viti për veprimtarinë vjetore të saj, zhvillimet në fushën e transmetimeve dhe mënyrën se si janë respektuar nga rrjeti publik dhe privat detyrimet, që rrjedhin nga ky ligj. Raportin e paraqet para Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe para Kuvendit në seancë plenare.

15. AMA kontrollon cilësinë e marrjes së sinjaleve në zonat e mbulimit dhe kërkon zgjidhje për ankesat e publikut për cilësinë e transmetimit të sinjaleve audiovizive.

16. AMA nxjerr vendime në zbatim të funksioneve të veta dhe të këtij ligji.

17. AMA i propozon Kuvendit strukturën organizative të institucionit.

18. AMA siguron shfrytëzimin me efektivitet të burimeve të financimit.

Neni 20

Këshilli i Ankesave

1. Këshilli i Ankesave caktohet nga AMA me shumicë të cilësuar dhe përbëhet nga kryetari dhe 2 anëtarë, specialistë të fushës së medias, të cilët emërohen për një periudhë 3-vjeçare, me të drejtë riemërimi jo më shumë se një herë.

2. Objekti i punës së Këshillit të Ankesave është mbikëqyrja e zbatimit të kodit dhe rregulloreve të miratuara nga AMA, që kanë të bëjnë sidomos me respektimin e dinjitetit e të drejtave të tjera themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e të miturve, të drejtës për informacion dhe sensibilizimit të opinionit publik, lidhur me respektimin e normave morale dhe etike në programet e ofruesve të shërbimeve audiovizive.

3. Funksionet kryesore të Këshillit të Ankesave, në përmbushje të objektit të punës së tij, janë:

a) të mbikëqyrë zbatimin e kodeve dhe rregulloreve nga OSHMA-të dhe RTSH-ja, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

b) të shqyrtojnë ankesat, sipas neneve 51, 52 dhe 53 të këtij ligji.

4. Për realizimin e funksioneve të tij, Këshilli i Ankesave mbështetet në strukturat e tjera të AMA-s.

5. Këshilli i Ankesave ndjek në mënyrë periodike masën, në të cilën programet e një transmetuesi të huaj, të cilët tërësisht ose kryesisht u drejtohen spektatorëve në Republikën e Shqipërisë ekskluzivisht për qëllime informative, përputhen me kodet e transmetimit.

6. Këshilli i Ankesave, me ekspertizë të pavarur, mund të organizojë anketime të publikut për problemet etike të programeve. Përfundimet që nxjerr nga studimi i anketimeve dhe nga ankesat e publikut ia raporton AMA-s, duke sugjeruar masat për përmirësim. Përfundimet mund të publikohen edhe në mjetet e informimit publik.

7. Çdo 6 muaj Këshilli i Ankesave boton një përmbledhje të përfundimeve të nxjerra, në bazë të pikës 6 të këtij neni, në një buletin të veçantë që botohet nga AMA.

8. Paga e anëtarëve të Këshillit të Ankesave përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mbulohet nga AMA.

Neni 21

Strategjia e AMA-s

1. AMA harton dhe miraton një strategji, ku pasqyron mënyrën e realizimit të funksioneve të veta ligjore.

2. Strategjia duhet:

a) të përfshijë qëllimet kryesore dhe aktivitetet në përmbushje të objektivave të AMA-s si dhe rrugët për arritjen e qëllimeve;

b) të përgatitet duke marrë në konsideratë edhe:

i) kërkesat e Kuvendit;

ii) sugjerimet e ministrit;

iii) sugjerimet e AKEP-it, Autoritetit të Konkurrencës dhe organeve të tjera;

c) të marrë parasysh nevojën për sigurimin e përdorimit sa më të frytshëm, të dobishëm dhe përfitues të burimeve të veta;

ç) të përfshijë një studim të frytshmërisë dhe dobishmërisë të strategjisë gjatë kohës së zbatimit të saj, duke përfshirë strategjinë e parë;

d) të miratohet, së pari, brenda 5 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe më tej çdo 3 vjet;

dh) të përfshijë një plan veprimi të AMA-s lidhur me numrin, qëllimin dhe natyrën e autorizimeve dhe/ose licencave, që propozon për të realizuar gjatë kohëzgjatjes që mbulon strategjia.

3. AMA, për përgatitjen e strategjisë, këshillohet me Këshillin e Ankesave.

4. Para miratimit të strategjisë, AMA ndërmerret një proces këshillimi publik me grupet e ndryshme të interesit, lidhur me projektin e strategjisë.

Neni 22

Roli i ministrit

1. Paraqet në Këshillin e Ministrave propozime për politika të zhvillimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike që mbështetin transmetimet audio dhe/ose audiovizive dhe ndjek zbatimin e tyre.

2. Propozon akte ligjore e nënligjore për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike që mbështetin transmetimet audio dhe/ose audiovizive.

3. Paraqet në Këshillin e Ministrave për miratim Planin Kombëtar të Frekuencave, si dhe punon për harmonizimin e këtij plani me politikat ndërkombëtare të zhvillimit të spektrit të frekuencave.

4. Ndjek zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga traktatet ndërkombëtare, ku aderon Republika e Shqipërisë për rrjetet e komunikimeve elektronike, që mbështetin transmetimet audio dhe/ose audiovizive.

Neni 23

Kompetencat e AMA-s

1. Për realizimin në mënyrë të plotë të funksioneve të saj, AMA ka këto kompetenca:
 - a) lëshon licenca dhe/ose autorizime;
 - b) u kërkon mbajtësve të licencave dhe/ose autorizimeve realizimin e detyrimeve financiare ndaj AMA-s;
 - c) siguron zbatimin e kushteve të licencave dhe/ose autorizimeve të lëshuara prej saj;
 - ç) ndërmerr, mbështet apo autorizon studime.
2. AMA, për realizimin e funksionimit të saj, administron fondet e veta sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 24

Financimi i AMA-s

1. Burimet e financimit të AMA-s janë:
 - a) të ardhurat nga pagesat për marrjen dhe rinovimin e licencave dhe/ose autorizimeve;
 - b) të ardhurat nga pagesat vjetore të licencave dhe/ose autorizimeve;
 - c) të ardhurat nga përpunimi administrativ i kërkesave për aplikime;
 - ç) të ardhurat nga tarifat për shërbimet e transmetimeve të caktuara në ligjet fiskale, në rolin e agjentit tatimor;
 - d) financime nga Buxheti i Shtetit;
 - dh) burime të tjera të ligjshme.
2. AMA merr financim nga Buxheti i Shtetit në rastet kur vlerëson se disa shpenzime janë të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të saj, të një natyre të veçantë dhe për të cilat nuk ekziston mundësi tjetër financimi.

Neni 25

Caktimi i pagesave

1. Me qëllim mbulimin e shpenzimeve të nevojshme për realizimin e funksioneve të veta, AMA cakton me vendim të veçantë të gjitha pagesat për licencat dhe/ose autorizimet e ofruesve të transmetimeve audio dhe shërbimeve të programeve audiovizive, shërbimet e tjera, si dhe pagesat për përpunimin administrativ.
2. Pagesat përcaktohen në bazë të parimit të objektivitetit, transparencës, jodiskriminimit dhe proporcionalitetit. Ato ndryshojnë për shërbimin publik, atë tregtar, transmetuesit lokalë dhe për kategoritë e ndryshme të licencave dhe/ose autorizimeve. Licencat për radiot e komunitetit përjashtohen nga pagesat.
3. Vendimi për caktimin e pagesave duhet të përcaktojë mënyrën e mbledhjes, pagimit, administrimit, duke përfshirë:
 - a) metodën e përlogaritjes së pagesës përkatëse;
 - b) kohën dhe formën e realizimit të pagesës;
 - c) mënyrën e regjistrimit të pagesave dhe mbikëqyrjes së tyre.
4. Pagesa për marrjen e licencave ose autorizimit bëhet në momentin e marrjes së licencës ose autorizimit. Pagesat vjetore kryhen brenda tremujorit të parë të çdo viti kalendarik.
5. Çdo tepriçë nga të ardhurat nga pagesat, që mbetet nga shpenzimet përkatëse funksionale të AMA-s, në përfundim të vitit financiar, mbahet në llogaritë e AMA-s, përfshihet në planin e shpenzimeve të vitit pasardhës dhe mbahet parasysht në rishikimin e pagesave përkatëse vjetore për licencë.
6. AMA bën rishikimin periodik të këtyre pagesave për të reflektuar koston e vet administrative.
7. Vendimi për caktimin e pagesave botohet në Fletoren Zyrtare.

Neni 26
Llojet e pagesave

Llojet e pagesave janë:

- a) pagesë për marrje licence dhe/ose autorizimi;
- b) pagesë vjetore për licencë dhe/ose autorizim;
- c) pagesë për përpunim aplikimi, dokumentacioni, ndryshime në licencë dhe/ose autorizim.

Neni 27
Administrimi i llogarive dhe kontrollit financiar

1. AMA mban llogarinë e të ardhurave dhe shpenzimeve në përputhje me legjislacionin shqiptar të kontabilitetit.
2. AMA publikon në faqen e saj zyrtare elektronike një pjesë ose të gjitha shpenzimet dhe të ardhurat.

Neni 28
Raportimi

1. AMA raporton në Kuvend, jo më vonë se data 31 mars i çdo viti, për mënyrën e përmbushjes së funksioneve dhe veprimtarive të veta për vitin paraardhës, përfshirë raportimin për realizimin e planit financiar.
2. Raporti vjetor duhet të përfshijë informacion mbi zhvillimin e transmetimeve në drejtim të personave me nevoja të veçanta shqisore dhe veçanërisht zhvillimin e arritur për qëllimet e përcaktuara në rregulloren e transmetimit.
3. Raporti vjetor duhet të përfshijë të dhënat për pjesëmarrjen e anëtarëve të AMA-s në mbledhjet e vitit të kaluar.
4. AMA, përveç raportit vjetor, mund të paraqesë raporte në lidhje me funksionet e veta, në bazë të kërkesës së Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Neni 29
Vlerësimi i efekteve në tregun e transmetimeve

1. AMA vlerëson rezultatet e zhvillimit në fushën e transmetimeve audio dhe/ose audiovizive dhe shqyrton masën në të cilën zhvillimi i transmetimeve prek:
 - a) cilësinë, shkallën e mbulimit me shërbime dhe llojet e tyre, si dhe mundësinë e zgjedhjes së shërbimeve nga shikuesit dhe dëgjuesit;
 - b) shpërndarjen e shërbimeve në fushën e transmetimeve;
 - c) efektet e zhvillimeve teknologjike, risive dhe investimeve në këtë fushë;
 - ç) tregjet e lidhura me transmetimet;
 - d) çështje të tjera që AMA i vlerëson të arsyeshme për këtë qëllim.
2. AMA analizon periodikisht efektet e ndryshme në tregun e transmetimeve, me qëllim ushtrimin sa më të përshtatshëm të funksioneve të veta rregullatore. Për këtë qëllim AMA mund të bashkëpunojë me institucionet përkatëse publike dhe me ofruesit e shërbimeve mediatike.

KREU III
KUSHTET DHE DETYRIMET PËR SHËRBIMET E TRANSMETIMIT

Neni 30

**Ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive
në juridiksionin e Republikës së Shqipërisë**

1. Ofruesi i shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv është në juridiksionin e Republikës së Shqipërisë kur zyra apo struktura drejtuese e tij është në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe vendimmarrja editoriale për shërbimet audio dhe/ose audiovizive realizohet brenda këtij territori.

2. Kur zyra apo struktura drejtuese e tij është në territorin e Republikën e Shqipërisë, por vendimmarrja editoriale për shërbimet audio dhe/ose audiovizive realizohet në një vend të Bashkimit Europian, presumohet se ofruesi i shërbimeve mediatike është në juridiksionin e Republikës së Shqipërisë, me kusht që pjesa më e madhe e personelit të angazhuar në aktivitetet e shërbimeve audio dhe/ose audiovizive veprojnë në Shqipëri.

3. Kur një pjesë e konsiderueshme e personelit të angazhuar në aktivitetet e shërbimeve audio dhe/ose audiovizive vepron në Republikën e Shqipërisë dhe në një vend të BE-së, ofruesi i shërbimit mediatik presumohet se është i vendosur në Republikën e Shqipërisë, nëse selia e tij qendrore është në Republikën e Shqipërisë.

4. Kur një pjesë e konsiderueshme e personelit të angazhuar në aktivitetet e shërbimeve audio dhe/ose audiovizive nuk vepron as në Republikën e Shqipërisë dhe as në një shtet anëtar të BE-së, ofruesi i shërbimit mediatik presumohet se është i vendosur në Republikën e Shqipërisë, nëse aktiviteti i tij ka filluar për herë të parë në këtë vend, në përputhje me legjislacionin shqiptar, me kusht që ai të mbajë lidhje të qëndrueshme dhe efektive me ekonominë shqiptare.

5. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për ato shërbime mediatike audio dhe/ose audiovizive që, pavarësisht se nuk përfshihen në pikat 1 e 2 të këtij neni:

- a) përdorin një lidhje satelitore nga territori i Republikës së Shqipërisë;
- b) nuk përdorin një lidhje satelitore nga territori i Republikës së Shqipërisë, por përdorin burime e hapësira të transmetimeve satelitore që i përkasin Republikës së Shqipërisë.

6. Kur një ofrues i shërbimit mediatik ka selinë qendrore në Republikën e Shqipërisë, por vendimet për shërbimet mediatike audio dhe/ose audiovizive merren në një vend të tretë, ose anasjelltas, ofruesi presumohet se është i vendosur në Republikën e Shqipërisë, me kusht që pjesa më e madhe e krahut të punës të përfshirë në aktivitetet e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive punon në Republikën e Shqipërisë.

7. Nëse juridiksioni nuk mund të përcaktohet sipas pikave 2 deri në 6 të këtij neni, vendi anëtar kompetent do të jetë ai në të cilin ndodhet OSHMA-ja, sipas kuptimit të neneve 49 dhe 50 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian dhe shteteve të tij anëtare.

Në datën e aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, çështja e juridiksionit, sipas pikës 6 të këtij neni, do të zgjidhet sipas neneve 49 deri 55 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.

Neni 31

Llojet e ofruesve të shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive

1. OSHMA-të klasifikohen sipas formës së pronësisë mbi kapitalin e qëllimin e veprimtarisë, si dhe mënyrës së shpërndarjes së sinjalit e mbulimit përkatës të territorit.

2. OSHMA-të mund të jenë:

- a) sipas formës së pronësisë mbi kapitalin dhe qëllimin e veprimtarisë, shërbime publike, private, tregtare ose jotregtare;

- b) sipas mënyrës së shpërndarjes, tokësore, satelitore, me kablo, TV në internet, ose në ndonjë formë tjetër;
- c) sipas mbulimit të territorit, kombëtarë, rajonalë, lokalë ose ndërkufitarë.

Neni 32

Rregulla të përgjithshme për ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive

1. OSHMA-të sigurojnë që marrësi i shërbimit të informohet për:
 - a) emrin e ofruesit të shërbimit mediatik;
 - b) adresën e qendrës së tij;
 - c) detajet e kontaktit, përfshirë adresën elektronike ose faqen e vet elektronike;
 - ç) kur është e mundur organet rregullatore ose mbikëqyrëse të ofruesve të shërbimit mediatik.
2. OSHMA-të i bëjnë lehtësisht të arritshme në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të përhershme marrësit të shërbimit shenjë identifikuese.
3. Ofruesit e shërbimit të transmetimit audio e bëjnë lehtësisht të arritshme në intervalet kohore të përcaktuara nga AMA emrin e ofruesit të shërbimit audio.
4. OSHMA-të nuk transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo formë tjetër diskriminimi.
5. Shërbimet e transmetimeve audiovizive marrin parasysh nevojat e personave me nevoja të veçanta shqisore.
6. OSHMA-të duhet të transmetojnë programet, përfshirë veprat kinematografike, në përputhje me kushtet dhe afatet për të cilat kanë nënshkruar marrëveshje me mbajtësit e të drejtave të këtyre veprave.

Neni 33

Detyrimet e OSHMA-ve

1. Ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv duhet:
 - a) të njoftojë dhe të paraqesë lajmet e transmetuara në një mënyrë të vërtetë, të paanshme dhe objektive;
 - b) të sigurojë që trajtimi i ngjarjeve, përfshirë çështjet, që janë tema të debatit publik, të jetë i drejtë për gjitha subjektet e interesuara në këto çështje dhe të paraqitet në mënyrë të vërtetë dhe të paanshme;
 - c) t'i kushtojë hapësirën e nevojshme në transmetim çështjeve të aktualitetit lokal;
 - ç) të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut;
 - d) të respektojë rregullat e etikës dhe moralit publik dhe të mos transmetojë programe që mund të nxisin vepra penale;
 - dh) të mos cenojë të drejtën e fshehtësisë së jetës private të individit në çdo program të transmetuar nga OSHMA-të dhe mjetet e përdorura për të realizuar këto programe;
 - e) të mos transmetojë programe pornografike pa siguruar mbrojtjen e të miturve nëpërmjet pajisjeve të aksesit të kushtëzuar dhe kontrollit prindëror;
 - ë) të respektojë të drejtat e autorit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të;
 - f) të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit;
 - g) të paraqesë bilancin vjetor pranë AMA-s jo më vonë se data 30 prill e çdo viti.
2. Përcaktimet e shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni nuk e ndalojnë OSHMA-në të transmetojë veprimtaritë e forcave politike. OSHMA-ja, gjatë kohës së këtij transmetimi, nuk duhet të shfaqë anshmëri politike.

Neni 34

Informacionet që transmetohen pa shpërblim

1. AMA përcakton me rregullore mesazhet me interes të lartë për publikun e gjerë, të cilat OSHMA-të detyrohen t'i transmetojnë pa shpërblim.
2. Organet e pushtetit dhe të administratës shtetërore vendore kanë të drejtë t'u kërkojnë OSHMA-ve të transmetojnë pa shpërblim komunikata të shkurtra, që paraqesin interes të veçantë për publikun e zonave ku ato transmetojnë dhe që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit, fatkeqësitë natyrore dhe njerëzore, rendin publik dhe sigurinë kombëtare.
3. Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive nuk mbajnë përgjegjësi për përmbajtjen e këtyre mesazheve.

Neni 35

Promovimi i veprave europiane

1. OSHMA-të u rezervojnë veprave europiane, shumicën e kohës së tyre të transmetimit, duke përjashtuar kohën e caktuar për lajmet, ngjarjet sportive, lojërat, reklamat, shërbimet e teletekstit dhe të shitjeve të drejtpërdrejta në televizion.
2. Kjo kohë, sipas pikës 1 të këtij neni, arrihet në mënyrë graduale duke marrë në konsideratë përgjegjësitë informuese, edukuese, kulturore dhe zbavitëse që ka OSHMA-ja ndaj publikut.
3. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen për transmetimet televizive, të cilët i drejtohen audiencës lokale dhe që nuk janë pjesë e rrjetit kombëtar.

Neni 36

Promovimi i punëve të pavarura

1. OSHMA-të rezervojnë për promovimin e punëve të pavarura:
 - a) të paktën 10 për qind të kohës së tyre të transmetimit, duke përjashtuar kohën e caktuar për lajmet, ngjarjet sportive, lojërat, reklamat, shërbimet e teletekstit dhe të shitjeve të drejtpërdrejta në televizion;
 - b) të paktën 10 për qind të buxhetit të tyre të programimit, për punë shqiptare dhe europiane, të krijuara nga prodhues që janë të pavarur nga transmetuesit.
2. OSHMA-të e arrijnë përqindjen, sipas pikës 1 të këtij neni, në mënyrë progresive:
 - a) duke marrë në konsideratë përgjegjësitë informuese, edukuese, kulturore dhe zbavitëse që ata kanë ndaj publikut që i shikon; dhe
 - b) duke përcaktuar një përqindje të përshtatshme për punët europiane të kohëve të fundit, që do të thotë punët e transmetuara brenda 5 viteve nga prodhimi i tyre.
3. Ky nen nuk zbatohet për transmetimet televizive, të cilat i drejtohen audiencës lokale dhe që nuk janë pjesë e rrjetit kombëtar.

Neni 37

Regjistrimi i transmetimeve

1. OSHMA-ja, me mjetet e pajisjet e veta dhe në një mënyrë të përcaktuar për këtë qëllim nga AMA, duhet të mbajë katalogun e programeve dhe të regjistrojë çdo transmetim apo program të ofruar prej tij, në përputhje me licencën.
2. Regjistrimet e bëra në përputhje me pikën 1 të këtij neni duhet të ruhen nga OSHMA-ja për një periudhë 3-mujore.
3. Në rastet e shqyrtimit të një ankese, sipas përcaktimeve të nenit 52 të këtij ligji, regjistrimi i transmetimit, me të cilin lidhet ankesa, si dhe regjistrimi, që vlerësohet se ka lidhje me të, duhet t'i paraqitet nga OSHMA-ja Këshillit të Ankesave, në bazë të kërkesës së këtij të fundit, brenda një periudhe të caktuar prej tij.

4. Mbajtja e regjistrimeve, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, nuk duhet të shkelë kërkesat e ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, për arkivat dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU IV KOMUNIKIMET AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIVE ME NATYRË TREGTARE DHE REKLAMAT

Neni 38

Format e reklamave

1. Në programet audio dhe/ose audiovizive të OSHMA-ve mund të ndërfiten këto forma reklamash:

- a) reklamë e zakonshme;
- b) reklamë e zgjeruar;
- c) reklama në ekran të ndarë;
- ç) reklamë e fshehtë;
- d) reklamë ndërvepruese;
- dh) reklamë virtuale;

2. Reklama e zgjeruar duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

- a) të identifikohet si i tillë përgjatë gjithë kohës së transmetimit të saj;
- b) nuk mund të transmetohet prej orës 19⁰⁰ deri në orën 23⁰⁰.

3. Reklama në ekran të ndarë duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

- a) nuk mund të mbulojë më shumë se një të tretën e hapësirës së ekranit;
- b) hapësira e saj nuk duhet të ndryshojë.
- c) duhet të jetë lehtësisht e identifikueshme si e tillë dhe qartësisht e ndarë në ekran;
- ç) OSHMA-të mund të ndërpusin reklama në ekran të ndarë në transmetimet e prodhuara nga prodhues të pavarur ose prodhues të tjerë, vetëm në bazë të lejes përkatëse të mbajtësve të të drejtave të këtyre prodhimeve;
- d) llogaritet në kohën e përgjithshme të transmetimit të reklamave.

4. Ndërfutja e reklamave virtuale duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

a) OSHMA-ja duhet të informojë për qenien e reklamave virtuale në transmetimin përkatës në fillim dhe në fund të këtij transmetimi;

b) OSHMA-ja nuk mund të ndërpusë reklama virtuale pa miratimin paraprak të organizuesit të ngjarjes, prodhuesit të programit ose autorit të tij;

c) organizuesi i ngjarjes nuk mund të ndërpusë reklama virtuale pa miratimin paraprak të OSHMA-së, i cili ka marrë të drejtën e transmetimit të ngjarjes;

ç) reklamat virtuale nuk mund të vendosen ose të shfaqen duke përdorur persona fizikë;

d) reklamat virtuale mund të vendosen vetëm në hapësira që përdoren normalisht për reklamim. Gjatë ndeshjeve sportive, reklamat virtuale mund të vendosen edhe në pjesën e fushës së lojës jashtë kohës që zhvillohet loja në këtë fushë.

5. Përdorimi i përmbajtjes së reklamës ndërvepruese duhet të paraprihet nga një paralajmërim, që duhet të shfaqet në ekran dhe të njoftojë përdoruesin se po del nga transmetimi për të hyrë në reklamën ndërvepruese. Kufizimet, lidhur me sasinë dhe kohëzgjatjen e reklamave, nuk zbatohen për reklamat ndërvepruese.

6. Dritaret e shitjeve të drejtpërdrejta zgjasin minimalisht 15 minuta. Nuk mund të ketë më shumë se 8 dritare shitjesh të drejtpërdrejta në ditë. Kohëzgjatja e përgjithshme e transmetimit të tyre nuk mund të jetë më shumë se 3 orë në ditë. Këto dritare shitjesh të drejtpërdrejta duhet të dallohen nga përmbajtja e pjesës tjetër të transmetimit si të tilla nëpërmjet mënyrave të përshtatshme zanore e pamore.

7. Rregullat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni nuk zbatohen për programet, që transmetojnë tërësisht shitje të drejtpërdrejta. Në këto programe ndërfutja e reklamave i nënshtrohet rregullave të përgjithshme për këtë qëllim të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 39

Reklama politike

(ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 91/2017, datë 22.5.2017)

1. Reklama konsiderohet politike në rastet kur:
 - a) përkrah interesat e partive politike, grupeve politike ose udhëheqësve politikë, në kërkim të qëllimeve politike;
 - b) ndikon mbi një ndryshim ligjor;
 - c) ndikon mbi një vendim politik ose administrativ;
 - ç) ndikon mbi një formim të opinionit të publikut, në lidhje me çështje politike të diskutueshme.
2. Reklama konsiderohet politike në rastet kur porositesit e saj janë:
 - a) partitë politike dhe institucionet;
 - b) organizatat që synojnë të përkrahin dhe ndërmarrin veprimtari politike;
 - c) organizatat, platformat dhe kolektivat të cilët përkrahin një ndryshim ligjor ose normativ me qëllim që të mbrojnë objektivat e tyre;
 - ç) çdo person ose grup tjetër të cilët përkrahin një projekt të veçantë ose program politik.
3. Gjatë periudhës zgjedhore transmetimi i reklamave politike bëhet sipas dispozitave të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar.

Neni 40

Reklama institucionale

1. Reklama konsiderohet institucionale në rastet kur objekti i vetëm i kësaj reklame është ofrimi i informacionit mbi shërbimet e institucioneve publike.
2. Nxitja e drejtpërdrejtë ose jo e konfuzionit, në lidhje me identifikimin e institucioneve me tiparet e partive politike, nuk lejohet.
3. Gjatë periudhës zgjedhore transmetimi i reklamave institucionale bëhet sipas dispozitave të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 41

Reklammat dhe shitjet e drejtpërdrejta

1. Transmetimi i një i programi në një shërbim transmetimi mund të përfshijë ndërfutjen e reklamave dhe shitjeve të drejtpërdrejta. Kohëzgjatja e reklamave ose shitjeve të drejtpërdrejta nuk duhet të kalojë 12 minuta për një orë transmetim. Këtu nuk përfshihen njoftimet e OSHMA-së, në lidhje me programet e veta dhe produktet ndihmëse për këto programe, njoftimet për sponsorizimin dhe vendosjen e mallrave në programe.
2. OSHMA-ja nuk lejohet të transmetojë reklama me qëllime politike ose që kanë lidhje me një konflikt gjyqësor.
3. Ofruesi i shërbimit mediatik nuk duhet të transmetojë reklama që i drejtohen një besimi fetar të caktuar, ose që kanë për qëllim reklamimin e një besimi fetar apo anëtarësimin në një organizatë fetare.
4. Përcaktimi në pikën 2 të këtij neni nuk e ndalon OSHMA-në të paraqesë veprimtaritë e subjekteve politike, nëse OSHMA-ja, gjatë kohës së këtij transmetimi, nuk shfaq ndonjë parapëlqim për ndonjë forcë të caktuar politike.

5. Përcaktimi në pikën 3 të këtij neni nuk e ndalon OSHMA-në të njoftojë se një gazetë, revistë ose periodik fetar ka dalë në shitje apo në qarkullim, si dhe se do të zhvillohet një veprimtari ose ceremoni, që ka lidhje me një besim të caktuar.

6. Përcaktimet në pikën 2 të këtij neni nuk zbatohen për reklamat e transmetuara në rastin e fushatës zgjedhore, sipas përcaktimit të Kodit Zgjedhor.

7. Përcaktimi i reklamës, sipas këtij neni, përfshin transmetimin e programeve të sponsorizuara, si dhe programet e përgatitura për qëllime reklamuese apo nga një subjekt reklamues.

Neni 42

Komunikimet me natyrë tregtare

1. Komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive duhet të jenë qartësisht të dallueshme si të tilla. Komunikimet me natyrë tregtare të fshehura janë të ndaluara.

2. Komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive nuk lejohet të përdorin mënyra të joshjes së shikuesve në mënyrë të pandërgjegjshme dhe teknika për sugjestionimin e tyre.

3. Komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive nuk lejohet:

a) të prekin dinjitetin njerëzor;

b) të përfshijnë ose të mbështesin diskriminimin në bazë seksuale, race ose origjine etnike, kombësie, moshe, besimi, feje, paafësie ose orientimi seksual;

c) të nxisin sjelljen e dëmshme për shëndetin dhe sigurinë fizike të individëve;

ç) të nxisin sjelljen apo veprimet e dëmshme për mbrojtjen e mjedisit.

4. Të gjitha format e komunikimeve me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive për cigaret dhe produktet e tjera të duhanit janë të ndaluara.

5. Komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive për pijet alkoolike nuk lejohet t'u drejtohen veçanërisht fëmijëve, duhet të shmangin ndjekjen e tyre nga të miturit dhe nuk duhet të nxisin përdorimin e tepruar të tyre për të rriturit;

6. Komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive për produktet farmaceutike apo produktet dhe trajtimet mjekësore, që jepen vetëm me recetën e mjekut, janë të ndaluara.

7. Komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive duhet të parandalojnë shkaktimin e dëmeve morale dhe fizike për të miturit, si dhe të mos i ekspozojnë ata në mënyrë abuzive në situata të rrezikshme për ta. Për këtë ato nuk duhet të nxisin apo të shtyjnë të miturit të blejnë apo të marrin prodhime ose shërbime, duke i nxitur drejtpërsëdrejti për të kërkuar nga prindërit ose të tjerë persona të afërm t'u marrin mallrat apo shërbimet e reklamuar, ose të shfrytëzojnë pozitën e fëmijëve në raport me prindërit, mësuesit ose persona të tjerë të afërm të tyre.

8. Shërbimet e transmetimeve audiovizive duhet të hartojnë dhe zbatojnë kode sjelljeje në lidhje me komunikimet e papërshtatshme me natyrë tregtare në transmetimet e tyre, që shoqërojnë ose përfshihen në programet për të mitur, të ushqimeve dhe pijeve, që përmbajnë substanca të dëmshme ose të padobishme për shëndetin fizik të të miturve, veçanërisht ato me përmbajtje të lartë yndyre, acide yndyrore, kripe, sode e sheqeri, që janë tej normave të lejuara për një dietë ushqimore të shëndetshme për të miturit, sipas orientimeve të AMA-s.

Neni 43

Kushtet për reklamat dhe shitjet e drejtpërdrejta

1. Reklama dhe shitjet e drejtpërdrejta duhet të jenë të dallueshme dhe të veçanta nga përmbajtja tjetër që është nën përgjegjësinë editoriale dhe të veçohen nga pjesa tjetër e përmbajtjes së programit edhe kur mund të transmetohen njëkohësisht, nëpërmjet mënyrave pamore dhe/ose zanore dhe/ose ndarjes së hapësirës së tyre në ekran.

2. Spotet e reklamave dhe shitjeve të drejtpërdrejta të izoluar mund të lejohen vetëm në programet sportive.

3. Transmetimi i filmave, veprave kinematografike dhe programeve të reja mund të ndërpritet nga reklama ose shitje të drejtpërdrejta jo më shpesh se çdo 30 minuta. Këtu nuk përfshihen serialet dhe dokumentarët.

4. Transmetimi i programeve për të miturit mund të ndërpritet nga spote reklamash ose shitjesh të drejtpërdrejta jo më shpesh se çdo 30 minuta, nëse kohëzgjatja e programit është më shumë se 30 minuta.

5. Nuk lejohet ndërputja e reklamave ose shitjeve të drejtpërdrejta gjatë programeve me natyrë fetare.

6. Ndalohe shitet e drejtpërdrejta për barnat, produktet farmaceutike dhe shërbimet mjekësore.

7. Reklammat dhe shitjet e drejtpërdrejta për pijet alkoolike duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

a) nuk duhet t'u drejtohen të miturve ose t'i paraqesin të miturit duke i konsumuar këto pije;

b) nuk duhet të lidhin në asnjë lloj mënyre përdorimin e alkoolit me drejtimin e automjeteve apo të përmendin rritjen e aftësive fizike të përdoruesve për shkak të përdorimit të këtyre produkteve;

c) nuk duhet të krijojnë në asnjë lloj mënyre ndjesinë se përdorimi i alkoolit ndikon në sjelljen e suksesshme shoqërore apo seksuale të përdoruesve të tij;

ç) nuk duhet të pretendojnë ose të krijojnë idenë se alkooli ka cilësi shëruese apo rigjeneruese ose se është mjet nxitës, qetësues ose që ndihmon për zgjidhjen apo lehtësimin e konflikteve personale;

d) nuk duhet të nxisin përdorimin e papërshtatshëm të alkoolit ose të paraqesin mospërdorimin e alkoolit në një këndvështrim negativ;

dh) nuk duhet të theksojnë përqindjen e lartë të alkoolit në një pije si cilësi pozitive të kësaj pijeje.

8. Ndërfutja e reklamave dhe shitjeve të drejtpërdrejta në programet audiovizive bëhet duke respektuar tërësinë e përmbajtjes dhe duke pasur parasysh, që ndërprerjet të jenë të natyrshme gjatë kohëzgjatjes dhe natyrës së programit dhe të respektojnë të drejtat e palëve të interesuara.

9. Dritaret e shitjeve të drejtpërdrejta në ekranin e integruar ose programet e tyre duhet të identifikohen qartë si të tilla nëpërmjet mënyrave pamore ose dëgjimore dhe duhet të zgjasin minimalisht 15 minuta.

10. Për shërbimet e programeve të dedikuara reklamimit, shitjeve të drejtpërdrejta, si dhe vetëreklamimit, kërkesat e këtij ligji aplikohen sipas parimit *mutatis mutandis*.

Neni 44

Vendosja e produkteve gjatë programeve

1. Vendosja e produkteve gjatë programeve, si një mënyrë e fshehur dhe abuzive e komunikimit me natyrë tregtare, është e ndaluar, përveçse në filma, vepra kinematografike, seriale të prodhuara për shërbimet e transmetimit mediatik, programeve sportive dhe atyre me natyrë zbavitëse.

2. Përjashtimi i bërë në pikën 1 të këtij neni nuk është i vlefshëm për çfarëdo programi për të mitur.

3. Programet që përmbajnë vendosjen e mallrave duhet të plotësojnë këto kushte:

a) përmbajtja e tyre dhe listimi i programeve nuk duhet të ndikohen në asnjë rrethanë në një mënyrë të tillë, që të prekë përgjegjësinë dhe pavarësinë editoriale të ofruesit të shërbimit mediatik;

b) nuk duhet të nxisin drejtpërdrejt marrjen ose përdorimin e mallrave dhe shërbimeve, veçanërisht duke bërë përmendje të posaçme promovionale të këtyre mallrave dhe shërbimeve;

- c) nuk duhet t'i kushtojnë vëmendje të tepruar mallrave në fjalë;
 - ç) shikuesit duhet të informohen qartë për ekzistencën e vendosjes së mallit.
4. Programet që përmbajnë vendosjen e produkteve duhet të identifikohen qartë në fillim, gjatë tij ose në përfundim të programit dhe kur programi përfundon pas një pushimi reklamash, në mënyrë që të shmangin çdo çoroditje të shikuesve.
5. Programet në asnjë rast nuk mund të përmbajnë vendosjen e produkteve:
- a) të prodhimeve të duhanit, cigareve apo vendosje të produkteve nga shoqëri, persona apo sipërmarrje, veprimtaria kryesore e të cilave është prodhimi dhe tregtimi i cigareve dhe prodhimeve të duhanit;
 - b) të prodhimeve farmaceutike, barnave, ose trajtimeve mjekësore që jepen vetëm me recetën e mjekut.

Neni 45

Sponsorizimi i shërbimeve të transmetimeve

1. Shërbimet e sponsorizuara të transmetimit audio dhe audioviziv duhet të plotësojnë këto kërkesa:
 - a) përmbajtja e tyre dhe listimi i programeve nuk duhet në asnjë rast të ndikohen në një mënyrë të tillë, që të prekin përgjegjësinë dhe pavarësinë editoriale të shërbimit mediatik;
 - b) nuk duhet të nxisin drejtpërsëdrejti blerjen apo porositjen e mallrave apo shërbimeve, veçanërisht duke bërë përmendje të posaçme promocionale për këto mallra e shërbime;
 - c) shikuesit duhet të informohen në mënyrë të qartë për marrëveshjen e sponsorizimit, mbi të cilën mbështetet programi. Programet e sponsorizuara duhet të identifikohen qartë nga emri, stema dhe/ose simbole të tjera të subjektit sponsorizues, si nëpërmjet një shenje të dallueshme në fillim, gjatë tij ose në përfundim të programit.
2. Shërbimet e transmetimit audioviziv nuk mund të sponsorizohen nga shoqëri, persona apo sipërmarrje, veprimtaria kryesore e të cilave është prodhimi apo tregtimi i cigareve apo prodhimeve të tjera të duhanit.
3. Sponsorizimi i shërbimeve të transmetimit audio dhe audioviziv ose programeve nga shoqëri, persona ose sipërmarrje, veprimtaria kryesore e të cilave përfshin prodhimin ose shitjen e barnave, produkteve farmaceutike dhe shërbimeve mjekësore, mund të përmendë vetëm emrin ose të tregojë stemën ose imazhe të tjera të tipit përfaqësues të subjektit sponsorizues, por nuk mund të reklamojë barna, prodhime të veçanta farmaceutike ose shërbime të caktuara mjekësore që jepen vetëm me recetën e mjekut.
4. Lajmet dhe programet informative që lidhen me politikën nuk mund të sponsorizohen.
5. Ndalohet shfaqja e shenjave të sponsorizimit gjatë transmetimit të programeve për të mitur, dokumentarëve dhe programeve që kanë lidhje me besimin fetar.

KREU V

KODI DHE RREGULLORET

Neni 46

Kodi i transmetimit

1. AMA përgatit dhe rishikon, në bazë të nevojës, kodin për rregullat, standardet dhe praktikatat e transmetimit, sipas përcaktimeve të këtij neni.
2. Kodi i transmetimit siguron që:
 - a) të gjitha lajmet e transmetuara të njoftohen dhe të paraqiten në mënyrë objektive dhe të paanshme;
 - b) trajtimi i ngjarjeve, përfshirë çështjet që janë tema të debatit publik, të jetë i drejtë për të gjitha subjektet e interesuara në këto çështje dhe të paraqitet në mënyrë objektive e të paanshme;

c) OSHMA-të të mos transmetojnë programe që cenojnë rregullat e etikës dhe moralit publik, që mund të nxisin vepra penale apo të cenojnë autoritetin e shtetit;

ç) në programet e transmetuara nga OSHMA-të të mos cenohet e drejta e fshehtësisë së jetës private të personit;

d) OSHMA-të të mos shfaqin njëanshmëri për ndonjë forcë politike gjatë ndarjes së kohës të transmetimit për veprimtaritë e subjekteve politike;

dh) në çështjet që përfshijnë moralin dhe etikën në materialet programore, veçanërisht paraqitja e sjelljeve të dhunshme dhe seksuale të realizohet me kujdesin e duhur ndaj ndjeshmërisë të publikut dhe efekteve të programeve të tilla në zhvillimin moral, mendor e fizik të të miturve. OSHMA-të nuk lejohet të transmetojnë programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor, ose moral të të miturve, në veçanti programe që përmbajnë pornografi ose që paraqesin skena dhune të skajshme dhe artificiale. OSHMA-të nuk lejohet të shfaqin programe të tjera që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor dhe moral të të miturve, përveç rasteve kur sigurohet, duke zgjedhur orarin e transmetimit ose ndonjë masë tjetër teknike, që të miturit normalisht nuk i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime. Kur programe të tilla transmetohen në formë të hapur ato duhet të paraprihen nga një paralajmërim akustik ose të identifikohen nga prezenca e një simboli viziv gjatë gjithë kohëzgjatjes së tyre;

e) reklamat, shitjet e drejtpërdrejta, materialet e shitjeve të drejtpërdrejta, sponsorizimet dhe format e tjera të paraqitjes tregtare, të përdorura në çdo shërbim transmetimi, veçanërisht ato që lidhen me çështje që mund të jenë drejtpërsëdrejti ose jo në interes të të miturve, duhet të ruajnë interesin e tyre, duke pasur kujdes të veçantë për shëndetin e tyre;

ë) reklamat, shitjet e drejtpërdrejta, materialet e shitjeve të drejtpërdrejta, sponsorizimet dhe format e tjera të paraqitjes tregtare, të përdorura në çdo shërbim transmetimi, të ndryshme nga ato të përcaktuara në shkronjën “e” të kësaj pike, të ruajnë interesat e shikuesve dhe të dëgjuesve;

f) shërbimi i transmetimit, i cili ka për qëllim parësor mbështetjen e interesave të një organizate, të ruajë interesat e shikuesve e të dëgjuesve;

g) të zbatohen kërkesat e neneve 42-46 të këtij ligji.

3. Në përgatitjen apo rishikimin e kodit të transmetimit, AMA duhet të mbajë parasysh:

a) shkallën e dëmit së shkaktuar nga paraqitja e ndonjë lloj materiali në programe përgjithësisht ose në programe të një natyre të caktuar;

b) masën dhe përbërjen e audiencës së mundshme për programet audiovizive në shërbimet e transmetimit në përgjithësi ose të një natyre të caktuar;

c) natyrën e përmbajtjes së programit dhe shkallën e njoftimit të publikut të mundshëm lidhur me këtë natyrë;

ç) vullnetin për të siguruar që përmbajtja e transmetimeve të përputhet me ndryshimet përkatëse në kodin e transmetimeve, në rastin kur kryhen këto ndryshime;

d) vullnetin e sigurimit të pavarësisë së kontrollit editorial mbi përmbajtjen e programeve.

4. Kodi i transmetimit, i miratuar nga AMA mund të ndalojë reklamat e kategorive të veçanta të ushqimeve dhe pijeve që konsiderohen se janë të dëmshme për të miturit, veçanërisht ato me përmbajtje të lartë yndyre, sheqeri, kripe etj. Në përgatitjen e kodit të transmetimit, AMA duhet të këshillohet paraprakisht me autoritetet përkatëse të shëndetit publik.

5. Në kodin e transmetimit, AMA përcakton në mënyrë të veçantë:

a) standardet e programit;

b) kërkesat për reklamat drejtuar të miturve;

c) kërkesat për reklamat;

ç) kërkesat për implementimin e promovimit progresiv të veprave europiane dhe veprave të pavarura;

d) kërkesat për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 47

Rregulloret e transmetimit

1. AMA, në përputhje me kërkesat e neneve 43-46 të këtij ligji miraton rregulloren për:
 - a) kohën ditore të lejuar për transmetimin e reklamave dhe shitjeve të drejtpërdrejta, materialeve të shitjeve të drejtpërdrejta në një shërbim transmetimi, sipas kushteve të përcaktuara në licencë dhe/ose autorizim;
 - b) kohën maksimale të lejuar në një orë transmetimi të reklamave dhe shitjeve të drejtpërdrejta, materialeve të shitjeve të drejtpërdrejta në një shërbim transmetimi, sipas kategorive të ndryshme të shërbimeve të transmetimit;
 - c) masat e veçanta, që ofruesi i shërbimit mediatik duhet të ndërmarrë për të realizuar marrjen nga personat që kanë një shkallë të caktuar paaftësie dëgjimi ose shikimi të programeve të transmetuara.
2. Rregulloret e transmetimit, lidhur me kërkesat e pikës 1 të këtij neni, duhet të përcaktojnë për çdo OSHMA sigurimin e shërbimeve të tilla si:
 - a) gjuha e shenjave;
 - b) shërbimet e teletekstit;
 - c) titrimin dhe përshkrimin me zë;
 - ç) të kenë parasysh, që materialet e sipërpërmendura të transmetohen në mënyrë periodike gjatë ditës, në intervale të rregullta, gjatë kohës së shikueshmërisë maksimale dhe sidomos për programet e lajmeve dhe veprimtarive, si dhe për programe të tjera.
3. Rregullat e përcaktuara në pikën 1 shkronja “c” të këtij neni mund të kërkojnë që një përqindje e caktuar e programeve në një shërbim transmetimi të angazhojnë mjete të veçanta, nëpërmjet të cilave marrja e këtyre shërbimeve nga personat e përcaktuar në këtë pikë të jetë e kënaqshme.
4. AMA rishikon rregulloren e transmetimit, lidhur me përcaktimet e pikës 1 shkronja “c” të këtij neni, minimalisht çdo vit.

Neni 48

Këshillimi publik

1. AMA, në procesin e përgatitjes së dokumenteve rregullatore, sipas kërkesave të këtij ligji, dhe përpara marrjes së vendimeve, të cilat kanë një ndikim të ndjeshëm në ofrimin e shërbimeve audio dhe audiovizive, është i detyruar të marrë dhe të vlerësojë mendimin e palëve të interesuara nëpërmjet këshillimit publik.
2. Në procesin e këshillimit publik, AMA publikon dokumentet rregullatore të propozuara dhe kërkon paraqitjen me shkrim të mendimit të palëve të interesuara, brenda një afati kohor të publikuar, i cili nuk duhet të jetë më pak se 30 ditë.
3. Në rast se AMA e gjykon të nevojshme, kryen edhe seancë dëgjimore, ku ftohen palët e interesuara për të parashtruar mendimin për dokumentet rregullatore të propozuara.
4. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni dhe para miratimit të dokumenteve rregullatore, AMA duhet të publikojë mendimet dhe komentet e palëve të interesuara, duke respektuar konfidencialitetin e informacionit.

Neni 49

Paraqitja e kodit dhe rregulloreve

1. Kodi dhe rregulloret e transmetimit të miratuara publikohen në faqen zyrtare të internetit të AMA-s.
2. AMA raporton për efektet e kodit dhe rregulloreve të transmetimit të miratuara në raportin vjetor për Kuvendin.

Neni 50

Bashkëpunimi me subjekte të tjera

1. AMA mund të bashkëpunojë, të mbështesë ose të nxisë një ose më shumë subjekte të specializuara brenda dhe jashtë vendit për përgatitjen e standardeve të përmbajtjes së transmetimeve.

2. AMA bashkëpunon me institucione të tjera publike, sipas fushës së kompetencës përkatëse të secilit, lidhur me përpilimin e përmbajtjes së standardeve të detajuar në kodin dhe rregulloret e transmetimit.

3. AMA mund të angazhojë veç administratës së vet dhe Këshillit të Ankesave dhe ekspertë të pavarur.

4. AMA bashkëpunon me Zyrën e të Drejtave të Autorit dhe me organet që mbrojnë të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të.

KREU VI

ANKIMI

Neni 51

Procedurat për trajtimin e ankesave

1. OSHMA-ja është e detyruar të shqyrtojë çdo ankesë të arsyetuar të paraqitur me shkrim nga çdo person për programet e transmetuara prej tij, lidhur me zbatimin e kërkesave të nenit 33 të këtij ligji, mbi cilësinë e shërbimit të ofruar ose përmbushjen e detyrimeve kontraktore për shërbimet me abonim.

2. Ankesa i paraqitet OSHMA-së jo më vonë se 30 ditë nga data e transmetimit, ose kur në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëra-tjetrën, nga data e transmetimit më të fundit.

3. Çdo OSHMA duhet të përgatisë dhe të zbatojë procedura të caktuara për trajtimin e ankesave. Këto procedura duhet të parashikojnë:

- a) mënyrën dhe vendin e paraqitjes së ankesës;
- b) afatin, brenda të cilit transmetuesit duhet të kthejnë përgjigje;
- c) mënyrën e zgjidhjes së ankesës përkatëse.

4. OSHMA-ja duhet të publikojë në faqen e vet të internetit apo të bëjnë publike në ndonjë mënyrë tjetër procedurat e trajtimit të ankesave, të hartuara në përputhje me udhëzimet e Këshillit të Ankesave.

5. Këshilli i Ankesave përgatit dhe publikon udhëzimet për OSHMA-të, me qëllim realizimin e përcaktimeve të pikës 3 të këtij neni.

6. OSHMA-ja paraqet informacionin e kërkuar nga pika 3 e këtij neni në Këshillin e Ankesave. Ky informacion mund të publikohet në faqen e internetit të AMA-s.

7. OSHMA-ja mban ankesat e bëra sipas pikës 1 të këtij neni dhe përgjigjet e tyre për një periudhë prej dy vjetësh nga data e regjistrimit të ankesës.

8. OSHMA-ja është e detyruar të lejojë inspektimin nga ana e Këshillit të Ankesave të regjistrimeve të mbajtura sipas pikës 7 të këtij neni.

Neni 52

Shqyrtimi i ankesave

1. Këshilli i Ankesave shqyrton çdo ankesë, lidhur me transmetimin e lajmeve dhe programeve në shkelje të kërkesave të nenit 33 të këtij ligji dhe rregulloreve të transmetimit të përcaktuara sipas nenit 47 të këtij ligji.

2. Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose kur në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëra-tjetrën, nga data e transmetimit më të vonë.

3. Këshilli i Ankesave, kur e çmon të nevojshme, ia kalon ankesën e paraqitur OSHMA-së për të paraqitur pretendimet e veta brenda 7 ditëve.

4. Pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të OSHMA-së, Këshilli i Ankesave, nëse çmon se ka shkelje, i propozon AMA-s masat përkatëse. Në çdo rast Këshilli i Ankesave njofton me shkrim personin që ka paraqitur ankesën dhe OSHMA-në përkatëse mbi konkluzionet dhe masat.

5. OSHMA-ja transmeton konkluzionin e Këshillit të Ankesave, kur ky konkluzion është në favor të personit që ka kryer ankesën, brenda 2 ditëve nga marrja e njoftimit, në një mënyrë të njëjtë me atë të realizimit të transmetimit, kundrejt të cilit është bërë ankesa.

6. Këshilli i Ankesave vendos lidhur me zgjidhjen e ankesës brenda një afati sa më të shkurtër. Gjatë procedurave të zgjidhjes së ankesës, Këshilli i Ankesave mund të vendosë organizimin e seancave dëgjimore me palët.

7. Kur një çështje ka qenë objekt i shumë ankesave të paraqitura, në bazë të këtij neni, ose për transmetime, që janë jashtë juridiksionit territorial të AMA-s, Këshilli i Ankesave, në qoftë se e konsideron të përshtatshme, i raporton AMA-s, lidhur me aspektet e saj dhe mënyrat e zgjidhjes.

Neni 53

E drejta e përgjigjes

1. Çdo person, dinjiteti dhe reputacioni i të cilit janë prekur nga publikimi i fakteve dhe informacioneve jo të sakta në një transmetim, ka të drejtën e përgjigjes.

2. AMA përgatit, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, një rregullore për ushtrimin e së drejtës së përgjigjes, pas një këshillimi publik, për këtë çështje.

3. Rregullorja përcakton procedurat që duhet të ndiqen për ushtrimin e së drejtës së përgjigjes, në mënyrë që:

a) përgjigjja të transmetohet brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës;

b) e drejta e përgjigjes duhet të paraqesë se në çfarë mase informacioni i paraqitur gjatë transmetimit është jo korrekt dhe mashtrues dhe të kufizohet në pohimin e fakteve të nevojshme për korrigjimin e fakteve apo informacioneve të pavërteta.

4. Personi që ushtron të drejtën e përgjigjes, në përputhje me rregulloren, duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim, drejtuar ofruesit përgjegjës të shërbimit mediatik, duke paraqitur arsyet dhe faktet që mbështetin kërkesën e tij.

5. Kërkesa për të drejtën e përgjigjes duhet të paraqitet tek OSHMA-ja brenda 10 ditëve nga transmetimi, të cilit i adresohet kjo kërkesë.

6. OSHMA-ja, brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës, vendos për ushtrimin ose refuzimin e së drejtës së përgjigjes dhe për këtë njofton me shkrim kërkuesin.

7. Nëse brenda afatit të përcaktuar në pikën 6 të këtij neni kërkuesi nuk merr një përgjigje, prezumohet se OSHMA-ja ka refuzuar kërkesën.

8. OSHMA-ja vë në dispozicion Këshillit të Ankesave regjistrimet e mbajtura në bazë të pikës 7 të nenit 51 të këtij ligji.

9. Për realizimin e kërkesave të ushtrimit të së drejtës së përgjigjes, OSHMA-ja nuk mund të aplikojë asnjë lloj tarife.

10. Këshilli i Ankesave, brenda 15 ditëve nga paraqitja e një ankese për refuzimin e së drejtës së përgjigjes nga një OSHMA, shqyrton çështjen dhe, nëse e gjen të drejtë ankesën e bërë, i kërkon OSHMA-së korrigjimin e fakteve dhe informacioneve, në lidhje me personin e interesuar, në një mënyrë të ngjashme dhe kohë të njëjtë me atë të transmetimit objekt ankese, brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit.

11. Në fillim të procedurës së shqyrtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave i kërkon OSHMA-së, të cilit i adresohet ankesa, dhënien e shpjegimeve në lidhje me këtë ankesë.

12. Këshilli i Ankesave i dërgon ankuesit dhe OSHMA-së përkatëse konkluzionet e arsyetuara për rastin.

13. Këshilli i Ankesave mund të refuzojë një ankesë kur:

- a) vlerëson se ajo është abuzive dhe e pabazuar, apo e bërë në keqbesim;
 - b) e drejta e kërkuar për përgjigje është opinion personal i personit dhe s'ka të bëjë me rregullimin e ndonjë lajmi me karakter fakti apo informacioni;
 - c) e drejta e kërkuar për përgjigje përmban parashtrimin e fakteve dhe informacioneve të rreme;
 - ç) e drejta e kërkuar për përgjigje është bërë për të kërkuar parandalimin e veprimeve të pritshme apo që s'kanë ndodhur ende;
 - d) përmbushja e së drejtës për përgjigje përfshin një ndëshkim, kapërcen rregullat e mirësjelljes, apo sjell dënimin e ofruesit të shërbimit mediatik në një proces gjyqësor civil;
 - dh) përmbushja e së drejtës për përgjigje sjell shkeljen e kushteve të licencës së transmetimit të përcaktuar në kreun VII të këtij ligji;
 - e) personi i dëmtuar nga informacioni i kundërshtuar nuk ka interes të ligjshëm në momentin e kërkesës për ushtrimin e së drejtës së përgjigjes;
 - ë) transmetimi i kundërshtuar përmban një thënie apo deklaram të personit të prekur, të tillë që konsiderohet i barasvlershëm me vetë përgjigjen e kërkuar ose kur personi ka dhënë pëlqimin paraprak në një mënyrë formale lidhur me përmbajtjen e transmetimit;
 - f) një korrigjim i barasvlershëm i të dhënave të informacionit të kundërshtuar është bërë paraprakisht dhe për këtë është njoftuar personi i prekur;
 - g) përmbajtja e përgjigjes së kërkuar dhunon të drejtat e një pale të tretë;
 - gj) çështja objekt ankese lidhet me thëniet gjatë veprimtarive parlamentare, zhvillimit të seancave gjyqësore apo transmetimit të veprimtarive të subjekteve politike;
 - h) transmetimi i së drejtës për përgjigje nuk është në interes të publikut;
 - i) kërkesa është paraqitur në tejkalim të afatit.
14. Kur Këshilli i Ankesave vëren se OSHMA-ja nuk i ka përmbushur detyrimet, sipas pikës 10 të këtij neni, njofton AMA-n. Kjo e fundit vendos në bazë të sugjerimit të Këshillit të Ankesave për rastin konkret.
15. Vendimi i AMA-s mund të kundërshtohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.
16. Rregullorja, sipas pikës 2 të këtij neni, publikohet nga AMA në faqen zyrtare të internetit.

KREU VII

LICENCAT E TRANSMETIMIT, LICENCAT E OFRIMIT TË PËRMBAJTJES DHE SHËRBIMEVE

Neni 54

Ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve audio dhe/ose audiovizive

1. Ofrimi i rrjeteve për transmetimet audio dhe/ose audiovizive, që kërkojnë përdorimin e frekuencave radiotelevizive, licencohet nga AMA, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në përcaktimin e frekuencave që mund të përdoren për transmetimet audio dhe/ose audiovizive, AMA mban parasysh që frekuencat janë një pasuri kombëtare, me vlerë ekonomike dhe rëndësi sociale e kulturore dhe duhet të garantojë shmangien e interferencave dhe shfrytëzimin efektiv të spektrit. Caktimi i frekuencave bëhet nga AMA mbi bazën e objektivitetit, transparencës, mosdiskriminimit, disponueshmërisë së frekuencave të lira dhe, në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave, vetëm në brezat e frekuencave të përcaktuara për t'u administruar nga AMA.

2. Ofrimi i rrjeteve për transmetimet audio dhe/ose audiovizive, që kërkojnë përdorimin e frekuencave jashtë brezave të frekuencave të caktuara për transmetimet radiotelevizive, sipas Planit Kombëtar të Frekuencave, i nënshtrohet rregullimit, sipas ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike".

3. Ofrimi i rrjeteve për transmetimet audio dhe/ose audiovizive që nuk kërkojnë caktimin e frekuencave, si rrjetet e televizionit kabllor, satelitor, i nënshtrohen rregullimit sipas ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike”.

4. Ofrimi i shërbimeve të programeve audio dhe/ose audiovizive, mbështetur në rrjetet e përshkruara në pikën 1 të këtij neni, bëhet në përputhje me kërkesat e parashikuara nga ky ligj dhe rregullat e nxjerra nga AMA. Në këtë rast AMA lëshon:

a) licenca të transmetimit audio dhe licenca të transmetimit audiovizive, kur licencohet rrjeti dhe programi ose programet e mbështetura në të;

b) licenca të shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv, kur licencohet vetëm programi.

5. Ofrimi i shërbimeve të programeve audio dhe/ose audiovizive, mbështetur në rrjetet e përshkruara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, bëhet në përputhje me kërkesat e parashikuara nga ky ligj dhe rregullat e nxjerra nga AMA. Në këtë rast, AMA lëshon autorizime të shërbimit audio dhe autorizime të shërbimit të programit audioviziv.

Neni 55

Llojet e licencave dhe autorizimeve dhe afatet e tyre

1. Llojet e licencave që jep AMA-ja janë:

a) licencë shërbimi programi audio, për ofrimin e një shërbimi programi audio;

b) licencë shërbimi programi audioviziv, për ofrimin e një shërbimi programi audioviziv;

c) licencë transmetimi audio, e cila përbëhet nga:

i) licencë shërbimi programi audio, sipas shkronjës “a” të kësaj pike;

ii) licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit, i cili mund të jetë analog ose numerik;

ç) licencë transmetimi audioviziv, e cila përbëhet nga:

i) licencë shërbimi programi audioviziv, sipas shkronjës “b” të kësaj pike;

ii) licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit.

2. Licencat kategorizohen si më poshtë:

a) licencat, sipas pikës 1/a dhe 1/b, janë kombëtare, rajonale apo lokale, në funksion të kategorisë së rrjetit tokësor, në të cilin mbështeten;

b) licencat, sipas pikës 1/c dhe 1/ç, në funksion të kategorisë së rrjetit tokësor, ndahen në:

i) kombëtare, kur mbulohet me sinjal jo më pak se 80 për qind e territorit të vendit;

ii) rajonale, për mbulim deri në 4 qarqe me vazhdimësi gjeografike;

iii) lokale, për mbulimin e një qarku.

3. Licencat për ndërtimin e rrjeteve numerike, sipas pikave 1/c/ii dhe 1/ç/ii i japin subjektit lejen për ndërtimin e operimin e një rrjeti numerik, përkatësisht audio ose audioviziv.

4. Autorizimet e shërbimit të programit audio dhe autorizimet e shërbimit të programit audioviziv, kur shërbimi mbështetet në rrjetet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të nenit 54 të këtij ligji, janë:

a) satelitor, kur shërbimi mbështetet në një sistem satelitor;

b) kabllor kur shërbimi mbështetet në një sistem kabllor;

c) shërbimi *on line*, kur shërbimi mbështetet në internet;

ç) ofrues shërbimi, përfshirë shërbimin e aksesit të kushtëzuar.

5. Afati maksimal i kohëzgjatjes së licencave dhe/ose autorizimeve është 15 vjet. AMA, me vendim, përcakton kohëzgjatjen maksimale të licencave dhe autorizimeve, sipas klasifikimit të tyre. Në përcaktimin e këtyre afateve, AMA mban parasysh natyrën e shërbimeve dhe kohën e arsyeshme për kthimin e investimit. Kërkesa për rinovimin e licencës dhe/ose autorizimit bëhet 90 ditë para përfundimit të afatit të licencës ose autorizimit.

6. Licencat dhe/ose autorizimet dhe çdo e drejtë apo detyrim i lidhur me to nuk mund të transferohet. Në rast se mbajtësi i licencës dhe/ose autorizimit, hyn në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave është edhe veprimtaria e licencuar/autorizuar, atëherë për cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca dhe/ose autorizimi kërkohet miratimi i AMA-s.

Subjektit që ka fituar këto të drejta, miratimi i jepet në formën e një licence dhe/ose autorizimi të ri me të njëjtën përmbajtje. Kur AMA nuk e miraton kalimin, për shkaqe të parashikuara në këtë ligj, licenca dhe/ose autorizimi bëhet e/i pavlefshëm.

Neni 56

Kërkesat e përgjithshme të aplikimit për licencë dhe/ose autorizim

Aplikimi për marrjen e çdo lloj licence dhe/ose autorizimi përmban:

1. Emërtimin, vendndodhjen, formën ligjore të subjektit që bën kërkesën bashkë me emrin dhe firmën e personit që ka të drejtë ta përfaqësojë atë.
2. Dokumentet që vërtetojnë të dhëna zyrtare e bankare mbi kapitalin financiar të personit juridik apo fizik që bën kërkesën.
3. Emërtimin e programit dhe të rrjetit ku do të mbështetet.
4. Objektin dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit, të dhëna për kohëzgjatjen e programeve dhe territorin që do të mbulojë, si dhe projektin teknik të instalimit dhe shfrytëzimit të aparaturave.
5. Listën e administratorëve, parashikimet për shpenzimet dhe të ardhurat, origjinën dhe shumën e financimeve të parashikuara për kohëzgjatjen për të cilën kërkohet licenca dhe/ose autorizimi.
6. Listën emërore të anëtarëve të bordit drejtues dhe *curriculum vitae* të tyre.
7. Përmbajtjen e programeve që do të transmetohen dhe strukturën programore të propozuar për transmetim, të cilat të shprehin qartë pluralizmin në tërësinë e tyre dhe paanësinë e informacionit.
8. Aplikimi duhet të përfshijë informacion mbi strukturën e pronësisë së kompanisë dhe aksionarëve të saj.
9. Aplikanti duhet t'i përgjigjet çdo pyetjeje të autoritetit rregullator gjatë shqyrtimit të aplikimit.

Neni 57

Parime të përgjithshme të shërbimit të transmetimit audio të komunitetit

Shërbimi i transmetimit audio i komunitetit:

1. Operohet, zotërohet dhe drejtohet nga komuniteti të cilit i shërbejnë.
2. Ofrohet pa qëllim fitimi, duke reflektuar nevojat kulturore, gjuhësore, demografike, të besimit të komunitetit.
3. Ka karakter informues, edukativ dhe argëtues.
4. Ofron programe me rëndësi të veçantë për komunitetin, duke përfshirë, por pa u kufizuar në çështje të zhvillimit, kujdesin shëndetësor, informacione bazë, edukim të përgjithshëm, çështje të ambientit, reflektim të kulturës lokale etj.
5. Mbështetet në punën vullnetare të pjesëmarrësve të komunitetit.
6. Mbështetet nga burime të ndryshme financiare të ligjshme, me përjashtim të reklamave për qëllime fitimi.

Neni 58

Licencimi i shërbimeve të transmetimit audio të komunitetit

1. Licencimi i shërbimit të transmetimit audio të komunitetit bëhet nga AMA me procedurë të hapur, transparente dhe jo diskriminuese. AMA miraton dhe publikon rregullat dhe procedurat e licencimit të transmetimeve audio të komunitetit.

2. Licenca jepet për një zonë gjeografike të kufizuar. AMA përcakton, me anë të një dokumenti rregullator, sasinë e frekuencave në dispozicion të shërbimit të transmetimit audio të

komunitetit, si dhe zonën gjeografike të ofrimit të shërbimit, në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave.

3. AMA, në procesin e licencimit, synon përmbushjen e objektivave të përcaktuara në nenin 18 të këtij ligji.

4. AMA, në vlerësimin e aplikimeve, kryen një proces konsultimi publik për një periudhë prej jo më pak se 60 ditë.

5. Refuzimi i aplikimit për shërbimin e transmetimit audio të komunitetit nga AMA, bëhet gjithmonë kundrejt një vendimi të arsyetuar.

Neni 59

Aplikimi për licencën e transmetimit audio për rrjete analoge

1. Për të siguruar zhvillimin e rregullt të shërbimeve audio dhe sigurimin e një larmie shërbimesh në hapësirën e mbulimit dhe respektimin e interesave të pakicave, AMA harton planin e përdorimit të frekuencave të destinuara për transmetimet audio, në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave.

2. AMA, duke pasur parasysh planin e përdorimit të frekuencave të përmendura në pikën 1 të këtij neni, duke marrë në konsideratë ekzistencën e frekuencave të lira për transmetimet audio, me nismën e vet ose me kërkesën e subjekteve të interesuara:

a) përcakton hapësirën e mbulimit të licencës së transmetimit audio, për të cilën mund të aplikohet;

b) çel garën për dhënien e licencës së transmetimit audio.

3. Në përcaktimin e hapësirës së mbulimit, të përmendur në pikën 2 të këtij neni, AMA duhet paraprakisht:

a) të realizojë studimin e interesave, pritshmërive dhe dëshirave të publikut në këtë zonë mbulimi;

b) të realizojë studimin e ndikimeve në sektorin e transmetimeve në këtë zonë.

4. AMA publikon në faqen e vet të internetit rezultatet e studimeve, të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni dhe mban në konsideratë këto të dhëna dhe ato të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni për dhënien e licencës përkatëse.

5. AMA shpall publikisht çeljen e garës për dhënien e licencës së transmetimit audio ose audiovizive sipas këtij ligji. Aplikimet për këtë licencë bëhen brenda 40 ditëve nga shpallja e garës dhe duhet të përshkruajnë mënyrën e planifikuar të ofrimit të shërbimit dhe plotësimit të kriterëve të shpallura paraprakisht nga AMA.

6. Njoftimi për shpalljen e garës mund të përfshijë ftesën e të gjitha palëve të interesuara për të shprehur propozimet e tyre, në lidhje me natyrën e transmetimit audio, për të cilën është çelur gara.

7. Gjatë shqyrtimit të aplikimeve për dhënien e licencës së transmetimit audio AMA vendos në përputhje me nenin 61 të këtij ligji dhe cakton pikët për çdo aplikues.

8. Shpallja e garës publikohet në faqen e internetit të AMA-s dhe, nëse është e mundur, në një organ shtypi, që shpërndahet në zonën e mbulimit të licencës së shërbimit.

9. Në njoftimin e shpalljes së garës përcaktohen procedurat që duhen ndjekur për bërjen e aplikimit dhe kërkesat përkatëse.

Neni 60

Aplikimi për licencën e shërbimit të programit audio dhe audioviziv

1. Ofrimi i shërbimeve të programeve audio dhe audiovizive, që mbështeten në rrjete tokësore analoge ose numerike, bëhet sipas licencës së lëshuar nga AMA nëpërmjet konkurrimit të aplikimeve në përputhje me kërkesat e nenit 56 të këtij ligji dhe rregullat e veçanta të miratuara nga AMA.

2. AMA, me nismën e vet ose me kërkesën e subjekteve të interesuara, çel garën për dhënien e licencës së shërbimit të programit audio ose audioviziv.

3. AMA shpall publikisht çeljen e garës për dhënien e licencës së shërbimeve të programeve audio ose audiovizive sipas këtij ligji. Aplikimet për këtë licencë bëhen brenda 40 ditëve nga shpallja e garës dhe duhet të përshkruajnë mënyrën e planifikuar të ofrimit të shërbimit dhe plotësimit të kriterëve të shpallura paraprakisht nga AMA.

4. Njoftimi për shpalljen e garës përfshin ftesën e të gjitha palëve të interesuara për të shprehur propozimet e tyre, në lidhje me natyrën e shërbimit të programit audio ose audioviziv, për të cilën është çelur gara.

5. Gjatë shqyrtimit të aplikimeve për dhënien e licencës së shërbimit të programit audio ose audioviziv AMA vendos në përputhje me nenin 61 të këtij ligji dhe cakton pikët për çdo rezultat.

Neni 61

Shqyrtimi dhe vendimmarrja për dhënien e licencave të transmetimeve audio për rrjete analoge dhe të shërbimit të programeve audio e audiovizive

1. Gjatë shqyrtimit të aplikimeve dhe vendimmarrjes për përzgjedhjen e aplikuesit fitues AMA mban parasysh:

a) vetitë, ekspertizën dhe eksperiencën e aplikuesit ose, nëse aplikuesi është një shoqëri, të organeve drejtuesve, administratorëve apo agjencive të tjera të shoqërisë dhe të pronarëve;

b) burimet financiare që zotërojnë aplikuesit dhe aspektet e funksionimit ekonomik dhe financiar të aplikimit;

c) cilësinë, llojet dhe shtrirjen e programeve në gjuhën shqipe dhe hapësirën e programeve të propozuara, që lidhen me tiparet dhe nevojat e kulturës kombëtare;

ç) hapësirën që aplikimi krijon brenda shërbimit të transmetimit të propozuar, për mundësinë e krijuesve të rinj në fushën e muzikës, të shfaqjeve teatrore dhe sidomos ato të lidhura me kulturën kombëtare;

d) gatishmërinë për të ofruar një shumëllojshmëri shërbimesh në hapësirën e mbulimit për kategoritë e ndryshme shoqërore, përfshirë këtu interesat e pakicave;

dh) gatishmërinë për t'i dhënë mundësinë çdo personi apo grupi personash për të pasur interesa në një numër shërbimesh të transmetimit audioviziv, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj;

e) masat, në të cilat shërbimi i propozuar realizon interesat e ndryshëm në komunitetin përkatës lokal, ose si i shërben këtyre interesave;

ë) ofrimin e teknologjisë digjitale në transmetim, si dhe plotësimin e kërkesave teknike për pajisjet për transmetimin dhe për realizimin e mbulimit të zonës së licencimit;

f) të mos jenë në proces falimentimi apo likuidimi;

g) të kenë kapital të regjistruar e të deklaruar në QKR në shumën 3 500 000 lekë.

2. Përveç përcaktimeve në pikën 1 të këtij neni, AMA duhet të vlerësojë edhe cilësinë e kryerjes së shërbimit të transmetimit nga ana e aplikuesit, mbajtës të një licence të mëparshme.

3. Kur AMA vendos mosmiratimin e aplikimit, duhet të njoftojë aplikuesit për:

a) arsyet e vendimit;

b) rezultatin e vlerësimit të aplikuesit;

c) rezultatin e aplikimit fitues.

4. Licenca e transmetimit audio dhe audioviziv nuk u jepet personave të dënuar për një vepër penale, nëse nuk kanë kaluar 5 vjet nga përfundimi i këtij dënimi.

5. Licenca e transmetimit nuk u jepet subjekteve që u është hequr ose u është bërë e pavlefshme licenca, me vendim të AMA-s, nëse nuk ka kaluar të paktën një periudhë 10-vjeçare nga data kur iu është hequr licenca e transmetimit. I njëjti kufizim zbatohet edhe ndaj subjekteve juridike, aksionarë të të cilëve janë individë që kanë qenë aksionarë në subjektet të cilëve iu është hequr licenca me vendim të AMA-s.

6. Për shqyrtimin e aplikimeve të përcaktuara në këtë nen, AMA duhet të vendosë jo më vonë se 60 ditë nga dita e aplikimit.

Neni 62

Rregullimi i pronësisë në transmetimet audio dhe audiovizive tokësore

(shfuqizuar paragrafi i tretë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 56, datë 27.7.2016)

1. Licenca kombëtare e transmetimit audio dhe licenca kombëtare e transmetimit audioviziv u jepen vetëm shoqërive aksionare të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë si objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive.

2. Aksionet që përfaqësojnë kapitalin në një shoqëri, mbajtëse të një licence kombëtare për transmetim audio apo licencë kombëtare e transmetimit audioviziv, janë nominative.

3. Shfuqizuar.

4. Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri që disponon një licencë kombëtare transmetimi audio ose licencë kombëtare transmetimi audioviziv, nuk mund të ketë më shumë se 20 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë kombëtare transmetimi audio ose licencë kombëtare të transmetimit audioviziv. Për transmetimet analoge audio lejohet pjesëmarrja në masën deri në 10 për qind në një shoqëri të tretë kombëtare. Një person i tillë nuk lejohet të marrë licencë transmetimi audio, lokale apo rajonale ose licencë transmetimi audioviziv, lokale apo rajonale.

5. Kushteve të mësipërme u nënshtrohen edhe licencat kombëtare për shërbimin e programit audio dhe/ose audioviziv.

6. Licenca lokale apo rajonale e transmetimit audio dhe licenca lokale apo rajonale e shërbimit të transmetimit audioviziv u jepen personave juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, me objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive.

7. Një person fizik ose juridik që ka 100 për qind të aksioneve në një shoqëri që zotëron një licencë transmetimi audioviziv lokale apo rajonale, mund të marrë vetëm një licencë të dytë për transmetim audio lokale apo rajonale. Një person fizik ose juridik që ka 100 për qind të aksioneve në një shoqëri që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale, mund të marrë vetëm një licencë transmetimi audiovizive lokale apo rajonale.

8. Një person fizik ose juridik që ka aksione në një subjekt që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale, nuk mund të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale.

9. Një person fizik ose juridik që ka aksione në një subjekt që zotëron një licencë transmetimi audioviziv lokale apo rajonale nuk mund të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë që zotëron një licencë transmetimi audioviziv lokale apo rajonale.

10. Në kuptim të këtij neni, aksionar konsiderohet mbajtësi i aksioneve dhe personat e lidhur me të deri në shkallën e dytë.

11. Kushteve të mësipërme u nënshtrohen edhe subjektet juridike të autorizuar për ofrimin e shërbimeve të programit audio dhe autorizimet e shërbimit të programit audioviziv të mbështetura në rrjete satelitore.

12. Asnjë zotërues i licensave kombëtare të transmetimeve audio dhe licensave kombëtare të transmetimit audioviziv, përfshirë OSHMA-të, të licencuar për shërbimin e programit audioviziv dhe/ose të autorizuar për shërbimin e programeve të mbështetura në rrjete satelitore, në bazë të këtij ligji, nuk mund të transmetojë më shumë se 30 për qind të reklamave në tregun e transmetimeve audiovizive. AMA monitoron dhe publikon informacion periodik mbi volumin e reklamave të transmetuara nga OSHMA-të kombëtare.

Shfrytëzimi i multipleksit

1. Mbajtësit e licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv janë të detyruar t'u japin akses në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese, në jo më pak se 40 për qind të kapacitetit të multipleksit të tyre, OSHMA-ve që zotërojnë licencë shërbimi programi audio dhe/ose licencë shërbimi programi audioviziv.

2. Pavarësisht përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, një subjekt i licencuar për transmetime numerike ose për ofrimin e shërbimit të programit audio ose audioviziv, nuk mund të ketë më shumë se një të tretën e sasisë së përgjithshme të programeve përkatëse lokale, rajonale dhe kombëtare.

3. Mbajtësit e licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv ofrojnë aksesin për transmetim në rrjetin numerik, mbi bazën e marrëveshjeve tregtare me OSHMA-të. Tarifat për dhënien e aksesit për transmetim në rrjetin numerik duhet të orientohen në kosto.

4. AMA siguron që të gjitha shërbimet që u ofrohen OSHMA-ve, që zotërojnë licencë shërbimi programi audio dhe ose licencë shërbimi programi audioviziv, nga mbajtësit e licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv, bazohen në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese.

5. Në rast mosmarrëveshjes midis OSHMA-ve dhe mbajtësve të licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv, palët i drejtohen AMA-s.

6. AMA, duke mbajtur parasysh garantimin e aksesit të barabartë dhe jodiskriminues për OSHMA-të, garantimin e konkurrencës së ndershme dhe shumëllojshmërisë së shërbimeve, pasi dëgjon pretendimet e palëve, vendos për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

7. Kundër vendimit të AMA-s, palët mund të bëjnë ankim gjykatë.

Autorizimet për shërbimet e programeve audio dhe audiovizive

1. Ofrimi i shërbimeve të programeve audio dhe audiovizive që mbështeten në rrjete të ndryshme nga rrjetet tokësore analoge apo numerike, sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 54 të këtij ligji, bëhet me autorizim të AMA-s pa garë, mbi bazën e kërkesës. Subjekti që bën kërkesën duhet të jetë paraprakisht i regjistruar në AKEP, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".

2. AMA garanton që i autorizuari:

a) të jetë përgjegjës në lidhje me interesat dhe ndjeshmërinë publike, të respektojë mirëkuptimin dhe bashkekzistencën shoqërore të të gjithë individëve në Republikën e Shqipërisë, të respektojë kërkesat e këtij ligji dhe kushtet e autorizimit, të përcaktuara nga AMA;

b) të nxisë vlerat demokratike të përcaktuara në Kushtetutën e Shqipërisë dhe në veçanti të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të informimit.

3. Autorizimi u jepet mbi bazën e kërkesës, subjekteve që plotësojnë kërkesat e këtij ligji lidhur me programet audio dhe audiovizive.

4. Autorizimi jepet pas shqyrtimit të dokumentacionit të plotësuar sipas kriterëve të përcaktuara nga AMA me rregullore të veçantë.

5. Autorizimi jepet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës së plotësuar. Refuzimi i aplikimit bëhet gjithmonë kundrejt një vendimi të arsyetuar. Nëse AMA nuk shprehet brenda afatit të mësipërm, nga data e marrjes së aplikimit të plotë, autorizimi konsiderohet i miratuar.

6. Autorizimi jepet për një afat 5-vjeçar me të drejtë rinovimi.

7. AMA mund të rinovojë këtë autorizim në bazë të plotësimit të kushteve të mësipërme dhe sipas procedurave të vendosura paraprakisht prej saj.

8. Mbajtësi i licencës për transmetime audio ose për transmetime audiovizive ka të drejtë të ofrojë shërbime satelitore kundrejt regjistrimit, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga AMA.

Neni 65

Kushtet e licencës së transmetimit audio

1. Licenca e transmetimit audio mund të përmbajë kushte dhe kërkesa që AMA i vlerëson dhe i përcakton si të nevojshme në licencë. AMA publikon paraprakisht termat dhe kushtet e licencës së transmetimeve audio.

2. Përveç të tjerave, në një licencë transmetimi audio AMA përcakton:

a) afatin e licencës;

b) kur një licencë mund të rinovohet, mënyrën, kushtet dhe kohën për të cilën mund të kryhet rinovimi;

c) kushtet për ndalimin e transferimit të të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga kjo licencë;

ç) kushtet për sigurimin e cilësisë, shtrirjes dhe llojeve të programeve;

d) pagesat që i licencuari duhet të kryejë në favor të AMA-s.

3. Subjekti i licencuar duhet të njoftojë AMA-n për çdo ndryshim në të dhënat e shoqërisë së licencuar brenda një afati 30-ditor nga bërja e ndryshimeve.

4. Çdo licencë transmetimi audio duhet të parashikojë detyrimin e të licencuarit për të paraqitur të dhënat mbi llogaritë e veta, bilanci ose informacionet e tjera që AMA vlerëson si të nevojshme për realizimin e funksioneve të veta.

5. Licenca e transmetimit audio është dokument zyrtar, i administruar nga AMA, sipas përcaktimit të ligjit nr. 8503 datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

6. Pavarësisht përcaktimeve të nenit 37 të këtij ligji, licenca e transmetimit audio duhet të përfshijë një kusht që detyron të licencuarit e transmetimit të realizojnë regjistrimin dhe arkivimin e disa kategorive të programeve, të cilat mund të kontrollohen nga AMA gjatë kohëzgjatjes së licencës së transmetimit dhe për një afat deri në 6 vjet pas përfundimit të kësaj licence.

7. AMA, brenda një viti nga miratimi i këtij ligji, përgatit një udhëzim me format dhe kategoritë e programeve të kërkuara për regjistrim dhe arkivim nga ana e subjekteve të licencuara të transmetimeve, sipas pikës 6 të këtij neni.

8. Në hartimin e rregullave të përcaktuara në pikën 7 të këtij neni, AMA mban parasysh natyrën dhe sasinë e programeve të transmetuara nga i licencuari, si dhe shpenzimet financiare për këtë qëllim.

9. Në realizimin e funksioneve të përcaktuara në pikat 7 dhe 8 të këtij neni, AMA vlerëson përmbajtjen e programeve, të cilat:

a) janë në gjuhën shqipe, apo lidhen me kulturën dhe aktualitetin kombëtar;

b) lidhen me zhvillimet në fushën e muzikës, teatrit, shfaqjeve dhe veprimtari të tjera kombëtare;

c) janë lajme, dokumentarë apo raportime, si dhe çdo kategori tjetër të përmbajtjes programore që AMA vlerëson se është e domosdoshme për t’u regjistruar dhe arkivuar nga ana e të licencuarit.

10. AMA mund të realizojë me mjetet e veta regjistrimin dhe arkivimin e programeve të përcaktuara më sipër dhe administron këto programe, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të.

11. AMA raporton në Kuvend çdo vit në lidhje me zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky nen.

Licencat e transmetimit audio për qëllime të përkohshme dhe nevoja institucionale

1. Për sigurimin e nevojave të përkohshme të institucioneve publike, AMA jep licencë transmetimi të përkohshme për mbulimin e një hapësire të caktuar. Afatet e licencave të përkohshme janë:

- a) deri në 60 ditë brenda një viti kalendarik për një shërbim transmetimi audio rajonal;
- b) deri në 120 ditë brenda një viti kalendarik për një shërbim transmetimi audio lokal.

2. AMA mund të japë një licencë për ofrimin e një shërbimi transmetimi audio, me fuqi të ulët, i cili ka për qëllim t'i shërbejë vetëm një institucioni arsimor, shëndetësor apo të natyrave të ngjashme, të përcaktuara në licencë.

3. Kërkesat e nenit 33 pika 1 shkronja "c" dhe të neneve 59 dhe 62 të këtij ligji nuk zbatohen në rastin e licencës së dhënë sipas këtij neni.

4. AMA miraton dhe publikon rregullat për dhënien e këtyre licencave, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

5. Licencat, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk jepen në periudhën 6-mujore përpara datës së zhvillimit të zgjedhjeve vendore apo të përgjithshme parlamentare, përveç rasteve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit, fatkeqësive natyrore dhe njerëzore, rendin publik dhe sigurinë kombëtare.

Licenca e shërbimit për programet audiovizive

1. AMA jep licenca shërbimi për programet audiovizive, në bazë të së cilës i licencuari ka të drejtat dhe detyrimet për të ngritur dhe realizuar një shërbim programi audioviziv. Në bazë të licencës, i licencuari ka të drejtë për të ngritur, realizuar dhe vënë në funksion pajisje transmetuese, me qëllim transmetimin e shërbimit të programit audioviziv.

2. AMA siguron që shërbimi i programit audioviziv:

a) të jetë përgjegjës në lidhje me interesat dhe ndjeshmërinë publike, të respektojë mirëkuptimin dhe bashkekzistencën shoqërore të të gjithë individëve në Republikën e Shqipërisë, të sigurojë që përmbajtja programore të pasqyrojë elementet përbërëse të kulturës dhe të gjuhës shqipe;

b) të nxisë vlerat demokratike të përcaktuara në Kushtetutë dhe në veçanti të drejtën e shprehjes dhe të informimit;

c) të mbajë në konsideratë nevojën e formimit të opinionit publik për t'u njohur dhe për të kuptuar vlerat dhe traditat europiane;

ç) të përfshijë në përpjesëtim të arsyeshëm programet e lajmeve dhe ato me natyrë informative.

d) të respektojë kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në bazë të këtij ligji në licencë;

dh) të përfshijë, në mënyrë të arsyeshme përdorimin e gjuhës së shenjave në emisionet e lajmeve për njerëzit që nuk dëgjojnë.

3. I licencuari i shërbimit të programit audioviziv realizon programin, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni. AMA kërkon, kur është e mundur, që pjesa më e madhe e kohës së transmetimit t'i kushtohet veprave europiane, duke përjashtuar kohën për lajmet, ngjarje sportive, lojërat, reklamat, shërbimin teletext dhe shitjeve të drejtpërdrejta apo të rezervohet për programe të subjekteve të pavarura, nga vetë i licencuari ose subjektet e lidhura me të.

4. AMA përfshin, në çdo licencë të dhënë në bazë të këtij neni dhe çdo rinovim, në bazë të këtij ligji, një kusht për transmetimin e prodhimeve të pavarura, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 123 të këtij ligji.

Neni 68

Pavlefshmëria e licencës dhe/ose autorizimit

Licenca dhe/ose autorizimi bëhet e pavlefshme kur:

- a) mbaron afati i vlefshmërisë dhe ajo nuk është rinovuar;
- b) i licencuari ose i autorizuari njofton me shkrim AMA-n për mbylljen e aktivitetit;
- c) AMA ka nxjerrë vendim për heqje licence dhe/ose autorizimi në bazë të kompetencave që i jep ky ligj;
- ç) deklarohet falimentimi;
- d) kërkuesi nuk e tërheq licencën dhe/ose autorizimin ose nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj pas 90 ditëve nga momenti kur merr dijeni zyrtarisht për miratimin e saj;
- dh) ka një vendim të formës së prerë nga gjykata që ndalon ushtrimin e aktivitetit nga i licencuari dhe/ose i autorizuari.

Neni 69

Heqja e licencës dhe/ose autorizimit

AMA ka të drejtë të heqë licencën dhe/ose autorizimin kur:

1. Është fituar sipas të dhënave të rreme të paraqitura në kërkesë.
2. Nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në licencë.
3. Nuk paguan detyrimet financiare të licencës për një vit.
4. Nuk ka filluar transmetim pas hyrjes në fuqi të vendimit për dhënie licence për një periudhë kohe:
 - a) 6 muaj në transmetimet audio lokale e rajonale;
 - b) 9 muaj në shërbimin e transmetimit audioviziv lokal e rajonal;
 - c) 12 muaj në vënien në funksionim të multipleksit lokal e rajonal;
 - ç) 12 muaj në transmetimet audio kombëtare;
 - d) 18 muaj në shërbimin e transmetimeve audiovizive kombëtare;
 - dh) 24 muaj në vënien në funksionim të multipleksit kombëtar.
5. Pas fillimit të transmetimit, gjatë një viti kalendarik, nuk transmetohet 30 ditë, pa llogaritur ndërprerjet për arsye teknike që nuk varen nga mbajtësi i licencës.
6. Te mbajtësi i licencës kanë ndodhur ndryshime që e bëjnë të pamundur respektimin e kushteve të vendosura në licencë.
7. Prona e mbajtësit të licencës, e cila shërben drejtpërdrejt për ushtrimin e aktivitetit të shërbimeve audiovizive, ka dalë në ankand për shitje.
8. Ndëshkohet më shumë se 3 herë brenda një viti kalendarik, për një nga kundërvajtjet administrative të parashikuara në nenet 132 dhe 133 të këtij ligji.

KREU VIII

TRANSMETIMET NUMERIKE

Neni 70

Aplikimi për licencat e rrjeteve numerike

1. Të drejtën e aplikimit për t'u pajisur me licencë rrjeti numerik, përkatësisht lokal, rajonal kombëtar e kanë shoqëritë aksionare që:
 - a) zotërojnë licencë për shërbime programi audio dhe audioviziv përkatësisht lokale, rajonale apo kombëtare;
 - b) nuk zotërojnë licencë për shërbime programi audio dhe audioviziv. Në këtë rast aplikimi bëhet njëkohësisht për licencë për shërbime programi sipas kërkesave të nenit 60 dhe kërkesave për licencë rrjeti numerik sipas këtij kreu. AMA shqyrton fillimisht aplikimin për shërbimin e programit sipas nenit 61 të këtij ligji.

2. Licenca e rrjetit numerik jepet me konkurrim të hapur duke garantuar trajtim të barabartë, objektiv dhe jo diskriminues. AMA, me nismën e vet ose me kërkesën e subjekteve të interesuara, çel garën duke pasur parasysh planin e përdorimit të frekuencave, si dhe duke marrë në konsideratë ekzistencën e frekuencave të lira për transmetimet numerike.

3. Licencat e rrjetit numerik jepen nga AMA në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara bazuar në:

a) planin e frekuencave për transmetimet numerike, të miratuar me Aktet Finale të Konferencës Rajonale të Radiokomunikacioneve "Për planifikimin e transmetimeve numerike tokësore në pjesë të rajoneve 1 dhe 3 në bandat e frekuencave 174-230 MHz dhe 470-862 MHz (RRC-06), ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr. 9851 datë 26.12.2007, duke përjashtuar frekuencat e digjital dividendit, sipas përcaktimeve në Aktet Finale të Konferencës Botërore të Radiokomunikacioneve WRC-07 dhe WRC-2012;

b) disponueshmërinë e frekuencave të lira;

c) zonat përkatëse të mbulimit me programe, shërbime shoqëruese dhe të dhëna të tjera të lidhura me to.

4. AMA përcakton hapësirën e mbulimit, në të cilën do të transmetohet, në përputhje me licencën, dhe fton subjektet e interesuara për të marrë pjesë në garë.

5. Njoftimi për çeljen e garës duhet të publikohet në faqen e internetit të AMA-s dhe në të paktën tre nga gazetatat me tirazh më të lartë dhe, kur është e mundur, në organet e shtypit, që qarkullojnë në zonën e përcaktuar të mbulimit. Në njoftim duhet të përcaktohen procedurat dhe kërkesat për kryerjen e aplikimit dhe çdo çështje përkatëse apo të nevojshme.

6. AMA, në njoftimin e përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, përcakton zonën minimale të mbulimit në të cilën do të transmetohet materiali programor, materiale të lidhura me të dhe të dhëna të tjera. Zona minimale e mbulimit mund të jetë më e vogël se hapësira maksimale e mbulimit e përcaktuar në njoftim.

7. Pavarësisht përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni, kur në njoftimin për çeljen e aplikimeve është përcaktuar një hapësirë mbulimi minimale, kjo hapësirë duhet të jetë zona minimale e mbulimit të licencës së miratuar, duke i kërkuar aplikuesit të realizojë mbulimin e hapësirës maksimale për aq sa është e mundur.

8. Në njoftimin për çeljen e garës, AMA përcakton numrin e shërbimeve të programeve audio dhe/ose audiovizive që do të mbështeten në multipleks, si dhe nëse ndonjë shërbim ekzistues i programeve audio dhe/ose audiovizive do të mbështetet në rrjetin numerik.

Neni 71

Shqyrtimi i aplikimeve për dhënien e licencës së rrjeteve numerike

1. AMA shqyrton çdo aplikim për një licencë rrjeti numerik, në bazë të njoftimit për çeljen e garës, me qëllim përcaktimin e aplikuesit të përshtatshëm për marrjen e licencës së rrjetit numerik.

2. Për shqyrtimin dhe përcaktimin e aplikuesve të përshtatshëm, sipas pikës 1 të këtij neni, AMA duhet të mbajë parasysh:

a) natyrën, ekspertizën dhe eksperiencën e aplikuesit përfshirë natyrën, ekspertizën dhe eksperiencën e drejtuesve, menaxherëve apo zyrtarëve të kompanisë dhe të pronarëve ose aksionarëve të saj;

b) burimet financiare në dispozicion të secilit aplikues dhe mënyrën e funksionimit ekonomik të paraqitur në aplikim;

c) gamën dhe llojin e programeve të propozuara për t'u përfshirë në multipleks dhe mënyrën e sigurimit të këtyre materialeve;

ç) në rastin e një rrjeti numerik të shërbimit audioviziv, propozimin e aplikuesit për përfitim të pajisjeve të nevojshme për marrjen nga shikuesit nëpërmjet këtyre pajisjeve të gjitha multiplekseve të shërbimit audioviziv që transmetojnë në atë zonë, përfshirë rrjetet numerike kombëtare, si dhe të shërbimeve me pagesë dhe realizimin e mundësisë së personave për t'u

informuar dhe zgjedhur mbi materialin programor të përfshirë në këto multiplekse;

- d) shtrirjen e zonës së mbulimit të propozuar për t'u kryer nga aplikuesi;
- dh) propozimet teknike, përfshirë periudhën e zbatimit, lidhur me ngritjen dhe vënien në funksionim të rrjetit numerik;
- e) në rastin e një rrjeti numerik transmetimi audio, propozimin e aplikuesit për lehtësimin e përfshirjes së çdo shërbimi të regjistruar transmetimi në rrjetin numerik;
- ë) çdo çështje tjetër që AMA vlerëson si të nevojshme për sigurimin e ngritjes dhe vënien në funksionim të multiplekseve.

Neni 72

Kushtet e licencës për rrjetin numerik

1. AMA në licencën e rrjetit numerik përcakton:
 - a) kërkesat për programet, shërbimet shoqëruese dhe të dhënat e tjera që do të mbështeten në multipleks, duke përfshirë kërkesat për programet ekzistuese;
 - b) kushtet dhe afatet për realizimin e mbulimit të zonës me sinjal;
 - c) kushtet për sigurimin e pajisjeve për marrjen e shërbimeve me pagesë nga përdoruesit e autorizuar dhe paraqitjen e programeve të mbështetura në të gjitha multiplekset, që transmetojnë në atë zonë;
 - ç) kushtet për përputhjen me kërkesat teknike dhe cilësinë e shërbimit.
2. Licenca e rrjetit numerik përmban kushtet për pagesën e detyrimeve nga i licencuari ndaj AMA-s, si dhe kushtet për sigurimin e informacionit që AMA kërkon t'i vihet në dispozicion për ushtrimin e kompetencave të veta, përfshirë kopje të llogarive dhe bilanceve.
3. AMA, në funksion të interesit të përdoruesve të shërbimeve të rrjetit numerik dhe në përmbushje të objektivave rregullatorë të saj, vendos kushte për të garantuar një konkurrencë efektive midis ofruesve të shërbimit mediatik që mbështeten në multipleks, në mënyrë që i licencuari:
 - a) të mos pengojë përdoruesit që, në ndonjë hapësirë mbulimi, të marrin shërbimet e multipleksit në aparatin marrës;
 - b) të garantojë që çdo aparat marrës të jetë në gjendje të realizojë sistemin e çkodimit për hapjen e të gjitha shërbimeve të koduara të mbështetura në rrjetin numerik në zonën përkatëse të mbulimit.
4. Operatorët e rrjeteve dhe ofruesit e shërbimeve numerike tokësore të transmetimit sigurojnë që programet që transmetojnë të respektojnë rregullat e etikës dhe të kriptimit e kodimit kur i dedikohen publikut të grupmoshave specifike.
5. Licenca e rrjetit numerik përmban edhe kushtet, që AMA i konsideron të përshtatshme në përmbushje të qëllimeve të këtij ligji.

Neni 73

Shërbime me ekran të gjerë

1. Rrjetet publike të komunikimit elektronik, të krijuara për shpërndarjen e shërbimeve televizive numerike, duhet të jenë në gjendje të shpërndajnë shërbime dhe programe televizive me ekran të gjerë.
2. Operatorët e rrjeteve që marrin dhe rishpërndajnë shërbime apo programe me ekran të gjerë ruajnë të njëjtën format.

Neni 74

Afati i licencës dhe transferimi i të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin prej saj

1. Afati i vlefshmërisë së licencës së rrjetit numerik është:
 - a) 15 vjet për transmetimet kombëtare;

- b) 8 vjet për transmetimet rajonale e lokale.
2. Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve, që rrjedhin nga licenca, nuk mund të realizohet pa marrë paraprakisht miratimin me shkrim të AMA-s.
3. Ndryshimi i neneve të statutit që përcaktojnë pronësinë dhe çështjet që lidhen me të, nuk mund të realizohet pa marrë paraprakisht miratimin me shkrim të AMA-s.

KREU IX
SHËRBIMET MEDIATIKE AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIVE
SIPAS KËRKESËS SË PËRDORUESIT

Neni 75

Ofrimi i shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit

1. Ofrimi i shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive, sipas kërkesës së përdoruesit, bëhet mbi bazën e autorizimit të lëshuar nga AMA përveç shërbimeve të shoqërisë së informacionit, të përcaktuara nga ligji nr. 10 128, datë 11.05.2009 “Për tregtinë elektronike”.
2. Autorizimi jepet brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të aplikimit.
3. Në aplikim duhet të përcaktohen emri, mbiemri, numri i dokumentit personal identifikues të subjektit aplikues, kur ky është person fizik, dhe emri i shoqërisë, numri i regjistrimit dhe informacioni përkatës për anëtarët themelues dhe për veprimtaritë e tyre, sidomos në fushën e medias, kur aplikuesi është person juridik. Nëse aplikimi paraqitet nga një sipërmarrje tregtare, duhet të përfshijë informacionin lidhur me anëtarët themelues, si dhe me personat e strukturave drejtuese të subjektit, përfshirë emrat dhe funksionet e tyre.
4. Aplikimi shoqërohet nga:
- a) oferta bazë e shërbimit, duke përcaktuar emrin e ofruesit të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv, në bazë të kërkesës së përdoruesit, emrin, qëllimin e përdorimit dhe formatin e katalogut, si dhe çdo informacion tjetër, të cilin aplikuesi e vlerëson të rëndësishëm për veprimtarinë që ka planifikuar të ofrojë;
 - b) dokumentet që vërtetojnë burimet e financimit për vitin e parë të ushtrimit të veprimtarisë së vet;
 - c) informacionin se cili rrjet komunikimi elektronik do të përdoret për shpërndarjen e shërbimit përkatës;
 - ç) dokumentacionin që vërteton pagesën e detyrimeve fiskale e financiare ndaj shtetit.
5. AMA regjistron në një regjistër të veçantë ofruesit e shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv, sipas kërkesës. Ky regjistër publikohet në faqen e internetit të AMA-s. Përmbajtja dhe ruajtja e regjistrit përcaktohen nga AMA.
6. I autorizuari njofton AMA-n për çdo ndryshim të të dhënave të paraqitura në aplikim.
7. Dhënia e autorizimit për ofrimin e shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv, sipas kërkesës së përdoruesit, nuk përfshin dhënien e frekuencave.
8. Vlefshmëria e autorizimit përfundon kur:
- a) ofruesi i shërbimit njofton me shkrim AMA-n për mbylljen e aktivitetit;
 - b) nuk e ushtron aktivitetin për më shumë se një vit;
 - c) nuk përmbush kërkesat teknike të transmetimit të programeve;
 - ç) ka një vendim të formës së prerë nga gjykata që ndalon ushtrimin e aktivitetit nga i autorizuari.
9. Pikat 1 deri në 8 të këtij neni zbatohen vetëm për ata OSHMA audiovizive që kryejnë transmetime televizive.

Kushtet për ofrimin e shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv sipas kërkesës së përdoruesit

1. Shërbimet e ofruara sipas kërkesës së përdoruesit nuk lejohen të përfshijnë programe që nxisin urrejtjen mbi baza racore, etnike, gjinore, kombëtare ose fetare.
2. Veprat kinematografike në këto shërbime duhet të transmetohen në bazë të kushteve të miratuara me mbajtësit e të drejtave përkatëse për këto vepra.
3. Dispozitat e kreut IV zbatohen edhe për shërbimet mediatike audio dhe/ose audiovizive, në bazë të kërkesës së përdoruesit.
4. Shërbimet mediatike audio dhe/ose audiovizive, në bazë të kërkesës së përdoruesit, që mund të dëmtojnë rëndë zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve, transmetohen në formë të koduar, të tillë që të sigurojnë mosmarrjen e tyre nga të miturit në kushte të zakonshme.

Promovimi i prodhimit të veprave europiane nga shërbimet mediatike audio dhe/ose audiovizive në bazë të kërkesës së përdoruesit

1. Shërbimet mediatike audio dhe/ose audiovizive, sipas kërkesës së përdoruesit, të ofruara nga operatorët e shërbimit të medias brenda juridiksionit të tyre promovojnë, kur është e mundur dhe me mjete të përshtatshme, prodhimin e veprave europiane dhe aksesin ndaj këtyre veprave.
2. Promovimi i veprave europiane mund të bëhet përmes kontributit financiar që shërbime të tilla mediatike akordojnë për prodhimin dhe blerjen e të drejtave të punëve europiane, ose në përqindjet dhe/ose dominimin e veprave europiane në katalogun e programeve të ofruara nga shërbimet mediatike audio dhe/ose audiovizive, sipas kërkesës së përdoruesit.
3. AMA përcakton në rregullore mënyrën e zbatimit të këtij neni.

KREU X

ZBATIMI DHE PËRPUTHSHMËRIA ME KUSHTET E LICENCËS DHE/OSE AUTORIZIMIT

Inspektimi i veprimtarisë së të licencuarit/të autorizuarit

1. AMA ka të drejtë të ushtrojë kontroll të veprimtarisë programore, financiare, teknike dhe organizative të mbajtësit të një licence dhe/ose autorizimi, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Çdo inspektim, veçanërisht inspektimi i veprimtarisë programore, nuk duhet të cenojë lirinë e shprehjes. I licencuari bashkëpunon me AMA-n për realizimin e këtij funksioni.
2. AMA autorizon nëpunës të specializuar të administratës së vet apo persona të tjerë të specializuar për të realizuar këtë inspektim nëse:
 - a) ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, që tregojnë se i licencuari dhe/ose i autorizuari nuk realizon shërbimin në përputhje me kushtet e licencës dhe/ose autorizimit;
 - b) realizimi i shërbimit të ofruar nga i licencuari shkakton interferenca;
 - c) ka informacion për veprimtari të palicencuar dhe/ose të paautorizuar;
 - ç) ka një njoftim të përligjur nga një palë e tretë e interesuar.
3. Përveç përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni, AMA ka të drejtë të kryejë inspektime periodike me ose pa njoftim paraprak të të licencuarit dhe/ose të të autorizuarit.
4. I licencuari dhe/ose i autorizuari duhet t'i paraqesë personit të autorizuar për kryerjen e inspektimit informacionin apo regjistrimet që zotëron lidhur me këtë kontroll, të lejojë hyrjen në mjediset e veta për të realizuar inspektimin dhe të ushtrojë këqyrjen e pajisjeve transmetuese në këto mjedise, si dhe, kur është e nevojshme, t'u përgjigjet kërkesave të personit të autorizuar për ushtrimin e inspektimit me qëllim realizimin e tij.

5. Kur personi i autorizuar për të ushtruar inspektimin, pas këqyrjes, vlerëson se i licencuari dhe/ose i autorizuari ka kryer shkelje të kushteve të licencës dhe/ose autorizimit, ia bën këtë me dije të licencuarit/të autorizuarit nëpërmjet një procesverballi që nënshkruhet nga të dy palët dhe e njofton për mundësinë që të paraqesë pretendimet e veta në përputhje me pikën 7 të këtij neni. Në rast se i licencuari/i autorizuari refuzon të nënshkruajë procesverballin, njoftimi kryhet sipas nenit 81 të këtij ligji.

6. I licencuari dhe/ose i autorizuari i interesuar i paraqet AMA-s informacionin dhe regjistrimet e nevojshme për realizimin e shqyrtimit të çështjes.

7. Pas paraqitjes së pretendimeve nga i licencuari dhe/ose i autorizuari, nëse ka, AMA përcakton nëse ky ka shkelur ose jo kushtet e licencës dhe/ose autorizimit dhe merr vendimin përkatës, duke përfshirë sanksionet në përputhje me këtë ligj.

8. AMA përcakton rregulla për realizimin e së drejtës së të licencuarve dhe/ose të autorizuarve, të përmendur në pikën 4 të këtij neni. Rregullat miratohen për kohëzgjatjen e procedurave të përcaktuara në pikën 4 të këtij neni dhe mund të përfshijnë dispozita për seanca dëgjimore ose forma të tjera, që vlerësohen të përshtatshme.

9. Pavarësisht nga përcaktimet e pikave 4 deri në 7 të këtij neni, në rastin e konstatimit të interferencave, veprohet në përputhje me pikën 5 të nenit 80 të këtij ligji.

Neni 79

Monitorimi i spektrit të frekuencave

1. AMA monitoron brezat e frekuencave, të caktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave për transmetime audiovizive, me qëllim që:

a) përdorimi i frekuencave të dhëna me licencë të jetë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zbatim të kushteve të licencës;

b) spektri i frekuencave të përdoret vetëm nga përdoruesit e lejuar, sipas dispozitave të këtij ligji;

c) të krijojë një mjedis të përshtatshëm dhe pa interferenca të dëmshme për operimin e sistemeve dhe të stacioneve të transmetimit audioviziv, që do të përdoren për qëllime private ose publike.

2. AMA, për monitorimin e frekuencave, bashkëpunon me AKEP-in dhe me institucionet e tjera, të ngarkuara për administrimin e spektrit të frekuencave.

3. Monitorimi i frekuencave bëhet në përputhje me rregulloren përkatëse, të hartuar nga AMA.

4. Monitorimi i frekuencave mund të bëhet edhe me kërkesë të subjekteve, të cilat zotërojnë një licencë të lëshuar nga AMA. Në këtë rast shpenzimet e monitorimit përballohen nga subjekti i interesuar.

Neni 80

Bllokimi i pajisjeve dhe/ose ndalimi i funksionimit të tyre

1. Kur një person fizik apo juridik zhvillon veprimtari në fushën e transmetimeve audio dhe/ose audiovizive, të palicencuar nga AMA, personat e autorizuar nga AMA bllokojnë pajisjet.

2. Pajisjet e bllokuara sipas pikës 1 të këtij neni, brenda një muaji inventarizohen në prani edhe të personit fizik apo juridik që ushtron veprimtari të palicencuar dhe sekuestrohen.

3. Kundër vendimit për sekuestrimin mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve në gjykatë.

4. Pas kalimit të afatit të ankimit dhe në rast se pas ankimit gjykata vlerëson të ligjshëm sekuestrimin, pajisjet e bllokuara konfiskohen dhe kalojnë në pronësi të shtetit.

5. Kur personat e autorizuar nga AMA zbulojnë se pajisjet transmetuese të OSHMA-së shkaktojnë interferenca të dëmshme, pavarësisht se për përdorimin e tyre është marrë licenca ose autorizimi përkatës, kanë të drejtë të bëjnë ndalimin e funksionimit të tyre.

6. Bllokimi dhe ndalimi i funksionimit të pajisjeve, sipas këtij neni, tregohet me një vulë, përmbajtja dhe forma e të cilës përcaktohen nga AMA.

7. Përkundrejt kërkesës me shkrim të subjektit që ka shkaktuar interferencën, personi i autorizuar nga AMA bën verifikimin e nevojshëm dhe, nëse vëren se interferencat e dëmshme janë shmangur, lejon funksionimin e mëtejshëm të pajisjes së ndaluar.

8. Për zbatimin e detyrave për bllokimin e pajisjeve, AMA bashkëpunon me autoritetet publike lokale, Policinë e Shtetit dhe shërbimin përmbartimor.

Neni 81

Njoftimi

1. Njoftimi i OSHMA-ve ose personave të tjerë, i përcaktuar në këtë kre duhet t'u drejtohet atyre në një nga mënyrat e mëposhtme:

- a) duke e dërguar atë në adresën ku OSHMA-ja ose personi tjetër kryen veprimtarinë e tij;
- b) duke e dërguar atë me postë rekomande në adresën e përmendur në shkronjën "a" të kësaj pike;
- c) duke e dërguar atë nëpërmjet postës elektronike ose faksit në adresën dhe faksin e OSHMA-së ose personit tjetër, vetëm nëse ekziston mundësia e konfirmimit të marrjes së postës elektronike, ose aparati i faksit siguron konfirmimin e të gjitha faqeve të njoftimit. Në këtë rast, njoftimi duhet të dërgohet edhe në një nga mënyrat e parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike.

2. Për qëllim të këtij neni, shoqëria e regjistruar sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare, prezumohet se ka adresë atë, në të cilën është regjistruar.

3. Një kopje e njoftimit nënshkruhet nga personi i autorizuar për të ushtruar inspektimin, duke deklaruar përgjegjësinë e tij personale që akti i njoftimit është një dokument zyrtar.

KREU XI

SHËRBIMET E MBROJTURA

Neni 82

Ofrimi i shërbimeve me akses të kushtëzuar

1. Ofrimi i shërbimeve me akses të kushtëzuar dhe shërbimet shoqëruese/mbështetëse të tyre realizohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga ky ligj dhe rregullat e nxjerra nga AMA. Me anë të rregullave të nxjerra në zbatim të këtij ligji, AMA siguron që shërbimet e mbrojtura ofrohen në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese.

2. AMA ka të drejtë të imponojë detyrime për ofruesit e shërbimeve me akses të kushtëzuar në masën e nevojshme për të siguruar marrjen nga përdoruesit të shërbimeve audio dhe audiovizive, sipas specifikimeve të këtij ligji.

3. Ofruesit e shërbimit me akses të kushtëzuar sigurojnë akses në ndërfaqet/përshtatësit e programeve të aplikimit ose në udhëzuesit elektronikë të programeve në kushte të ndershme, jodiskriminuese dhe të përshtatshme.

4. AMA përcakton kushtet e funksionimit të pajisjeve të televizionit numerik për përdoruesit.

Neni 83

Sistemet e aksesit të kushtëzuar

1. Sistemet e aksesit të kushtëzuar për shërbimet radiotelevizive numerike duhet të kenë kapacitetet e nevojshme teknike për të mundësuar që operatorët e rrjeteve të kenë kontrollin e plotë mbi shërbimet që përdorin këto sisteme.

2. Ofruesit e shërbimeve të aksesit të kushtëzuar, që sigurojnë aksesin në shërbimet radio dhe televizive numerike, janë të detyruar t'u ofrojnë të gjithë OSHMA-ve, në kushte të ndershme, të arsyeshme dhe jo diskriminuese, asistencë teknike, që mundëson abonentët e tyre të kenë akses në shërbimet e ofruara me anë të dekodeve.

3. Për ofrimin e shërbimit të aksesit të kushtëzuar, operatorët që ofrojnë këtë shërbim mbajnë llogari të ndara nga pjesa tjetër e aktivitetit.

Neni 84

Aktivitetet të ndaluara për aksesin e kushtëzuar

Në territorin e Republikës së Shqipërisë ndalohet kryerja e aktiviteteve të mëposhtme:

1. Prodhimi, importimi, shpërndarja, shitja, dhënia me qira ose posedimi për qëllime tregtare të pajisjeve të ndaluara.
2. Instalimi, mirëmbajtja ose zëvendësimi për qëllime tregtare të një pajisje të ndaluar.
3. Përdorimi i komunikimeve tregtare për promovimin e pajisjeve të ndaluara.

Neni 85

Kriteret për mbrojtjen e aksesit të kushtëzuar

1. Mosrespektimi i detyrimeve të përcaktuara në nenin 84 të këtij ligji, kur nuk përbën vepr penale, ndëshkohet me gjobë sipas përcaktimeve të nenit 133 të këtij ligji. Masa e ndëshkimit duhet të jetë efektive dhe në proporcion me dëmin e shkaktuar.

2. Ofruesit e shërbimeve me akses të kushtëzuar, interesat e të cilëve cenohen nga një veprimtari e paligjshme, kanë të drejtë të kërkojnë kompensim për dëmin e shkaktuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rast konstatimi të kësaj veprimtarie, AMA bashkëpunon me organet kompetente dhe, kur e shih të arsyeshme, kërkon nxjerrjen jashtë tregut të pajisjeve të paligjshme.

Neni 86

Udhëzuesi elektronik i programit

1. Udhëzuesi elektronik i programit është mënyra elektronike e informimit të publikut lidhur me listën dhe orarin e programeve nga shërbimi i transmetimit, e cila është pjesë përbërëse e sistemit të transmetimit.

2. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë të përgatisë dhe të vërë në përdorim një ose më shumë udhëzues elektronikë të programit, sipas një autorizimi të dhënë nga AMA.

3. Autorizimi për udhëzuesin elektronik të programit duhet të përfshijë kushtet e përcaktuara në rregulloren e përgatitur nga AMA për këtë qëllim. Kjo rregullore përcakton:

- a) formën e paraqitjes së informacionit;
- b) listën dhe oraret e programeve;
- c) përparësinë e renditjes së shërbimeve të ofruara nga RTSH-ja brenda udhëzuesit;
- ç) përparësinë e renditjes së ofruesve të tjerë të shërbimeve mediatike;
- d) kushtet për përdorimin sa më të thjeshtë të udhëzuesit elektronik nga përdoruesit për të marrë lehtësisht informacionin për listën dhe orarin e programeve objekt i licencës.

4. AMA ka të drejtë të udhëzojë RTSH-në ose një të licencuar, si ofrues i shërbimeve mediatike, të përdorë udhëzuesin elektronik të programit të licencuar sipas pikës 3 të këtij neni.

Neni 87

Detyrimet e mbartjes

1. AMA ka të drejtë t'u vendosë OSHMA-ve detyrime të arsyeshme për transmetimin e një ose më shumë programeve audio dhe audiovizive me interes të përgjithshëm për publikun, me qëllim marrjen e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë në nivel kombëtar, rajonal ose lokal.

2. Detyrimet e mbartjes, sipas pikës 1 të këtij neni, imponohen në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe transparencës, vetëm ndaj operatorëve të komunikimeve elektronike, rrjetet e të cilëve shfrytëzohen nga një numër i konsiderueshëm përdoruesish, si mjet kryesor për marrjen e programeve audiovizive, dhe vetëm nëse kjo është në interes të publikut.

3. Në rastin e aplikimit të pagesave për mbartjen e programeve, në përputhje me detyrimet e përcaktuara pikës 1 të këtij neni, ato caktohen në përputhje me parimet e proporcionalitetit, transparencës dhe mosdiskriminimit.

4. AMA verifikon periodikisht zbatimin e detyrimeve të mbartjes, sipas pikës 1 të këtij neni. Çdo OSHMA, ndaj të cilit është vendosur detyrimi i mbartjes, ka të drejtë t'i kërkojë AMA-s rishqyrtimin e këtyre detyrimeve pas një periudhe 2-vjeçare nga fillimi i këtij detyrimi.

Neni 88

Ndryshimi i kushteve të licencës

1. AMA ndryshon kushtet e licencës së transmetimit audio dhe/ose audiovizive me nismën e vet:

a) kur ka ndryshuar Plani Kombëtar i Frekuencave ose Plani i Përdorimit të Frekuencave ose rregullat për kushtet e përdorimit të frekuencave;

b) për nevoja publike, që nuk mund të plotësohen në mënyrë tjetër;

c) kur ndryshimi i kërkuar i shërben përdorimit eficient të frekuencave dhe është me interes publik;

ç) kur interferencat e dëmshme nuk mund të shmangen në mënyrë tjetër;

d) kur ndryshimi buron nga aktet ndërkombëtare, të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

2. I licencuari përballon, me shpenzimet e veta, kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme, që burojnë nga ndryshimet në kushtet e licencës së transmetimit audio dhe/ose audiovizive.

Neni 89

Gjendja e jashtëzakonshme

1. Gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme, AMA, me kërkesë të organeve kompetente të menaxhimit të kësaj gjendjeje, mund të nxjerrë urdhër për pezullimin e lejes së transmetimit ose të lejes së funksionimit të rrjetit. Vendimi i AMA-s, duhet të jetë proporcional, objektiv dhe jodiskriminues për OSHMA-të.

2. AMA mund t'i kërkojë të licencuarit të transmetimit, të bashkëpunojë me autoritetet përkatëse publike për përhapjen e informacioneve përkatëse gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme.

3. Kur AMA ushtron kompetencën e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, i licencuari i transmetimit ose i rrjetit të transmetimit ka të drejtë të kërkojë mbulimin e shpenzimeve të nevojshme për zbatimin e kushteve të përcaktuara në urdhrin e AMA-s dhe kompensimin për dëmet e shkaktuara pronës së tij, si rrjedhojë e zbatimit të këtij urdhri.

4. Me kërkesë të organeve kompetente të menaxhimit të gjendjes së jashtëzakonshme, AMA udhëzon të licencuarin e transmetimit, për të vënë në dispozicion kohë transmetimi për njoftimet e institucioneve shtetërore, lidhur me gjendjen e jashtëzakonshme.

KREU XII
RADIOTELEVISIONI PUBLIK SHQIPTAR (RTSH)

Neni 90

Emërtimi, vendndodhja

1. Radio e Televizioni Shqiptar (RTSH) është person juridik publik, jo me qëllim fitimi, me seli në Tiranë, që kryen shërbimet e transmetimit publik në fushën e shërbimeve audio dhe audiovizive në Republikën e Shqipërisë. RTSH-ja ka stemën dhe vulën e saj të përcaktuar nga statuti i saj.

2. Veprimtaria e RTSH-së rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, deklaratës së qëllimit, kontratës së shërbimit të transmetimit publik të miratuar sipas nenit 117 dhe statutit të saj.

3. Në përbërjen e saj RTSH-ja ka edhe persona të tjerë juridikë, sipas përcaktimeve të Statutit të saj. Këta persona kanë zotësi juridike të kufizuar për të vepruar.

Neni 91

Deklarata e Qëllimit

1. Si një OSHMA i përkushtuar ndaj idealeve më të larta të transmetimit të shërbimit publik kombëtar, RTSH-ja realizon shërbime cilësore radioje dhe televizioni për të informuar, edukuar dhe argëtuar publikun, duke i shërbyer kombit, të gjitha grupeve të shoqërisë, përfshirë dhe pakicat kombëtare.

2. RTSH-ja zotohet për një mbulim të paanshëm të lajmeve të vendit dhe të atyre ndërkombëtare.

3. RTSH-ja realizon programe, të cilat duhet të pasqyrojnë të dëgjuesit dhe shikuesit e të gjitha moshave larminë e jetës shqiptare. RTSH-ja përgatit programe cilësore e me vlera për pasurimin e botës mendore dhe shpirtërore të njerëzve.

Neni 92

Organet drejtuese

Organet drejtuese të RTSH-së janë:

- a) Këshilli Drejtues (KDRTSH).
- b) Drejtori i Përgjithshëm.
- c) Bordi i Administrimit.

Neni 93

Përbërja e KDRTSH-së

1. KDRTSH-ja përbëhet nga Kryetari dhe 10 anëtarë.

2. Kandidat për t'u zgjedhur anëtar i KDRTSH-së mund të jetë çdo person, i cili ka përvojë pune jo më pak se 10 vjet në fushat e:

- a) medias në përgjithësi;
- b) transmetimeve audiovizive të shërbimit publik, tregtar ose jotregtar;
- c) prodhimit të përmbajtjes së transmetimeve audiovizive;
- ç) teknologjive të medias;
- d) ekonomisë, administrimit dhe rregullave të konkurrencës;
- dh) çështjeve të zhvillimit të gjuhës shqipe;
- e) çështjeve që lidhen me personat me aftësi të kufizuar e grupeve të tjera vulnerabël;
- ë) artit, kulturës e muzikës;
- f) drejtësisë, ligjit, administrimit publik;

- g) shkencës, mjedisit dhe zhvillimit teknologjik;
- gj) mbrojtjes së konsumatorit;
- h) veprimtarive shoqërore, edukuese dhe zhvillimit të bashkësive lokale, publike e kombëtare, të cilat kanë lidhje ose ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi qëllimet e veprimtarisë audiovizive, siç përcaktohet në këtë ligj.

Neni 94

Zgjedhja e anëtarëve të KDRTSH-së

1. Anëtarët e KDRTSH-së zgjidhen nga Kuvendi për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

2. Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, brenda 30 ditëve nga krijimi i një vendi vakant, fton me anë të mjeteve të informimit publik për paraqitjen e kandidaturave, subjektet e mëposhtme:

- a) shoqatat dhe grupimet e mediave elektronike;
- b) shoqatat e medias së shkruar;
- c) profesoratin dhe shoqatat e inxhinierisë elektrike dhe elektronike;
- ç) profesoratin e së drejtës, gazetari-komunikimit dhe ekonomisë, shoqatat e juristëve dhe Dhomen Kombëtare të Avokatisë;
- d) organizatat jofitimprurëse që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të drejtave të fëmijëve ose kërkimeve në politikat publike, ose përfaqësues të shoqatave që veprojnë në fushën e mbrojtjes së personave me aftësi të kufizuar.

Subjektet e mësipërme propozojnë kandidaturat brenda 30 ditëve nga marrja e ftesës.

3. Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik bën përzgjedhjen sipas përcaktimeve të neneve 93 dhe 97 të këtij ligji, mes të paktën 4 kandidaturave për çdo vend anëtar i KDRTSH-së.

4. Për përzgjedhjen e kandidaturave alternative për çdo vend anëtar i KDRTSH-së, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik zbaton procedurën e mëposhtme:

- a) shqyrton të gjitha kandidaturat e paraqitura nga subjektet propozuese;
- b) kandidaturat e administruara, në bazë të propozimeve të mësipërme, i nënshtrohen përjashtimit një nga një. Procedura e përjashtimit zbatohet sipas radhës: një nga përfaqësuesit e shumicës parlamentare dhe një nga përfaqësuesit e opozitës.

Në çdo rast komisioni mban parasysh ruajtjen e balancës, pesë kandidatë të mbështetur nga maxhoranca, pesë të mbështetur nga opozita. Kandidatët për anëtarë të KDRTSH-së i propozohen për miratim seancës plenare.

Përjashtimi i çdo kandidature duhet të argumentohet duke garantuar respektimin e parimit të moscenimit të integritetit personal dhe profesional të kandidatëve.

5. Pas përfundimit të mandatit, anëtar i KDRTSH-së, qëndron në detyrë deri në zgjedhjen e anëtarit të ri.

Neni 95

Zgjedhja e Kryetarit të KDRTSH-së

1. Anëtar i njëmbëdhjetë dhe njëkohësisht Kryetari i KDRTSH-së zgjidhet jo më vonë se 10 ditë pasi të ketë përfunduar procedura e zgjedhjes së anëtarëve të KDRTSH-së, sipas nenit 94 të këtij ligji.

2. Jo më vonë se 30 ditë para datës së mbarimit të mandatit të Kryetarit të KDRTSH-së, Kuvendi i Shqipërisë publikon shpalljen për vendin vakant të Kryetarit të KDRTSH-së. Çdo shtetas që plotëson kushtet e neneve 93 dhe 97 të këtij ligji mund të paraqitet si kandidat për Kryetar i KDRTSH-së. Kërkesa paraqitet e shoqëruar me dokumentacionin përkatës, që provon përmbushjen e kriterëve ligjorë për anëtar të KDRTSH-së.

3. Lista e kandidatëve i kalon Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik për të verifikuar përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në këtë ligj. Në këtë listë nuk mund të përfshihen ose, nëse janë përfshirë, përjashtohen kandidatët e propozuar për anëtarë të KDRTSH-së, sipas pikës 4 të nenit 94 të këtij ligji. Komisioni, pas verifikimit të kandidaturave, zbaton procedurën si më poshtë:

- a) identifikon katër kandidatët që kanë marrë mbështetjen më të madhe midis anëtarëve të komisionit. Çdo anëtar i komisionit mund të mbështesë deri në katër kandidatë;
- b) nëse dy apo më shumë kandidatë gëzojnë të njëjtën mbështetje, përzgjedhja e tyre bëhet me short;
- c) përfaqësuesit e pakicës parlamentare në komision përjashtojnë dy nga katër kandidatët e përzgjedhur. Kandidatët e mbetur i kalojnë Kuvendit për votim;
- ç) kryetar i KDRTSH-së zgjidhet kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të deputetëve të Kuvendit.

Neni 96

Zëvendëskryetari i KDRTSH-së

1. KDRTSH-ja zgjedh si Zëvendëskryetar një nga anëtarët e tij, të zgjedhur mbi bazën e mbështetjes së propozimit të opozitës, sipas pikës 4 të nenit 94 të këtij ligji.
2. Zgjedhja zhvillohet me votim të fshehtë, sipas procedurës së mëposhtme:
 - a) në një fletë votimi shkruhen emrat e pesë anëtarëve të KDRTSH-së, sipas pikës 1 të këtij neni;
 - b) secili prej anëtarëve voton, duke bërë shënimin përkatës, për një nga emrat që janë në fletëvotim;
 - c) anëtari që ka marrë 7 vota zgjidhet Zëvendëskryetar i KDRTSH-së;
 - ç) në rast se asnjë prej kandidatëve nuk ka marrë numrin e kërkuar të votave, bëhet një raund i dytë votimi. Anëtari që merr më shumë vota në raundin e dytë zgjidhet Zëvendëskryetar i KDRTSH-së. Votimi zhvillohet brenda së njëjtës dite;
 - d) mbledhja për zgjedhjen e Zëvendëskryetarit, kur mungon Kryetari, drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë i KDRTSH-së dhe procedura e zgjedhjes zhvillohet në prani të një noteri.

Neni 97

Papajtueshmëritë dhe konflikti i interesave të anëtarëve të KDRTSH-së

1. Anëtarë të KDRTSH-së nuk mund të jenë individët që:
 - a) janë anëtarë të partive dhe shoqatave politike, kandidojnë për deputet apo janë zgjedhur të tillë gjatë 2 legjislativave të fundit, kanë konkurruar për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore në zgjedhjet e fundit të organizuara për to apo kanë ushtruar detyrën e kryetarit të bashkisë, anëtarit të Këshillit të Ministrave apo të prefektit gjatë 3 vjetëve të fundit, si dhe ata që janë anëtarë të Këshillit të Ankesave, AKEP-it apo punonjës të këtij të fundit;
 - b) janë persona të lidhur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” ose që kanë në pronësi pjesë kapitali apo aksione të shoqërive tregtare, si dhe të drejta të tjera në fushën e transmetimeve audiovizive, reklamës, prodhimeve të përmbajtjes së transmetimeve audiovizive, rrjeteve të komunikimit elektronik apo persona të punësuar gjatë vitit të fundit, anëtarë të organeve drejtuese apo këshilluese të këtyre subjekteve apo të lidhur me ndonjë licencë me këto subjekte.
2. Anëtarët e KDRTSH-së duhet të deklarojnë:
 - a) çdo interes apo lidhje me ndonjë subjekt, me të cilin RTSH-ja ka realizuar ose synon të realizojë;

b) çdo interes të mundshëm në ndonjë kontratë, që RTSH-ja ka realizuar ose synon të realizojë.

3. Anëtarët e KDRTSH-së nuk mund të marrin pjesë në diskutimin apo vendimmarrjen e çështjeve të lidhura me këta interesa apo lidhje.

4. KDRTSH-ja harton një kod sjelljeje lidhur me rregullimin e veprimtarisë së vet për çështjet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në bazë të përcaktimeve të këtij ligji dhe të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, si dhe miraton kodet e të njëjtit lloj për drejtuesit e strukturave dhe punonjësit e RTSH-së.

Neni 98

Shpërblimi

1. Për pjesëmarrje në mbledhje, Kryetari dhe anëtarët e KDRTSH-së përfitojnë një shpërblim mujor fiks. Kuvendi cakton me vendim masën e shpërblimit të anëtarit të KDRTSH-së.

2. Kryetari përfiton një shpërblim 20 për qind më të lartë se ai i anëtarit.

Neni 99

Organizimi i KDRTSH-së

(bequr fjalë në pikën 6, me ligjin nr. 22/2016, datë 10.3.2016)

1. KDRTSH-ja, në mbledhjen më të parë, cakton afatin kohor për hartimin e rregullores së veprimtarisë së tij.

2. KDRTSH-ja mbledhet sa herë është e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të veta por jo më pak se një herë në 2 muaj. Ai mund të mbledhet jashtë programit të vet kur mbledhjen e kërkojnë Kryetari i KDRTSH-së, Drejtori i Përgjithshëm, Kryetari i Bordit të Administrimit ose 3 anëtarë.

3. Drejtori i Përgjithshëm, Kryetari i Bordit të Administrimit, kryetarët e këshillave të krijuara për çështje të ndryshme dhe drejtues të administratës dhe subjekteve përbërëse të RTSH-së kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e KDRTSH-së, me kërkesë të këtij të fundit apo me kërkesë të tyre, përveç rasteve kur KDRTSH-ja vendos ndryshe.

4. Mbledhjet e KDRTSH-së janë të vlefshme kur në to marrin pjesë shumica e anëtarëve. Vendimet e KDRTSH-së merren me shumicën e votave të pjesëmarrësve, me përjashtim të rasteve, kur kërkohet shumicë e cilësuar për marrjen e vendimit, sipas pikës 6 të këtij neni.

5. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë dhe votimi nuk ka qenë i fshehtë, vota e kryetarit është vendimtare.

6. Vendimet e KDRTSH-së për miratimin e rregullores së veprimtarisë së tij, statutin e RTSH-së dhe shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm quhen të miratuara, kur për to votojnë pro jo më pak se 7 anëtarë.

Neni 100

Lirimi nga detyra

1. Kryetari, Zëvendëskryetari dhe çdo anëtar i KDRTSH-së lirohet nga detyra nga organi që e zgjedh kur:

- a) dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- b) bëhet i paaftë përgjithmonë për kryerjen e detyrës për shkaqe shëndetësore;
- c) mungon pa arsye në më shumë se një të tretën e mbledhjeve të KDRTSH-së, brenda 1 viti;
- ç) vërtetohet se ka shkelur detyrimet e nenit 97 të këtij ligji;
- d) i hiqet zotësia për të vepruar.
- dh) jep dorëheqjen.

2. Lirimi nga detyra i një anëtar i KDRTSH-së mund të kërkohej nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ose jo më pak se 7 anëtarë të KDRTSH-së. Kuvendi e shqyrton kërkesën brenda 10 ditëve.

3. Para se të lirohet një anëtar i KDRTSH-së, atij i jepet mundësia për të parashtruar pretendimet e tij para Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Vendimi për të liruar Kryetarin, Zëvendëskryetarin, një anëtar ose më shumë se një anëtar duhet të jetë i bazuar në ligj dhe i arsyetuar për shkaqet që çojnë në lirim të tyre. Vendimi i Kuvendit publikohet.

4. Kryetari, Zëvendëskryetari dhe çdo anëtar i KDRTSH-së mund të japë dorëheqjen me shkrim në çdo kohë. Dorëheqja i paraqitet KDRTSH-së në mbledhjen e radhës dhe i dërgohet Kuvendit sa më parë.

5. Kur konstatohet njëri nga rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, Kryetari i KDRTSH-së njofton me shkrim brenda 5 ditëve Kuvendin.

6. Në çdo rast lirimi zgjidhet një zëvendësues, duke ndjekur procedurën e parashikuar për zgjedhjen dhe për një kohë të barabartë me kohën që i kishte mbetur pararendësit që u lirua.

Neni 101

Detyrat e anëtarëve të KDRTSH-së

Anëtarët e KDRTSH-së ushtrojnë funksionin e tyre në mënyrë të tillë që:

- a) të përfaqësojnë interesat e shikuesve dhe dëgjuesve;
- b) të sigurojnë që veprimtaria e RTSH-së në përgjithësi dhe e subjekteve përbërëse të tij në veçanti të realizohet në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe statutit të vet;
- c) të sigurojnë pavarësinë e RTSH-së lidhur me krijimin, prodhimin dhe përmbajtjen e materialeve programore, përpilimin dhe paraqitjen e programeve të lajmeve dhe çështjeve me interes publik dhe mosndërhyrjen e shtetit, politikës dhe biznesit në këto veprimtari.

Neni 102

Kompetencat e KDRTSH-së

(ndryshuar pika 3, dhe shtuar pika 3/1, me ligjin nr. 22/2016, datë 10.3.2016)

KDRTSH-ja ka këto kompetenca:

1. Miraton rregulloren e veprimtarisë së saj.
2. Miraton statutin e RTSH-së, në të cilin përcakton:
 - a) strukturën e institucionit;
 - b) organet drejtuese dhe kompetencat e tyre;
 - c) kriteret dhe procedurat për emërimin dhe lirim të Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm, të drejtorëve të radios dhe televizionit, subjekteve përbërëse të RTSH-së, si dhe të shefave të departamenteve;
 - ç) përshkrimin e punës për të gjitha kategoritë e punonjësve;
 - d) përshkrimin e veprimtarisë së RTSH-së, përfshirë atë ekonomike dhe financiare.
3. Emëron Drejtorin e Përgjithshëm me tre të pestat e votave të të gjithë anëtarëve të tij në votimin e parë, në votimin e dytë ose në votimin e tretë. Nëse në votimin e parë nuk arrihet shumica prej tre të pestave, KDRTSH-ja cakton menjëherë datën e kryerjes së votimit të dytë, i cili zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga kryerja e votimit të parë. Në rast se edhe në votimin e dytë nuk arrihet shumica prej tre të pestave, KDRTSH-ja cakton menjëherë datën e kryerjes së votimit të tretë, i cili zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga kryerja e votimit të dytë. Në rast se edhe në votimin e tretë nuk arrihet shumica prej tre të pestave, KDRTSH-ja cakton menjëherë datën e kryerjes së votimit të katërt, i cili zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga kryerja e votimit të tretë. Në votimin e katërt dhe të pestë KDRTSH-ja vendos për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm me më shumë se gjysmën e votave të të gjithë anëtarëve të tij. Votimi i pestë kryhet në rastin kur në votimin e katërt asnjë kandidat nuk ka siguruar shumicën e kërkuar të votave dhe zhvillohet jo

më vonë se 7 ditë nga kryerja e votimit të katërt. Votimi i pestë zhvillohet vetëm midis dy kandidatëve që kanë marrë më shumë vota në votimin e katërt. Në rast se ka më shumë se dy kandidatë me të njëjtin numër votash, kandidati që merr pjesë në votim caktohet me short. Në rast se edhe pas votimit të pestë asnjë kandidat nuk siguron shumicën e kërkuar, KDRTSH-ja shpërndahet.

3/1. Liron Drejtorin e Përgjithshëm me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të tij.

4. Emëron dhe liron Zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm dhe drejtorët e subjekteve përbërëse të RTSH-së me shumicë të thjeshtë votash, sipas propozimeve të Drejtorit të Përgjithshëm, jo më vonë se 2 javë pas propozimit të këtij të fundit.

5. Emëron anëtarët e Bordit të Administrimit, të propozuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

6. Miraton ngritjen e këshillave të dëgjuesve dhe shikuesve apo komiteteve këshillimore, sipas statutit.

7. Miraton planin strategjik të propozuar nga Drejtori i Përgjithshëm, lidhur me përcaktimin e shërbimeve të transmetimit, ngritjen e shërbimeve të reja dhe shfrytëzimin e burimeve dhe pasurive të RTSH-së, në përputhje me mundësitë ekzistuese.

8. Miraton platformën, strukturën organizative dhe strukturën programore të RTSH-së.

9. Miraton Deklaratën e Qëllimit të RTSH-së dhe subjekteve përbërëse të tij, sipas përcaktimeve në statut, lidhur me veprimtaritë e propozuara për t'u realizuar gjatë një afati 5-vjeçar për përmbushjen e qëllimeve të shërbimit të transmetimit publik, si dhe deklaratat njëvjeçare në lidhje dhe në përputhje me Deklaratën e Qëllimit.

10. Miraton propozimet për çeljen e kanaleve apo shërbimeve të reja të RTSH-së, para se ky propozim t'i paraqitet AMA-s.

11. Mbikëqyr paanshmërinë, objektivitetin dhe tërësinë e informacionit audioviziv.

12. Miraton kriteret kryesore për marrjen në punë, vlerësimin e punës dhe shpërblimin e punonjësve.

13. Këshillon Drejtorin e Përgjithshëm në lidhje me programet dhe ndihmon në caktimin e normave dhe të koncepteve programore, në përputhje me ligjin.

14. Këshillon dhe ndihmon Drejtorin e Përgjithshëm në realizimin e përgjegjësive të tij.

15. Shqyrton dhe miraton kërkesat për transmetime të caktuara, rregullimin e procedurave të arkivimit dhe ruajtjes së arkivave, si dhe miraton rregulloret për porositjen apo marrëveshjet e transmetimit për prodhuesit e pavarur të përmbajtjes dhe programet nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian, sipas kërkesave të këtij ligji.

16. Shqyrton dhe miraton buxhetin vjetor, kontratat me vlerë mbi 1 për qind të buxhetit vjetor, huatë, qiratë dhe raportet ekonomiko-financiare të RTSH-së, si dhe çdo propozim për hyrjen në marrëdhënie ekonomiko-civile.

17. Shqyrton dhe miraton huamarrjet para se t'i dërgohet për marrje mendimi Ministrit të Financave.

18. Harton raport për veprimtarinë vjetore të RTSH-së, në përputhje me kërkesat e këtij neni dhe ia paraqet atë Kuvendit në fund të muajit mars të çdo viti për vitin paraardhës.

Neni 103

Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së

1. Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së drejton dhe kontrollon administrimin e veprimtarisë së RTSH-së, si dhe mban përgjegjësinë editoriale të saj.

2. Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së zgjidhet me votim të fshehtë nga KDRTSH-ja për një periudhë 5-vjeçare ndërmjet jo më pak se 2 kandidaturave.

3. Përzgjedhja e kandidaturave bëhet nga KDRTSH-ja, mbi bazën e konkurrimit të hapur dhe kriterëve të përcaktuara në statutin e RTSH-së.

Papajtueshmëritë dhe konflikti i interesave të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së

1. Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së nuk lejohet:

a) të jetë anëtar i partive dhe shoqatave politike, kandidat për deputet apo të jetë zgjedhur i tillë gjatë 2 legjislaturave të fundit, të ketë konkurrar për kryetar të njësisë vendore në zgjedhjet e fundit të organizuara për to apo kanë ushtruar detyrën e kryetarit të bashkisë, anëtarit të Këshillit të Ministrave apo të prefektit gjatë 3 vjetëve të fundit, si dhe ata që janë anëtarë të Këshillit të Ankesave, AKEP-it apo punonjës të këtij të fundit;

b) të jetë person i lidhur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” ose që ka në pronësi pjesë kapitali apo aksione të shoqërive tregtare, si dhe të drejta të tjera në fushën e transmetimeve audiovizive, reklamës, prodhimeve të përmbajtjes së transmetimeve audiovizive, rrjeteve të komunikimit elektronik apo persona të punësuar gjatë vitit të fundit, anëtarë të organeve drejtuese apo këshilluese të këtyre subjekteve apo të lidhur me ndonjë licencë me këto subjekte.

2. Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së nuk lejohet të kryejë ndonjë detyrë, veprimtari fitimprurëse ose të jetë i lidhur në ndonjë marrëdhënie punësimi të dytë gjatë kohës që është në detyrë.

Detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së

1. Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së:

a) drejton veprimtarinë e RTSH-së, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të statutit të RTSH-së;

b) me kërkesë të KDRTSH-së, informon këtë të fundit lidhur me çdo informacion të nevojshëm në lidhje me funksionet e tij dhe funksionimin e RTSH-së;

c) emëron, liron apo shkarkon nga detyra, vetë ose me propozim të drejtorëve të subjekteve përbërëse të RTSH-së, drejtuesit e departamenteve dhe të sektorëve;

ç) përgjigjet për programet, në mënyrë që ato të jenë në përputhje me parimet e programimit, të vendosura me këtë ligj, në Deklaratën e Qëllimit dhe në statut;

d) merr vendime që lidhen me çështje të organizimit, financave dhe pagave, pasi të jetë konsultuar me Bordin e Administrimit, në bazë të kriterëve të përcaktuara nga KDRTSH-ja;

dh) përfaqëson zyrtarisht RTSH-në në marrëdhëniet me të tretët;

e) përgjigjet për ligjshmërinë në veprimtarinë e institucionit;

ë) bashkërendon punën e njësisë administrative të sistemit të RTSH-së dhe zgjidh, brenda kompetencave të tij, mosmarrëveshjet e lindura midis tyre;

f) në mungesë mund të delegojë ushtrimin e kompetencave të tij me disponim të posaçëm personit përkatës.

2. Gjatë mungesave objektive apo mbetjes vakant të vendit të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së, deri në zgjedhjen e drejtorit të ri, detyrat e tij i kryen zëvendës-drejtori ose, në rast të mungesës së këtij të fundit, një anëtar i administratës drejtuese të RTSH-së, i caktuar për këtë qëllim nga KDRTSH-ja.

3. Kriteret e emërimit, detyrat dhe kompetencat specifike të Zëvendës-drejtorit të Përgjithshëm përcaktohen në statut.

Lirimi nga detyra i Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së

Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së lirohet nga detyra në rastet kur:

a) shkel kompetencat që i jep ky ligj;

- b) kryen një vepër penale, për të cilën është dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë;
- c) bëhet i paaftë përgjithmonë për kryerjen e detyrës, për shkaqe shëndetësore;
- ç) i hiqet zotësia për të vepruar;
- d) jep dorëheqjen.

Neni 107

Bordi i Administrimit të RTSH-së

1. Bordi i Administrimit është organ këshillimor i KDRTSH-së dhe organ kompetent për përgatitjen e analizave që lidhen me çështjet financiare të RTSH-së, të brendshme dhe të jashtme, përveç çështjeve që kanë të bëjnë me programimin.

2. Bordi i Administrimit përbëhet nga 5 anëtarë, 3 të brendshëm dhe 2 të jashtëm, të cilët janë ekspertë në problemet e administrimit, financës dhe biznesit. Anëtarët e Bordit të Administrimit caktohen për një periudhë 4-vjeçare dhe mund të ricaktohen për dy periudha të tjera, në rast se gjatë kësaj kohe nuk kapërcejnë kufirin e moshës për pension.

3. Anëtarët e Bordit të Administrimit emërohen nga KDRTSH-ja me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë midis të paktën 10 kandidaturave.

4. Kryetari i Bordit zgjidhet nga anëtarët e tij me shumicë votash dhe me votim të fshehtë ndërmjet të paktën 2 kandidaturave.

Neni 108

Lirimi nga detyra i anëtarëve të Bordit të Administrimit

Anëtari i i Bordit të Administrimit lirohet nga detyra në rastet kur:

- a) shkel detyrimet, me të cilat i ngarkon ky ligj dhe rregullorja e miratuar për veprimtarinë e bordit;
- b) vërehet se është i paaftë për kryerjen e detyrës nga jo më pak se 5 anëtarë të KDRTSH-së;
- c) mungon pa arsye në katër mbledhje radhazi;
- ç) dënohet për një vepër penale;
- d) jep dorëheqjen.

Neni 109

Papajtueshmëritë dhe konflikti i interesave të anëtarëve të Bordit të Administrimit

1. Anëtarë të Bordit të Administrimit nuk mund të jenë individët që:

a) janë persona të lidhur ose kanë në pronësi kuota kapitali apo aksione të shoqërive tregtare, si dhe të drejta të tjera në fushën e transmetimeve audiovizive, reklamës, prodhimeve të përmbajtjes së transmetimeve audiovizive, rrjeteve të komunikimit elektronik apo persona të punësuar, anëtarë të organeve drejtuese apo këshilluese të këtyre subjekteve ose të lidhur me ndonjë kontratë me këto subjekte;

b) janë zgjedhur anëtarë të KDRTSH-së;

c) kandidojnë për deputet apo janë zgjedhur të tillë;

ç) janë anëtarë të forumeve drejtuese të ndonjë partie politike;

d) janë kryetarë komunash, bashkish, qarqesh dhe prefektë;

dh) janë anëtarë të AMA-s, AKEP-it apo punonjës të këtyre institucioneve.

2. Anëtarëve të Bordit të Administrimit nuk u lejohet që, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, të përfaqësojnë interesat e palëve të treta ose të konkurrentëve të institucionit, si dhe të jenë të lidhur me interesa biznesi me konkurrentë ose palë të treta.

3. Anëtarët e Bordit të Administrimit duhet të deklarojnë:

a) çdo interes apo lidhje me ndonjë subjekt, me të cilin RTSH-ja ka realizuar ose synon të realizojë kontratë;

b) çdo interes të mundshëm në ndonjë kontratë, që RTSH-ja ka realizuar ose synon të realizojë.

4. Nuk mund të marrin pjesë në diskutimin apo vendimmarrjen e çështjeve të lidhura me këta interesa apo lidhje.

5. Kërkesat e kodit të sjelljes, të miratuar nga KDRTSH-ja sipas pikës 4 të nenit 97 të këtij ligji, janë të detyrueshme për anëtarët e Bordit të Administrimit.

Neni 110

Organizimi i Bordit të Administrimit

1. Bordi i Administrimit mbledhet sipas kalendarit të çështjeve të miratuara prej tij, jo më pak se një herë në muaj. Bordi mbledhet jashtë radhe sa herë e kërkojnë të paktën 2 prej anëtarëve të tij, KDRTSH-ja ose Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së.

2. Në mbledhjen e parë, Bordi i Administrimit përcakton afatin për miratimin e rregullores së tij të brendshme, ku shpreh qartë procedurat e veprimtarisë së këtij organizmi. Rregullorja miratohet me shumicën e votave të anëtarëve të Bordit.

3. Vendimet e Bordit të Administrimit janë të vlefshme kur për to votojnë shumica e anëtarëve të pranishëm. Kur numri i votave është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.

Neni 111

Detyrat e Bordit të Administrimit

Bordi i Administrimit ka këto detyra:

1. Përpilon rregulla për çështjet financiare, të cilat janë në juridiksionin e Drejtorit të Përgjithshëm.

2. Jep mendim për projektbuxhetin e RTSH-së, llogaritë vjetore dhe ndjek realizimin e tyre.

3. Shqyrton leverdishmërinë e bizneseve, në të cilat angazhohet RTSH-ja, bazuar në analizën e riskut.

4. Shqyrton kontratat, shuma e të cilave kalon 1 për qind të buxhetit vjetor të RTSH-së.

5. Jep mendim për shpenzimet e paparashikuara në buxhet. KDRTSH-ja miraton me vendim masat e propozuara nga Bordi i Administrimit, në lidhje me shpenzimet e paparashikuara në buxhet.

6. I paraqet Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së raporte dhe bilance financiare, si dhe kryen detyra të tjera, në përputhje me rregullat e përcaktuara në statutin e RTSH-së.

7. Kërkon dhe merr gjithë informacionin e nevojshëm për punën e tij nga departamentet dhe sektorët e RTSH-së.

8. Në rast konflikti midis Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së dhe Bordit të Administrimit, ky i fundit mund t'i drejtohet KDRTSH-së.

9. Pëlqimi i Bordit të Administrimit është i domosdoshëm për veprimtaritë e mëposhtme:

a) kontratat e punësimit, përfundimin e marrëveshjeve dhe negocimin e konflikteve me sindikatat;

b) blerjen, shitjen dhe lënien peng të pasurisë së luajtshme;

c) marrjen dhe shlyerjen e kredive bankare.

10. Bordi i Administrimit të RTSH-së shpërblehet me pagesë fikse mujore. Masa e shpërblimit caktohet nga KDRTSH-ja.

11. Bordi i Administrimit i raporton KDRTSH-së pas çdo mbledhjeje.

Neni 112

Këshilli për shikuesit dhe dëgjuesit

1. RTSH-ja krijon këshillin për shikuesit dhe dëgjuesit brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Këshilli përbëhet nga 15 anëtarë, të zgjedhur nga KDRTSH-ja, mes anëtarëve të saj, gazetarëve ose punonjësve të tjerë të RTSH-së dhe të paktën dy të tretat prej tyre të jenë përfaqësues të jashtëm të kategorive të ndryshme shoqërore.

3. Këshilli për shikuesit dhe dëgjuesit, në funksionimin e tij, duhet të sigurojë përfaqësimin e shikuesve dhe dëgjuesve dhe veçanërisht personave me nevoja të veçanta shqisore.

4. RTSH-ja i siguron këshillit kushtet për ushtrimin e funksioneve të këtij të fundit.

5. Këshilli për shikuesit dhe dëgjuesit mund t'i kërkojë RTSH-së, kur e sheh të nevojshme dhe të mundur, vëzhgime dhe studime lidhur me ndjekjen e shërbimeve të transmetimeve nga ana e të miturve dhe të rinjve, të moshuarve dhe kategorive të tjera të veçanta të shoqërisë.

6. Në ushtrim të funksioneve të veta, këshilli mund të organizojë seanca dëgjimore në transmetime të drejtpërdrejta dhe të kërkojë nga RTSH-ja, për këtë qëllim, dy herë në vit vënien në dispozicion të paktën të një ore transmetimi, si në transmetimet e programit televiziv dhe në ato audio.

7. Këshilli për shikuesit dhe dëgjuesit harton një raport vjetor, në lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij, dhe ia paraqet KDRTSH-së, AMA-s, ministrit dhe Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik të Kuvendit.

Neni 113

Financimi i RTSH-së

1. RTSH-ja i siguron fondet financiare për funksionimin dhe ushtrimin e detyrave të veta nga:

a) tarifa e shërbimit për përdorimin e aparatit marrës televiziv, e miratuar sipas legjislacionit për taksat;

b) kontratat me palë të treta për transmetime të ndryshme, duke shfrytëzuar kapacitetet e lira teknike;

c) shërbime të tjera programesh;

ç) tregtimin e prodhimeve muzikore, video e audiokasetave, librave, gazetave dhe revistave që lidhen me programet e veta;

d) veprimtaritë nga shfaqjet publike;

dh) veprimtari të tjera të përcaktuara nga statuti i RTSH-së;

e) reklamat dhe publikimi i mesazheve të tjera të paguara;

ë) sponsorizimet dhe dhurimet;

f) shitja e programeve të RTSH-së;

g) financimi nga Buxheti i Shtetit.

2. RTSH-ja mund të hyjë në marrëdhënie huaje, kontrate shërbimi, transaksione apo sipërmarrjeje të përbashkët me subjekte të tjera, kur këto marrëdhënie ngrihen mbi bazën e pronave të veta, në bazë të legjislacionit në fuqi që rregullon këto veprimtari.

Neni 114

Rregullimi i pronësisë së RTSH-së

Pasuritë e paluajtshme të RTSH-së regjistrohen si prona të paluajtshme publike dhe administrohen vetëm nga RTSH-ja për përmbushjen e qëllimit të përcaktuar në këtë ligj.

Neni 115

Tarifa e shërbimit për përdorimin e aparatit marrës televiziv

1. Tarifa e shërbimit për përdorimin e aparatit marrës aplikohet për aparatin marrës të transmetimeve televizive në posedimin e personave në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nëse aparati është për përdorim personal apo kolektiv në nivelin, mënyrën dhe formën e përcaktuar në ligjin për taksat kombëtare dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Aparati marrës i ngarkuar me pagesën e tarifës, sipas këtij neni, është ai që shërben për marrjen dhe ndjekjen e shërbimeve audiovizive, pavarësisht nëse ky aparat gjendet në një banesë, mjedis publik apo privat ose automjet.

Neni 116

Financimi nga Buxheti i Shtetit

1. Buxheti i Shtetit financon:
 - a) shërbimin e transmetimeve audio për shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;
 - b) shërbimin e transmetimeve audio për publikun e huaj;
 - c) shërbimin e transmetimeve audiovizive për shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;
 - ç) projekte të rëndësishme teknike për futjen e teknologjive të reja për prodhim dhe transmetim;
 - d) projekte të rëndësishme prodhimi filmik dhe veprimtari artistike të mëdha mbarëkombëtare, të prodhuara nga RTSH-ja;
 - dh) orkestrën simfonike të RTSH-së dhe kinematografisë.
2. Masa e financimit përcaktohet në ligjin vjetor të Buxhetit të Shtetit, pas miratimit paraprak, në bazë të projektit të propozuar.
3. Ministrinë dhe institucionet e tjera shtetërore mund të financojnë projekte të veçanta me rëndësi kombëtare në fushat e kulturës, të shkencës dhe të edukimit, me miratimin e KDRTSH-së.

Neni 117

Kontrata e shërbimit të transmetimit publik

1. RTSH-ja, pas realizimit të një konsultimi publik, përgatit, jo më vonë se 1 vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe më pas çdo 5 vjet, një kontratë të shërbimit të transmetimit publik, ku përcakton parimet që zbaton dhe veprimtaritë që merr përsipër për përmbushjen e qëllimeve të veta si transmetues publik, të cilën ia paraqet AMA-s.
2. Kontrata e shërbimit të transmetimit publik duhet të parashikojë, veç të tjerash:
 - a) natyrën dhe numrin e orëve të programeve të transmetimit për të miturit;
 - b) natyrën dhe numrin e orëve të programeve të transmetimit për shkencën dhe teknologjinë;
 - c) numrin e botimeve që duhet të përgatisë, botojë dhe shpërndajë në përputhje me qëllimet e veta si transmetues publik;
 - ç) përpilimin, publikimin dhe shpërndarjen e materialeve audiovizive, të regjistruara në përputhje me qëllimet e veta si transmetues publik.
3. AMA mund të nënshkruajë kontratën e shërbimit të transmetimit publik ose të kërkojë rishikimin e saj brenda 30 ditëve nga paraqitja e saj.

Neni 118

Qëllimet kryesore të veprimtarisë së RTSH-së

1. Qëllimet kryesore të veprimtarisë së RTSH-së janë:
 - a) t'i përgjigjet interesave, kërkesave dhe shqetësimeve të të gjithë popullatës, të mbajë parasysh nevojën për mirëkuptim dhe paqe në Republikën e Shqipërisë e më gjerë, të sigurojë që programet e veta të pasqyrojnë elementet e ndryshme njerëzore dhe kulturore dhe t'i kushtojë vëmendje të veçantë elementeve dalluese të kulturës dhe gjuhës shqipe;
 - b) të mbështesë vlerat njerëzore dhe demokratike, të mbrojtura nga Kushtetuta, në veçanti të drejtën e shprehjes dhe informimit;

c) të mbajë parasysh nevojën e informimit të publikut dhe kuptimit nga ana e tij të vlerave dhe traditave të vendeve të tjera, në veçanti ato europiane;

ç) të sigurojë një gamë të plotë të programeve në gjuhën shqipe, që pasqyrojnë larminë kulturore, argëtojnë, informojnë dhe edukojnë publikun, sigurojnë mbulimin e pasqyrimit të veprimtarive sportive, fetare e kulturore dhe plotësojnë pritshmëritë e publikut në përgjithësi, si dhe të individëve, që i përkasin pakicave shoqërore, duke respektuar në çdo rast dinjitetin njerëzor;

d) të sigurojë programe me lajme dhe çështje aktuale, në vend dhe jashtë, përfshirë mbulimin e veprimtarive parlamentare;

dh) të ndihmojë dhe të lehtësojë shprehjen e kulturës bashkëkohore dhe nxitjen e risive dhe eksperimentimit në fushën e transmetimeve.

2. Në përmbushje të qëllimeve kryesore të veprimtarisë së saj, sipas pikës 1 të këtij neni, RTSH-ja duhet:

a) të ngrejë, të mirëmbajë dhe të vërë në funksionim shërbimin kombëtar të transmetimeve audio dhe audiovizive, i cili duhet të jetë shërbim transmetimi pa pagesë për publikun dhe i kapshëm, për aq sa është e mundur, nga të gjithë individët në Republikën e Shqipërisë;

b) të ngrejë, të mirëmbajë dhe të vërë në funksionim stacione të transmetimit dhe të sigurojë instalimin dhe përdorimin e rrjeteve të komunikimit elektronik për transmetimet radiotelevizive;

c) të ofrojë shërbimin e teletekstit dhe informacion nëpërmjet faqes së internetit, në lidhje me shërbimet e veta dhe të sigurojë përditësimin e mirëmbajtjen e kësaj faqeje;

ç) të krijojë dhe të mbajë orkestrën dhe/ose grupe të ngjashme;

d) të ndihmojë dhe të bashkëpunojë me institucionet përkatëse publike për përgatitjen dhe shpërndarjen e informacionit përkatës për publikun në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme;

dh) të krijojë dhe të mirëmbajë arkivat e materialeve përkatëse, që lidhen me qëllimet e veprimtarisë së vet;

e) të ngrejë, të mirëmbajë dhe të vërë në funksionim një shërbim transmetimi televiziv dhe një shërbim transmetimi audio, që të jetë i kapshëm, për aq sa është e mundur, nga shqiptarët jashtë Republikës së Shqipërisë;

ë) të ngrejë, të mirëmbajë dhe të vërë në funksionim, pas miratimit nga AMA, shërbime transmetimi lokale, rajonale apo për kategori ose grupime të ndryshme shoqërore, shërbime të cilat duhet të jenë të lira;

f) të ngrejë, të mirëmbajë dhe të vërë në funksionim shërbime audiovizive jolineare, në bazë të kërkesës së përdoruesit, shërbime të cilat të kenë karakterin e shërbimit publik;

g) të ngrejë, të mirëmbajë dhe të vërë në funksionim multiplekse kombëtare.

3. RTSH-ja, në përmbushje të qëllimeve të veta, siç përcaktohen në pikën 1 të këtij neni, ka të drejtë:

a) të shfrytëzojë, për aq sa është e mundur dhe e arsyeshme, mundësitë tregtare, në përputhje me qëllimet e veta;

b) të krijojë, të porosisë dhe të gjejë programe nga burime të ndryshme;

c) të lidhë kontrata dhe marrëveshje, të mbledhë informacione e lajme dhe të pajtohet në agjencitë e shërbimeve të lajmeve e shërbime të tjera, për qëllimet e RTSH-së;

ç) të regjistrohet në shoqëri ndërkombëtare dhe institucione të muzikës, edukimit, artit skenik, kulturës, spektaklit, për qëllimet e RTSH-së;

d) të sigurojë, të organizojë dhe të subvencionojë koncerte, shfaqje, dhe veprimtari të tjera, në lidhje me shërbimin e transmetimit;

dh) të përgatisë, të botojë dhe të shpërndajë, me ose pa pagesë, shtypshkrime që i shërbejnë qëllimeve të RTSH-së;

e) të realizojë marrëveshje me shoqëri të tjera transmetimesh ose institucione për shpërndarjen, marrjen, shkëmbimin dhe ritransmetimin e programeve, qofshin këto drejtpërdrejt apo të regjistruara;

ë) të prodhojë, të botojë dhe të shpërndajë, me ose pa pagesë, materiale audiovizive të regjistruara;

f) të investojë në realizimin e filmave;

g) të realizojë transmetimet e programeve, me anë të rrjeteve tokësore, satelitore dhe kablllore, duke përdorur teknologjitë e reja të transmetimeve.

4. RTSH-ja mund të përfshihet në listat e programit, të përpiluara jashtë Republikës së Shqipërisë.

5. RTSH-ja mund të sigurojë shërbime transmetimi të një tematike të veçantë, për kategori të caktuara shoqërore, të kapshme nëpërmjet abonimit.

Neni 119

Programet audiovizive të RTSH-së

RTSH-ja përfshin në transmetimet e saj pa pagesë jo më pak se:

a) 2 programe kombëtare transmetimi audioviziv;

b) 2 programe kombëtare transmetimi audio;

c) 1 program transmetimi audio në gjuhë të huaja;

ç) 1 program transmetimi audio për bashkatdhetarët;

d) programet e qendrave audiovizive rajonale;

dh) 1 program satelitor audioviziv;

e) 1 program transmetimi të drejtpërdrejtë audioviziv për veprimtaritë e Kuvendit.

Neni 120

RTSH-së i ndalohet propaganda politike dhe fetare. Pasqyrimi i fushatës zgjedhore bëhet në përputhje me përcaktimet e Kodit Zgjedhor.

Neni 121

Hapësira e mbulimit

1. Programet kombëtare të RTSH-së duhet të mbulojnë territorin e banuar nga të paktën 90 për qind e shtetasve të Republikës së Shqipërisë.

2. Brenda 5 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të paktën njëri nga rrjetet e RTSH-së duhet të mbulojë 99 për qind të popullsisë.

Neni 122

Infrastruktura e transmetimit

1. AMA, pas këshillimit me RTSH-në, mund t'i kërkojë kësaj të fundit të bashkëpunojë me një të licencuar për transmetime audio ose audiovizive, për përdorimin e mjeteve të infrastrukturës së shpërndarjes së sinjalit, për shërbimet e transmetimit audio ose audioviziv të licencës përkatëse.

2. I licencuari i shërbimit të transmetimit audio ose audioviziv i paguan RTSH-së tarifat periodike për përdorimin e infrastrukturës së transmetimit.

3. Tarifat hartohen bazuar në parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit. Ato propozohen nga RTSH-ja dhe miratohen nga AMA, e cila shprehet brenda 30 ditëve nga paraqitja e propozimit. Nëse AMA nuk shprehet brenda këtij afati, tarifat konsiderohen të miratuara.

Fondi i prodhimit të pavarur

1. RTSH-ja krijon dhe administron një fond nga të ardhurat e veta për financimin e prodhimit të pavarur.

2. Prodhim i pavarur është programi i transmetimit audioviziv, i bërë nga një person ose shoqëri, që plotëson kushtet e mëposhtme:

a) personat pjesëmarrës në program apo ata të përfshirë në përgatitjen e tij dhe pajisjet e mjetet për realizimin e programit vendosen nga vetë personi apo shoqëria e kontraktuar për realizimin e prodhimit të pavarur;

b) personi apo shoqëria e kontraktuar për realizimin e prodhimit të pavarur nuk është një transmetues audioviziv, pjesë e tij apo aksionar në një transmetues.

3. Fondi i prodhimit të pavarur përdoret nga RTSH-ja vetëm për:

a) porositjen e realizimit të programeve të pavarura të transmetimit audioviziv;

b) realizimin e konkurrimit të hapur publik për përzgjedhjen e propozimeve të paraqitura për realizimin e programeve të përmendura në shkronjën “a” të kësaj pike.

4. RTSH-ja nuk mund të shpenzojë më shumë se 10 për qind të fondit të prodhimit të pavarur për qëllimin e përcaktuar në shkronjën “b” të pikës 2 të këtij neni.

5. Fondi i prodhimit të pavarur që nuk shpenzohet brenda vitit financiar, në të cilin është krijuar, duhet të shpenzohet brenda dy vitesh, duke përfshirë vitin financiar përkatës.

6. Nëse fondi i prodhimit të pavarur nuk shpenzohet brenda periudhës së përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, pas këshillimit me Bordin e Administrimit, i propozon KDRTSH-së kalimin e pjesës së mbetur të fondit të prodhimit të pavarur në buxhetin e përgjithshëm të RTSH-së.

7. Në përgatitjen e propozimit, sipas pikës 6 të këtij neni, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së mban parasysh:

a) detyrimet financiare aktuale dhe të planifikuara të RTSH-së;

b) efektet në periudhat financiare përkatëse për punësimin dhe angazhimin e burimeve njerëzore në RTSH;

c) kryerjen e detyrimeve të RTSH-së si shërbim publik dhe realizimin e prodhimeve të pavarura të transmetimit audioviziv.

8. Brenda 3 muajve nga përfundimi i vitit financiar, RTSH-ja përgatit një raport për AMA-n për:

a) prodhimet e porositura gjatë vitit të kaluar nga fondi i prodhimit të pavarur;

b) emrin e shoqërisë ose personave të kontraktuar për këtë qëllim;

c) përdorimin e fondit të prodhimit të pavarur gjatë vitit të kaluar dhe shumën e mbetur pa u shpenzuar;

ç) çdo çështje tjetër që lidhet me ato të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “c” të kësaj pike që AMA mund të kërkojë. Kopje të këtyre raporteve i paraqiten Kuvendit gjatë raportimit vjetor të RTSH-së.

Prodhimet e RTSH-së

1. Prodhimet e RTSH-së, bashkëprodhimet dhe prodhimi i porositur i programeve përbëjnë të paktën 50 për qind të kohës së transmetimit.

2. Prodhimi i porositur është pjesë e programeve të RTSH-së. Porositë realizohen nga subjekte të licencuara për prodhimin e programeve audiovizive ose të filmave.

3. Bashkëprodhim është prodhimi i programeve në bashkëpunim mes RTSH-së dhe një subjekti të licencuar, ku secili prodhues angazhohet me potencialin e tij financiar e teknik.

4. RTSH-ja ofron konkurrencë të hapur publike për prodhimet e porositura, sipas strukturës programore.

5. Modalitetet për prodhimet e porositura dhe bashkëprodhimet përcaktohen në statutin e RTSH-së.

6. Për prodhimin e veprave audiovizive, që realizohen me porosi, RTSH-ja ka të drejtë të përdorë deri në 25 për qind të buxhetit të saj të destinuar për prodhimet.

Neni 125

Rrjetet e transmetimeve të RTSH-së

Shërbimet e programeve të RTSH-së mbështeten në rrjetet e transmetimit si më poshtë:

a) rrjete që përdorin frekuencat për transmetime audiovizive. Këto frekuenca caktohen nga AMA, sipas Planit Kombëtar të Frekuencave dhe janë pjesë e kontratës së shërbimit të transmetimit publik, në përputhje me nenin 117 të këtij ligji;

b) rrjete që përdorin frekuenca jashtë brezave audiovizive. Këto frekuenca jepen nga AKEP-i, sipas përcaktimeve në Planin Kombëtar të Frekuencave, në përputhje me nenin 54 pika 2 të këtij ligji;

c) rrjete që nuk kërkojnë caktimin e frekuencave. Ofrimi i shërbimeve të mbështetura në këto rrjete bëhet në bazë të përcaktimeve të nenit 54 pika 3 të këtij ligji.

Neni 126

Transmetimet numerike të RTSH-së

1. RTSH-ja, në bazë të kontratës që lidh me AMA-n, krijon, shfrytëzon dhe vë në funksionim një rrjet numerik kombëtar për të realizuar transmetimet numerike për:

a) shërbimet e veta audio dhe audiovizive pa pagesë;

b) shërbime të tjera me natyrë publike, të përcaktuara si të tilla nga AMA;

c) shërbime të transmetuesve të tjerë, në bazë të kontratave përkatëse.

2. Përcaktimet e pikës 1 të këtij neni nuk e ndalojnë RTSH-në që të kërkojë krijimin e një rrjeti numerik të dytë.

KREU XIII

MBULIMI I NGJARJEVE ME RËNDËSI PËR PUBLIKUN

Neni 127

Përcaktimi i ngjarjeve me rëndësi të madhe

1. AMA, me vendim, përcakton:

a) listën me ngjarjet me rëndësi të madhe për publikun, të cilat do të transmetohen pa pagesë nga OSHMA-ja që do të fitojë të drejtën e transmetimit të kësaj ngjarjeje dhe që siguron mbulimin e përgjithshëm;

b) mënyrën e transmetimit pa pagesë të një ngjarjeje me rëndësi të madhe, nëse duhet të transmetohet direkt, i regjistruar apo në të dyja mënyrat dhe në të gjithë ose një pjesë të territorit të vendit.

2. AMA, për të marrë vendimin e përcaktimit, duhet të mbajë parasysh të gjitha rrethanat dhe, në veçanti, jehonën dhe interesimin e veçantë, si dhe vlerat e veçanta e të rëndësishme që ngjarja ka për kulturën e të gjithë popullsisë në Republikën e Shqipërisë.

3. Për të përcaktuar masën, në të cilën ekzistojnë rrethanat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, AMA vlerëson pjesëmarrjen e një skuadre kombëtare apo të një individi shqiptar, si dhe përvojën e mëparshme, në lidhje me mbulimin e transmetimit të ngjarjes apo ngjarjeve të ngjashme.

4. AMA, në vendimin e përcaktimit, vlerëson natyrën e ngjarjes, kohën kur ngjarja zhvillohet dhe vlerësimin praktik të transmetimeve në vend.

5. Në marrjen e vendimit të përcaktimit, AMA këshillohet me ministrin që mbulon kulturën, artin, sportin dhe turizmin dhe me Këshillin e Ankesave.

6. Vendimi i përcaktimit i paraqitet për mendim Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik të Kuvendit.

Neni 128

Kualifikimi i OSHMA-ve për mbulimin e ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun

1. Dy ose më shumë OSHMA mund të lidhin kontratë ose marrëveshje për të realizuar së bashku mbulimin e përgjithshëm të një ngjarjeje me rëndësi. Në një rast të tillë këta OSHMA konsiderohen së bashku si një OSHMA i kualifikuar në lidhje me mbulimin e përgjithshëm.

2. Një OSHMA mund të kërkojë nga AMA të zgjidhë mosmarrëveshjet, në lidhje me shërbimin pa pagesë të transmetimit brenda vendit për mbulimin e përgjithshëm.

3. AMA mund të konsultohet me ekspertë teknikë ose persona të tjerë të specializuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 129

Detyrimet e OSHMA-ve në lidhje me ngjarjet e përcaktuara

1. Nëse një OSHMA në juridiksionin e Republikës së Shqipërisë nuk është i kualifikuar, por zotëron të drejtën ekskluzive për të transmetuar një ngjarje të përcaktuar, ky OSHMA ia vë në dispozicion transmetimin e ngjarjes OSHMA-së së kualifikuar, kundrejt pagesës së një shume të arsyeshme, mbi bazën e vlerës së tregut, prej këtij të fundit.

2. Kur një OSHMA i kualifikuar zotëron të drejtën ekskluzive ose të transmetimit të ngjarjes, sipas përcaktimeve të këtij kreu, ose në bazë të një kontrate me organizuesin e ngjarjes, OSHMA-ja i kualifikuar duhet të transmetojë ngjarjen në një shërbim pa pagesë, duke siguruar mbulimin e përgjithshëm, në përputhje me vendimin përkatës të përcaktimit të AMA-s.

3. Nëse për arsye të vlerës së çmimit të tregut, kalimi i së drejtës së transmetimit, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të realizohet, OSHMA-ja, që zotëron të drejtën ekskluzive të transmetimit të ngjarjes së përcaktuar, i vë në dispozicion OSHMA-së të kualifikuar një përmbledhje të transmetimit të ngjarjes. Karakteristikat e përmbledhjes së transmetimit të ngjarjes dhe mënyra e transmetimit të saj përcaktohen në rregullore të veçantë të AMA-s.

Neni 130

E drejta për raporte të lajmeve të shkurtra

1. Për qëllim të raporteve të lajmeve të shkurtra, çdo OSHMA, i krijuar në Bashkimin Europian, ka akses me kushte të barabarta në ngjarje me interes të lartë për publikun, të cilat transmetohen mbi baza ekskluzive nga një OSHMA nën juridiksionin e Shqipërisë.

2. Nëse një OSHMA, i krijuar në Republikën e Shqipërisë, ka kërkuar të drejta ekskluzive për ngjarje me interes të lartë për publikun, një tjetër OSHMA, i krijuar në Shqipëri, mund të kërkojë prej tij akses për ngjarjen në fjalë. Të gjithë OSHMA-të kanë të drejtën për akses në ngjarje të interesit të lartë për publikun, në kushte të barabarta.

3. AMA siguron që aksesin në ngjarjet e referuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni të jetë i garantuar duke lejuar OSHMA-në të zgjedhë lirisht pjesë të shkurtra nga sinjali i OSHMA-së së përcaktuar, duke identifikuar burimin e tyre.

4. Pjesë të shkurtra përdoren vetëm për programet e lajmeve të përgjithshme dhe mund të përdoren në shërbimet mediatike audiovizive, sipas kërkesës, vetëm nëse i njëjti program ofrohet mbi një bazë më të vonë nga i njëjti OSHMA.

5. OSHMA-ja që transmeton ngjarjen me interes të lartë për publikun ka të drejtën të kërkojë nga një OSHMA tjetër kompensimin e kostos aktuale për përmbushjen e këtij detyrimi. Kompensimi i parashikuar nuk duhet të tejkalojë kostot shtesë, të shkaktuara drejtpërdrejt nga lejimi i aksesit.

6. AMA rregullon zbatimin e këtij neni, duke përfshirë përgatitjet e kompensimit, gjatësinë maksimale të pjesëve të shkurtra dhe kufizimet kohore për sa i përket ritransmetimit të tyre.

Neni 131

Ankimi për ngjarjet me rëndësi të madhe

Nëse një OSHMA pretendon se ka ndodhur ose mund të ndodhë mosrespektimi prej një ose disa OSHMA-ve i neni 129 të këtij ligji, mund bëjë ankim në gjykatë kundër këtyre OSHMA-ve, duke kërkuar:

- a) anulimin e kontratës së të drejtës ekskluzive të transmetimit;
- b) përcaktimin e dëmeve civile, të shkaktuara nga ofruesit e tjerë;
- c) njohjen e së drejtës për ofrimin e mbulimit të ngjarjes subjektivit të interesuar, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

KREU XIV

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONET

Neni 132

Masat për shkeljet

1. Në rastet e shkeljes së dispozitave të këtij ligji, AMA vendos:

- a) gjobë;
- b) pezullim të përkohshëm të licencës dhe/ose autorizimit;
- c) reduktim të kohës së licencës dhe/ose autorizimit;
- ç) heqje të licencës dhe/ose autorizimit.

AMA në vendimin e saj merr në konsideratë masën dhe kohëzgjatjen e shkeljes së kryer.

2. AMA vendos sanksionet e parashikuara në ligj jo më vonë se një vit nga data e kryerjes së shkeljes.

3. Kur AMA vëren shkelje të dispozitave ligjore, për të cilat me ligj vendosin sanksione organet e tjera shtetërore, atëherë ajo njofton këto të fundit.

4. Subjekti i ndëshkuar mund të bëjë ankim pranë AMA-s brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit. AMA shqyrton ankesën dhe shpall vendimin brenda 30 ditëve.

Kundër vendimit të AMA-s mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor ku ka selinë organi administrativ.

5. Vendimet e AMA-s, ekzekutohen nga shërbimi përmbartimor, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. AMA nuk ka detyrim të parapaguajë taksën apo tarifën për shërbimin përmbartimor.

Neni 133

Gjobat

Shkeljet e mëposhtme, të kryera nga i licencuari ose i autorizuari, kur nuk përbëjnë veprë penale, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

1. Me gjobë nga 40 000 deri në 400 000 lekë për rastet kur:

a) nuk respekton detyrimet që rrjedhin nga neni 33 i këtij ligji;
b) nuk zbaton afatin e ruajtjes së regjistrimit të transmetimeve, sipas përcaktimeve të nenit 37 të këtij ligji.

2. Me gjobë nga 120 000 deri në 2 000 000 lekë për rastet kur:

a) nuk respekton kohën e përcaktuar për transmetim, sipas kushteve të licencës;
b) nuk respekton detyrimet e neneve 42, 43, 44 dhe 62 pika 12 të këtij ligji për transmetimin e reklamave;

c) nuk respekton detyrimet e nenit 45 të këtij ligji për sponsorizimet;

ç) nuk respekton kushtet e licencës dhe/ose autorizimit për sa i përket programeve të prodhuara në vend dhe veprave europiane;

d) nuk njofton për ndryshimet që kanë ndodhur në të dhënat e paraqitura në kërkesën për licencë dhe/ose autorizim, brenda afatit prej 30 ditësh nga data e kryerjes së ndryshimeve;

dh) ndalon hyrjen e inspektorëve në mjediset ku janë vendosur pajisjet audiovizive të të licencuarit dhe/ose të të autorizuarit ose nuk jepen të dhënat e kërkuara prej tyre;

e) shkakton interferenca ndaj një subjekti tjetër, si rezultat i mosrespektimit të kushteve teknike në transmetim.

3. Me gjobë nga 1 000 000 deri në 3 000 000 lekë për rastet kur:

a) kryen transmetime në një frekuencë tjetër të paautorizuar;

b) kryen transmetime me fuqi rrezatuese më të madhe se ato të autorizuar;

c) transmeton nga vende të ndryshme nga ato të përcaktuara në licencë;

ç) transmeton shërbime audio dhe/ose audiovizive, sipas kërkesës, pa autorizimin e AMA-s, sipas përcaktimeve të nenit 75 të këtij ligji;

d) kryen aktivitet në ofrimin e shërbimeve audio dhe/ose audiovizive, sipas kërkesës, në kundërshtim me kërkesat e nenit 76 të këtij ligji.

4. Me gjobë nga 1 000 000 deri në 5 000 000 lekë për rastet kur nuk respekton në transmetim kufijtë territorialë, të përcaktuar në kushtet e licencës;

5. Me gjobë nga 5 000 000 deri në 10 000 000 lekë për rastet kur një person instalon pajisje televizive ose radioje, duke dalë në transmetim në efir me sinjal audio ose audioviziv pa autorizimin ose licencimin e AMA-s.

6. Me gjobë në masën 300 000 lekë për rastin kur i licencuari dhe/ose i autorizuari nuk respekton të drejtën e përgjigjes, sipas nenit 53 të këtij ligji.

7. Me gjobë nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë kur nuk respekton detyrimet e parashikuara në nenin 32 pika 6 të këtij ligji. Përsëritja e shkeljes më shumë se 3 herë dënohet me uljen deri në 50 për qind të afatit të licencës dhe/ose autorizimit. Në rast ripërsëritjeje, shkelja ndëshkohet me heqjen e licencës dhe/ose autorizimit.

8. Me gjobë nga 100 000 deri në 2 000 000 lekë për rastet kur:

a) prodhon, importon, shpërndan, shet, jep me qira ose posedon, për qëllime tregtare, pajisje të ndaluara;

b) instalon, mirëmban ose zëvendëson, për qëllime tregtare, pajisje të ndaluara;

c) përdor komunikime tregtare për promovimin e pajisjeve të ndalura;

ç) nuk respekton kushtet e licencës sipas nenit 72 të këtij ligji.

9. AMA vendos pezullimin e përkohshëm të licencës dhe/ose autorizimit në rast se subjekti:

a) shkakton në mënyrë të përsëritur interferenca të dëmshme;

b) nuk respekton detyrimin e parashikuar në nenin 63 të këtij ligji për shfrytëzimin e rrjetit numerik;

10. Gjopa vendoset nga inspektorët ose AMA, me nismën e tyre ose pas ankimit të subjekteve të interesuara. Ndëshkimi me gjobat e mësipërme është i vlefshëm edhe për RTSH-në.

11. Kundër vendimit të dënimit me gjobë mund të bëhet ankim në AMA brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni. AMA merr vendim brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së ankimit.

12. Kundër vendimit të AMA-s mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor ku ka selinë organi administrativ.

13. Gjopa është titull ekzekutiv që ekzekutohet nga shërbimi përmbarimor dhe derdhet 80 për qind në Buxhetin e Shtetit dhe 20 për qind në buxhetin e AMA-s.

KREU XV DISPOZITA KALIMTARE

Neni 134

Mandatet e anëtarëve të KKRT-së

Kryetari dhe anëtarët e KKRT-së, të zgjedhur sipas ligjit nr. 8410 datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, deri në përfundim të afatit të caktuar në mandatin e emërimit. Vendet vakante të AMA-s plotësohen sipas përcaktimeve të neneve 8 dhe 9 të këtij ligji.

Neni 135

Mandatet e anëtarëve të KDRTSH-së

Gjatë mandatit të parë, Kryetari, Zëvendëskryetari dhe dy anëtarë të KDRTSH-së, zgjidhen në funksion për një periudhë 5-vjeçare, 4 anëtarë për një periudhë 4-vjeçare dhe 3 anëtarë për një periudhë 3-vjeçare. Përcaktimi i mandatit të anëtarëve bëhet me short, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e veprimtarisë së institucionit.

Neni 136

Kalimi i plotë në transmetimet numerike

1. Afati përfundimtar i kalimit të plotë në transmetimet numerike televizive është data 17 qershor 2015.

2. Mënyra e kalimit të plotë në transmetimet numerike, institucionet përkatëse, financimet, si dhe çështjet e tjera, që lidhen me këtë proces, përcaktohen në strategjinë për kalimin nga transmetimet analoge në ato numerike të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ndalohet dhënia e licencave për transmetime televizive analoge tokësore.

Neni 137

Ndryshimi i statutit të RTSH-së

1. KDRTSH-ja brenda 120 ditëve nga mbledhja e tij e parë, por jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton ndryshimet në statut, në përputhje me këtë ligj, dhe ia paraqet për miratim Kuvendit.

2. Në përgatitjen e ndryshimeve në statut, RTSH-ja këshillohet paraprakisht me AMA-n, Kuvendin dhe kryen një konsultim publik, sipas mënyrës së miratuar paraprakisht nga KDRTSH-ja për këtë qëllim.

Neni 138

Vlefshmëria e licencave ekzistuese

1. Licencat për transmetim radio FM, të dhëna sipas ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, mbeten në fuqi deri në përfundim të afatit të tyre.

2. Licencat për transmetim të programeve televizive kabllore të dhëna sipas ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, zëvendësohen me autorizimet e mëposhtme:

a) autorizimin për shërbimin e programeve audio dhe/ose shërbimin e programeve audiovizive lëshuar nga AMA;

b) autorizimin e përgjithshëm, sipas përcaktimit të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, kundrejt njoftimit në AKEP-it. Zëvendësimet e mësipërme kryhen brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Licencat për transmetim të programeve televizive me satelit të dhëna sipas ligjit nr. 8410 datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, zëvendësohen me autorizimet e mëposhtme:

a) me autorizimin për shërbimin e programeve audio dhe/ose shërbimin e programeve audiovizive, të lëshuar nga AMA;

b) me autorizimin përkatës, sipas përcaktimit të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, kundrejt njoftimit të AKEP-it. Zëvendësimet e mësipërme kryhen brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. Licencat për transmetim televiziv, të dhëna sipas ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, zëvendësohen me licencat për transmetime audiovizive, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Zëvendësimi i licencave ekzistuese kryhet brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me afat deri në përfundimin e transmetimeve analoge.

5. Deri në përfundimin e transmetimeve analoge, transmetimet audiovizive analoge mund të mbështeten në rrjete numerike të ofruara nga zotëruesit e licencave për transmetime televizive numerike, me cilësinë e të licencuarit për shërbimin e programit audioviziv.

Neni 139

Licencimi i rrjeteve numerike dhe programeve që mbështeten në to në periudhën transitore

Pavarësisht nga sa përcaktohet në nenet 70 dhe 71 të këtij ligji, në përputhje me strategjinë për realizimin e kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, AMA kryen licencimin e rrjeteve numerike private dhe programet që mbështeten në to si më poshtë:

1. Licencat për rrjete kombëtare numerike:

a) AMA përcakton numrin e licencave të transmetimeve numerike private kombëtare, rajonale ose lokale dhe rregullat kriteret e licencimit, sipas përcaktimeve në strategjinë e kalimit në transmetimet numerike;

b) AMA, bazuar në zhvillimet e tregut të transmetimeve audiovizive, përcakton operatorët privatë historikë kombëtarë, si dhe operatorët ekzistues, me eksperiencë në transmetimet numerike, që ftohen të marrin pjesë në procedurën e përzgjedhjes, sipas *beauty contest*-it për rrjetet numerike kombëtare. AMA, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, bën njoftimin publik dhe fton operatorët për të marrë pjesë në procesin e përzgjedhjes;

c) aplikantët që marrin pjesë në procedurën e përzgjedhjes, sipas shkronjës b të pikës 1 të këtij neni, duhet të përmbushin kushtet e mëposhtme:

i) lirim e frekuencave të zëna arbitrarisht, nëse operojnë në kushte të tilla, dhe të migrojnë në frekuencat e përcaktuara në Planin Numerik (GE 06), sipas specifikimeve të AMA-s, brenda një kohe të përcaktuar në licencë;

ii) secili operator licencohet për një rrjet kombëtar numerik DVB-T2 me standard kompresioni MPEG-4. Në licencë vendosen afate të përcaktuara kohore për kalimin në DVB-T2 dhe MPEG-4, por jo më shumë se tre vjet nga momenti i licencimit;

iii) mbështetjen e rrjeteve të operatorëve vendorë për programet, sipas përcaktimeve në nenin 63 të këtij ligji, si dhe për bashkëpërdorimin;

iv) sigurimin e aksesit të barabartë, mosdiskriminimin dhe transparencën;

- v) standardizimin e sistemeve të aksesit të kufizuar për mbrojtjen nga programet me karakter dëmtues për të miturit;
- vi) aplikimin e shërbimeve të reja dhe interaktive.
2. I licencuari për rrjetet numerike i nënshtrohet të gjitha kërkesave të përcaktuara në këtë ligj.
3. Programet analoge kombëtare ekzistuese vazhdojnë të transmetohen hapur edhe pasi të mbështeten në platformat numerike.
4. Licencimi për rrjete lokale ose rajonale numerike bëhet sipas procedurës së mëposhtme:
- të gjithë operatorët vendorë analogë ekzistues kanë të drejtë:
 - të kërkojnë mbështetjen e programeve të tyre në rrjetin numerik të televizionit publik ose rrjetet e tjera numerike, të licencuara sipas këtij ligji;
 - të aplikojnë bashkërisht për një licencë rrjeti numerik vendor brenda një zone të planifikuar për t'u mbuluar nga një rrjet SFN, sipas planit të frekuencave numerike;
 - të marrin pjesë në garën e organizuar nga AMA për licencë për rrjetin numerik vendor, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- b) brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, çdo operator analog njofton me shkrim AMA-n për mënyrën e mbështetjes së programeve të tij në rrjetet numerike, sipas përcaktimeve në shkronjën “a” të pikës 4 të këtij neni;
- c) AMA fton, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjithë operatorët vendorë analogë ekzistues, që operojnë brenda një zone të planifikuar, për t'u mbuluar nga një rrjet SFN DVB-T2 me standard kompresioni MPEG-4, sipas planit të frekuencave numerike, të aplikojnë për të zotëruar bashkërisht një rrjet numerik vendor pa kaluar në procesin e konkurrimit, duke përcaktuar dhe afatin përfundimtar për paraqitjen e marrëveshjes së përbashkët;
- ç) nëse marrëveshja për ndërtimin e përbashkët të rrjetit numerik nuk arrihet prej të paktën 70 për qind e operatorëve ekzistues analogë, sipas shkronjës “c” të pikës 4 të këtij neni, AMA shpall konkurrimin për licencimin e rrjetit numerik lokal në zonën përkatëse, sipas përcaktimeve të nenit 70 të këtij ligji;
- d) AMA, në licencimin e rrjeteve numerike, siguron vazhdimësinë e operimit të operatorëve ekzistues analogë në zonat respektive të mbulimit, sipas të paktën një prej mënyrave të përcaktuara në pikën 4 shkronja “a” të këtij neni, si dhe lirin e brezit të dividendit digjital;
- dh) nëse zona ekzistuese e mbulimit të një operatori vendor ose rajonal analog i tejkalon përmasat e një zone të planifikuar për t'u mbuluar nga një rrjet SFN, ky operator ka të drejtë të zotërojë, bashkërisht me operatorët e tjerë, jo më shumë se katër rrjete numerike vendore, me kusht që kjo të mos jetë në kundërshtim me kërkesat e nenit 63 të këtij ligji.
5. Programet analoge vendore ekzistuese vazhdojnë të transmetohen hapur edhe pasi të mbështeten në platformat numerike.
6. Licencat e rrjetit numerik jepen nga AMA në frekuencat e planit numerik të frekuencave, përveç frekuencave të dividendit digjital.
7. Nëse frekuencat e planit numerik janë të zëna nga transmetime analoge ekzistuese, operatori analog ekzistues migron me shpenzimet e tij në frekuencat e tjera që përcaktohen nga AMA.
8. Licencimi, sipas këtij neni, kryhet nga AMA për një periudhë tranzicioni deri në përfundimin e afatit për kalimin e plotë në transmetimet numerike, të përcaktuar në nenin 136 pika 1 të këtij ligji.
9. Me përfundimin e afatit të tranzicionit, AMA kryen licencimin e rrjeteve numerike dhe/ose programeve që mbështeten në to, sipas procedurave të licencimit, të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 140

Afati maksimal për lirin e frekuencave të zëna arbitrarisht

1. Subjektet, që ushtrojnë veprimtari të palicencuar në transmetimet numerike audio dhe/ose audiovizive, janë të detyruara që, brenda 30 ditëve nga përfundimi i procedurës së licencimit, sipas nenit 139 të këtij ligji, por jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të ndërpresin transmetimin.

2. Në rast të mosrespektimit të pikës 1 të këtij neni, AMA zbaton procedurat e përcaktuara në nenin 80 të këtij ligji për bllokimin e pajisjeve dhe lirimimin e frekuencave të zëna arbitrarisht.

Neni 141

Ngarkohet AMA të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja e tij në fuqi, me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj.

KREU XVI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 142

Shfuqizime

Ligji nr. 8410 datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligji nr. 9742 datë 28.5.2007 “Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë” shfuqizohen.

DISPOZITA KALIMTARE ME LIGJIN, ME LIGJIN NR. 22/2016, DATË 10.3.2016

Dispozita kalimtare

Dispozitat e statutit të RTSH-së për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 143

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 4.3.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8061, datë 15.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

VENDIM
Nr. 98/2016

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË RADIO TELEVISIONIT SHQIPTAR
(RTSH)⁵

Në mbështetje të nenit 137, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 88, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit Drejtues të RTSH-së,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet Statuti i Radiotelevizionit Publik Shqiptar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Vendimi i Kuvendit nr. 440, datë 1.6.2000, “Për miratimin e Statutit të Radiotelevizionit Shqiptar” shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

III. Ngarkohet RTSH për zbatimin e këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 22.12.2016

STATUTI
I RADIO TELEVISIONIT SHQIPTAR (RTSH)

KREU I
OBJEKTI DHE DEKLARATA E QËLLIMIT

Neni 1

Objekti

1. Statuti i Radio Televizionit Shqiptar, i hartuar në bazë dhe në detyrim të ligjit nr. 97/2013, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ka për objekt rregullimin e përgjithshëm dhe në hollësi të veprimtarisë së këtij institucioni publik kombëtar.

2. Ky Statut synon të caktojë rregulla të mjaftueshme, që të garantojë funksionimin normal të RTSH-së.

Neni 2

Deklarata e qëllimit

1. Si një OSHMA i përkushtuar ndaj idealeve më të larta të transmetimit të shërbimit publik kombëtar, RTSH-ja realizon shërbime cilësore audio dhe audiovizive për të informuar, edukuar dhe argëtuar publikun, duke i shërbyer kombit, të gjitha grupeve të shoqërisë, përfshirë dhe pakicat kombëtare.

2. RTSH-ja garanton një mbulim të paanshëm të lajmeve të vendit dhe të atyre ndërkombëtare.

3. RTSH-ja realizon programe, të cilat duhet të pasqyrojnë të dëgjuesit dhe shikuesit e të gjitha

⁵ Sipas dispozitës kalimtare të ligjit 22/2016, datë 10.3.2016 (neni 3): “Dispozitat e statutit të RTSH-së për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.”

moshave larminë e jetës shqiptare. RTSH-ja përgatit programe cilësore e me vlera për pasurimin e botës mendore dhe shpirtërore të njerëzve.

4. Radio Televizioni Shqiptar është një institucion publik i një rëndësie të veçantë kombëtare (që kryen një shërbim publik në fushën e medias audiovizive, me qëllimin për të siguruar nevojat demokratike, sociale dhe kulturore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë dhe të shqiptarëve në mbarë botën.

5. RTSH-ja synon të arrijë nivelet më të larta të shërbimit ndaj audiencës. RTSH-ja angazhohet për të zbatuar vlerat themelore të përbashkëta të mediave të shërbimit publik:

- Gjithëpërfshirja – për të arritur të gjithë, kudo.
- Besueshmëria – për të qenë një prodhues programesh i besueshëm.
- Përsosmëria – të veprojë me integritet dhe profesionalizëm.
- Diversiteti – për të pasur një qasje pluraliste.
- Llogaridhënia - për të dëgjuar audiencën dhe për t'u angazhuar në debat kuptimplotë.
- Inovacioni – për të qenë një forcë lëvizëse për risi dhe krijimtari.
- Paanshmëria – për të ofruar informim objektiv, të plotë dhe të padiferencuar, jashtë çdo ndikimi ideologjik, politik, social, fetar, financiar, kulturor.

KREU II EMËRTIMI DHE PËRFAQËSIMI JURIDIK

Neni 3

1. Emri i shkurtuar i Radio Televizionit Shqiptar është RTSH.
2. Radio Televizioni Shqiptar (RTSH) është person juridik publik, jo me qëllim fitimi, funksionon bazuar në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.
3. Themeluesi i institucionit publik të Radio Televizionit Shqiptar është shteti shqiptar. Shteti shqiptar garanton autonominë institucionale dhe pavarësisë editoriale të Radio Televizionit Shqiptar, si dhe merr përsipër financimin e domosdoshëm për të bërë të mundur kryerjen e shërbimit publik në fushën e medias audiovizive nga RTSH.
4. Selia e RTSH-së është në Tiranë.
5. Përveç njësisë administrative në përbërje të RTSH-së, të përcaktuara në këtë statut, me vendim të Këshillit Drejtues të RTSH-së (KDRTSH) mund të krijohen edhe njësi të tjera analoge.
6. Vula zyrtare e RTSH-së është në formë rrethore dhe përmban këto shenja e shkronja në rrethin e jashtëm: Lart “Republika e Shqipërisë”, poshtë TIRANË dhe në rrethin e brendshëm lart: “Radio Televizioni Shqiptar”, ndërsa në mes të saj vihet shqiponja e njëjtë me atë të stemës së Republikës.
7. Madhësia dhe përmasat e vulave të tjera caktohen me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues.

Neni 4

1. RTSH-ja funksionon si një sistem unik me njësi të tjera administrative përbërëse të saj.
2. Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, si menaxher kryesor i këtij sistemi, përfaqëson RTSH-në dhe vepron në emër të këtij institucioni në të gjitha marrëdhëniet juridike me persona të tretë, në të gjitha transaksionet ku palë është RTSH-ja, përveç atyre të pasurive të paluajtshme.
3. Në mungesë të Drejtorit të Përgjithshëm, RTSH-ja përfaqësohet nga Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm dhe në mungesë të tij, nga njëri prej drejtuesve të lartë të njësisë administrative në përbërje të RTSH-së, i cili autorizohet me shkrim nga Drejtori i Përgjithshëm.
4. Autorizimet e përfaqësimit për më shumë se 60 ditë, përveç atyre për Zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm, miratohen nga Këshilli Drejtues (KDRTSH).
5. Njësitë administrative përbërëse të RTSH-së përfaqësohen nga drejtuesit përkatës në të gjitha marrëdhëniet juridike me persona të tretë, ku palë janë njësitë përkatëse, brenda të drejtave dhe detyrimeve ligjore që ata kanë. Në rastet kur vërehen parregullsi, ose shkelje të kompetencave,

Drejtori i Përgjithshëm ka të drejtë të ndërhyjë, për t'i bërë të pavlefshme vendimet ose marrëveshjet e arritura.

KREU III STRUKTURA E RTSH-së, ORGANET E SAJ DREJTUESE DHE MËNYRA E ZGJEDHJES SË TYRE

Neni 5

RTSH-ja e kryen veprimtarinë e vet mbështetur në:

- a) drejtimin ekonomik - financiar të decentra-lizuar;
- b) prodhimin e programeve audio dhe audiovizive për transmetim në RTSH dhe për të tretët;
- c) transmetimin audio dhe audiovizive për programin e RTSH-së dhe për të tretët.

Neni 6

RTSH-ja ka këtë strukturë organizative:

- a) Drejtoria e Përgjithshme e RTSH-së.
- b) Njësia e Programeve;
- c) Njësia e Teknikës;
- ç) Njësia e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve;
- d) Qendrat vendore audiovizive.

Neni 7

1. Drejtuesit e njësive administrative i propozojnë Drejtorit të Përgjithshëm strukturat organizative të njësive të tyre . Pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm, ato hyjnë në fuqi vetëm pas miratimit përfundimtar nga Këshilli Drejtuesi RTSH. Kur mendimi i Drejtorit të Përgjithshëm është i ndryshëm nga propozimi i njësive administrative, Këshillit Drejtues të RTSH-së i paraqiten të dyja variantet.

2. Ndryshimet në strukturat e njësive administrative bëhen mbi propozime të argumentuara dhe ndjekin të njëjtin rregull.

Neni 8

1. Në mbështetje të ligjit nr. 97, datë 4.3.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, organet drejtuese të RTSH-së janë:

- a) Këshilli Drejtues (KDRTSH);
- b) Drejtori i Përgjithshëm;
- c) Bordi i Administrimit.

2. Për organizimin e përditshëm të punës veprojnë edhe organet drejtuese të njësive administrative dhe strukturat e tjera vartëse, si me poshtë:

- a) Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm;
- b) Drejtuesi i Njësive të Programeve;
- c) Drejtuesi i Njësive të Teknikës;
- ç) Drejtuesi i Njësive të Emisioneve Tematike dhe Lajmeve;
- d) drejtor drejtorie pranë Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH-së;
- dh) drejtor i qendrave audiovizive vendore.

3. Anëtarët e organeve drejtuese dhe organeve drejtuese të njësive administrative të RTSH-së i ushtrojnë funksionet e tyre vetëm në interes të RTSH-së dhe nuk marrin mandat apo udhëzime nga ndonjë person apo organ i jashtëm.

Neni 9

Përzgjedhja e anëtarit të Këshillit Drejtues të RTSH-së

Kriteret e përzgjedhjes së anëtarit dhe Kryetarit të Këshillit Drejtues të RTSH-së (KDRTSH) janë të përcaktuara nga neni 93 deri në nenin 97 të ligjit nr. 97, datë 4.3.2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

Neni 10

Kriteret dhe papajtueshmëritë e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së

1. Këshilli Drejtues i RTSH-së shpall publikisht kriteret e konkurrimit për Drejtor të Përgjithshëm të RTSH-së, të cilat janë:

- a) të jetë shtetas/e shqiptar;
- b) të ketë kryer arsimin e lartë;
- c) një individ me ndjenjë më të lartë të integritetit, përgjegjësisë, kualifikimeve profesionale dhe meritave;
- ç) të ketë përvojë pune jo më pak se 10 vjet, nga të cilat 5 vjet pozicione menaxhimi në media, institucione publike (jo administratë), sektori privat, në shkenca komunikimi, teknologji komunikimi dhe digjitale;
- d) të ketë përvojë të spikatur në menaxhim dhe drejtim;
- dh) të dëshmojë njohje të sektorit publik audioviziv, misionin dhe zhvillimin e tij në përputhje me standardet europiane.

2. Kandidatët duhet të paraqesin në Këshillin Drejtues, sipas kërkesave që përcakton ligji:

- a) curriculum vitae të plotë;
- b) dëshmi penaliteti;
- c) platformë zhvilluese për Radio Televizionin Publik Shqiptar, që përmban:
 - strukturën programore dhe organizative të sistemit të RTSH-së në përmbushje të Deklaratës së Qëllimit;
 - planin e menaxhimit për veprimtarinë prodhuese e financiare të këtij institucioni.

3. Përveç kushteve të papajtueshmërisë dhe konfliktit të interesit së zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm, sipas nenit 104 të ligjit 97/2013, Drejtori i Përgjithshëm nuk mund të zgjidhet nga radhët e Këshillit Drejtues të RTSH.

4. Drejtori i Përgjithshëm nuk duhet të marrë udhëzime nga një grupim apo parti politike.

Neni 11

Procedurat e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së

1. Kandidatët për postin e Drejtorit të Përgjithshëm dorëzojnë në zarf të mbyllur te Kryetari i Këshillit Drejtues të RTSH-së, dokumentacionin, sipas kriterëve të shpallura, brenda 10 ditëve pas publikimit të tyre.

2. Me mbarimin e afatit të aplikimit, Këshilli Drejtues bën vlerësimin e kandidaturave të paraqitura në mbështetje të dokumentacionit të dorëzuar, verifikon dhe saktëson vërtetësinë e tyre dhe, me votim të fshehtë, vendos përfshirjen e tyre në konkurrim, duke i renditur sipas rendit alfabetik të mbiemrit.

3. Kandidatët që plotësojnë kriteret ftohen të paraqesin platformat e tyre para Këshillit Drejtues jo më vonë se 5 ditë nga data e përfundimit të afatit të aplikimit. Kandidatët kanë në dispozicion 15 minuta kohë për të paraqitur platformën e tyre dhe 15 minuta kohë për pyetje.

4. Më tej votohet për listën e pranuar, sipas procedurës së përcaktuar nga Këshilli Drejtues, ku secili anëtar ka të drejtën e një vote. Kandidatura që në votimin e parë siguron tre të pestat e votave të të gjithë anëtarëve të KDRTSH-së zgjidhet Drejtor i Përgjithshëm i RTSH-së. Në të kundërt, vetëm dy kandidatët, të cilët kanë marrë numrin më të madh të votave, do të shkojnë për votim në raundet e

tjera. Nëse janë më shumë se dy kandidatë me të njëjtin numër votash, atëherë do të kualifikohen në raundin e dytë të gjithë kandidatët me të njëjtin numër votash.

5. Nëse në votimin e parë nuk arrihet shumica prej tre të pestave, KDRTSH-ja cakton menjëherë datën e kryerjes së votimit të dytë, i cili zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga kryerja e votimit të parë. Në rast se edhe në votimin e dytë nuk arrihet shumica prej tre të pestave, KDRTSH-ja cakton menjëherë datën e kryerjes së votimit të tretë, i cili zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga kryerja e votimit të dytë. Në rast se edhe në votimin e tretë nuk arrihet shumica prej tre të pestave, KDRTSH-ja cakton menjëherë datën e kryerjes së votimit të katërt, i cili zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga kryerja e votimit të tretë. Në votimin e katërt dhe të pestë KDRTSH-ja vendos për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm me më shumë se gjysmën e votave të të gjithë anëtarëve të tij. Votimi i pestë kryhet në rastin kur në votimin e katërt asnjë kandidat nuk ka siguruar shumicën e kërkuar të votave dhe zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga kryerja e votimit të katërt. Votimi i pestë zhvillohet vetëm midis dy kandidatëve që kanë marrë më shumë vota në votimin e katërt. Në rast se ka më shumë se dy kandidatë me të njëjtin numër votash, kandidati që merr pjesë në votim caktohet me short. Në rast se edhe pas votimit të pestë asnjë kandidat nuk siguron shumicën e kërkuar, KDRTSH-ja shpërndahet.

6. Këshilli Drejtues shpall me vendim kandidatin fitues dhe e bën atë menjëherë të njohur për publikun.

Neni 12

Bordi i Administrimit

Emërimi, lirimi dhe funksionimi i Bordit të Administrimit bëhet në mbështetje të neneve 107 deri në 111 të ligjit nr. 97, datë 4.3.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 13

Kriteret dhe papajtueshmëritë e zgjedhjes së Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së dhe drejtuesve të njësive administrative në përbërje të RTSH-së

1. Kriteret për zgjedhjen e Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së dhe drejtuesit e njësive administrative të RTSH-së, janë:

- a) të jenë shtetas shqiptar;
- b) të kenë kryer arsimin e lartë;
- c) të kenë përvojë pune ose drejtuese të drejtpërdrejtë në median e shkruar, ose audiovizive jo më pak se 5 vjet;
- ç) të kenë aftësi drejtuese edhe ide të qarta për zhvillimin e një transmetuesi audioviziv.

2. Kandidatët duhet t'i paraqesin Drejtorit të Përgjithshëm curriculum vitae të plotë, platformën dhe strukturën programore e organizative për vendin drejtues ku kandidojnë.

3. Papajtueshmëritë për Zëvendës drejtorin e Përgjithshëm dhe drejtuesit e njësive administrative të RTSH-së janë të njëjta me ato të Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 14

Procedurat e zgjedhjes

1. Procedurat për zgjedhjen Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së dhe drejtuesit e njësive administrative të RTSH-së janë:

a) Drejtori i Përgjithshëm në bazë të kriterëve, të përcaktuara në nenin 13 të këtij statuti, bën studimin dhe përzgjedhjen e kandidaturave dhe për çdo nivel drejtimi, si rregull, i paraqet Këshillit Drejtues të RTSH-së më shumë se një kandidaturë;

b) Këshilli Drejtues i RTSH-së, kur e çmon të nevojshme i kërkon Drejtorit të Përgjithshëm sqarime plotësuese për kandidatët;

c) kandidatët votohen sipas radhës së propozuar nga Drejtori i Përgjithshëm. Kur kandidati i parë nuk fiton shumicën e thjeshtë të votave të të gjithë anëtarëve, kalohet në votimin e kandidatit pasardhës;

ç) nëse asnjëri nga kandidatët e votuar veç e veç nuk fiton me shumicën e thjeshtë të votave të të gjithë anëtarëve, atëherë bëhet votimi përfundimtar dhe shpallet fitues kandidati që merr më shumë vota.

2. Këshilli Drejtues i RTSH-së shpall fituesit me vendim, të cilin e bën publik.

3. Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së dhe drejtuesit e njësive administrative të RTSH-së të zgjedhur nga Këshilli Drejtues kanë të njëjtin mandat si ai i Drejtorit të Përgjithshëm që i ka propozuar.

4. Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së dhe drejtuesit e njësive administrative të RTSH-së do të qëndrojnë në detyrë deri në zgjedhjen nga Këshilli Drejtues, pas propozimit të Drejtorit të ri të Përgjithshëm, të Zëvendës drejtorit të ri të Përgjithshëm dhe drejtuesve të rinj të njësive administrative të RTSH-së.

Neni 15

Procedurat e lirimit nga detyra të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH

1. Procedurat për lirimin e Drejtorit të Përgjithshëm ndërmerren me nismën e Këshillit Drejtues të RTSH-së, kur për këtë gjë shprehen me shkrim një e treta e anëtarëve të këtij Këshilli, në rastet e parashikuara në nenin 106, të ligjit nr. 97/2013. Përfundimisht, në rastet e dorëheqjes dhe të përfundimit të periudhës ligjore të mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm, njoftimi bëhet nga Kryetari i Këshillit Drejtues në Këshill. Konstatimi i përfundimit të mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm bëhet nga Kryetari i Këshillit Drejtues, i cili njofton Këshillin. Në rast mosmarrëveshjeje, Këshilli vendos me votim.

2. Këshilli Drejtues i RTSH-së mbledhet për shqyrtimin e kërkesës për shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së brenda 7 ditëve nga paraqitja e kërkesës. Votimi është i fshehtë.

3. Drejtori i Përgjithshëm ka të drejtën të dëgjohet përpara marrjes së një vendimi për lirimin nga detyra.

Neni 16

Rastet dhe procedurat e lirimit nga detyra të Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së dhe drejtuesve të njësive administrative të RTSH-së

1. Rastet për lirimin nga detyra të Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm dhe drejtuesit e njësive administrative të RTSH-së ndërmerren:

a) kur bëhen pengesë në zbatimin e detyrimeve që ngarkon Statuti i RTSH-së dhe shkel kompetencat që i jep ky Statut;

b) kur aplikon praktika të reformës institucionale dhe praktika punësimi të pambështetura në ligj dhe në aktet e tjera që rregullojnë marrëdhëniet e punës;

c) kur personat e sipërpërmendur, në mënyrë të përsëritur, pas paralajmërimeve me shkrim, thejnë ose nuk zbatojnë vendimet dhe rregulloret e miratuara nga Këshilli Drejtues i RTSH-së;

ç) kur me veprimet ose mosveprimet e tyre sjellin dëme financiare dhe programore në veprimtarinë e RTSH-së;

d) kur nuk realizohet përmbushja e strukturës programore dhe Planit të Biznesit;

dh) kur pa arsye, nuk paraqiten në vendin e punës për kryerjen e detyrës së ngarkuar, për më shumë se 10 ditë;

e) kryen një veprë penale, për të cilën është dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë;

ë) bëhet i paafte përgjithmonë për kryerjen e detyrës, për shkaqe shëndetësore;

f) i hiqet zotësia për të vepruar;

g) i mbaron mandati;

gj) jep dorëheqjen.

2. Procedurat për shkarkimin e Zëvendës-drejtorit të Përgjithshëm dhe drejtuesit e njësive administrative të RTSH-së nis me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm. Në rast se vendi i Drejtorit të Përgjithshëm është vakant, procedura ndërmerret me nismën e Këshillit Drejtues, kur për këtë gjë shprehen me shkrim të paktën 1/3 e anëtarëve të këtij Këshilli.

3. Zëvendës-drejtori i Përgjithshëm dhe drejtuesit e njësive administrative të RTSH-së kanë të drejtën të dëgjohen përpara marrjes së një vendimi për lirim të tyre nga detyra.

KREU IV KOMPETENCAT E ORGANEVE DREJTUESE TË RTSH-së

Neni 17 **Këshilli Drejtues i RTSH-së**

Këshilli Drejtues i RTSH-së, përveç kompe-tencave të përcaktuara në nenin 102 të ligjit nr. 97, datë 4.3.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ka edhe këto kompe-tenca:

a) miraton strategjitë për zhvillimin e RTSH-së dhe marrëdhëniet e këtij institucioni, brenda dhe jashtë vendit, të paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm dhe i kërkon këtij të fundit të raportojë për zbatimin e tyre;

b) miraton strukturën organizative e programore;

c) shprehet publikisht për transmetime, programe dhe qëndrime të organeve të tjera drejtuese të RTSH-së dhe të stafit të tij, të cilat bien në kundërshtim me ligjin dhe aktet e tjera, që rregullojnë veprimtarinë e institucionit;

ç) në çdo fillim viti, por jo më vonë se 31 marsi, në bazë të raportit të Bordit të Administrimit, analizon raportin financiar të RTSH-së. Jep njoftim publik për rezultatet e analizës financiare;

d) miraton planin vjetor financiar dhe buxhetin e RTSH-së e të njësive administrative apo strukturave vartëse në përbërje të saj;

dh) përcakton masën e shpërblimit mujor për anëtarët e Bordit të Administrimit, si dhe masën e shpërblimit për anëtarët e Këshillit për Shikuesit dhe Dëgjuesit;

e) miraton bashkëpunimin e RTSH-së në projekte të rëndësishme të veçantë me interes kombëtar, si dhe të gjitha veprimtaritë e tjera me një vlerë ekuivalente të projektit mbi 1 (një) për qind të buxhetit vjetor të RTSH-së;

ë) të gjitha procesverbalet që mbahen në mbledhjet që zhvillon Këshilli Drejtues ruhen në arkiv për dhjetë vjet;

f) Këshilli Drejtues i propozon Kuvendit për largimin nga detyra të anëtarit të vet, kur ai mungon pa arsye në më shumë se një të tretën e mbledhjeve të KDRTSH-së, brenda 1 viti;

g) procedura e largimit nga detyra, në mbështetje të shkronjës “P” të këtij neni, bëhet sipas përcaktimeve të dispozitës së nenit 100 të ligjit nr. 97, datë 4.3.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”;

gj) krijon njësi të reja administrative të të njëjtit nivel me Njësinë e Programeve, Njësinë e Teknikës, Njësinë e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së.

Neni 18 **Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së**

1. Drejtori Përgjithshëm organizon dhe menaxhon punën në RTSH dhe është përgjegjës për menaxhimin e biznesit dhe programeve të RTSH-së.

2. Në kryerjen e detyrave të tij Drejtori Përgjithshëm udhëhiqet nga principet e transparencës, pluralizimit dhe pavarësisë, siç specifikohen në ligj, në deklaratën e qëllimit dhe në këtë statut.

3. Drejtori Përgjithshëm siguron që puna në të gjitha nivelet e institucionit është në përputhje me ligjin, deklaratën e qëllimit dhe parimet editoriale.

4. Nëse Drejtori Përgjithshëm vlerëson se performanca e çdo niveli drejtuesish nuk është në përputhje me principet e sipërpërmendura, me standardet programore, apo plan-biznesin, apo nëse nuk janë përmbushur detyrime kontraktore, atëherë merr masa për ndreqjen e situatës dhe ndërmerr sanksione në përputhje me ligjin, statutin, rregulloret, apo aktet në fuqi.

5. Koordinon punën e drejtuesve të njëjësive dhe drejtuesve të tjerë dhe në përputhje me Statutin zgjidh mosmarrëveshjet mes tyre.

6. Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, përveç kompetencave të përcaktuara në nenin 105, të ligjit nr. 97, datë 4.3.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ka edhe këto kompetenca:

a) i propozon Këshillit Drejtues të RTSH-së për emërimin, apo lirim nga detyra, të Zëvendës-drejtorit të Përgjithshëm, të anëtarëve të Bordit të Administrimit, të drejtuesve të njëjësive administrative dhe anëtarëve të Këshilli për Shikuesit dhe Dëgjuesit;

b) i paraqet për miratim Këshillit Drejtues të RTSH-së strukturat organizative programore dhe planin financiar e të biznesit të RTSH-së;

c) çdo muaj në mbledhjen e drejtorëve bën orientimin dhe analizën e realizimit të planeve mujore;

ç) i raporton rregullisht Këshillit Drejtues të RTSH-së për realizimin e planeve të zhvillimit të programeve e të biznesit;

d) është titullar i Autoritetit Kontraktor “Radio Televizioni Shqiptar (RTSH)”. Në mungesë të tij, këtë përgjegjësi ia delegon Zëvendës-drejtorit të Përgjithshëm;

dh) u delegon me shkrim drejtorëve të të gjitha niveleve përgjegjësi për periudha të caktuara kohore;

e) kontrollon programacionin;

ë) është përgjegjës, së bashku me strukturat vartëse përkatëse, për përputhshmërinë e programit informativ me parimet e përcaktuara në ligjin nr. 97, datë 4.3.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe në këtë Statut;

f) emëron dhe shkarkon drejtuesit e njëjësive administrative pas miratimit nga Këshilli Drejtues RTSH;

g) emëron dhe shkarkon drejtuesit e programeve në përputhje me aktet në fuqi;

gj) emëron dhe shkarkon anëtarët e stafit drejtues/drejtorisë së përgjithshme;

h) emëron apo largon nga puna punonjësit e sistemit të RTSH-së, me propozim të drejtuesve të njëjësive, drejtorive, departamenteve apo sektorëve;

i) ndërhyr për ndryshime, apo për bllokim të programit në transmetim, kur e shih të arsyeshme, ose me propozim të Këshillit të Shikuesve dhe Dëgjuesve, në rast se ka emergjencë kombëtare, ose vërehen shkelje të të drejtave të njeriut dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve si dhe grupeve të shoqërisë që gëzojnë mbrojtje të veçantë;

j) krijon njësi, drejtori, departamente apo sektorë të rinj, si struktura në varësi të tij, duke ia propozuar për miratim KDRTSH-së.

Neni 19

Bordi i Administrimit të RTSH-së

Bordi i Administrimit të RTSH-së është organ këshillimor i Këshillit Drejtues të RTSH-së, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 111, pika 9, të ligjit nr. 97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” për çështjet e administrimit dhe për çështjet financiare e të biznesit të RTSH-së.

Neni 20

Kompetencat e Bordit të Administrimit

Bordi i Administrimit, përveç kompetencave të përcaktuara në nenin 111, të ligjit nr. 97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ka edhe këto kompetenca:

a) miraton projektbuxhetin vjetor të RTSH-së;

- b) miraton bilancin financiar vjetor, me të dhënat e paraqitura nga Drejtoria Ekonomike, brenda afateve të përcaktuara në ligj;
- c) jep mendim për shpenzimet e paparashikuara në buxhet;
- ç) i paraqet Këshillit Drejtues raportin për shpenzimet dhe të ardhurat e RTSH-së, në formë raportesh financiare, mujore, tremujore dhe gjashtëmujore, pasi ka marrë të dhënat e nevojshme nga departamentet dhe sektorët e RTSH-së;
- d) shqyrton kontratat, shuma e të cilave kalon 1 për qind të buxhetit vjetor të RTSH-së.

Neni 21

Këshilli për Shikuesit dhe Dëgjuesit

1. Këshilli përbëhet nga 15 anëtarë, të zgjedhur nga Këshilli Drejtues, mes anëtarëve të saj, gazetarëve ose punonjësve të tjerë të RTSH-së dhe të paktën dy të tretat prej tyre të jenë përfaqësues të jashtëm të kategorive të ndryshme shoqërore.
2. Në mbledhjen e tij të parë, Këshilli zgjedh midis anëtarëve të vet Kryetarin me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve, si dhe harton dhe miraton rregulloren e funksionimit të vet, të cilën ia paraqet për miratim përfundimtar Këshillit Drejtues RTSH.
3. Këshilli mbledhet jo më pak se një herë në dy muaj, por mund të mbledhet edhe sa herë kërkohet nga Kryetari i Këshillit Drejtues, 1/3 e anëtarëve të Këshillit Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm dhe nga 1/3 e vetë anëtarëve të Këshillit për Shikuesit dhe Dëgjuesit.
4. Për punën e kryer, anëtarët e Këshillit për Shikuesit dhe Dëgjuesit marrin një shpërblim mujor që miratohet nga Këshilli Drejtues RTSH-së.
5. Rastet e lirimit nga detyra të anëtarit të Këshillit për Shikuesit dhe Dëgjuesit janë të njëjta me ato të përcaktuara në nenin 108, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Propozimi për lirim të anëtarit bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 22

Kompetencat e Këshillit të Shikuesve dhe Dëgjuesve

1. Përveç sa është përcaktuar në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli për Shikuesit dhe Dëgjuesit ka këto kompetenca:
 - a) jep mendim për strukturat programore të RTSH-së;
 - b) monitoron strukturën programore të RTSH-së;
 - c) një herë në tre muaj paraqet një raport para Këshillit Drejtues mbi zbatimin e strukturës programore;
 - ç) organizon vëzhgime dhe studime lidhur me ndjekjen e shërbimeve të transmetimeve nga ana e të miturve dhe të rinjve, të moshuarve dhe kategorive të tjera të veçanta të shoqërisë, pasi kërkon mbështetjen e strukturave të RTSH-së;
 - d) organizon seanca dëgjimore në transmetime të drejtpërdrejta, për çështje të programacionit dhe i kërkon RTSH-së, për këtë qëllim, dy herë në vit vënien në dispozicion të paktën të një ore transmetimi, si në transmetimet e programit audioviziv dhe në ato audio;
 - dh) jep mendim lidhur me programe të caktuara, kur konstaton mospërfaqësimin e duhur të shikuesve dhe dëgjuesve dhe veçanërisht personave me nevoja të veçanta shqisore.
 - e) harton një raport vjetor, në lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij, dhe ia paraqet Këshillit Drejtues RTSH-së.
2. Këshilli për Shikuesit dhe Dëgjuesit nuk ka kompetenca vendimmarrëse mbi ankesat.

Neni 23

Zëvendës drejtori i Përgjithshëm

1. Zëvendës drejtori i Përgjithshëm ushtron të gjitha përgjegjësitë me të drejtë vendimmarrje, kur autorizohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

2. Në veprimtarinë e përditshme ka detyrë funksionale ndjekjen operative të Drejtorisë së Përgjithshme dhe veçanërisht të administratës.

3. Me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues i RTSH-së shqyrton dhe vendos detyra shtesë për Zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm.

4. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm ushtron të gjitha përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm, kur ky post mbetet vakant.

Neni 24

Njësia e Programeve

Drejtuesi i Njesisë së Programeve ka këto kompetenca:

- a) përgjigjet për veprimtarinë krijuese dhe programe;
- b) harton, propozon dhe zbaton buxhetin e njësisë;
- c) harton dhe propozon strukturën programore, organizative, planin e prodhimit të programeve dhe të transmetimit të tyre;
- ç) drejton dhe bashkërendon punën mes strukturave në varësi për zbatimin e strukturës programore, planeve të prodhimit të programeve dhe transmetimit të tyre;
- d) miraton planet javore, mujore, tremujore dhe ndryshimet në planet ditore të transmetimit;
- dh) i raporton çdo tre muaj me shkrim Drejtorit të Përgjithshëm për realizimin e planeve të prodhimit të programeve dhe të transmetimit të tyre;
- e) harton rregulloren e njësisë dhe ia paraqet për shqyrtim Drejtorit të Përgjithshëm;
- ë) propozon te Drejtori i Përgjithshëm rregulloret e projekteve të rëndësisë së veçantë, që kanë lidhje me krijimtarinë dhe programet;
- f) propozon te Drejtori i Përgjithshëm emërimin dhe lirimin nga detyra të punonjësve në varësi të tij, duke përfshirë këtu edhe ata me kontrata pune me kohë të pjesshme;
- g) propozon te Drejtori i Përgjithshëm për shpërblymjet ose masat disiplinore për punonjësit në varësi të tij, pas kërkesës së strukturës vartëse përkatëse.

Neni 25

Njësia e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve

Drejtuesi i Njesisë së Emisioneve Tematike dhe Lajmeve ka këto kompetenca:

- a) bën planizimin e lajmeve dhe siguron bashkërendimin e tyre në transmetimet audio, audiovizive, në internet, rrjetet sociale etj.;
- b) harton, propozon dhe zbaton buxhetin e njësisë;
- c) siguron një mbulim të qëndrueshëm dhe të paanshëm me lajme nga ana e RTSH-së, duke iu ofruar shërbime edhe qendrave vendore audiovizive, bazuar në politikat e redaksive;
- ç) harton dhe propozon strukturën programore, organizative, planin e prodhimit të programeve tematike dhe të lajmeve dhe të transmetimit të tyre;
- d) drejton dhe bashkërendon punën mes strukturave në varësi për zbatimin e strukturës programore të programeve tematike dhe të lajmeve, planeve të prodhimit të programeve dhe transmetimit të tyre;
- dh) miraton planet javore, mujore, tremujore dhe ndryshimet në planet ditore të transmetimit;
- e) i raporton çdo tre muaj me shkrim Drejtorit të Përgjithshëm për realizimin e planeve të prodhimit të programeve dhe të transmetimit të tyre;
- ë) harton rregulloren e njësisë dhe ia paraqet për shqyrtim Drejtorit të Përgjithshëm;
- f) propozon te Drejtori i Përgjithshëm rregulloret e projekteve të rëndësisë së veçantë, që kanë lidhje me emisionet tematike dhe lajmet;
- g) propozon te Drejtori i Përgjithshëm emërimin dhe lirimin nga detyra të punonjësve në varësi të tij, duke përfshirë këtu edhe ata me kontrata pune me kohë të pjesshme;

gj) propozon te Drejtori i Përgjithshëm për shpërblimet ose masat disiplinore për punonjësit në varësi të tij, pas kërkesës së strukturës vartëse përkatëse.

Neni 26 **Njësia Teknike**

Drejtuesi i Njesisë Teknike ka këto kompetenca:

- a) organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e njësisë;
- b) harton, propozon dhe zbaton buxhetin e njësisë;
- c) përgjigjet për gjendjen teknike, shfrytëzimin e kapaciteteve prodhuese dhe transmetuese të teknikës së RTSH-së dhe për projektet zhvillimore të kësaj njësie;
- ç) përgjigjet për shpërndarjen e transmetimeve audio dhe audiovizive të programeve kombëtare audio dhe audiovizive të Radio Televizionit Shqiptar;
- d) zbaton kontratat me të tretë që lidh RTSH-ja për shfrytëzimin e infrastrukturës së lirë të shpërndarjes së sinjalit;
- dh) realizon lidhjet direkte, sipas kërkesave të njësive të tjera administrative të RTSH-së, për transmetime audio dhe audiovizive nga zona të ndryshme të Shqipërisë dhe jashtë saj;
- e) harton rregulloren e njësisë dhe ia paraqet për shqyrtim Drejtorit të Përgjithshëm;
- ë) harton dhe propozon te Drejtori i Përgjithshëm planet teknike të prodhimit të studiove të radios dhe televizionit dhe të transmetimit të programeve nga pikat e transmetimit të RTSH-së;
- f) drejton dhe bashkërendon punën me sektorët teknikë në sistemin e RTSH-së;
- g) harton dhe propozon para Drejtorit të Përgjithshëm plane biznesi për përdorim për të tretë të kapaciteteve të lira teknike, prodhuese dhe transmetuese;
- gj) harton planin vjetor të zhvillimeve teknike dhe të investimeve të RTSH-së, në bashkëpunim me strukturat e tjera organizative të RTSH-së;
- h) miraton planet mujore të sektorëve përbërës të njësisë dhe ndjek zbatimin e tyre;
- i) raporton me shkrim çdo muaj në Drejtorinë e Përgjithshme për defektet teknike dhe ndërprerjet e transmetimeve kombëtare të programeve audio dhe audiovizive të RTSH-së;
- j) i raporton me shkrim çdo tre muaj Drejtorit të Përgjithshëm për realizimin e planeve të zhvillimit dhe të investimit;
- k) kontrollon mbarëvajtjen e punës për zbatimin e planit të shfrytëzimit të aparaturave;
- l) propozon në Drejtorinë e Përgjithshme të RTSH-së projektplane për blerje dhe investime;
- ll) propozon te Drejtori i Përgjithshëm emërimin dhe lirimin nga detyra të punonjësve në varësi të tij, duke përfshirë këtu edhe ata me kontrata pune me kohë të pjesshme;
- m) propozon te Drejtori i Përgjithshëm për shpërblimet ose masat disiplinore për punonjësit në varësi të tij, pas kërkesës së strukturës vartëse përkatëse.

Neni 27 **Drejtuesit e qendrave vendore audiovizive**

Drejtuesit e qendrave vendore audiovizive kanë këto kompetenca:

- a) organizojnë dhe drejojnë veprimtarinë e qendrës vendore audiovizive;
- b) hartojnë, propozojnë dhe përgjigjen për zbatimin e buxhetit të akorduar qendrës vendore audiovizive që drejojnë;
- c) përgjigjen për veprimtarinë programore të qendrës vendore audiovizive, miratojnë planet ditore, javore, mujore dhe tre mujore të prodhimit;
- ç) ruajnë një kopje të dokumentacionit të prodhimit;
- d) hartojnë, propozojnë dhe përgjigjen për zbatimin e strukturës programore, planin e prodhimit të programeve dhe mënyrën e transmetimit të tyre;
- dh) zbatojnë planin e transmetimeve të programeve kombëtare audio dhe audiovizive për zonat që mbulon qendra vendore;

- e) ndjekin realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve që rrjedhin nga zbatimi i kontratave me të tretë, në bashkëpunim me strukturat e tjera në sistemin e RTSH-së;
- ë) hartojnë dhe propozojnë te Drejtori i Përgjithshëm rregulloren e qendrës vendore audiovizive;
- f) I propozojnë Drejtorit të Përgjithshëm emërimin dhe lirin nga puna, si dhe shpërblimet e masat disiplinore për punonjësit në varësi të tyre;
- g) raportojnë me shkrim çdo muaj në njësinë përkatëse defektet teknike dhe ndërprerjet e transmetimeve të programeve kombëtare audio dhe audiovizive të RTSH-së.

KREU V MARRËDHËNIET E PUNËS DHE KATEGORITË E PUNONJËSVE NË SISTEMIN E RTSH-së

Neni 28

Marrëdhëniet e punës në RTSH rregullohen me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, si dhe me akte të tjera që rregullojnë këto marrëdhënie.

Neni 29

1. Marrëdhëniet e punës rregullohen me kontrata pune:
 - a) individuale;
 - b) kolektive;
 - c) me kohë të pjesshme, ku parashikohet garantimi i sigurimeve shoqërore nga institucioni;
 - ç) me projekte, ku detyrimet financiare mbulohen nga vetë projekti.
2. Marrja në punë bëhet sipas kritereve të pranimit në punë, të miratuara me vendim të Këshillit Drejtues të RTSH-së, ku përcaktohet edhe përbërja e komisionit *ad-hoc* për përzgjedhjen e punonjësve. KDRTSH, në përcaktimin e kritereve të marrjes në punë, përfshin edhe kritere të tjera ligjore, për aq sa parashikohen si subjekte të ligjeve të posaçme.
3. Largimi nga puna bëhet sipas kritereve të përcaktuara në Kodin e Punës, kontratën kolektive dhe individuale të punës:
 - a) me mbarimin e kontratës së punës;
 - b) për shkelje flagrante të disiplinës në punë;
 - c) për përvetësim të pasurisë së RTSH-së;
 - ç) me kërkesën e të punësuarit.

Neni 30

1. Punonjësit të RTSH-së i ndalohet të shpërndajë ose të publikojë çdo material konfidencial, i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, që është siguruar në funksion të postit ose detyrës që mban.
2. Rastet e ndodhura vlerësohen në varësi të rrjedhojave dëmtuese dhe struktura drejtuese ushtron të drejtën e masave ndëshkimore.
3. Ndalohet dypunësimi i punonjësve të sektorëve programorë e krijues, të sektorëve të teknikës dhe të specialistëve të tjerë të administratës së RTSH-së në mediat e tjera audiovizive.

Neni 31

1. Punonjësit në sistemin e RTSH-së grupohen në:
 - a) punonjësit e sektorit të krijimtarisë;
 - b) punonjësit e sektorit teknik;
 - c) punonjësit e sektorit ekonomiko-administrativ.
2. Në grupin e parë përfshihen të gjithë punonjësit e RTSH-së, që merren me punë krijuese, si:

gazetarë, regjisorë, redaktorë, redaktorë muzike, operatorë, kameramanë, piktorë etj., që merren në punë me kontratë afatgjatë, me kohë të pjesshme dhe me kontratë projektfinancimi. Punonjësit me kohë të pjesshme ose ata të punësuar në bazë të një kontrate projektfinancimi duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në përshkrimet përkatëse të punës.

3. Në grupin e dytë përfshihen të gjithë ata që merren me problemet teknike të prodhimit, regjistrimit dhe të transmetimit audioviziv.

4. Në grupin e tretë përfshihet i gjithë stafi drejtues i RTSH-së, të gjithë punonjësit e administratës, si: specialistë ekonomistë, juristë, burimeve njerëzore, marketing etj., që janë në shërbim të administratës dhe që kryejnë detyra shërbimi për të dyja grupet e para, si dhe punonjës të shërbimeve mbështetëse si: hidraulikë, marangozë, elektrikistë, korrierë, sekretarë, arkivistë, roje shërbimi etj.

Neni 32

Përshkrimi i punës për kategoritë e punonjësve

Përshkrimi i punës për secilën nga kategoritë e përcaktuara në nenin 31, pika 1, bëhet me vendim të KDRTSH-së dhe është pjesë e kontratës individuale të punës.

KREU VI

VEPRIMTARIA DHE PROGRAMET E RTSH-së

Neni 33

Veprimtaria e RTSH-së

1. RTSH-ja kryen një shërbim publik në fushën e transmetimeve audio dhe/ose audiovizive dhe aktiviteteve multimedia (internet, OTT, IPTV), duke përdorur edhe teknologjitë e reja të transmetimeve.

2. Veprimtaria e RTSH-së bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, në këtë statut, në kontratën e shërbimit të transmetimit publik, në Kodin e Etikës, parimet editoriale dhe standardet profesionale, si dhe në aktet e tjera të organeve drejtuese të RTSH-së. Në veprimtarinë e vet, RTSH-ja respekton legjislacionin shqiptar, konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare për veprimtarinë radiofonike dhe audiovizive të pranuar nga Republika e Shqipërisë.

3. Veprimtaria e RTSH-së përfshin përgatitjen, prodhimin e transmetimin e të paktën:

- a) dy programeve kombëtare audiovizive;
- b) një programi audioviziv satelitor;
- c) dy programeve kombëtare audio;
- ç) një programi audio për bashkatdhetarët;
- d) një programi audio në gjuhë të huaj;
- dh) katër programeve audiovizive të qendrave rajonale;
- e) një programi të drejtpërdrejtë audioviziv për veprimtaritë e Kuvendit.

4. Përveç sa përcaktohet në pikën 3, të këtij neni, RTSH-ja mund të prodhojë dhe të transmetojë programe të tjera me karakter të përgjithshëm dhe tematikë, të përcaktuara në kontratën e shërbimit të transmetimit publik, duke respektuar kriteret dhe detyrimet që rrjedhin nga ligji për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë.

Neni 34

Veprimtaria tregtare e RTSH-së

1. Përveç kryerjes së një shërbim publik në fushën e transmetimeve audio dhe/ose audiovizive dhe aktiviteteve multimedia, RTSH-ja gjithashtu do të jetë e angazhuar, në një masë të kufizuar, edhe në aktivitete tregtare.

2. Aktivitetet tregtare që kryen nga RTSH-ja përfshijnë:

- shitjen e kohës reklamuese dhe të programeve;
 - shërbimet teknike dhe telekomunikative që nuk janë pjesë përbërëse e shërbimit publik;
 - dhënien me qira të infrastrukturës së transmetimit, pronave të tjera të paluajtshme, koncertet, aktivitetet botuese;
 - shitjen e shërbimeve të programeve, duke përfshirë shërbimet e programeve interaktive.
 - përdorimin komercial të materialeve të arkivuara;
 - shitje të pajisjeve që mundësojnë futjen e teknologjive të avancuara në transmetim.
3. Brenda fushës tregtare, si edhe shërbimeve të programeve interaktive, RTSH-ja do të ofrojë mundësi për ngritjen e nivelit profesional dhe për këtë arsye do të kryejë programe trajnuese dhe profesionale. Programet profesionale të trajnimit për nevojat komerciale nuk përfshijnë trajnimet e punonjësve të institucionit.
4. RTSH-ja do të kryejë aktivitete mbështetëse për shërbimin publik, aktivitete shitjeje dhe do të ruajë vlerat kulturore kombëtare.

Neni 35

Transparenca e veprimtarisë së RTSH-së

1. Vendimet dhe qëndrimet e Këshillit Drejtues, Bordit të Administrimit, që kanë lidhje me veprimtarinë e RTSH-së dhe atë tregtare të RTSH-së, që paraqesin interes publik, duhet të publikohen në mënyrë të hapur, me përjashtim të rasteve kur këto organe vendosin ndryshe.
2. Operacionet e biznesit të RTSH-së janë publike. Raporti vjetor duhet të publikohet në një botim të veçantë dhe në faqet zyrtare të internetit të RTSH-së.
- RTSH-ja bën publike në faqen zyrtare të internetit: ligjin, Statutin, raportin vjetor të veprimtarisë së tij, përfshirë edhe atë financiar, vendet e lira të punës, rezultatet e vlerësimit të kandidatëve dhe shpalljen e fituesit, vendimet e Këshillit Drejtues, planin strategjik të miratuar nga KD i RTSH-së, parimet editoriale, burimet e financimit dhe shpenzimet vjetore, kontratën e lidhur me AMA-n, si dhe raportet vjetore të Këshillit të Dëgjuesve dhe Shikuesve dhe atij të Bordit të Administrimit.
3. Raporti vjetor duhet të përmbajë specifikim të shpenzimeve, të përfshira në prodhimin e programeve, sipas kategorive funksionale të programeve dhe përmbajtjes.
4. Funksionimi i RTSH-së duhet të jetë transparent, ndërkohë që një akt shkresor individual, ose marrëveshje mund të deklarohet publikisht vetëm me miratimin e organit që e ka nënshkruar atë, duke respektuar dispozitat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sekretet e biznesit.
5. Në shërbim të publikut, RTSH-ja vë në qarkullim një botim periodik, ku publikohen të dhëna të hollësishme për situatën financiare të institucionit dhe, në bashkëpunim me Këshillin për Shikuesit dhe Dëgjuesit, të dhëna testuese që opinioni ka për veprimtarinë programore të RTSH-së.

Neni 36

Shërbimet teknike të RTSH-së

1. Mirëmbajtja dhe operimi i objekteve dhe pajisjeve të destinuara për marrjen, shkëmbimin, shpërndarjen dhe transmetimin e programeve të prodhuara nga RTSH-ja, duke përdorur teknologji analoge dhe digjitale.
2. Sigurimi i shikimit dhe dëgjimit të progra-meve të transmetuara nga RTSH-ja, duke bërë të mundur edhe transmetimin e programeve të operatorëve të tjerë.
3. Modernizimi teknologjik dhe rregullimi i rrjetit të transmetimit, sipas standardeve të vendeve europiane.
4. Sigurimi i shikimit dhe dëgjimit të progra-meve të RTSH-së në zonat kufitare, të banuara nga minoriteti kombëtar shqiptar, në përputhje me marrëveshjet dypalëshe.
5. Aktivitetet e operatorëve në lidhje me ofri-min e shërbimeve të komunikimit, duke përdorur teknologji analoge dhe digjitale.

Programet e RTSH-së

1. Programet e RTSH-së respektojnë kërkesat e neneve 4, 32 deri 36, 46, 47, 119, 121 të ligjit nr. 97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilave ata:

- a) kanë karakter informativ, edukativ, kulturor dhe artistiko-argëtues;
 - b) respektojnë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut, paanshmërinë dhe objektivitetin e informacionit, të drejtat e fëmijëve, gjuhën dhe kulturën shqiptare, të drejtat kushtetuese të shtetasve dhe të pakicave kombëtare, përkatësinë fetare shqiptare, rendin publik dhe sigurinë kombëtare, gjuhën e kulturën shqiptare, të drejtat kushtetuese të shtetasve e të pakicave kombëtare, si dhe dallimet fetare të shqiptarëve;
 - c) informojnë publikun, me objektivitet dhe profesionalizëm, për ngjarjet në Shqipëri e në botë;
 - ç) përgatisin dhe realizojnë informacione me interes publik, që transmetohen pa shpërbllim, për rastet e fatkeqësive natyrore, për shëndetin dhe rendin, vetëm me vendim me shkrim të Drejtorit të Përgjithshëm;
 - d) realizojnë shërbimin me titrimin apo dublimin në shqip të programeve të huaja, të filmave artistike e të dokumentarëve;
 - dh) ruajnë fshehtësinë e burimit të informacionit;
 - e) njohin të drejtën e përgënjeshtimit;
 - ë) nuk nxisin dhunën, urrejtjen kombëtare, fetare e raciale, ndarjen territoriale dhe veprime antikushtetuese.
2. RTSH-ja do të sigurojë në programet e saj cilësi të lartë dhe të larmishme të përmbajtjes informative, kulturore, arsimore, zbavitëse, si dhe krijimin, riprodhimin dhe prezantimin e veprave artistike.
3. Planet e prodhimit të programeve miratohen nga drejtuesit e njësive përkatëse.
4. Të gjitha materialet e përgatitura për transmetim regjistrohen e arkivohen.
5. Përgjegjës për programin e RTSH-së është gazetari përkatës dhe drejtuesi i njësisë përkatëse.

KREU VII

PRODHIMI I RTSH-së

1. RTSH-ja do të vazhdojë të jetë prodhuesi kryesor i programeve të veta audio dhe audiovizive të Radios e Televizionit, do të kryejë bashkëprodhime vetëm programesh edukative, kulturore, artistike dhe argëtuese me prodhues privatë, vendas dhe të huaj, si dhe mund të porosisë programe të prodhuara nga të tretët.
2. RTSH-ja prodhon programe audio të të gjitha gjinive radiofonike.
3. RTSH-ja prodhon programe audiovizive të të gjitha gjinive dhe filma artistikë. Prodhimi i programeve audio dhe/ose audiovizive planifikohet dhe realizohet në përputhje me strukturën programore të miratuar.
4. Prodhimi financohet nga buxheti i RTSH-së, nga sponsorë ose donatorë të ndryshëm.
5. Prodhimi realizohet me projekte të hollësishme, me plane ekonomiko-financiare dhe me planskenare.
6. Bashkëprodhimi realizohet pas miratimit të planskenarit dhe të buxhetit të programit.

Modalitetet për prodhimet e porositura dhe bashkëprodhimet e RTSH-së

1. Prodhim i porositur është një nga programet e transmetimit audioviziv të RTSH-së, i përgatitur nga personat fizikë ose juridikë për llogari të RTSH-së.

2. RTSH-ja mund të porosisë prodhime filmike e artistike tek të tretët, sipas nevojave të strukturës programore.

3. Modalitetet për prodhimet e porositura nga fondi i prodhimit të pavarur dhe bashkëprodhimet përcaktohen në një rregullore të veçantë, të hartuar nga Njësia e Programeve dhe që miratohet nga Këshilli Drejtues i RTSH-së.

Neni 40

Të gjitha departamentet krijuese në RTSH janë edhe njësi prodhuese.

Neni 41

Orkestra Simfonike e RTSH-së

1. Orkestra Simfonike e RTSH-së është nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së.

2. Orkestra Simfonike e RTSH-së dhe formacioni i vogël muzikor, përveç veprimtarisë koncertale për publikun, prodhojnë programe muzikore për transmetime audio dhe audiovizive, për fonotekën dhe arkivin e RTSH-së, si dhe kryejnë shërbime me porosi për të tretët.

3. Orkestra ka për qëllim:

- a) riprodhimin e veprave muzikore shqiptare e të huaja dhe prodhimin e regjistrimeve të muzikës së lehtë dhe popullore;
- b) promovimin e trashëgimisë së vërtetë muzikore shqiptare dhe krijimtarisë bashkëkohore;
- c) përgatitjen dhe shfaqjen e koncerteve dhe të shfaqjeve të tjera publike;
- ç) regjistrimin e krijimeve artistike të vendit dhe të huaja;
- d) koncertet mujore, festivalet dhe krijimtari të tjera.

Neni 42

Qendrat vendore audiovizive

1. Qendrat vendore audiovizive prodhojnë, përgatisin dhe transmetojnë programe audio dhe audiovizive për rajonet që mbulojnë, si dhe programe të porositura informative për Njësinë e Programeve, Njësinë e Programeve Tematike dhe Lajmeve dhe për të tretët.

2. Programet e qendrave vendore audiovizive përgatiten nga redaksitë përkatëse.

3. Përgatitja e programeve rajonale të qendrave vendore audiovizive drejtohet nga drejtuesi i qendrës audiovizive vendore dhe bashkërendohet me drejtuesin e Njesisë së Programeve.

Neni 43

Prodhimi i programeve audio dhe audiovizive të qendrave vendore audiovizive drejtohet nga drejtorët e programeve të këtyre institucioneve, në bashkëpunim me redaktorët përgjegjës të programeve, duke zbatuar strukturën programore, të miratuar nga Këshilli Drejtues i RTSH-së.

Neni 44

Shërbimet për vete dhe për të tretët

RTSH-ja kryen këto shërbime për vete dhe për të tretët:

- a) prodhon në formatin analog dhe digjital programe për vete dhe për të tretët.
- b) prodhon e transmeton mesazhe tregtare, reklama dhe shërbime reklamash në programet audio dhe/ose audiovizive;
- c) organizon marketingun e filmave televizive, të programeve audio dhe audiovizive dhe të regjistrimeve muzikore në tregjet vendase dhe të huaja;

- ç) organizon blerjen, shitjen, shkëmbimin e dhënien me qira të filmave dhe videofilmave, si dhe të programeve audio dhe/ose audiovizive;
- d) prodhon me porosi nga shfrytëzimi i arkivit të RTSH-së;
- dh) vë në dispozicion, kundrejt pagesës, kapacitetet e lira të prodhimit e të transmetimit për të tretë, në formë shërbimesh, kundrejt detyrimeve kontraktore;
- e) kryen shërbime teleteksti;
- ë) ka të drejtë të botojë revista dhe materiale të ndryshme propagandistike, për promovimin e programeve audio dhe/ose audiovizive, si dhe libra profesionale dhe të gjinive të tjera me interes publik.

Neni 45

Pasqyrimi i aktivitetit të Kuvendit dhe fushatave zgjedhore

1. Detyrimet e RTSH-së për transmetimin e reklamave politike dhe reklamave institucionale gjatë periudhës zgjedhore bëhet sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.
2. Gjatë fushatave zgjedhore, RTSH-ja ofron në mënyrë të balancuar dhe të paanshme diversitetin e alternativave dhe programeve politike.
3. RTSH-ja ka detyrimin për të raportuar mbi ngjarjet, në përputhje me praktikën më të mira dhe Kodin e Etikës, parimet editoriale dhe standardet profesionale.
4. RTSH-ja është e detyruar të përfshijë në transmetimin e saj një program transmetimi të drejtpërdrejtë audioviziv për veprimtaritë e Kuvendit.

Neni 46

Aktet e përgjithshme, miratimi dhe zbatimi

1. Aktet e përgjithshme të RTSH-së përfshijnë rregulloret, rregullat e procedurës, aktet organizative dhe të tjera, që rregullojnë çështje të rëndësishme për menaxhimin dhe operimin e transmetuesit publik.
2. Aktet e përgjithshme të RTSH-së rregullojnë të gjitha çështjet, të cilat nuk janë të rregulluara në ligjet përkatëse, statutin dhe kontratat kolektive të punës, në veçanti:
 - marrëdhëniet e punësimit dhe klasifikimin e vendeve të punës;
 - masat disiplinore, përgjegjësinë, dëm-shpërblimin dhe shpërblimin e punonjësve;
 - marrëdhëniet me krijuesit dhe ofruesit e programeve;
 - bazat dhe kriteret për vlerësimin e performancës së punës;
 - operacionet financiare;
 - rregullat organizative për mënyrat dhe metodat e punës.
3. Aktet e përgjithshme përgatiten nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, në bashkëpunim me drejtuesit e njësive organizative.
4. Aktet e përgjithshme propozohen nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së dhe miratohen nga KDRTSH-ja.
5. Aktet e përgjithshme duhet të orientohen drejt optimizimit të punës dhe operacioneve të biznesit.

KREU VIII PRONËSIA E RTSH-së

Neni 47

1. Pasuritë e paluajtshme të RTSH-së regjistro-hen si prona të paluajtshme publike dhe administrohen vetëm nga RTSH-ja për përmbu-shjen e qëllimit të përcaktuar në këtë ligj.
2. Pasuria e paluajtshme e RTSH-së përfshin:

a) ndërtesat, sipas projekteve përkatëse, gjithë sipërfaqen e tokës së rrethuar, ku janë objektet e RTSH-së;

b) kullat metalike të stacioneve dhe të përsëritësve televizivë;

c) përsëritësit televizivë që sigurojnë transmetimin e programeve audiovizive të RTSH-së;

ç) çdo pasuri tjetër që është e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me truallin e RTSH-së.

3. Pasuria e luajtshme e RTSH-së përfshin:

a) pajisjet teknike;

b) automjetet;

c) pajisjet e zyrave;

ç) materialet arkivore të filmit, të fonotekës dhe të dokumentacionit shkresor.

4. Është pronë ekskluzive e RTSH-së, mbështetur në legjislacionin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, çdo program audio dhe audioviziv i prodhuar nga strukturat e saj, me porosi të RTSH-së dhe që ka siglën e këtij institucioni.

Neni 48

1. Pronat e RTSH-së mund të jepen me qira, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Drejtuesit e strukturave përbërëse të RTSH-së kanë të drejtë të propozojnë dhënien me qira të pronave.

2. Të gjitha pronat e paluajtshme regjistrohen në hipotekë, sipas dispozitave ligjore.

3. Me vendime të veçanta të organit përgjegjës dhe sipas legjislacionit në fuqi bëhet nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i pasurisë së luajtshme.

KREU IX

BURIMET E FINANCIMIT TË RTSH-së

Neni 49

1. RTSH-ja i siguron fondet financiare për nevojat e veta nga burimet e përcaktuara në ligjin nr. 97, datë 4.3.2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", si dhe nga burimet e mëposhtme:

a) tarifa e shërbimit për përdorimin e aparatit marrës të transmetimeve audiovizive në posedimin e personave në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) shërbimet audiovizive me pagesë për publikun;

c) shërbimet për përdorimin e infrastrukturës së transmetimit;

ç) vënia në dispozicion për të tretët dhe me pagesë e godinave dhe e kullave metalike, e stacioneve dhe përsëritësve televizivë, kundrejt kontratave dypalëshe, e të operatorëve të tjerë që punojnë në fushën e telekomunikacioneve, si:

- operatorët publikë ose privatë të shërbimit fiks dhe të lëvizshëm telefonik;

- operatorë strategjikë shtetërorë;

- operatorë të tjerë shtetërorë, publikë e privatë;

d) shërbimet ndihmëse për të tretët;

dh) dhëniet me qira të pajisjeve, pronë e RTSH-së, mbështetur në kontratat dypalëshe;

e) shërbime të tjera, si prodhim, montim e transmetim programesh për të tretë, vendas dhe të huaj;

ë) shfrytëzimi i studiove radiotelevizive, fikse dhe të lëvizshme, në favor të të tretëve, vendas dhe të huaj;

f) shërbime teleteksti.

2. Tarifat e shërbimeve miratohen me votim të hapur me shumicën e anëtarëve të Bordit të Administrimit dhe KDRTSH-së.

3. Programet e përgatitura dhe të transmetuara nga RTSH-ja financohen nga pagesa e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparatit marrës të transmetimit audioviziv, të ardhurat e fituara përmes veprimtarisë tregtare dhe fondet buxhetore.

Neni 50

Ndarja e operacioneve financiare nga shërbimi publik

1. RTSH-ja duhet të sigurojë që operacionet e saj financiare në fushën e veprimtarisë tregtare do të organizohen ndaras nga shërbimi publik.

2. Tarifa e shërbimit për përdorimin e aparatit marrës të transmetimeve audiovizive, fondet buxhetore, fondet e tjera publike, si dhe të ardhurat nga kryerja e shërbimit publik, mund të përdoren vetëm për kryerjen e shërbimit publik, të përcaktuar në ligjin në fuqi.

3. Të ardhurat nga veprimtaria tregtare mund të shfrytëzohen për bashkëfinancimin e shërbimit publik, shpërblimet, ose për ruajtjen dhe zgjerimin e veprimtarinë tregtare, por vetëm në fusha të specifikuara që kanë lidhje me shërbimin publik.

Neni 51

1. Granti nga Buxheti i Shtetit financon:

- a) shërbimin e transmetimeve audio për shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;
- b) shërbimin e transmetimeve audio për publikun e huaj;
- c) shërbimin e transmetimeve audiovizive për shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;
- ç) projekte të rëndësishme teknike për futjen e teknologjive të reja për prodhim dhe transmetim;
- d) projekte të rëndësishme prodhimi filmik dhe veprimtari artistike të mëdha mbarëkombëtare, të prodhuara nga RTSH-ja;
- dh) Orkestrën Simfonike të RTSH-së.

2. Masa e financimit përcaktohet në ligjin vjetor të Buxhetit të Shtetit, pas miratimit paraprak, në bazë të projektit të propozuar.

3. Ministrinë dhe institucionet e tjera shtetërore mund të financojnë projekte të veçanta me rëndësi kombëtare në fushat e kulturës, të shkencës dhe të edukimit.

Neni 52

Plani i biznesit

1. Një element bazë në organizimin e punës dhe operacionet e biznesit është plani i biznesit, i cili përbëhet nga katër pjesë të rëndësishme:

- përgatitja e planit të biznesit;
- miratimi i planit të biznesit;
- zbatimi i planit të biznesit;
- mbikëqyrja e zbatimit të planit të biznesit.

2. Përgatitja dhe zbatimi i planit të biznesit janë elementet më të rëndësishme për funksionimin racional dhe ekonomik të institucionit publik.

3. Planin vjetor të biznesit është i bazuar dhe matet brenda Strategjisë së Zhvillimit të RTSH-së.

Neni 53

Përgatitja e planit të biznesit

1. Përgatitja në kohë dhe zbatimi i planit të biznesit është përgjegjësi e organeve si më poshtë:

- Drejtorit të Përgjithshëm;
- Bordit të Administrimit;
- Zëvendësdirigjtorit të Përgjithshëm;
- drejtuesve të njësive organizative;
- redaktorëve përgjegjës të programeve;
- menaxherëve, drejtuesve të drejtorive, departamenteve dhe sektorëve për fusha të veçanta të

punës, drejtuesve të qendrave rajonale, drejtorëve të njësive organizative të transmetimit dhe drejtorëve të njësive organizative.

2. Drejtori i Përgjithshëm, së bashku me drejtuesin e njësive të programeve dhe redaktorët përgjegjës të programeve, duhet të përgatisin strukturën programore të RTSH-së. Pas marrjes së mendimit edhe të Këshillit për Shikuesit dhe Dëgjuesit, e dërgojnë për miratim në Këshillin Drejtues RTSH-së.

3. Drejtuesi i Njësive të Programeve, së bashku me redaktorët e programeve do të përgatisin programin vjetor për prodhimin e programeve, që do të miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së.

4. Pas miratimit të strukturës programore dhe programit vjetor të prodhimit të programeve, projektplanin e biznesit përgatitet për vlerësim sipas funksionit, stafit financiar dhe parametereve të prodhimit teknologjik.

5. Planin e biznesit duhet të jetë në përputhje me mundësitë financiare, njerëzore dhe teknologjike të prodhimit.

6. Planin e biznesit duhet të zbatohet plotësisht, në kuadër të fondeve të akorduara, kapaciteteve të stafit, dhe kapaciteteve teknologjike dhe mbikëqyrja e zbatimit të tij është përgjegjësi e Drejtorit të Përgjithshëm.

7. Drejtori i Përgjithshëm informon Këshillin Drejtues për përdorimin e fondeve për zbatimin e planit të biznesit.

Neni 54

Reklama

1. Reklama, kushtet, forma, kohëzgjatja, reklamat e ndaluara përcaktohen në nenet 38 deri në 44 të ligjit nr. 97, datë 4.3.2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

2. Reklama është qartësisht e ndarë nga programet dhe përgjegjësia editoriale e RTSH-së.

3. Reklama porositen nga agjenci, individë, si dhe subjekte të tjera publike e private, vendase dhe të huaja.

4. Marrëdhëniet me kontraktuesit përcaktohen në aktmarrëveshjet tip dhe ndryshojnë në varësi të nivelit të tregut të reklamës.

5. Me propozimin e Drejtorit të Marketingut, Bordi i Administrimit përcakton kriteret dhe tarifën bazë të reklamës, si dhe të kohës tregtare që ia paraqet për miratim Këshillit Drejtues.

6. Përcaktimi dhe ndryshimi i tarifave të reklamave, sipas kriterëve të miratuara nga Këshilli Drejtues dhe sipas kohëzgjatjes së tyre e orareve të transmetimit, me propozimin e Drejtorisë së Marketingut dhe pas marrjes së mendimit nga Bordi i Administrimit, miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm.

7. Ndryshimi i tarifave të reklamës duhet të sjellë rritje të të ardhurave.

8. Njësia e Programeve, Njësia e Programeve Tematike dhe Lajmeve dhe qendrat vendore audiovizive në bashkëpunim me Drejtorinë e Marketingut përcaktojnë kohën televizive që do të vihet në dispozicion të reklamës, sipas limiteve të shprehura në Rregulloren e Brendshme të RTSH-së.

Neni 55

1. Spoti reklamues standard është 30 sekonda.

2. Njësia matëse për spotin është çmimi në vlerë monetare për sekondë.

3. Spotet me interes publik jotregtar, që nuk reklamojnë veprimtaritë fitimprurëse, futen në transmetim me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm.

4. Gjatë edicioneve të lajmeve dhe gjatë transmetimit të ceremonive fetare nuk lejohet ndërprerja e tyre me transmetimin e reklamave.

Neni 56

1. Çdo komision i paguar një agjenti duhet të jetë jo më e madhe se 10 për qind e vlerës së kontratës së reklamës.

2. Format e pagesës për reklamën janë me llogari ose çek bankar dhe në natyrë. Kur bëhet me shkëmbim në natyrë, shkëmbimi bëhet me kontratë të veçantë.

Neni 57

Sponsorizimi

Sponsorizimi rregullohet në mbështetje të nenit 45, të ligjit nr. 97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, sipas kontratave të hidhura ndërmjet sponsorizuesit, i cili mund të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, dhe RTSH-së.

KREU X

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 58

1. Ndryshimet në Statut miratohen sipas përcaktimeve në ligj.

2. Në mbështetje e për zbatim të këtij Statuti, hartohen rregulloret e brendshme të të gjitha strukturave organizative të RTSH-së që miratohen nga Këshilli Drejtues i RTSH-së.

VENDIM

Nr. 480, datë 3.6.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE PËR APARATET MARRËSE TELEVIZIVE, QË DO TË VENDOSEN NË TREG

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 22, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, dhe të pikës 3, të nenit 5, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave teknike për aparatet marrëse televizive, DVB-T2/MPEG4, me ndërfaqe të përbashkët, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet 3 muaj pas hyrjes në fuqi të tij.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

RREGULLA TEKNIKE
PËR APARATET MARRËSE TELEVIZIVE, DVB-T2/MPEG4, ME NDËRFAQE TË
PËRBASHKËT

1. Fusha e zbatimit

1.1 Ky rregull teknik zbatohet për aparatet marrëse televizive të cilat përfshijnë:

- a) aparatet marrëse televizive të integruara;
- b) dekodrat.

1.2 Ky rregull teknik përcakton kërkesat/ specifikat e detajuara për veprimtarinë e vendosjes në treg, lëvizjes së lirë dhe vënies në shërbim të aparateve marrëse televizive në Republikën e Shqipërisë.

1.3 Ky rregull teknik zbatohet për të gjitha aparatet marrëse televizive të importuara, si dhe për ato që mund të prodhohen në Shqipëri.

1.4 Ky rregull teknik zbatohet për prodhuesit, përfaqësuesit e autorizuar të prodhuesit, subjektet përgjegjëse për vendosjen e pajisjeve në treg dhe operatorët e rrjeteve numerike, nëse ata janë përgjegjës për vendosjen në treg të pajisjeve.

2. Përkufizime

Për qëllime të këtij rregulli teknik, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- 1. “Akses i kushtëzuar”, ka kuptimin që i jep ligji nr. 97/2013.
- 2. “Aparat marrës televiziv”, bashkësia e pajisjeve elektronike, që realizon marrjen dhe shfaqjen e transmetimeve televizive numerike për përdoruesit dhe çdo aparat tjetër apo program i lidhur me të për këtë qëllim.
- 3. “Aparat marrës i integruar”, aparati marrës televiziv që ka të integruar pajisjen për marrjen e sinjaleve numerike.
- 4. “HD (*High-definition television (or HDTV)*)”, sinjali video me rezolucion substancialisht më të lartë se sinjalet video të sistemeve televizive tradicionale.
- 5. “SD (*Standard-definition television (ose SDTV)*)”, rezolucioni i figurës së sistemeve televizive tradicionale.
- 6. “Dekoder”, pajisja që konverton sinjalet numerike në sinjale analoge, për t’u kapur (marrë) nga aparatet marrëse të zakonshme analoge.
- 7. “DVB-T - *Digital Video Broadcasting Terrestrial*”, transmetimi numerik video tokësor (DVB-T), është sistemi në shërbimin tokësor, i përcaktuar në rekomandimin ITU-R BT.1306 të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve si “Sistemi numerik B”.
- 8. “DVB-T2”, sistemi i transmetimeve numerike tokësore DVB-T i përmirësuar.
- 9. “ETSI - *European Telecommunications Standards Institute*”, e njohur zyrtarisht nga Bashkimi Evropian, si Organizata e Standardeve Evropiane, prodhon standarde për teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (ICT), përfshirë teknologjitë e konvergjuara fikse, të lëvizshme, radio, transmetimet audiovizive dhe internet.
- 10. “ITU (*International Telecommunications Union*)”, Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve.
- 11. “ITU-T (*International Telecommunications Union-T*)”, sektori i standardizimeve të telekomunikacioneve të ITU-së.
- 12. “MPEG 2”, sistemi i kompresimit të figurës.
- 13. “MPEG 4”, sistemi i avancuar i kompresimit të figurës.
- 14. “Ndërfaqe e përbashkët”, një teknologji që lejon ndarjen e funksioneve të aksesit të kushtëzuar nga një aparat marrës televiziv, nëpërmjet një moduli të aksesit të kushtëzuar (CAM) për të mundësuar aksesin në disa sisteme enkriptimi që mund të ofrohen nga operatorë të ndryshëm.
- 15. “Moduli i aksesit të kushtëzuar (CAM)”, një pajisje elektronike që përmban një fole për një kartë (*smart card*), vendosur në një aparat marrës televiziv për të mundësuar aksesin në një shërbim të mbrojtur në një formë të kuptueshme/të qartë.

3. Kërkesat/specifikat e detajuara

Për të gjitha pajisjet brenda fushës së këtyre rregullave teknike, aplikohen këto kërkesa/specifika të detajuara:

- a) Aparati marrës televiziv të jetë me ndërfaqe të përbashkët.
- b) Aparati marrës televiziv të jetë i standardit DVB-T2/MPEG-4.
- c) Aparati marrës televiziv të mundësojë marrjen dhe dekodimin e sinjaleve numerike të transmetuara në standardet DVB-T/MPEG-2.
- ç) Aparati marrës televiziv të mundësojë marrjen e sinjaleve numerike tokësore në standardet SD dhe/ose HD.
- d) Aparati marrës televiziv të jetë në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare, të listuara në shtojcën 1 të këtij vendimi.
- dh) Aparati marrës televiziv të jetë në përputhje me specifikimet teknike të miratuara nga AMA, si në shtojcën 2 të këtij vendimi.

4. Vendosja në treg

4.1 Aparati marrës televiziv vendoset në treg nga një person fizik ose juridik vetëm nëse plotëson kërkesat/specifikimet e detajuara sipas këtyre rregullave teknike.

4.2 Prodhuesi ose personi që vendos në treg aparatin marrës televiziv është përgjegjës për të siguruar që aparati është në përputhje me këto rregulla teknike.

4.3 Importuesi ose personi i cili importon aparatin marrës televiziv dhe e vendos atë në treg, mban të njëjtën përgjegjësi si prodhuesi dhe duhet të sigurojë që produkti është në pajtim me këto rregulla teknike.

4.4 Importuesi siguron që produkti të shoqërohet nga udhëzimet për përdorimin ose, sipas rastit, udhëzimet për mirëmbajtjen, si dhe nga informacioni për sigurinë në gjuhën shqipe, të cilat duhet të jenë lehtësisht të kuptueshme nga konsumatori ose përdoruesi i fundit.

4.5 Kur aparati marrës televiziv vendoset në treg, informacioni rreth qëllimit të përdorimit duhet të jetë i mjaftueshëm për t'u identifikuar në paketim dhe në instruksionet e përdorimit të pajisjes.

4.6 Kur aparati marrës televiziv vendoset në treg, informacioni duhet të jetë i mjaftueshëm për të identifikuar ndërfaqet në rrjetin numerik audioviziv, ku pajisja do të lidhet.

4.7 Mosrespektimi i këtyre rregullave, kur nuk përbën veprë penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimorë".

SHTOJCA 1

LISTA E STANDARDEVE TË MIRATUARA NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT

Nr.	Nr. i standardit	ICS	ICS	Titulli i standardit, anglisht	Titulli i standardit, shqip
	S SH EN 300 744:2001	33.060.20		<i>Digital Video Broadcasting (DVB); Framing structure, channel coding and modulation for digital terrestrial television</i>	Transmetimi numerik video (DVB); Struktura e kuadrit, kodimi i kanalit dhe modulimi për televizionin numerik tokësor
	S SH EN 300 744:2004	33.060.20		<i>Digital Video Broadcasting (DVB); Framing structure, channel coding and modulation for digital terrestrial television</i>	Transmetimi numerik video (DVB); Struktura e kuadrit, kodimi i kanalit dhe modulimi për televizionin numerik tokësor
	S SH EN 300 744:2009	33.060.20		<i>Digital Video Broadcasting (DVB); Framing structure, channel coding and modulation for digital terrestrial television</i>	Transmetimi numerik video (DVB); Struktura e kuadrit, kodimi i kanalit dhe modulimi për televizionin numerik tokësor

S SH EN 302 755:2011	33.060.20		<i>Digital Video Broadcasting (DVB); Frame structure channel coding and modulation for a second generation digital terrestrial television broadcasting system (DVB-T2)</i>	Transmetimi numerik video (DVB); Struktura e kuadrit, kodimi i kanalit dhe modulimi për një sistem të transmetimit numerik tokësor televiziv të gjeneratës së dytë (DVB-T2)
S SH EN 302 755:2012	33.060.20		<i>Digital Video Broadcasting (DVB); Frame structure channel coding and modulation for a second generation digital terrestrial television broadcasting system (DVB-T2)</i>	Transmetimi numerik video (DVB); Struktura e kuadrit, kodimi i kanalit dhe modulimi për një sistem të transmetimit numerik tokësor televiziv të gjeneratës së dytë (DVB-T2)
S SH EN 101 162:2014	33.060.20		<i>Digital Video Broadcasting (DVB); Allocation of identifiers and codes for Digital Video Broadcasting (DVB) systems</i>	Transmetimi numerik video (DVB); Vendorsja e identifikuesve dhe e kodeve për sistemet e transmetimit numerik video (DVB)
S SH EN 102 992:2010	33.060.20		<i>Digital Video Broadcasting (DVB); Structure and modulation of optional transmitter signatures (T2-TX-SIG) for use with the DVB-T2 second generation digital terrestrial television broadcasting system</i>	Transmetimi numerik video (DVB); Struktura dhe modulimi i firmosjes opsionale të transmetuesit (T2-TX-SIG) për përdorimin me sistemin e gjeneratës së dytë të transmetimit numerik televiziv DVB-T2

SHTOJCA 2

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MARRËSIT NUMERIK

(Miratuar me vendimin nr. 3, datë 4.2.2015, të AMA-s, me disa ndryshime, miratuar me vendimin nr. 38, datë 11.5.2015, të AMA-s)

1.1 Kërkesa të përgjithshme

Marrësi duhet të plotësojë të gjitha kërkesat ligjore të detyrueshme që specifikohen nga Bashkimi Evropian dhe autoritetet përkatëse kombëtare. Marrësi duhet të jetë efikas nga pikëpamja energjetike dhe të minimizojë konsumin e fuqisë për të gjitha mënyrat e operimit. Prodhuuesit rekomandohen të ndjekin marrëveshjet vullnetare për konsumin e energjisë për dekoderat (*set-top-box*) kompleksë nën rregulloret e BE-së dhe/ose të rregullores së Komisionit Evropian (EC) nr. 1275/2008 që implementon direktivën 2005/32/EC të Parlamentit Evropian, lidhur me kërkesat *Ecodesign* për mënyrën “stendbaj” (*stand-by*) dhe kyçur (*off*) të konsumit të energjisë elektrike të pajisjeve elektrike e elektronike të familjeve dhe zyrave.

1.2 Kërkesat e *hardware*-it

1.2.1 Pjesa RF

1.2.1.1 Të përgjithshme

Marrësi duhet të mbështetë të paktën një ndërfaqe të përbashkët sipas pikës 1.2.2.3, gjithashtu, duhet të lejojë marrjen e sinjalit DVB-T2/MPEG-4 dhe të suportoje sinjalin DVB-T/MPEG-2 në rrjete me frekuencë të vetme (*Single Frequency Networks - SFN*) ose me shumë frekuenca (*Multi Frequency Networks - MFN*).

a) marrësi në standardin DVB-T2/MPEG-4 duhet të lejojë marrjen dhe demodulimin e sinjalit të transmetuar në përputhje me EN 302 755 [2]; si dhe

b) në standardin DVB-T/MPEG-2 duhet të lejojë marrjen dhe demodulimin e sinjalit të transmetuar në përputhje me EN 300 744 [1].

Marrësi duhet të lejojë marrjen e të gjitha kanaleve në bandën UHF (banda IV-V me gjerësi brezi 8 MHz) dhe të të gjitha kanaleve në bandën VHF (banda III me gjerësi brezi 7 MHz).

Marrësi DVB-T2/MPEG-4 që suporton dhe DVB-T/MPEG-2 duhet të lejojë marrjen e sinjalit me të gjitha kombinacionet e lejueshme të parametrave të mëposhtëm në përputhje me EN 302 755 [35] (opsionet DVB-T2/MPEG-4 jepen me *bold*):

- Mënyra e transmetimit: 1k, 2k, 4k, 8k normale dhe e zgjeruar, 16k normale dhe e zgjeruar, 32k normale dhe e zgjeruar;
- Modulimi: QPSK, 16 QAM, 64 QAM, 256 QAM *both rotated and non-rotated*;
- *Code rate*: 1/2, 3/5, 2/3, 3/4, 4/5, 5/6, 7/8;
- *Guard interval* (intervali mbrojtës) : 1/4, 19/256, 1/8, 19/128, 1/16, 1/32, 1/128;
- Forma pilot (*Pilot pattern*): PP1, PP2, PP3, PP4, PP5, PP6, PP7, PP8;
- SISO/MISO;
- FEC *Frame length*: 64800, 16200;
- Mënyra e hyrjes A (Input Mode A (*single PLP*)) ose mënyra e hyrjes B (Input Mode B) (PLP të shumëfishta (*Multiple PLPs*)) – PLP e përbashkët (*Common PLP*), tipi 1 dhe 2 deri në shufrën maksimale të lejuar 255);
- Frekuencë RF e vetme (*Single RF Frequency*) ose ndarje kohore e frekuencave (*Time Frequency Slicing -TFS*);
- Mënyra normale (*Normal Mode*) ose mënyra e efikasitetit të lartë (*or High Efficiency Mode*);
- Pjesët FEF (2);
- Tufat ndihmëse (*Auxiliary streams*) (2).

Marrësi DVB-T2/MPEG-4, që suporton dhe DVB-T/MPEG-2, duhet të lejojë marrjen e sinjalit në ambient me jehona (*echo*) në përputhje me EN 300 744 [1].

Brenda ndërfaqes së përdoruesit marrësi duhet të ofrojë informacion mbi nivelin e sinjalit dhe cilësinë e tij. Implementimi i ndërfaqes së përdoruesit është përgjegjësi e prodhuesit.

1.2.1.2 Nivelet e hyrjes së sinjalit në marrës (*Receiver Signal Input Levels*)

Për sinjalet DVB-T dhe DVB-T2 me gjerësi normale 8 MHz, marrësi duhet të mbështetë operimin “pothuaj pa gabime” (*QEF-Quasi Error Free*). Niveli minimal i sinjalit të hyrjes pa degradim të figurës dhe audios së dekoduar:

- $P(\min) = -105,2\text{dBm} + \text{NF}(\text{dB}) + \text{C/N}(\text{dB})$
- $\text{NF} = \text{Maximum Noise Figure}$ (Niveli maksimal i zhurmave)
- $\text{C/N} = \text{Raporti Sinjal zhurmë}$

Në bandat VHF III, UHF IV dhe UHF V niveli maksimal i zhurmave (NF) i marrësve DVB-T nuk duhet të kalojë 7dB dhe në S Band I, S Band II dhe S Band III nuk duhet të kalojë 10 dB.

Në bandat VHF III, UHF IV dhe UHF V niveli maksimal i zhurmave (NF) i marrësve DVB-T2 nuk duhet të kalojë 6 dB dhe në S Band I, S Band II dhe S Band III nuk duhet të kalojë 10 dB.

Pra, niveli minimal i llogaritur i hyrjes së marrësve DVB-T për marrje QEF në 8 MHz dhe profil *Gaussian* për bandat VHF S Band I dhe II dhe UHF S Band III duhet të jetë i rendit prej:

- -90,1dBm për QPSK CR 1/2 GI 1/4 deri
- -72,7dBm për 64-QAM CR 7/8 GI 1/4

Për bandat UHF band IV dhe V (8MHz) the vlerat duhet të jenë të rendit nga:

- -93,1dBm për QPSK CR 1/2 GI 1/4 deri
- -75,7dBm për 64-QAM CR 7/8 GI 1/4

Niveli minimal i llogaritur i hyrjes së marrësve DVB-T2 për marrje QEF në 8 MHz dhe profil *Gaussian* për bandat VHF S Band I dhe II dhe UHF S Band III do të jetë në rendin prej:

- -91,6dBm për QPSK CR 1/2 GI 1/4 deri
- -70,0dBm për 256-QAM CR 5/6 GI 1/8

Për bandat UHF band IV dhe V (8MHz) the vlerat duhet të jenë të rendit nga:

- -95,6dBm për QPSK CR 1/2 GI 1/4 deri
- -74,0dBm për 256-QAM CR 5/6 GI 1/8

Niveli maksimal i sinjalit të hyrjes në STB për DVB-T dhe DVB-T2 është -23dBm.

1.2.1.3 Konektori i hyrjes

Marrësi duhet të ketë të paktën një konektor tuner në përputhje me IEC 60169-2, pjesa 2 [2]

dhe duhet të lejojë lidhjen me antenën e jashtme me konektorin e tipit IEC 169-2 mashkull. Impendenca e hyrjes duhet të jetë 75 Ohm.

Marrësi, gjithashtu, duhet të ketë një konektor hyrjeje për të krijuar një lidhje shtesë me instalimin e antenës.

Sinjalet RF të marrësit duhet të vijohen te konektori i daljes RF, pavarësisht nga statusi (gjendja) e marrësit (në punë apo *stand-by*), me qëllim që pajisja e lidhur (d.m.th. marrësin TV) të mund të operojë edhe nëse marrësi është në *stand-by*.

Marrësi duhet të ofrojë suport me rrymë të vazhduar për një antenë të jashtme me amplifikator. Ai nuk duhet të degradojë karakteristikat RF të hyrjes. Ushqimi me rrymë të vazhduar duhet të jetë i mbrojtur nga lidhjet e shkurtra. Në sistemin e menysë së marrësit duhet të ketë një opsion për të kyçur apo shkyçur ushqimin me rrymë të vazhduar. Ky opsion në vlerat e fabrikës duhet të jetë i shkyçur.

1.2.1.4 Procedurat e kërkimit/skanimit

Në rastin e të njëjtit numër identifikimi të fluksit të transportit (*Transport stream ID*) dhe numër identifikimi i shërbimit (*Service ID*) në dy ose më shumë frekuenca të ndryshme, marrësi duhet të ruajë të gjitha frekuencat ose të zgjedhë frekuencën me sinjalin më të mirë.

Marrësi duhet të jetë i aftë të marrë dhe të reagojë ndaj parametrave të kërkimit në tabelat PSI/SI tables (*SDT ose NIT information*).

Përveç kërkimit automatik, marrësi duhet të lejojë një kërkim manual ku numri identifikues i kanalit (*Channel ID*) (ose frekuenca) futet nga përdoruesi fundor. Marrësi duhet të akordohet në këtë kanal, të kërkojë të gjitha mënyrat (*mode*) e disponueshme DVB-T dhe DVB-T2, të shtojë shërbimet e reja dhe të zëvendësojë shërbimet ekzistuese në listën e shërbimeve (pa marrë parasysh ndonjë kriter cilësor).

1.2.1.5 Menaxhimi dinamik i kanalit (*Dynamic channel management*)

Marrësi duhet të azhurnojë parametrat e modulimit në përputhje me tabelën NIT (*Network Information Table*). Marrësi duhet të azhurnojë “Listën e shërbimeve”, në përputhje me tabelën SDT (*Service Description Table*).

1.2.1.6 PMT (*Program Map Table*) dinamike

Marrësi duhet të jetë i aftë të kryejë ndryshimet dinamike në PMT. Një skenar praktik përdorimi për ndryshimet dinamike të PMT-së është, p.sh., kërkesa për të kyçur dhe shkyçur variantet rajonale të programeve nga një OSHM.

Marrësi duhet të kryejë ndryshimet dinamike të PMT-së në mënyrë të saktë duke mbikëqyrur disa kufizime shtesë:

- Ndryshimet dinamike në PMT nuk duhet të prodhojnë asnjë shqetësim në daljen audio/video.

- Në rast kyçjeje të fluksit elementar audio dhe video, koha maksimale e kyçjes (e matur nga azhurnimi i PMT-së deri në figurën e pastër) duhet të jetë 3 sekonda. Koha maksimale e kyçjes duhet të plotësohet pavarësisht nëse flukset elementare janë të kriptuara ose jo.

Rekomandohet që video në dalje të ngrijë (*freeze frame*), derisa fluksi i ri video të dekodohet dhe të shfaqet.

1.2.2 Ndërfaqet

1.2.2.1 Ndërfaqja SCART

Marrësi duhet të ketë të paktën një ndërfaqe SCART në përputhje me EN 50049-1 [8] dhe EN 50157-2-1 [9].

Tabela e mëposhtme përmbledh sinjalet hyrje / dalje në të gjitha ndërfaqet SCART:

Tabela 1-1: Kërkesat për SCART

SCART	Requirement	CVBS/AUDIO	RGB	PIN 8	PIN 16**
1 TV	E detyruar*	Out	Out	Out (1)	Out (2)
2 VCR	Opsionale	in and out (3)	In	In	In (2)

*Jo e rëndësishme për iDTV

**Opsionale(1): Sinjali i kontrollit në PIN 8:

Nom. 0 Volt/DC: burim i brendshëm i TV set;

Nom. 6 Volt: burim i jashtëm, format 16:9;

Nom. 12 Volt: burim i jashtëm format 4:3 format.

(2): Sinjali i kontrollit në PIN 16:

Nom.0 Volt/DC:CVBS (*Composite Video Baseband Signal*) aktive

1-3 Volt/DC: RGB (*Red Green Blue*) aktive

(3): Grafikët OSD (?) nuk duhet të jenë prezentë në daljen VCR SCART *output* me përjashtim kur kërkohet subtitrimi i DVB-së (nëse është disponibël dhe nëse zgjidhet).

Ndërfaqja audio e VCR SCART duhet të japë të njëjtin sinjal audio si sinjali i disponueshëm në ndërfaqen TV SCART. Kontrolli i brendshëm i volumit duhet të prekë vetëm sinjalin audio në ndërfaqen TV SCART, por jo sinjalin audio të ndërfaqes VCR SCART.

1.2.2.2 Dalja video RCA

Si një nivel opsional i HDTV, STB (*Set Top Box*) duhet të ofrojë dalje për video analoge YPbPr në përputhje me CEA 770.3 [26].

Marrësi duhet të ketë të paktën një ndërfaqe videoje analoge CVBS të bazuar në konektorin RCA tip femër IEC 60603-14 [32].

1.2.2.3 Ndërfaqet për akses të kushtëzuar

Marrësi duhet të mbështetë të paktën një ndërfaqe të përbashkët DVB (*DVB Common Interface*) (për modulën CA module) për aksesin e kushtëzuar. Sloti CI (*CI-slot*) duhet të jetë në përputhje me EN50221 [19].

1.2.2.4 Dalja audiodigjitale

Marrësi duhet të ketë një ndërfaqe koaksiale ose optike S/PDIF për audion digjitalë për të ofruar sinjal PCM në përputhje me IEC 60958 [20] ose një fluks audio jolinear të koduar PCM në përputhje me IEC 61937 [21].

1.2.2.5 Dalja analoge audio RCA

Marrësi duhet të ketë të paktën një ndërfaqe audioanaloge bazuar në dy konektorë RCA të tipit femër IEC 60603-14 [32].

1.2.2.6 Ndërfaqja HDMI

Marrësi i nivelit HDTV me ekran (iDTV) duhet të plotësojë kërkesat e specifikuara për ndërfaqet video nga EICTA për postet *iDTV/TV HD Ready (HD Ready iDTV-sets* [28]).

Marrësi i nivelit HDTV pa ekran (STB) duhet të ketë të paktën një ndërfaqe multimedia me definicion të lartë (*High-Definition Multimedia Interface - HDMI*) me konektor të tipit A [29], që mbështetin ekrane kompatibël me kërkesat EICTA HD-Ready [28].

STB-ja e nivelit HDTV duhet të jetë e aftë të përdorë informacionin EDID të ofruar nga ekrani për të përcaktuar automatikisht daljen e STB-së.

STB-ja e nivelit HDTV duhet të ofrojë opsionin “Formati origjinal”, d.m.th., të nxjerrë të njëjtin format me formatin e marrë nëse mbështetet nga ekrani siç tregohet nga informacioni EDID. Nëse formati i marrë nuk mbështetet STB-së duhet të zgjedhë mënyrën e shfaqjes (*display mode*) që ofron cilësinë më të lartë të mundshme të videos. Kjo kërkohet për të shmangur që dalja e STB-së të bëhet e zezë nëse ka një mospërputhje midis formatit të marrë dhe aftësive të shfaqjes (ekranit).

Duhet, gjithashtu, të bëhet e mundur që të vendoset manualisht formati default nga STB-ja i nivelit HDTV në një format të fiksuar. Formati i fiksuar do të përfshijë formatet e mëposhtme:

- 1920x1080i@25Hz;

- 1280x720p@50Hz;
- 720x576p@25Hz;
- dhe si opsion
- 1920x1080p@25Hz;
- 1920x1080p@50Hz.

Dalja e preferuar *default* duhet të ruhet (*stored*) në STB.

Dalja HDMI duhet të japë *audio stereo* ose *stereo downmix* ose audio shumëkanalëshe (*multichannel audio*) dhe duhet të pajiset me funksionin (*Auto lip-synch*). Dalja HDMI duhet të njohë *auto lip-synch* dhe duhet të vonojë audion ose videon të kompensojë latencat në pajisjet e marrjes së fluksit (*downstream devices*). Hyrja (hyrjet) iDTV HDMI duhet të deklarojë informacionin e fshehur (*latency*) audio/video në EDID-në e saj.

1.2.3 Procesori

Marrësi duhet të ketë një orë/kalendar në kohë reale që funksionon vazhdimisht. Ora duhet të azhurnohet nga TDT dhe TOT hyrëse nga SI.

Marrësi duhet të ketë një *timer* të brendshëm për mundësinë e komutimit automatikisht nga mënyra *standby* (*stand-by mode*) në mënyrën e punës (*operational mode*). Ky *timer* duhet të vihet në punë lokalisht (i pranuar nga përdoruesi fundor).

1.2.4 Demultiplekseri MPEG

Demultiplekseri duhet:

- të jetë sipas shtresës së transportit MPEG-2 (*MPEG-2 transport layer*) të përcaktuar në ISO/IEC 13818-1 [5] dhe ETSI TS 101 154 [3]; dhe
- të jetë i aftë të dekodojë një fluks (stream) ISO/IEC 13818-1 [5] me shpejtësi (*data rates*) deri në 32 Mbit/s për DVB-T dhe deri në 50,34 Mbit/s për DVB-T2;
- të suportojë flukse elementare me shpejtësi të ndryshme (*Variable Bit Rate Elementary Streams*) brenda një fluksi transporti me shpejtësi konstante.

1.2.5 VIDEO Dekoderi MPEG

Dekoderi i marrësit duhet të jetë plotësisht sipas standardit ISO IEC 14496-10 [4] për të dekoduar sinjale MPEG-4 dhe ISO/IEC 13818-2 [17] për të dekoduar sinjale MPEG-2. Dekoderi, gjithashtu, duhet të jetë në përputhje me ETSI TS 101 154 [3] dhe duhet të mbështetë VBR (*Variable Bit Rate*) dhe CBR (*Constant Bit Rate*).

Dekoderi i marrësit duhet të sigurojë sinkronizimin midis AUDIO-s dhe VIDEO-s, si më poshtë:

Audioja kurrë nuk duhet të paraprijë programin video për më shumë se 20 ms dhe nuk duhet të vonohet ndaj videos për më shumë se 45 ms.

Dekoderi i marrësit duhet të ketë elemente procesuese për konvertimin e videoformatit në dalje të videos së dekoduar në HDMI-në e tij dhe/ose në SCART ose ndërfaqe tjetër analoge, Sinjalizimi i Formatit të afishimit midis STB dhe pajisjes së afishimit (ekranit) janë ose LINE23 WSS dhe/ose nivele voltazhi në SCART PIN8, siç përcaktohet nga IEC 62216-1 [25] ose në rastin e daljes HDMI sipas zgjatimeve EICTA të IEC 62216-1 (6.4.3.7.4 procesimi AFD *processing* për dalje HDMI).

Tipikisht një rajon i ngushtë kufitar brenda kufirit të zonës 720x576 *pixel* nuk është i dukshëm për shkak të mbiskanimit në ekranin SD. Për shërbimet që përmbajnë viedon ISO/IEC 14496-10, OSHM-ja mund të përdorë shenjat (*flag*) “*overscan_info_present*” dhe “*overscan_appropriate*” për të treguar nëse marrësi do të aplikojë këtë *overscan* tipik apo do të shfaqë imazhin e plotë video të transmetuar.

Tabela A – Shenjat *Overscan* të transmetimit (*Broadcast overscan flags*)

<i>overscan_info_present_flag</i>	<i>overscan_appropriate_flag</i>	<i>Usage</i>
0x0 ose jo transmetim	n/a	Nuk ka metodë shfaqjeje të preferuar
0x1	0x0	Informacion i rëndësishëm në të gjithë video rajonin
0x1	0x1	Figurë e dekoduar e përshtatshme për <i>Overscan</i>

Për marrësit me dalje HDMI, marrësi duhet të kalojë në dalje videon pa riformatimin *overscan*, duke i vendosur bitet në *info framen* (info kuadrin) AVI [30].

Tabela C – Sinjalizimi *Overscan* në HDMI

<i>overscan_info_present_flag</i>	<i>overscan_appropriate_flag</i>	<i><S1,S0> (in HDMI AVI Infoframe)</i>
0x0 ose jo transmetim	n/a	<0,0>
0x1	0x0	<1,0>
0x1	0x1	<0,1>

1.2.5.1 Dekodimi i shërbimeve SDTV

Dekoderi i marrësit duhet të mbështetë *profiling* “H.264/AVC Main Profile at Level 3” (i përdorur për H.264/AVC SDTV) dhe të jetë konform ETSI TS 101 154 [3] (kapitujt 5.5 dhe 5.6; 25 Hz SDTV).

Dekoderi i marrësit duhet të dekodojë videon me rezolucionin 720x576 piksel me shpejtësi minimale (*minimum data rate*) prej 600 kbit/s.

Dekoderi i marrësit duhet të jetë i aftë të komutojë midis figurave 4:3 dhe 16:9 (*aspect ratios*)-raporteve të pamjes). Në rastin e marrjes së një figure (*anamorphic picture*) me vendosje 4:3 në marrësin TV, marrësi DVB-T duhet të kryejë konvertimin në “16:9 letterbox”. Opsionisht dekodleri duhet të kryejë konvertimin në “14:9 letterbox”. Konversioni “16:9 letterbox” duhet të implementohet nga filtrimi vertikal. Degradimi i sinjalit për shkak të filtrimit duhet të jetë i papercptueshëm subjektivisht. Linja (rreshti) 23 dhe linja (rreshti) 623 duhet të maskohen përpara konvertimit për të shmangur gjysmërreshtat irritues.

1.2.5.2 Dekodimi i shërbimeve HDTV

Marrësi i nivelit HDTV duhet të suportojë plotësisht dekodimin e shërbimeve SDTV në përputhje me kapitullin 1.1 të këtij dokumenti.

Videodekoderi duhet të mbështetë “H.264/AVC High Profile at Level 4” dhe të jetë sipas ETSI TS 101 154 [3] (kapitulli 5.7 H.264/AVC HDTV).

Në rastin e SCART-it ose çfarëdo daljeje video analoge (Y, Pb, Pr ose të tjera, videoja e dekoduar me definicion të lartë (*High Definition*) duhet të konvertohet nga konverteri me format SD në rezolucion me definicion standard (SD) për dalje nëpërmjet këtyre ndërfaqeve. Konvertimi i figurës duhet të implementohet nga secili prej rezolucioneve të koduara HD 1920x1080 dhe 1280x720 (si opsion, gjithashtu, edhe prej 1440x1080, 1280x1080, 960x1080, 960x720 dhe 640x720) në rezolucionin standard definicion (SD). Videoja e konvertuar duhet të shfaqet si 16:9 *letterbox* në ekran 4:3. Konverteri me format SD duhet të aplikojë *riinterlacing* të përshtatshëm.

1.2.6 Dekoderi audio

1.2.6.1 Kërkesat për dekoderin audio në marrësin e nivelit SDTV

Marrësi duhet të ketë të paktën një audio *decoder stereo* që të jetë i aftë të plotësojë kërkesat minimale të dekodimit të bazuara në shtresën II të MPEG 1 (MPEG 1 Layer II - “*Musican*” ISO/IEC 11172-3) dhe dekoder për AC3 (Standard numerik i kompresionit audio i njohur si *Dolby Digital*). Dekoderi audio duhet të mbështetë, gjithashtu, dekodimin MPEG-4 AAC sipas ISO/IEC 14496-4 sub part 4. [34], MPEG-4 HE-AAC v1 (ISO/IEC 14496-3:2001/Amd.1:2003) dhe MPEG-4 HE-AAC v2 (ISO/IEC 14496-3:2005/Amd.2:2006) [34].

Dekoderët audio duhet të jenë në përputhje të plotë me udhëzuesin e implementimit DVB (*DVB Implementation Guidelines*) për përdorimin e sistemeve MPEG- 2, video dhe audio në aplikimet satelitore, kabllore dhe transmetime tokësore ETSI TS 101 154 [3].

1.2.6.2 Kërkesa shtesë të dekoderit audio për marrësin e nivelit HDTV

1.2.6.2.1 Të përgjithshme

Marrësi i nivelit HDTV duhet të mbështetë marrjen e audios shumëkanalëshe (*multi-channel audio*) (sipas 5.1) përveç audiokërkesave të detyrueshme për marrësit e nivelit SDTV. Marrësi i nivelit HDTV duhet të ofrojë dalje audioanaloge për dalje *stereo/mono*, S/PDIF dhe një dalje HDMI për audio shumëkanalëshe. Opsionalisht dalje shtesë analoge mund të ofrohen për tinguj shtesë të

ambientit ose audiokomponentët për gjuhë shtesë dhe/ose për njerëzit me aftësi të kufizuara.

Një dalje audio e marrësit iDTV⁶ të nivelit HDTV duhet të jetë në sinkronizim me videon e shfaqur.

Marrësi i nivelit HDTV duhet të jetë i aftë të dekodojë dhe (*down-mixing*) formatet e mëposhtme të daljeve analoge:

- HE AAC (5.1 channel down-mix to stereo), nëse në marrës është implementuar HE AAC;⁷
- AC3⁸ (5.1 channel down-mix to stereo), nëse në marrës është implementuar AC3;
- E-AC3⁹ (5.1 channel down-mix to stereo), nëse në marrës është implementuar E-AC3;
- MPEG1 layer II (*Musicam ISO/IEC 11172-3*) (2 kanale).

Marrësi duhet të ketë prezent sinjalin audio në daljet analoge (SCART dhe daljen stereo) kurdoherë që merren katër formatet e mbështetura.

Audio shumëkanalëshe mund të suportohet në dy formate: HE-AAC [34] ose E-AC3 [33]. Për marrësit në treg të dyja formatet duhet të jenë të detyrueshme.

Shërbimet HDTV me audio shumëkanalëshe

Pajisja e jashtme ndërfaqësuese (si njësia e shfaqjes TV - ekrani) nuk duhet të kërkohej të mbështetnin më shumë se 2 PCM audio brenda ndërfaqes kryesore video/audio (HDMI / SCART).

Marrësi i nivelit HD duhet të ketë një nivel reference të audios digjital ekuivalent me nivelin reference të dialogut *Dolby*.

Marrësi i nivelit HD duhet të rregullojë nivelin e daljes së të gjithë dekoderave audio për t'u përputhur me nivelin e brendshëm reference, me qëllim që volumi i perceptuar i programit të jetë i qëndrueshëm për të gjitha skemat e kodimit audio. Për marrësit me E-AC3, kjo duhet të jetë në përputhje me buletin teknik 11 *Dolby* (*Dolby Technical Bulletin 11*): Azhurnimi i kërkesave për AC3 dhe E-AC3 në produktet DVB [34] (*Requirement Updates for AC3 and E-AC3 in DVB Products [34]*). Marrësit me dekodim AC3 ose E-AC3 duhet të përfshijnë tiparin (*feature*) e kontrollit të nivelit PCM (*PCM Level Control*) të përshkruar në këtë buletin. Për shembull, për flukset audio (*audio streams*) MPEG-1 shtresa 2 që kanë një volum mesatar rreth -20 dBLeq, marrësi duhet të aplikojë një shuarje prej 11 dB për daljen digjitale për t'u barazuar me nivelin e brendshëm reference.

1.2.6.2.2 Formatet audio

Marrësi i nivelit HDTV, përveç kërkesave audio për marrësin e nivelit SDTV, duhet të mbështesë edhe formatet e specifikuara në kapitujt 1.2.2.1 dhe 1.2.2.2 të këtij dokumenti.

1.2.6.2.2.1 Sistemi me fluksin e biteve (*bit stream*) E-AC3.

Marrësi i nivelit HDTV duhet të ketë aftësi për procesimin e flukseve AC3 dhe E-AC3.

Marrësi duhet të jetë i aftë të ofrojë formatet e mëposhtme të konektorit të daljes HDMI:

- Kalimin e fluksit vendës të biteve (*bit stream*) AC3 dhe E-AC3.
- Transkodimin e fluksit të biteve E-AC3 në AC3.
- PCM stereo nga fluksi i dekoduar i biteve ose nga fluksi i biteve i përzier (*down-mixed bit stream*).

Formatet e mëposhtme janë opsionale për konektorin e daljes HDMI:

- PCM shumëkanalëshe (*multi-channel*) nga fluksi i biteve i dekoduar.
- Kalim (*Pass-through*) i fluksit të biteve DTS.¹⁰

Marrësi duhet të jetë i aftë të ofrojë formatet e mëposhtme në konektorin S/PDIF connector:

- Transkodimin e fluksit të biteve E-AC3 në AC3.
- PCM stereo nga fluksi i dekoduar i biteve ose nga fluksi i biteve i përzier (*down-mixed bit stream*).
- Kalim (*Pass-through*) i fluksit të biteve AC3.
- Kalimi i fluksit të biteve DTS në konektorin S/PDIF është opsional.

Marrësi duhet:

⁶ Marrës TV i Integruar (*Integrated Digital TV set*).

⁷ *High Efficiency AAC*.

⁸ *Standard numerik i kompresionit audio i njohur si Dolby Digital*.

⁹ AC3 i përmirësuar i njohur si *Dolby Digital Plus*.

¹⁰ *Digital Theatre Sound*.

- të dekodojë flukset AC3 me të gjitha shpejtësitë (*bit rates*) dhe shpejtësitë e kampionimit (*sampling rates*) të listuara në ETSI TS 102 366 [33] (pa përfshirë *Annex E*);

- (*additionally*) të dekodojë (shitesë) flukset E-AC3 *streams* me shpejtësi (*data rates*) nga 32 kbit/s deri në 3 024 kbit/s dhe të mbështetë të gjitha shpejtësitë e kampionimit të listuara në TS 102 366 [33] *Annex E*;

- të jetë i aftë të transkodojë flukset E-AC3 në flukse AC3 sipas ETSI TS 102 366 [33].

Transkodimi në flukset audio AC3 duhet të jetë në një shpejtësi të fiksuar prej të paktën 640 kbit/s. Marrësi duhet të mbështetë përdorimin e *Dolby metadata* [33] të vendosur në fluksin audio kur dekodon fluks bitesh AC3 ose E-AC3, *transkodon fluks bitesh* E-AC3 në AC3 ose kur krijon një (*PCM stereo down-mix*) nga një fluks bitesh i dekoduar E-AC3 ose AC3.

1.2.6.2.2.2 Sistemi me fluks bitesh HE AAC¹¹

Marrësi i nivelit HDTV duhet të ketë aftësinë e procesimit të flukseve HE AAC.

Marrësi duhet të jetë i aftë të ofrojë formatet e mëposhtme në konektorin e daljes HDMI:

- Kalimin e fluksit vendës të biteve (*bit stream*) HE AAC;

- Transkodimin e fluksit të biteve shumëkanalësh HE AAC (*Multi-channel HE AAC*) në AC3 ose DTS;

- PCM stereo nga fluksi i biteve të dekoduar ose të përzier (*down-mixed*).

Formatet e mëposhtme janë opsionale për konektorin e daljes HDMI:

- PCM shumëkanalëshe (*multi-channel*) nga fluksi i biteve i dekoduar;

- Kalim i fluksit të biteve DTS.

Marrësi duhet të jetë i aftë të ofrojë formatet e mëposhtme në konektorin S/PDIF:

- PCM stereo nga fluksi i biteve të dekoduar ose të përzier (*down-mixed*);

- Fluks bitesh shumëkanalëshe HE AAC të transkoduar në AC3 ose DTS.

Kalimi i fluksit të biteve DTS në konektorin S/PDIF është opsional.

Marrësi duhet:

- të jetë i aftë të dekodojë nivelin 2 HE AAC (*mono, stereo*) me shpejtësi kampionimi prej 48 kHz sipas ETSI TS 101 154 [3], *Annex C*;

- të jetë i aftë të dekodojë nivelin 4 HE AAC *Level 4* (*multi-channel*, deri në 5.1) me shpejtësi kampionimi prej 48 kHz sipas ETSI TS 101 154 [3], *Annex C* (*down-mix*);

- të jetë i aftë të transkodojë nivelin 4 HE AAC *Level 4* (*multi-channel*, deri në 5.1) me shpejtësi kampionimi prej 48 kHz sipas ETSI TS 101 154 [3], *Annex C* në AC3 ose DTS.

Nëse mbështetet, transkodimi në flukset audio AC3 duhet të jetë sipas ETSI TS 102 366 [33] me shpejtësi të fiksuar prej 640 kbit/s.

Nëse mbështetet, transkodimi në flukset audio DTS duhet të jetë sipas TS 102 114 [24] me shpejtësi të fiksuar prej 1,536 Mbit/s.

Marrësi i nivelit HDTV duhet të mbështetë përdorimin e metadatave HE AAC të mëposhtme të inkorporuara në fluksin audio kur dekodon HE AAC dhe transkodon HE AAC shumëkanalëshe (*multi-channel*) në AC3 ose DTS:

- Kontrollin dinamik të rendit (*Dynamic Range Control*) sipas ISO/IEC 14496-3 [34];

- Nivelin e referencës së programit (*Program Reference Level*) sipas ISO/IEC 14496-3 [34];

- Parametrat e miksim (përzierjes) (*Mix Down Parameters*) sipas pjesës “Transmetimi i të dhënave ndihmëse MPEG4” (*Transmission of MPEG4 Ancillary Data*) të specifikimeve DVB, ETSI TS 101 154 [3].

1.2.7 Mënyra radio (*Radio mode*)

STB-ja duhet të lejojë marrjen dhe operimin (komutimin midis kanaleve) e DVB-T RADIO bazike pa ekran TV. Kjo mund të bëhet me një buton radio/TV, buton në pllakën e përparme ose në telekomandë (*remote control*).

Në rastin e një shfaqjeje alfanumerike (opsionale) në STB, shfaqja duhet të jetë e gjerë aq sa të lejojë gjatësinë e plotë të emrit të stacionit (deri në 8 karaktere).

¹¹ *High Efficiency AAC (Advanced Audio Coding).*

Nëse një fluks DVB etiketohet si një “Radio shërbim”, ai duhet tregohet gjithmonë nga STB-ja në listën e radiokanaleve edhe nëse do të ketë një video fluks elementar të dërguar në paralel.

1.2.8 Zgjerimi i *software*-it të sistemit (*System software upgrade*)

Marrësi duhet të ofrojë të paktën një mekanizëm për zgjerimin e *software*-it të sistemit.

Marrësit e nivelit HDTV duhet të mbështetin përdorimin e procedurës së zgjerimit të *software*-it të sistemit OTA (*OTA System Software Update procedure*) sipas ETSI TS 102 006 [12]. Prodhuksi duhet të japë procedurën dhe funksionet që kryejnë zgjerimin (*upgrade*) në marrës.

Marrësi duhet të ofrojë një mekanizëm për të detektuar *software* të korruptuar sistemesh të ngarkuara, përpara se këta *software* të përdoren për të zëvendësuar *software*-in aktual në punë. Nëse *software*-i i sistemit është i korruptuar, marrësi duhet të mbajë versionin aktual (në punë) të *software*-it të sistemit, duke e bërë marrësi përsëri operacional. Nëse veprohet kështu dështimi i ngarkimit (*download*-imit) duhet t’i tregohet përdoruesit me një mesazh gabimi (*error*) që mund të përdoret në kontakt me zyrën e marrëdhënieve me abonentët. Duhet të bëhet e mundur për përdoruesin të abortojë ngarkimin (*download*) (në zonat me cilësi të ulët marrjeje, ngarkimi mund të marrë kohë shumë të gjatë) dhe marrësi mund të mbetet operativ duke përdorur versionin aktual të *software*-it të sistemit.

Prodhuksi i marrësit duhet të ofrojë skedarin (*file*) binar të kërkuar MPEG-2 TS (MPEG-2 TS *binary file*) (që përmban vetëm shërbimin e aplikueshëm SSU dhe të gjithë sinjalizimin (PSI/SI), të nevojshëm për një zgjerim (*upgrade*) të suksesshëm) të projektuar për transmetimin ciklik të secilit version të ri të ngarkimit të SS-së (*System Software*). Për secilin nga versionet e reja të SS-së së ngarkimit, prodhuksi duhet t’i japë operatorit të rrjetit të gjitha dokumentet e nevojshme të përshkrimit për transmetimin e *software*-it të ri. Prodhuksi është përgjegjës për dhënien dhe shpërndarjen e njoftimeve për SS.

1.2.9 *Middleware*

1.2.9.1 Informacioni i shërbimit (*Service information*)

Marrësi duhet të ketë SS (*System Software*) për interpretimin dhe përdorimin e informacionit të shërbimit aktiv dhe kontrollin e *hardware/software*-it lokal, sipas EN 300 468 [10] dhe ETSI TR 101 211 [11].

Marrësi duhet të jetë i aftë të procesojë tabelat PSI/SI për të dyja flukset e transportit (*TS-Transport stream*) si “*Actual*” dhe “*Other*”.

Tabelat e mëposhtme janë një paketë tabelash të detyrueshme që marrësi duhet të jetë i aftë t’i procesojë:

NIT, CAT, PAT, PMT, SDT, EIT, TDT, TOT

Marrësi duhet të ofrojë funksionet bazë të EPG-së, me qëllim që të paraqesë:

- EIT aktuale (i tanishëm/pasues/i programuar (*scheduled*)).
- EIT tjetër (i tanishëm/pasues/i programuar (*scheduled*)).

1.2.9.2 Navigatori (Ndërfaqja e përdoruesit - *User Interface*)

Navigatori duhet të paraqitet në gjuhën shqipe dhe do të mbështetë karakteret/germat nga tabelat e kodeve të përcaktuara në grupin e standardeve ISO/IEC 8859-x.

Standardi individual për Shqipërinë:

- ISO/IEC 8859-1 [23] (*Latin-1 Western European*) ku mbështeten gjuhët gjermane, italiane dhe shqipe.

Duhet të mbështeten të gjitha gjuhët e mundshme, me qëllim që përdoruesi të zgjedhë gjuhën, sipas preferencës së tij.

Përdoruesi duhet të jetë i aftë të vendosë preferencë të depozitueshme (të ruajtura) për gjuhën *audio default*¹². Nëse një fluks audio për një gjuhë audio *default* është i disponueshëm, marrësi duhet të zgjedhë automatikisht atë fluks audio.

Marrësi duhet të ofrojë një EPG bazë për shfaqjen e EIT-së së tanishme/pasuese (*Present /Following*) (përshkruesi i shkurtër i ngjarjes (*short event descriptor*), përshkrues i zgjeruar i ngjarjes (*extended event descriptor*), përshkrues i përmbajtjes (*content descriptor*). Po ashtu, tabela e programimit

¹² E vendosur nga fabrika.

EIT (*EIT Scheduling table*) duhet të paraqitet brenda një navigatori marrësi të disenjuar nga firma prodhuese.

1.2.9.3 Teleteksti

Marrësi i nivelit SDTV duhet të ofrojë të paktën opsionet e mëposhtme për paraqitjen e teletekstit:

- Nëpërmjet futjes së të dhënave të teletekstit në VBI¹³ - në e daljes video analoge CVBS¹⁴. Futja duhet të jetë konform ITU-R BT.653-3 [18] dhe kërkesave për nivelin 1.5 të përcaktuara në ETS 300 706 [22].

- Nëpërmjet paraqitjes së teletekstit brenda navigatorit të marrësit.

1.2.9.3.1 Teleteksti për marrësin e nivelit HDTV

Marrësi i nivelit HDTV duhet të jetë i aftë të shfaqë (EBU) teletekst (faqet normale teletekst dhe faqet e subtitruara teletekst), duke përdorur OSD-në, që plotëson kërkesat për nivelin 1.5 në ETSI EN 300 706 “Specifikimet e përmirësuara teletekst” (*Enhanced Teletext Specification*). (Rifutja e të dhënave teletekst në VBI-në e videosinjalit për faqet e teletekstit nuk mjafton, pasi sinjali VBI nuk është caktuar për HDMI. Prandaj të gjithë marrësit e nivelit HDTV duhet të implementojnë një dekoder teletekst të plotë të nivelit 1.5 (*full Teletext decoder level 1.5*).

1.2.9.4 Subtitrimi

Marrësi duhet të jetë i aftë të dekodojë dhe të shfaqë shërbimet e subtitrimit DVB, të cilat transmetohen konform ETSI EN 300 743 [27], përfshirë dhe karakteret nga tabelat e kodeve të paraqitura nga secili vend në kapitullin 1.2.9.2.

Marrësi i nivelit HDTV duhet të përfshijë germa (font/s) *default* me lexueshmëri të mirë për të gjitha mënyrat e videorezolucionit në dalje për SDTV dhe HDTV.

Marrësi i nivelit HDTV duhet të jetë i aftë të përshkallëzojë subtitrimin DVB SDTV dhe subtitrimin teletekst EBU (*EBU Teletext subtitling*) për një shërbim me video HDTV, me synimin për të mbajtur të njëjtën përmasë relative, si dhe subtitrimi DVB SDTV brenda një videoje grid SDTV.

1.2.9.5 Konfigurimet nga përdoruesi (*User settings*)

Përdoruesi duhet të jetë i aftë të depozitojë preferencat në memorien e qëndrueshme.

Marrësi duhet të ofrojë një funksion për të rivendosur (*Reset*) të gjithë parametrat sipas parametrave të fabrikës, duke fshirë të gjitha listat e shërbimeve, preferencat e përdoruesit etj. Pas rivendosjes, marrësi duhet të futë gjendjen e instalimit.

1.2.10 Telekomandimi (*Remote control*)

Marrësi duhet të ketë një kontroll në distancë të përdorshëm lehtësisht. Funksionimi i kontrollit në distancë mund të përcaktohet nga prodhuesi.

Konfigurimi i fabrikës (*Factory presets*)

Për marrësit e nivelit SDTV dhe HDTV duhet të bëhet konfigurimi i mëposhtëm (ose një njoftim special duhet të vendoset ku të shpjegohet se si të vendosen këta parametra):

- Gjuha *Default* për ndërfaqen e përdoruesit dhe subtitrimin të vendoset në shqip, siç përcaktohet në kapitullin 1.2.9.2;

- Kodi i faqes *Default* të vendoset në shqip, siç përcaktohet në kapitullin 1.2.9.2;

- Ushqyesi DC i antenës, të vendoset në off;

- Subtitrimi: ON (*enabled*);

- Format i daljes analoge: 4:3;

- Konversioni “16:9 letterbox”: ON;

- Zgjerimi I SS OTA (*OTA System Software Upgrade: ON (enabled)*);

- Dalja *Default* audiodigjitale të vendoset në PCM *Stereo* sipas IEC 60958 [20].

Terminologjia:

QEF – (*Quasi-Error-Free*) do të thotë më pak se një gabim i pakorrektuar për orë që i korrespondon (*MPEG TS Packet Error Rate*) PER= 10⁻⁷ ose BER = 10⁻¹⁰ deri në 10⁻¹¹ në hyrje të demultipleksit MPEG-4 dhe MPEG-2 .

¹³ *Vertical Blanking Information.*

¹⁴ *Composite Video Baseband Signal.*

Termi “MARRËS” u referohet të gjitha pajisjeve, të afta për të marrë dhe dekoduar sinjale DVB-T2/MPEG-4 që suporton dhe DVB-T/MPEG-2, me qëllim që të shfaqet përmbajtja AUDIO dhe VIDEO (iDTV, STB, pajisje të tjera).

Lista e shkurtimeve:

3DTV 3D	<i>Television</i>
AAC	<i>Advanced Audio Coding</i>
AC3	<i>Digital audio compression standard, known as Dolby Digital</i>
ASO	<i>Analogue switch-off</i>
AV	<i>Audio Visual</i>
AVC	<i>Advanced Video Coding</i>
CA	<i>Conditional Access</i>
CAT	<i>Conditional Access Table</i>
CBR	<i>Constant Bit Rate</i>
CI	<i>Common Interface</i>
COFDM	<i>Coded Orthogonal Frequency Division Multiplexing</i>
CVBS	<i>Composite Video Baseband Signal</i>
DTT	<i>Digital terrestrial television</i>
DVB-H	<i>Digital video broadcasting - Handheld</i>
DVB-T	<i>Digital Video Broadcasting - Terrestrial</i>
DVB-T2	<i>Digital Video Broadcasting – Second Generation Terrestrial</i>
E-AC3	<i>Enhanced AC3, known as Dolby Digital Plus</i>
EIT	<i>Event Information Table</i>
EN	<i>European Norm</i>
EPG	<i>Electronic Programming Guide</i>
ETSI	<i>European Telecommunication Standards Institute</i>
HDMI	<i>High-Definition Multimedia Interface</i>
HDTV	<i>High Definition Television</i>
HE-AAC	<i>High Efficiency AAC</i>
HRT	<i>Croatian Radio and Television</i>
IDTV	<i>Integrated Digital TV set</i>
ISO	<i>International Organization for Standardization</i>
ITU	<i>International Telecommunication Union</i>
MFN	<i>Multi Frequency Network</i>
MHP	<i>Multimedia Home Platform</i>
MPEG	<i>Moving Pictures Expert Group</i>
MUX	<i>Multiplex</i>
NIT	<i>Network Information Table</i>
NF	<i>Noise Figure</i>
PAT	<i>Program Association Table</i>
PCM	<i>Pulse Coded Modulation</i>
PMT	<i>Program Map Table</i>
PSI	<i>Program Specific Information</i>
QAM	<i>Quadrature Amplitude Modulation</i>
QEF	<i>Quasi Error Free</i>
QPSK	<i>Quaternary Phase Shift Keying</i>
RF	<i>Radio Frequency</i>
RGB	<i>Red Green Blue</i>
RTRS	<i>Radio Television of Republic of Serbia</i>
SDT	<i>Service Description Table</i>

SDTV	<i>Standard Definition Television</i>
SFN	<i>Single Frequency Network</i>
SI	<i>Service Information</i>
STB	<i>Set-top Box</i>
TDT	<i>Time and Date Table</i>
TOT	<i>Time Offset Table</i>
TS	<i>Transport Stream</i>
UHF	<i>Ultra-High Frequency</i>
VBI	<i>Vertical Blanking Information</i>
VBR	<i>Variable Bit Rate</i>
VHF	<i>Very-High Frequency</i>

Dokumentet referencë:

- [1] EN 300 744 *DVB Framing structure, channel coding and modulation for digital terrestrial television.*
(ETSI)
- [2] IEC 60169-2, part 2 *Radio-frequency connectors. Part 2: Coaxial unmatched connector.*
- [3] ETSI TS 101 154 *Digital Video Broadcasting (DVB); Implementation guidelines for the use of MPEG-2 Systems, Video and Audio in satellite, cable and terrestrial broadcasting applications.*
- [4] ISO/IEC 14496-10 *Information technology - Coding of audio-visual objects - Part 10: Advanced Video Coding*
- [5] ISO/IEC 13818-1 *Information technology - Generic coding of moving pictures and associated audio information: Systems*
- [6] ISO 639.2 *Code for the representation of names of languages*
- [7] ITU-T V. 92 *Enhancements to Recommendation V.90*
- [8] EN 50049-1 *Domestic and similar electronic equipment interconnection requirements: Peritelevision connector*
- [9] EN 50157-2-1 *Domestic and similar equipment interconnection requirements: AV link-Part 2-1: Signal quality matching and automatic selection of source devices.*
- [10] EN 300 468 *Digital Broadcasting Systems for television, sound and data services; Specification for service information (SI) in Digital Video Broadcasting (DVB) Systems.*
- [11] ETSI TR 101 211 *Guidelines on Implementation and Usage of Service Information (SI)*
- [12] ETSI TS 102 006 *Digital Video Broadcasting (DVB); Specification for System Software Update in DVB Systems.*
- [13] ETS 300 231 *Television systems; Specification of the domestic video Programme Delivery Control system (PDC).*
- [14] ETSI ES 202 130 *Human Factors (HF); User Interfaces; Character repertoires, ordering rules and assignments to the 12-key telephone keypad.*
- [15] ETSI EN 300 472 *Conveying ITU-R System B Teletext in DVB bit streams*
- [16] ETSI EN 301 775 *Conveying VBI data bit streams*
- [17] ISO/IEC 13818-2 *Information technology - Generic coding of moving pictures and associated audio information - Part 2: Video*
- [18] ITU-R BT.653-3 *Teletext systems*
- [19] EN 50221 *Common Interface Specification for Conditional Access and other Digital Video Broadcasting Decoder Applications.*
- [20] IEC 60958 *Digital Audio Interface*
- [21] IEC 61937 *Digital audio - Interface for non-linear PCM encoded Document name/version: audio bit streams applying IEC 60958.*
- [22] ETS 300 706 *Enhanced Teletext Specification.*
- [23] ISO/IEC 8859-1 *Information technology - 8-bit single-byte coded graphic character sets - Part 1: Latin alphabet No. 1*
- [24] ETSI TS 102 114 *DTS coherent acoustics; Core and extensions.*

- [25] IEC 62216-1 *Digital terrestrial television receivers for the DVB-T system – Part 1: Baseline receiver specification.*
- [26] CEA 770.3 *High Definition TV Analogue Component Video Interface.*
- [27] EN 300 743 *Subtitling systems*
- [28] EN 50049-1 *Domestic and similar electronic equipment interconnection requirement: Peritelevision Connector.*
- [29] HDMI Licensing, LLC: HDMI, “High- Definition Multimedia Interface”, rev. 1.3A, October 10, 2006.
- [30] CEA 861- D *Consumer Electronics Association (CEA): A DTV Profile for Uncompressed High Speed Digital Interfaces, July 18, 2006.*
- [31] EICTA HD *Extension to IEC 62216-1 “High Definition” extensions to the IEC 62216-1 “Digital Terrestrial Television Receivers for the DVB-T System”.*
- [32] IEC 60603-14 *Connectors for frequencies below 3 MHz for use with printed boards – Part 14: Detail specification for circular connectors for low-frequency audio and video applications such as audio, video and audio-visual equipment.*
- [33] ETSI TS 102 366 *Digital Audio Compression (AC-3, Enhanced AC-3) Standard*
- [34] ISO/IEC 14496-3 *ISO/IEC: Information technology -- Coding of audiovisual objects -- Part 3: Audio*
- [35] EN 302 755 *Frame structure channel coding and modulation for a second generation digital terrestrial television broadcasting system (DVB-T2).*
- [36] ISO/IEC 8859-16 *Information technology - 8-bit single-byte coded graphic character sets -Part 16: Latin alphabet No. 10*
- [37] *IRD GUIDELINES FOR THE DVB-T (S) PLATFORM AUSTRIA – Interactive profile*
The Interactive Profile defines requirements to receive digital broadcast with support for enhanced applications and for an interaction channel.
- [38] *IRD GUIDELINES FOR THE DVB-T (S) PLATFORM AUSTRIA – Enhanced profile*
The Enhanced Profile defines requirements to receive digital broadcast with support for enhanced applications.
- [39] *IRD GUIDELINES FOR THE DVB-T (S) PLATFORM AUSTRIA – Zapping profile*
The Zapping Profile defines requirements to receive digital broadcast. The requirements for this profile are based on the DVB Specification.
- [40] *Recommendation on minimum Receiver technical requirements for The reception of DVB-T and DVB-T2 Signal in the Republic of Croatia*
The Croatian Post and Electronic Communications Agency (HAKOM) has issued this document as a recommendation regarding the minimum technical requirements to be met by DVB-T and DVB-T2 receivers in order to facilitate high- quality reception of basic digital terrestrial television services in the Republic of Croatia.
- [41] DGTVi D-Book 1.3 (rev. 2)
Compatible DTV receivers for the Italian market: baseline requirements.
- [42] DGTVi Z-Book 1.3 (rev. 2)
Compatible DTV zapper receivers for the Italian market: baseline requirements.
- [43] HD Book (final 1.0)
Compatible High Definition receivers for the Italian market: baseline Requirements.
- [44] *Requirement specifications*
For DVB-T receivers used in Republic of Slovenia

The document represents minimum requirements for DVB-T receivers used in Republic of Slovenia.

*[45] Test specifications for DVB-T
receivers used in Republic of
Slovenia*

Test specifications are established in order to ensure that decoders comply with the common minimum requirements for use in Republic of Slovenia.

*[46] NorDig unified requirements
for integrated receiver decoders*

Document specifies a set of equipment requirements for reception of DVB-based and related services from cable, satellite and/or terrestrial broadcast networks.

*[47] NorDig unified test
specifications for integrated
receiver decoders*

Common test specifications are established in order to ensure that decoders comply with the common minimum requirements.

*[48] ISO/IEC 8859-2 Information technology - 8-bit single-byte coded graphic.
character sets - Part 2: Latin alphabet No. 2*

*[49] ISO/IEC 8859-5 Information technology - 8-bit single-byte coded graphic
character sets - Part 5: Latin/Cyrillic alphabet*

VENDIM

Nr. 690, datë 14.11.2018

PËR PRODHIMIN, TRANSMETIMIN DHE FINANCIMIN E EMISIONEVE TË POSAÇME TELEVIZIVE, ARSIMORE DHE KULTURORE, TË DEDIKUARA PËR DIASPORËN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13, të ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”, të nenit 116, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Prodhimin, transmetimin dhe financimin nga buxheti i shtetit të emisioneve të posaçme televizive, për mësimin e gjuhës shqipe dhe për kulturën shqiptare, të dedikuara për diasporën, si pjesë të programit “RTSH 3”, të Radio-televizionit Shqiptar (RTSH).

2. Emisioni i posaçëm televiziv për mësimin e gjuhës shqipe prodhohet e transmetohet nga Radiotelevizioni Shqiptar (RTSH) dhe financohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

3. Emisioni i posaçëm televiziv për kulturën shqiptare, si prodhim i pavarur i Ministrisë së Kulturës, transmetohet nga Radiotelevizioni Shqiptar (RTSH), me financimin e buxhetit të miratuar për ministrinë.

4. Përmbajtja e programeve të emisionit të posaçëm televiziv për mësimin e gjuhës shqipe do t’u kushtohet interesave të arsimimit për komunitetet shqiptare jashtë vendit, sipas kurrikulës së përbashkët të realizuar për këtë qëllim, në bazë të marrëveshjes me qeverinë e Republikës së Kosovës.

5. Platforma e programeve të emisioneve të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe, kulturën shqiptare dhe identitetin kombëtar të përgatitet nga një grup pune ndërinstitucional, që ngrihet me urdhër të Kryeministrit, me përfaqësues të ministrive përgjegjëse për arsimin, kulturën dhe diasporën.

6. Transmetimet e programeve të miratuara do të inkurajojnë mësimdhënien *online* dhe, pas transmetimit periodik në “RTSH 3”, do të vihen në dispozicion të publikut të interesuar pa pagesë.

7. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Kulturës, për prodhimin, transmetimin dhe financimin e emisioneve të posaçme, sipas pikave 1, 2 e 3 të këtij vendimi, të lidhin marrëveshjet përkatëse me Radiotelevizionin Shqiptar (RTSH).

8. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës dhe ministri i Shtetit për Diasporën, brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, në bashkëpunim me Radiotelevizionin Shqiptar, të marrin masat e nevojshme për realizimin e emisioneve të posaçme dhe transmetimin e tyre, duke filluar nga viti i ri mësimor 2019–2020.

9. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës dhe ministri përgjegjës për diasporën të mbështesin Radiotelevizionin Shqiptar (RTSH) për zbatimin e marrëveshjes me Radiotelevizionin e Kosovës (RTK) për realizimin, brenda vitit 2019, të programit të përbashkët televiziv mbi bazën e interesave të diasporës shqiptare.

10. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

UDHËZIM
Nr. 5, datë 19.2.2016

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 758, DATË 16.9.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË MIRËQENIES SOCIALE DHE
RINISË PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR PAJISJEN ME
DEKODERA TË FAMILJEVE NË NEVOJË, PËRFITUESE NGA SKEMA E
NDIHMËS EKONOMIKE, DHE PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT
2015, MIRATUAR PËR KËTË MINISTRI**
(ndryshuar me udhëzimin nr. 20, datë 3.10.2016)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të nenit 10, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të nenit 22 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikës 4 të vendimit nr. 758, datë 16.9.2015, të Këshillit të Ministrave për ngarkimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për kryerjen e procedurave të prokurimit për pajisjen me dekodera të familjeve në nevojë, përfituese nga skema e ndihmës ekonomike, dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për këtë ministri”,

UDHËZOJ:

1. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë bën transferim kapitali të dekodereve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror të shoqëruar me fletëdalje.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror lidh marrëveshje me bashkitë për shpërndarjen e dekodereve të familjet përfituese të skemës së ndihmës ekonomike si përdorues fundorë të këtyre pajisjeve.

3. Çdo bashki dërgon listat e familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike pas njoftimit të marrë nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, e cila i dorëzon këto lista pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror nëpërmjet strukturave të saj rajonale transferon pranë çdo bashkie dekoderat përkatës dhe administron dokumentacionin që vërteton dorëzimin e mallit.

5. Bashkitë realizojnë shpërndarjen e dekode-rave të familjet përfituese të skemës së ndihmës ekonomike dhe administrojnë dokumentacionin që vërteton dorëzimin e mallit të përdo-ruesi fundor, së bashku me kopjen e kartës së identitetit të nënshkruar nga personi që tërheq dhe merr në dorëzim ndihmën ekonomike.

6. *Shpërndarja e dekoderave në familjet në nevojë, përfituese të skemës së ndihmës ekonomike, do të realizohet në mënyrë progresive në përputhje me rendin dhe afatet e digjitalizimit të transmetimeve audiovizive, të miratuara nga Komiteti Ndërinstitucional për zbatimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike.*

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Shërbimi Social Shtetëror njoftoben menjëherë mbi vendimin e Komitetit Ndërinstitucional për rendin dhe afatet e digjitalizimit të transmetimeve audiovizive dhe fillojnë shpërndarjen e dekoderave duke llogaritur kohën e nevojshme për t'i paraprirë afatit të mbylljes së transmetimeve analoge.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQËNIES SOCIALE
DHE RINISË
Blendi Klosi

VENDIM
Nr. 220, datë 1.12.2017

**MBI PËRCAKTIMIN E PAGESAVE PËR LICENCË/AUTORIZIM DHE
SHËRBIMET QË KRYHEN NGA AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, germa “f” dhe pika 16, si dhe të nenit 25, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Autoriteti i Medive Audiovizive

VENDOSI:

KREU I
PAGESAT PËR LICENCË

1. “Miratimin e pagesave vjetore për licencë”, si më poshtë:
 - 1.1. Pagesat vjetore për licencë kombëtare transmetimi numerik tokësor
 - 1.1.1. Masa e pagesës vjetore për licencë kombëtare transmetimi numerik tokësor audio:
 - Pagesë vjetore për licencë transmetimi audio (T-DAB): 1,500,000 lekë
 - Pagesë vjetore për licencë shërbimi programi audio: 350,000 lekë
 - 1.1.2. Masa e pagesës vjetore për licencë kombëtare transmetimi numerik tokësor audioviziv:
 - Pagesë vjetore për licencë transmetimi audioviziv: 9,330,000 lekë
 - Pagesë vjetore për licencë shërbimi programi audioviziv: 1,700,000 lekë
 - Pagesë vjetore për licencë shërbimi të programit audio, mbështetur në rrjete numerike audiovizive (DVB-T2): 350,000 lekë
 - 1.2. Pagesat vjetore për licencë rajonale transmetimi numerik tokësor
 - 1.2.1. Masa e pagesës vjetore për licencë rajonale transmetimi numerik tokësor audio dhe audioviziv (1 qark):

në lekë

Nr.	Allotmentet	Transmetime audiovizive	Transmetime audio
1	Berat	495,715	18,596
2	Dibër	382,293	14,341
3	Elbasan	942,415	35,353
4	Fier	1,064,915	39,949
5	Gjirokastër	327,248	12,276
6	Korçë	754,868	28,318
7	Kukës	233,212	8,749
8	Lezhë	464,076	17,409
9	Shkodër	711,833	26,703
10	Tiranë – Durrës	3,144,003	117,942
11	Vlorë	809,421	30,364

1.2.2. Masa e pagesës vjetore për licencë shërbimi programi audio dhe audioviziv mbështetur në një rrjet rajonal numerik tokësor (1 qark):

në lekë

Nr.	Allotmentet	Transmetime audiovizive	Transmetime audio
1	Berat	90,323	18,596
2	Dibër	69,657	14,341
3	Elbasan	171,715	35,353
4	Fier	194,036	39,949
5	Gjirokastër	59,627	12,276
6	Korçë	137,543	28,318
7	Kukës	42,493	8,749
8	Lezhë	84,558	17,409
9	Shkodër	129,702	26,703
10	Tiranë – Durrës	572,862	117,942
11	Vlorë	147,483	30,364

1.3. Pagesa për licencë për transmetime analoge

1.3.1. Masa e pagesës vjetore për licencë transmetimi audioviziv analog:

në lekë

Nr.	Zona	Numri i popullsisë	Masa e pagesës
1	Për zona me popullsi	1 – 5.000	2,300
2	Për zona me popullsi	5.001 – 10.000	2,860
3	Për zona me popullsi	10.001 – 30.000	14,300
4	Për zona me popullsi	30.001 – 50.000	25,800
5	Për zona me popullsi	50.001 – 100.000	45,800
6	Për zona me popullsi	100.001 – 300.000	71,500
7	Për zona me popullsi	300.001 – 400.000	85,800
8	Për zona me popullsi	mbi 400.000	100,000
9	Për qytetin e Tiranës		114,300

1.3.2. Masa e pagesës vjetore për licencë transmetimi audioanaloge:

në lekë

Nr.	Zona	Numri i popullsisë	Masa e pagesës
1	Për zona me popullsi	1 – 75.000	30,000
2	Për zona me popullsi	75.001 – 150.000	60,000
3	Për zona me popullsi	150.001 – 250.000	100,000
4	Për zona me popullsi	250.001 – 500.000	150,000
5	Për zona me popullsi	500.001 – 800.000	200,000
6	Për zona me popullsi	800.001 – 1.000.000	350,000
7	Për zona me popullsi	1.000.001 – 1.500.000	400,000

8	Për zona me popullsi	1.500.001 – 2.000.000	450,000
9	Për zona me popullsi	mbi 2.000.000	500,000
10	Me mbulim kombëtar	---	1,500,000

Pagesa vjetore për licencë transmetimi audioanaloge do të llogaritet mbi numrin total të popullsisë së zonës së ofrimit të shërbimit, pavarësisht ndarjeve administrativo-territoriale në fuqi.

1.4. Pagesat për licencë transmetimi audio për qëllime të përkohshme dhe institucionale

1.4.1. Masa e pagesës për licencë transmetimi audio të përkohshme:

Për zona me popullsi deri në 60.000 banorë: 20,000 lekë/muaj

Për zona me popullsi deri në 70.000 banorë: 40,000 lekë/muaj

Për zona me popullsi deri në 200.000 banorë: 60,000 lekë/muaj

Për zona me popullsi mbi 200.000 banorë, përveç Tiranës: 100,000 lekë/muaj

Për qytetin e Tiranës: 160,000 lekë/muaj

1.4.2. Masa e pagesës për licencë transmetimi audio për nevoja institucionale:

Për zona me popullsi deri në 60.000 banorë: 20,000 lekë/muaj

Për zona me popullsi deri në 70.000 banorë: 40,000 lekë/muaj

Për zona me popullsi deri në 200.000 banorë: 60,000 lekë/muaj

Për zona me popullsi mbi 200.000 banorë, përveç Tiranës: 80,000 lekë/muaj

Për qytetin e Tiranës: 100,000 lekë/muaj

KREU II PAGESAT VJETORE PËR AUTORIZIM

2. Miratimin e pagesave vjetore për autorizim, si më poshtë:

2.1. Pagesa vjetore për autorizim për shërbimin e programit audioviziv dhe/ose përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjetin e tij satelitor (platformë satelitore): 4,500,000 lekë

2.2. Pagesa vjetore për autorizim për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor:

në lekë

Nr.	Zona	Numri i popullsisë	Masa e pagesës
1	Për zona me popullsi	1 – 10.000	138,000
2	Për zona me popullsi	10.001 – 20.000	207,000
3	Për zona me popullsi	20.001 – 30.000	276,000
4	Për zona me popullsi	30.001 – 50.000	483,000
5	Për zona me popullsi	50.001 – 70.000	690,000
6	Për zona me popullsi	70.001 – 100.000	966,000
7	Për zona me popullsi	100.001 – 200.000	1.380,000
8	Për zona me popullsi	200.001 – 400.000	1.656,000
9	Për zona me popullsi	mbi 400.000	1.932,000

2.3. Pagesa vjetore për autorizimin për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në IPTV:

në lekë

Nr.	Zona	Numri i popullsisë	Masa e pagesës
1	Për zona me popullsi	01– 100.000	1.440,000
2	Për zona me popullsi	100.001 – 200.000	1.730.000
3	Për zona me popullsi	200.001 – 300.000	2.070.000
4	Për zona me popullsi	300.001 – 500.000	2.490,000
5	Për zona me popullsi	500.001 – 700.000	2.980.000
6	Për zona me popullsi	700.001 – 900.000	3.580.000

7	Për zona me popullsi	900.001 – 1.100.000	4.300.000
8	Për zona me popullsi	1.100.001 – 1.300.000	5.160.000
9	Për zona me popullsi	1.300.001 – 1.500.000	6.190.000
10	Për zona me popullsi	1.500.001 – 1.700.000	7.430.000
11	Për zona me popullsi	1.700.001 – 1.900.000	8.910.000
12	Për zona me popullsi	1.900.001 – 2.100.000	10.700.000
13	Për zona me popullsi	2.100.001 – 2.300.000	12.840.000
14	Për zona me popullsi	2.300.001 – 2.500.000	15.400.000
15	Për zona me popullsi	mbi 2.500.000	18.490.000

2.4. Pagesat vjetore për autorizimin për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në OTT:

Numri i abonentëve	Masa e pagesës
Për vitin e parë dhe deri në 10,000	2,000,000
10,001 – 20,000	3,000,000
20,001 – 30,000	4,000,000
mbi 30,000	4,500,000

- Subjektet e pajisura me autorizim për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në OTT, kanë detyrim që brenda datës 31 janar të çdo viti, të depozitojnë në AMA, informacion mbi numrin e kontratave të shërbimit lidhur me abonentët për vitin paraardhës. Në rast të mosdepozitimit të informacionit të kërkuar, pagesa vjetore për autorizim do të llogaritet në vlerën maksimale.

- Termi “për vitin e parë” nënkupton vitin në të cilin subjekti pajiset me autorizim.

2.5. Pagesat vjetore për autorizim për përsëritjen e shërbimit të programit audio të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor dhe jashtë brezit të frekuencave radiotelevizive:

1. Satelitor: 50,000 lekë
2. Internet: 50,000 lekë
3. OTT: 50,000 lekë
4. IPTV/kabllor: 20,000 lekë

2.6. Pagesat vjetore për autorizim për ofrimin e shërbimit të programit audio, mbështetur në rrjet satelitor, kabllor, internet, OTT, IPTV: 50,000 lekë

2.7. Pagesat vjetore për autorizim për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv, mbështetur në rrjet satelitor, kabllor, internet, OTT, IPTV: 350,000 lekë

2.8. Pagesat për autorizimin e ofrimit të shërbimit me akses të kushtëzuar

Autorizimi i ofruesit të shërbimit teknik, përfshirë ofrimin e shërbimeve me:

- 2.8.1. Akses të kushtëzuar: 2,000,000 lekë
- 2.8.2. Guida elektronike e programeve: 50,000 lekë

- Pagesa vjetore për autorizim për shërbimet e parashikuara në pikën 2.8. do të zbatohet për subjektet që do të autorizohen ekskluzivisht për këto shërbime.

2.9. Pagesa vjetore për autorizim për shërbimet audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit (*Video On Demand*)

2.9.1. Masa e pagesës për shërbimin sipas kërkesës:

Mbulim kombëtar: 1,870,000 lekë

2.9.2. Masa e pagesës për shërbimin sipas kërkesës:

Mbulim lokal (1 qark)

në lekë

Nr.	Allotmentet	Transmetime audiovizive
1	Berat	99,356
2	Dibër	76,622
3	Elbasan	188,887
4	Fier	213,439
5	Gjirokastrë	65,590

6	Korçë	151,297
7	Kukës	46,742
8	Lezhë	93,014
9	Shkodër	142,672
10	Tiranë – Durrës	630,149
11	Vlorë	162,231

Pagesa vjetore për autorizim për shërbimet e parashikuara në pikën 2.9. do të zbatohet për subjektet që do të autorizohen ekskluzivisht për këto shërbime.

KREU III PAGESA PËR SHËRBIMET E AMA-s

3. Miratimin e pagesave për shërbimet që kryhen nga AMA, si më poshtë:

3.1. Masa e pagesave për marrje licence/rinovim licence dhe/ose autorizimi:

a) Licencë për transmetime numerike kombëtare audiovizive dhe për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv, mbështetur në rrjet numerik kombëtar: 50,000 lekë

b) Licencë për transmetime numerike rajonale/lokale audiovizive dhe për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv, mbështetur në rrjet numerik rajonal ose lokal: 30,000 lekë

c) Licencë transmetimi audio mbështetur në rrjet numerik: 30,000 lekë

d) Licencë shërbimi programi audio mbështetur në rrjet numerik: 20,000 lekë

e) Licencë transmetimi audiovizive analoge lokale ose rajonale: 20,000 lekë

f) Licencë transmetimi audioanaloge kombëtare: 40,000 lekë

g) Licencë transmetimi audioanaloge lokale ose rajonale: 15,000 lekë

h) Licencë transmetimi audio për nevoja të përkohshme ose institucionale: 10,000 lekë

i) Autorizimi për përsëritjen e shërbimit të programit audio/audioviziv të të tretëve, pavarësisht rrjetit ku mbështetet: 30,000 lekë

j) Autorizimi për ofrimin e shërbimit të programit në rrjet kabllor ose jashtë brezit të frekuencave radiotelevizive (satelitor, internet TV, IPTV dhe OTT): 30,000 lekë

k) Autorizimi për ofrues shërbimi dhe ofrimin e shërbimeve mediatike audio/audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit: 15,000 lekë

3.2. Masa e pagesave për përpunimin administrativ

a) Aplikimi për licencë për transmetime numerike kombëtare audiovizive: 500,000 lekë

b) Aplikimi për licencë për transmetime numerike rajonale audiovizive: 225,000 lekë

c) Aplikimi për licencë për transmetime numerike lokale audiovizive: 112,500 lekë

d) Aplikimi për licencë shërbimi programi audioviziv mbështetur në rrjet numerik: 100,000 lekë

e) Licencë transmetimi audio mbështetur në rrjet numerik: 100,000 lekë

f) Licencë shërbimi programi audio mbështetur në rrjet numerik: 100,000 lekë

g) Aplikimi për licencë transmetimi audio-analoge lokale ose rajonale përsëritës: 50,000 lekë

h) Aplikimi për licencë transmetimi audioanaloge kombëtare: 200,000 lekë

i) Aplikimi për licencë transmetimi audio për nevoja të përkohshme ose institucionale: 40,000 lekë

j) Aplikimi për ofrimin e shërbimit të programit audio/audioviziv ose për përsëritjen e shërbimit të programit audio/audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor, internet TV, IPTV, OTT): 40,000 lekë

k) Aplikim për autorizim për ofrimin e shërbimit të programit audio/audioviziv ose për përsëritjen e shërbimit të programit audio/ audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet satelitor: 40,000 lekë

l) Aplikimi për platformë satelitore: 200,000 lekë

m) Autorizimi për ofrimin e shërbimeve sipas kërkesës së përdoruesit: 50,000 lekë

n) Aplikimi për miratimin e ndryshimeve në të dhënat e licencës: 50,000 lekë

o) Aplikimi për miratimin e ndryshimeve në të dhënat e autorizimit: 20,000 lekë

3.3. Masa e pagesave për shërbimet

a) Tarifa e shërbimit për lëshimin e dokumentacionit nga arkivi i AMA-s, për çdo fletë të fotokopjuar: 15 lekë

b) Tarifa e shërbimit për lëshimin e materialeve autentike të transkriptuara (për çdo fletë): 1,000 lekë

c) Tarifa e shërbimit për lëshimin e materialeve autentike të kaluara në DWD: 1,400 lekë

Nga detyrimi për pagesën e marrjes së materialeve autentike të kaluara në DWD përjashtohen:

- Studenti, në rastin e përdorimit të tyre për nevoja studimore, për regjistrime deri në 2 orë;

- Institucionet me të cilat AMA ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi;

- Çdo person, i cili pretendon se dinjiteti dhe reputacioni i tij janë prekur nga publikimi i fakteve dhe i informacioneve jo të sakta në një transmetim.

d) Shpenzimet e monitorimit të frekuencave që do të bëhet me kërkesë të subjekteve do të likuidohen nga subjekti i cili e kërkon këtë shërbim, në bazë të një preventivi të përgatitur nga AMA dhe të miratuar nga subjekti.

e) Shpenzimet e monitorimit të programeve që do të bëhet me kërkesë të subjekteve do të likuidohen nga subjekti i cili e kërkon këtë shërbim, në bazë të një preventivi të përgatitur nga AMA dhe të miratuar nga subjekti.

KREU IV DISPOZITA TË TJERA

1. Pagesa vjetore kryhet brenda tremujorit të parë të vitit kalendarik. Në rastin kur pagesa kryhet pas kalimit të këtij afati, aplikohet kamatëvonesa në masën 0.1% të vlerës së detyrimit të mbetur për çdo ditë vonese, por jo më shumë se 30% e vlerës së pagesës vjetore. Detyrimi i lindur në formën e kamatëvonesës së vitit paraardhës dhe i palikuiduar brenda datës 31 dhjetor të çdo viti, përfshihet në pagesën vjetore për licencë/autorizim të vitit pasardhës.

2. Subjekti i licencuar për transmetime audio për qëllime të përkohshme përjashtohet nga detyrimi i parashikuar në pikën 1, të kreut IV të këtij vendimi. Pagesa për licencë transmetimi audio për qëllime të përkohshme kryhet në momentin e licencimit.

3. Subjektet kanë detyrimin të parapagujnë tarifën për shërbimet që kryhen nga AMA.

4. Pagesa për marrjen e licencës ose autorizimit bëhet në momentin e marrjes së licencës ose autorizimit.

5. Pagesat vjetore për licencë dhe/ose autorizim janë të parimbursueshme.

6. Pagesat do të kryhen në llogaritë bankare të AMA-s.

7. Subjekti i licencuar për transmetime audio ose audiovizive dhe subjekti i pajisur me autorizim për ofrimin e shërbimit të programit audio ose audioviziv ka të drejtë të mbështetet në rrjetin satelitor, rrjetin kabllor ose në rrjetet IP, kundrejt regjistrimit në AMA. Në këtë rast, subjekti nuk do të tarifohet me detyrim financiar shtesë.

8. Pagesat e miratuara për transmetimet audiovizive analoge do të zbatohen deri në mbylljen e transmetimeve analoge.

9. Për efekt të zbatimit të këtij vendimi, termi “zonë”, nënkupton ndarjet administrativo-territoriale, sipas ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjet administrativo-territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

10. Vendimi nr. 4, datë 22.5.2013, “Mbi miratimin e pagesave për licencë”, i AMA-s, i ndryshuar; vendimi nr. 5, datë 22.5.2013, “Mbi miratimin e pagesave për autorizim”, i AMA-s, i ndryshuar; vendimi nr. 6, datë 22.5.2013, “Mbi miratimin e pagesave për shërbimet që kryhen nga AMA”, i AMA-s, i ndryshuar shfuqizohen.

11. Ngarkohet administrata e Autoritetit të Mediave Audiovizive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletore Zyrtare dhe hyn në fuqi në datën 1.1.2018.

KRYETAR
Gentian Sala

LIGJ
Nr. 34/2017

PËR LIRIMIN E FREKUENCAVE TË DIXHITAL - DIVIDENTIT

(ndryshuar me ligjin nr. 28/2018, datë 24.5.2018)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

1. Ky ligj ka për qëllim të sigurojë vazhdimësinë e marrjes nga publiku të të gjitha programeve TV, transmetuar nëpërmjet rrjeteve tokësore edhe pas kalimit të plotë në transmetimet numerike, nëpërmjet kompensimit të pjesshëm të kostove neto shtesë që shkakton kalimi nga transmetimet analoge në ato numerike.

2. Ky ligj ka për qëllim të krijojë kushtet për lirin e Dividentit Numerik 1, që përdoret aktualisht për transmetime audiovizive, dhe vënien e frekuencave të tij në përdorim të rrjeteve të komunikimeve të lëvizshme, sipas legjislacionit në fuqi për komunikimet elektronike dhe mediat audiovizive.

3. Ky ligj përcakton masën e kompensimit financiar, mënyrën e krijimit të saj, kategoritë që përfitojnë, mënyrën e kompensimit, procedurën e administrimit dhe të pagesave.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Ofrues shërbimi mediatik audioviziv (OSHMA)” është personi fizik ose juridik që ka përgjegjësinë editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv dhe që vendos mënyrën e organizimit të saj, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

b) “Operatori i rrjetit numerik” është personi juridik që ofron infrastrukturën teknike për shpërndarjen tokësore dhe bashkimin e programeve numerike e të shërbimeve shtesë të përfshira në fluksin numerik të të dhënave.

c) “Operatorë privatë historikë kombëtarë” janë subjektet e licencuara për transmetim televiziv kombëtar, sipas ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998, “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të cilët janë ftuar për të marrë pjesë në procedurën e licencimit të rrjeteve numerike dhe programeve të tyre nëpërmjet *Beauty Contest*.

ç) “Operatorë me eksperiencë në transmetimet numerike” janë subjektet që kanë ofruar shërbim televiziv numerik përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 97/2013, të cilët janë ftuar nga AMA të marrin pjesë në procedurën e licencimit të rrjeteve numerike dhe programeve që mbështeten në to, sipas procedurës së *Beauty Contest*.

d) “AMA”, Autoriteti i Mediave Audiovizive, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

dh) “AKEP”, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

e) “Kosto neto shtesë” është kosto që shoqërojnë kalimin nga transmetimet analoge në transmetime numerike.

ë) “Dividenti Numerik 1” janë frekuencat e brezit 790-862 MHz, që lirohen nga kalimi nga transmetime analoge në transmetime numerike dhe që janë përcaktuar për përdorim nga rrjetet e komunikimeve të lëvizshme.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për mbulimin e pjesshëm të kostove neto shtesë që shoqërojnë kalimin nga transmetimet analoge në transmetime numerike dhe që përfshijnë:

- a) tarifën e mbështetjes së operatorëve ekzistues analogë lokalë/rajonale në rrjetin numerik të RTSH-së apo në rrjetet e tjera numerike të licencuara sipas ligjit për median audiovizive;
- b) investime të operatorëve me eksperiencë në transmetimet numerike, që dalin jashtë funksionit, si rezultat i ndryshimeve teknologjike të imponuara nga ligji për mediat audiovizive;
- c) investime të kryera nga operatorët privatë historikë kombëtarë për ndryshimin e infrastrukturës së transmetimit nga analog në numerik, siç kërkohet nga ligji nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 4

Subjektet e përjashtuara

Përjashtohen nga e drejta e përfitimit të kompensimit financiar, sipas këtij ligji:

- a) subjektet që kanë ndërprerë aktivitetin ose iu është hequr licenca e transmetimit nga AMA në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji;
- b) subjektet që nuk afektohen nga kalimi i transmetimeve analoge në transmetime numerike, si ato që ofrojnë shërbim audioviziv nëpërmjet rrjeteve kablllore CaTv, rrjeteve satelitore, internetit etj.;
- c) subjektet që kanë detyrime të papërmbushura, sipas legjislacionit për taksat kombëtare edhe ndaj AMA-s, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duke përfshirë pagesat vjetore për licencë, si dhe sanksionet gjobë të kthyera në titull ekzekutiv;
- ç) subjektet, të cilat përdorin frekuenca pa autorizimin e AMA-s.

KREU II

KRIJIMI, PËRDORIMI DHE NDARJA E KOMPENSIMIT FINANCIAR

Neni 5

Kompensimi financiar

(ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 28/2018, datë 24.5.2018)

1. Për vijimin e ofrimit të shërbimit mediatic audioviziv, sipas këtij ligji, dhe krijimin e kushteve për lirin e Dividentit Numerik 1, jepet kompensim financiar për kalimin nga transmetimet analoge në transmetimet numerike.

2. Fondet e nevojshme për kompensimin financiar krijohen nga pagesat në vlerën e arritur në procesin e konkurimit, sipas procedurës së përcaktuar në nenet 68 dhe 69, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për frekuencat e brezit 790-862

MHz, e cila derdhet në Buxhetin e Shtetit nga fituesit e të drejtave të përdorimit të tyre.

3. Masa e kompensimit financiar do të jetë 5 000 000 (pesë milionë) euro dhe do të financohet nga të ardhurat e arkëtuara nga dhënia e autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të Dividentit Numerik 1.

4. Ky fond i jepet, në formën e transfertës, Autoritetit të Mediave Audiovizive, për t'u përdorur për kompensimin financiar, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 6

Ndarja dhe përdorimi i kompensimit financiar

Masa e kompensimit financiar, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 5, të këtij ligji, do të ndahet dhe do të përdoret si më poshtë:

1. 1/5 e tij do të përdoret për të mbuluar pjesërisht tarifën e mbështetjes së operatorëve ekzistues lokalë/rajonale në rrjetin numerik të RTSH-së apo në rrjetet e tjera numerike, të licencuara sipas ligjit nr.

97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

2. 2/5 e tij do të përdoren për të mbuluar pjesërisht investimet e operatorëve me eksperiencë në transmetime numerike, që dalin jashtë funksionit, si rezultat i ndryshimeve teknologjike të imponuara nga ligji nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

3. 2/5 e tij do të përdoren për të mbuluar pjesërisht investimet e operatorëve privatë historikë kombëtarë për ndryshimin e infrastrukturës së transmetimit nga analoge në numerike.

4. Mënyra e ndarjes së detajuar brenda secilit nëngrup, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, mbi bazën e propozimit të AMA-s, duke respektuar parimin e objektivitetit, të proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit.

Neni 7

Mënyra e administrimit të kompensimit financiar

1. Administrimi i fondeve të kompensimit financiar bëhet nga administrata e AMA-s, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. AMA përcakton operatorët ekzistues të rrjeteve analoge lokale/rajonale, që do të mbështeten në rrjetin numerik të RTSH-së apo në rrjetet e tjera numerike private, të licencuara sipas ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të cilët përfitojnë nga kompensimi financiar gjatë vitit të parë.

3. AMA përcakton kompanitë me eksperiencë në transmetimet numerike, që përfitojnë nga kompensimi financiar, sipas pikës 2, të nenit 6, të këtij ligji, dhe ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

4. AMA përcakton operatorët privatë historikë kombëtarë, që përfitojnë nga kompensimi financiar, sipas pikës 3, të nenit 6, të këtij ligji, dhe ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

5. AMA kryen analizën e ndarjes së kompensimit financiar, sipas nenit 6 të këtij ligji.

6. AMA kryen pagesën përkatëse për përfituesit e kompensimit financiar.

Neni 8

Llogaritja e kostove neto shtesë

1. Kostoja për tarifën e mbështetjes në rrjetin numerik të RTSH-së apo në rrjetet e tjera numerike, të licencuara sipas ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", mbështetet në tarifën e miratuar nga AMA. Ajo llogaritet, për çdo rast, mbi bazën e zonës së mbulimit, sipas licencës, për një vit, nga momenti i lidhjes së kontratës së mbështetjes në rrjetet numerike. AMA, mbi bazën e tarifës së mbështetjes në rrjetin numerik të RTSH-së, bën llogaritjen e vlerave të mbështetjes për secilin nga subjektet përfitues.

2. Nëse fondi i shpërndarë sipas pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji, rezulton më i ulët se totali në bazë vjetore i tarifave të mbështetjes së të gjitha subjekteve përfituese në rrjetin numerik të RTSH-së apo në rrjetet e tjera numerike, të licencuara sipas ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në

Republikën e Shqipërisë”, vlera e mbulimit të tarifës së mbështetjes për çdo subjekt përfitues do të llogaritet me përqindjen që fondi i shpërndarë zë në totalin në bazë vjetore të tarifave të mbështetjes së të gjitha subjekteve përfituese.

3. Subjekti përfitues i kompensimit financiar, sipas pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji, duhet, fillimisht, të paguajë në bazë mujore tarifën e mbështetjes në llogarinë e RTSH-së apo të operatorëve të rrjeteve të tjera numerike, të licencuara sipas ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, dhe të paraqesë faturën bankare përkatëse të pagesës pranë AMA-s.

4. AMA, me marrjen e faturës bankare të pagesës, kalon vlerën e tarifës së mbështetjes në llogarinë e subjektit përfitues.

5. Shpërndarja e kompensimit financiar për operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike, sipas pikës 2, të nenit 6, të këtij ligji, bëhet bazuar në raportin e përgjegjësive tatimore të paguara me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 9

Ekzekutimi i kompensimit financiar

1. AKEP-i, me disponimin për administrim, sipas ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të frekuencave të Dividentit Numerik 1, kryen menjëherë procedurën për dhënien e të drejtave të përdorimit, sipas neneve 68 dhe

69, të këtij ligji. AMA, në bazë të njoftimeve nga AKEP-i mbi të ardhurat e krijuara, kërkon në Ministrinë e Financave transferimin e një pjese të tyre, sipas përcaktimit të pikës 3, të nenit 5, të këtij ligji.

2. Me marrjen e kërkesës, sipas pikës 2, të këtij neni, Ministria e Financave transferon në llogari të AMA-s shumën e të ardhurave të kërkuara.

3. AMA, menjëherë pasi konfirmon hyrjen e të ardhurave të kërkuara për kompensimin financiar në llogarinë e vet, verifikon nëse subjektet që përfitojnë nga kompensimi financiar kanë detyrime të papaguara ndaj saj dhe detyrime të papërmbushura, sipas legjislacionit për taksat kombëtare.

4. AMA kryen pagesën për subjektet që përfitojnë nga kompensimi financiar, sipas këtij ligji, vetëm pasi të jenë plotësuar të gjitha kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky ligj, si dhe pasi të jetë marrë miratimi nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore.

5. Në momentin e përfundimit të procesit të kompensimit financiar, sipas përcaktimeve të këtij ligji, çdo e ardhur e mëtejshme që mund të krijohet nga dhënia e autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të Dividentit Numerik 1 i nënshtrohet përcaktimeve të ligjit nr. 9918, datë

19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 10

Dispozita kalimtare

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për miratimin e aktit nënligjor, sipas pikës 4, të nenit 6, të këtij ligji, brenda tre muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 30.3.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10143, datë 19.4.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

VENDIM
Nr. 240, datë 4.4.2019

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR NDARJEN E KOMPENSIMIT
FINANCIAR TË OPERATORËVE ME EKSPERIENCË NË TRANSMETIMET
NUMERIKE DHE OPERATORËVE PRIVATË HISTORIKË KOMBËTARË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 4, të nenit 6, të ligjit nr. 34/2017, “Për lirimimin e frekuencave të digjital-dividentit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. Ndarjen e kompensimit financiar për kategoritë operatorë privatë historikë kombëtarë dhe operatorë me eksperiencë në transmetimet numerike, si më poshtë vijon:

1. Operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike të kompensohen në masën 2 000 000 (dy milionë) euro, për mbulimin e pjesshëm të investimeve që dalin jashtë funksionit si rezultat i ndryshimeve teknologjike, sipas ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Operatorët privatë historikë kombëtarë të kompensohen në masën 2 000 000 (dy milionë) euro, për mbulimin e pjesshëm të investimeve të kryera për ndryshimin e infrastrukturës së transmetimit, nga analoge në numerike.

3. Vlera e kompensimit për operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike do të llogaritet me përqindjen që vlera financiare për përgjegjësitë tatimore, e paguar prej secilit operator, zë në totalin e vlerës financiare për përgjegjësitë tatimore të paguara nga të gjithë operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike.

4. Vlera e kompensimit për operatorët historikë kombëtarë do të ndahet në mënyrë të barabartë.

5. Operatori me eksperiencë në transmetimet numerike, për të përfituar kompensimin financiar sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të depozitojë pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, si më poshtë vijon:

a) Ekstraktin historik për të dhënat e subjektit, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

b) Relacionin e vlerësimit të firmosur dhe të vulosur nga një ekspert kontabël i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi, mbi përgjegjësinë tatimore të paguar pas datës 4 prill 2013 e deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Relacioni duhet të përfshijë informacion për masën e paguar nga subjekti për tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin mbi fitimin, tatimin mbi pagat dhe kontributet për të punësuarit, taksat kombëtare, tarifatat sipas llojit të ushtrimit të aktivitetit, tatimin e mbajtur në burim ku deklarohen (dividenti, tatimi mbi qiradhënie, shërbimet teknike etj.), taksat lokale e akcizën, dhe duhet të depozitohet në AMA, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi i këtij të fundit. Në të kundërt, vlerësimi i masës së përgjegjësisë tatimore të paguara prej subjekteve

përfutuese do të përcaktohet nga AMA, bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare vjetore të depozituara pranë AMA-s.

c) Vërtetim lëshuar prej organeve tatimore, që konfirmon shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

ç) Vërtetim lëshuar prej organeve përkatëse, që konfirmon shlyerjen e detyrimeve sipas ligjit për taksat kombëtare, për të cilat operatori është subjekt.

6. Operatori privat historik kombëtar, për të përfutuar kompensimin financiar, duhet të depozitojë pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, si më poshtë vijon:

a) Ekstraktin historik për të dhënat e subjektit, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

b) Dokumentacionin financiar për investimet e kryera për ndryshimin e infrastrukturës së transmetimit, nga analoge në numerike (përshtatjen e pajisjeve ekzistuese, instalimin e pajisjeve të reja të sistemit të transmetimit) etj., si fatura tatimore blerjeje, fatura zhdoganimi, kontrata shërbimi.

c) Vërtetimin e lëshuar nga organet tatimore, që konfirmon shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

ç) Vërtetimin e lëshuar nga organet përkatëse, që konfirmon shlyerjen e detyrimeve sipas ligjit për taksat kombëtare, për të cilat operatori është subjekt.

7. Autoriteti i Mediave Audiovizive shqyrton dokumentacionin e subjekteve dhe kryen veprimet, si më poshtë vijon:

a) Verifikon nëse subjektet kanë detyrime financiare të pashlyera ndaj saj.

b) Verifikon nëse subjektet kanë detyrime financiare për sanksione gjobë të shndërruara në titull ekzekutiv.

c) Verifikon nëse subjektet përdorin frekuenca pa autorizimin/licencimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive.

8. Autoriteti i Mediave Audiovizive kryen pagesën për operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike dhe operatorët historikë kombëtarë pas plotësimit të kërkesave sipas këtij vendimi.

II. Ngarkohet Autoriteti i Mediave Audiovizive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 521, datë 6.8.2014

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT PËR PUNËN ME PAJISJE ME EKRAN SHFAQËS”¹⁵

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 38, pika 2, shkronja “b”, 39, pika 1, shkronja “b”, e 44, pika 1, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekran shfaqës”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

¹⁵. Direktiva e Këshillit 90/270 KE, e datës 29 maj 1990, “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekrane shfaqës” (direktiva e pestë individuale në kuptim të nenit 16 (1) të direktivës89/391/KEE) (Celex 31990L0270).

2. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet në varësi të tyre për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORE
PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT PËR PUNËN ME
PAJISJE ME EKRAN SHFAQËS

SEKSIONI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale për sigurinë dhe shëndetin për punën me pajisje me ekran shfaqës.

2. Rregullorja zbatohet për të gjitha subjektet dhe vendet e punës, brenda fushës së zbatimit të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, ku zhvillohet një veprimtari pune ose formim, pavarësisht mënyrës së organizimit, llojeve të pronësisë, ose arsytet pse zhvillohet puna ose formimi në vendin e punës.

3. Kjo rregullore nuk zbatohet për:

- a) pajisjet me ekran shfaqës në kabinat e shoferëve ose kabinat e kontrollit për automjetet ose makineritë;
- b) pajisjet me ekran shfaqës në bordin e mjeteve të transportit;
- c) pajisjet me ekran shfaqës të cilat janë kryesisht për përdorim publik;
- ç) pajisjet “portative” me ekran shfaqës jo me përdorim të zgjatur në një vend individual pune;
- d) makinat llogaritëse, pajisjet numëruese të parave dhe çfarëdo pajisje që ka një ekran shfaqës të vogël të të dhënave ose të matjes, të nevojshëm për përdorimin direkt të pajisjes;
- dh) makinat e shtypit me projektimin tradicional, të njohura si “makina shtypi me dritare”.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllim të kësaj rregulloreje, termat e përdorur kanë kuptimet e mëposhtme:

a) “Pajisje me ekran shfaqës” është çdo ekran shfaqës, që reflekton shkronja, numra, shenja ose figura, pavarësisht procesit të shfaqjes që përdoret;

b) “Vendi individual i punës” është një tërësi elementesh, që përfshin pajisjet me ekran shfaqës, që mund të shoqërohen me tastierë, ose pajisje për hedhjen e informacionit dhe/ose software-in, i cili përcakton ndërfaqen operator-makinë, pajisjet ndihmëse fakultative, pajisjet e jashtme duke përfshirë telefonin, modemën, printerin, mbajtësen e dokumenteve, karrigen dhe tryezën e punës ose sipërfaqen e punës, si dhe mjedisin e punës përreth tij.

c) “Punëmarrës në punë me pajisje me ekran shfaqës” është çdo punëmarrës, siç përkufizohet në ligjin nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i cili përdor rregullisht pajisje me ekran shfaqës, jo më pak se 4 orë në ditë pune.

ç) “Ergonomia” është një disiplinë, e cila fokusohet te parimet e projektimit të elementeve të sistemit të punës, përfshirë objektet, proceset dhe kushtet e punës, që t’i përshtaten njeriut, me qëllim zvogëlimin e sforcimit fizik, parehatisë dhe risqeve.

SEKSIONI II DETYRIMET E PUNËDHËNËSVE

Neni 3

Analiza e vendeve individuale të punës

1. Punëdhënësi kryen një analizë të vendeve individuale të punës, për të vlerësuar kushtet e sigorisë dhe shëndetit për punëmarrësit, veçanërisht lidhur me risqet e mundshme për shikimin, lodhjen fizike dhe mendore.

2. Punëdhënësi merr masa të përshtatshme për të korrigjuar kushtet e punës dhe për të zvogëluar ose eliminuar risqet e gjetura, mbi bazën e vlerësimit të përmendur në pikën 1, duke marrë parasysh efektet shtesë dhe/ose të kombinuara të risqeve të konstatuara.

3. Punëdhënësi ndërmerr hapa të përshtatshme për të siguruar që vendi individual i punës të plotësojë kërkesat e përcaktuara në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.

Neni 4

Puna e përditshme

Punëdhënësi planifikon veprimtaritë e punëmarrësit në mënyrë të tillë që, puna me ekran shfaqës, të ndërpritet rregullisht, nëpërmjet pushimeve ose ndryshimeve të veprimtarisë, për të zvogëluar ngarkesën e punës me ekran shfaqës.

Neni 5

Informimi dhe formimi i punëmarrësve

1. Punëdhënësi informon punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e tyre për të gjitha aspektet e sigorisë dhe shëndetit mbi vendin e tyre individual të punës, lidhur me pajisjet me ekran shfaqës, veçanërisht për masat e përcaktuara në nenet 3, 5 dhe 7, si dhe për çdo masë të sigorisë dhe shëndetit të marrë në përputhje me këtë rregullore.

2. Punëdhënësi siguron formim të përshtatshëm për sigurinë dhe shëndetin në vendin individual të punës lidhur me pajisjet me ekran shfaqës, përpara fillimit të punës dhe sa herë që organizimi i vendit individual të punës ndryshon në mënyrë thelbësore.

Neni 6

Konsultimi dhe pjesëmarrja e punëmarrësve

Në përputhje me nenin 13 të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, punëdhënësi merr masa të përshtatshme për konsultimin dhe pjesëmarrjen e punëmarrësve në lidhje me punën me pajisje me ekran shfaqës, rezultatet e analizës së vendeve të punës dhe masat që duhet të merren, për të zvogëluar dhe eliminuar aspektet negative të punës.

Neni 7

Mbikëqyrja shëndetësore

1. Mbrojtja e syve dhe e shikimit të punëmarrësve.

a) Punëdhënësi siguron për punëmarrësit një test të përshtatshëm të syve dhe shikimit nga një specialist i fushës.

- përpara fillimit të punës me ekrane shfaqëse,
- më pas, në intervale të rregullta, minimumi 1 herë në 3 vjet,
- nëse paraqesin vështirësi të shikimit, që mund të jenë për shkak të punës me ekrane shfaqëse.

b) Punëdhënësi siguron ekzaminim oftalmologjik për punëmarrësit kur rezultatet e testit të përmendur në pikën 1.a të këtij neni tregojnë se kjo është e nevojshme.

c) Nëse rezultatet e testit të përmendur në pikën 1.a, ose të ekzaminimit të përmendur në pikën 1.b të këtij neni, tregojnë se është e nevojshme dhe nëse pajisjet korrigjuese për përdorim normal nuk mund të përdoren, punëdhënësi pajis punëmarrësin me pajisje korrigjuese speciale, të përshtatshme për punën në fjalë.

2. Nëse punëmarrësi paraqet ndonjë problem shëndetësor, në lidhje me punën me ekran shfaqës, punëdhënësi siguron një ekzaminim shëndetësor të sistemit muskulo-skeletik, neurologjik dhe të venave.

3. Masat e marra në bazë të këtij neni, në asnjë rrethanë, nuk mund t'i ngarkojnë punëmarrësit me kosto financiare shtesë.

SHTOJCË KËRKESA MINIMALE

Koment paraprak

Detyrimet e përcaktuara në këtë shtojcë zbatohen për të arritur objektivat e kësaj rregulloreje, në mënyrë që:

- elementët e nevojshëm të pajisjeve me ekran shfaqës, të jenë të pranishëm në vendin individual të punës; dhe

- kërkesat bazë ose karakteristikat e punës me pajisje me ekran shfaqës të mos e pengojnë zbatimin e kësaj rregulloreje.

Përshtatjet teknike me kërkesat e kësaj rregulloreje duhet të marrin parasysh progresin teknik.

1. PAJISJET

a) Koment i përgjithshëm

Përdorimi i pajisjes me ekran shfaqës, në vendin individual të punës, nuk paraqet risk për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve.

b) Ekran shfaqës

Shenjat në ekran janë me konture dhe forma të qarta, me përmasa të përshtatshme dhe me hapësirë të mjaftueshme ndërmjet shenjave dhe vijave.

Imazhi në ekran është i qëndrueshëm, pa dridhje ose forma të tjera të paqëndrueshmërisë.

Ndriçimi dhe/ose kontrasti ndërmjet shenjave dhe sfondit janë lehtësisht të ndryshueshme nga punëmarrësi dhe lehtësisht të përshtatshme me kushtet e ambientit.

Ekran është lehtësisht i rrotullueshëm dhe i anueshëm për t'iu përshtatur nevojave të punëmarrësit.

Është i mundur përdorimi i një baze të ndarë për ekranin, ose një tavoline, që mund të përshtatet.

Ekran nuk ka shkëlqim dhe reflektim verbues që mund të shkaktojë parehati për punëmarrësin.

Distanca optimale e të parit, ndërmjet syrit të punëmarrësit dhe detajit të vëzhguar në ekran, varet nga përmasa e detajit dhe ekranit shfaqës dhe është ndërmjet 500-700 mm. Distanca e të parit nuk duhet të jetë më e vogël se 400 mm.

c) Tastiera

Tastiera është e anueshme dhe e ndarë nga ekranin në mënyrë që punëmarrësi të gjejë pozicion të rehatshëm pune duke shmangur lodhjen e duarve ose krahëve.

Hapësira përballë tastierës është e mjaftueshme për të ofruar mbështetje për duart dhe krahët e punëmarrësit.

Tastiera ka sipërfaqe jo reflektuese për të shmangur shkëlqimin verbues.

Dizenjimi dhe përmasat e butonave të tastierës lehtësojnë përdorimin e saj.

Simbolet në butonat e tastierës janë me kontrast të mjaftueshëm dhe të lexueshme nga pozicioni normal i punës.

ç) Tryeza e punës ose platforma e punës

Tryeza ose syprina e punës kanë sipërfaqe të mjaftueshme, me gjatësi të paktën 1200 mm dhe me gjerësi të paktën 750 mm, me reflektim të ulët dhe lejojnë vendosje të përshtatshme të ekranit, tastirës, dokumenteve dhe pajisjeve të lidhura.

Mbajtësja e dokumenteve është e qëndrueshme dhe e përshtatshme dhe pozicionohet në mënyrë që të minimizojë nevojën për lëvizje të parehatshme të kokës dhe të syve.

Hapësira e punës është e mjaftueshme për punëmarrësin për të gjetur një pozicion pune të rehatshëm dhe për të ndryshuar pozicionin e këmbëve. Hapësira poshtë pjesës ku punohet ka lartësi prej të paktën 650 mm, gjerësi 500-800 mm dhe thellësi prej 750 mm.

d) Karrigia e punës

Karrigia e punës është e qëndrueshme dhe i lejon punëmarrësit lirshmëri lëvizjeje dhe pozicion të rehatshëm.

Ndenjësja ka lartësi të ndryshueshme prej 400 deri 520 mm, thellësi prej 350 deri 500 mm dhe gjerësi rreth 480 mm.

Mbështetësja e ndenjësës është e ndryshueshme në lartësi dhe në pjerrësi.

Është e përshtatshme që ndenjësja të jetë e pajisur me mbështetëse për çlodhjen e krahëve, me lartësi rreth 270 mm mbi ndenjësen, gjerësi minimale prej 70 mm dhe distanca ndërmjet vendeve për çlodhjen e krahëve prej 500 mm.

Mbështetëse për këmbët ofrohet për çdo punëmarrës sipas kërkesës së tij. Mbështetësja për këmbët ka lartësi dhe pjerrësi të ndryshueshme nga 5° deri 15°, gjatësi minimale prej 450 mm, gjerësi minimale prej 300 mm dhe sipërfaqe jo rrëshqitëse.

2. MJEDISI

a) Kërkesa të hapësirës

Hapësira e vendit individual të punës është jo më pak se 12m³ për person dhe projektohet në mënyrë të tillë që të ofrojë lehtësi për ndryshimin e pozicionit dhe kryerjen e lëvizjeve të punëmarrësit.

b) Ndriçimi

Ndriçimi i mjedisit të punës dhe/ose ndriçimi i vendit individual të punës sigurohet në nivele nga 300 deri 700 luks dhe me kontrast të përshtatshëm ndërmjet ekranit dhe mjedisit në sfond, duke marrë parasysh llojin e punës dhe nevojat e shikimit të përdoruesit.

Shkëlqimi i mundshëm verbues shqetësues dhe reflektimet në ekran ose pajisje të tjera parandalohen nëpërmjet përshtatjes së vendit të punës dhe vendit individual të punës me pozicionimin dhe karakteristikat teknike të burimeve artificiale të dritës.

c) Reflektimet dhe shkëlqimi verbues

Vendet individuale të punës projektohen në mënyrë të tillë që burimet e dritës, si dritaret dhe pjesë të tjera të hapura, sipërfaqet ndarëse të tejdukshme ose që lejojnë kalimin e dritës dhe instalimet, ose muret e ngjyrosura me ngjyra të shndritshme, të mos shkaktojnë shkëlqim verbues të drejtpërdrejtë dhe as reflektime shpërqëndruese mbi ekran.

Dritaret pajisen me sistem të përshtatshëm mbulimi të ndryshueshëm për të zbutur dritën e diellit, që bie mbi vendin individual të punës.

ç) Zhurma

Gjatë mobilimit të vendit ose vendeve individuale të punës, merret parasysh që zhurma e emetuar nga pajisjet të mos kalojë vlerën prej 60dB(A) në vendin individual, për të mos shpërqëndruar vëmendjen ose vështirësuar komunikimin.

d) Temperatura

Pajisjet që i përkasin vendit ose vendeve individuale të punës nuk prodhojnë nxehtësi të tepërt, që mund të shkaktojë parehati për punëmarrësit. Temperatura optimale është 22-27° C dhe temperatura e pranueshme 18-30° C.

dh) Rrezatimi

Rrezatimi, me përjashtim të pjesës së dukshme të spektrit elektromagnetik, është në nivele të papërfillshme nga pikëpamja e mbrojtjes së sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve.

e) Lagështia

Niveli i lagështisë mbahet në nivele të pranueshme, ndërmjet 30-70%.

3. NDËRFAQJA E OPERATORIT/ KOMPJUTERIT

Në projektimin, përzgjedhjen, autorizimin dhe modifikimin e software-it dhe në projektimin e detyrave, që përfshijnë përdorimin e pajisjeve me ekran shfaqës, punëdhënësi merr parasysh parimet e mëposhtme:

- a) software-i është i përshtatshëm për detyrën;
- b) software-i është i lehtë për t'u përdorur dhe, kur është e përshtatshme, i adaptueshëm me nivelin e njohurive ose përvojën e punëmarrësit; asnjë pajisje kontrolluese sasiore ose cilësore nuk mund të përdoret pa dijeninë e punëmarrësve;
- c) sistemet i japin informacion punëmarrësit mbi ecurinë e punës së tyre;
- ç) sistemet paraqesin informacion në një format dhe në një ritëm të përshtatshëm për punëmarrësit;
- d) parimet e ergonomisë së software-it zbatohen, në veçanti, për përpunimin e të dhënave njerëzore.
- dh) pajisjet e kontrollit sasior dhe cilësor nuk mund të përdoren pa informimin paraprak të punëmarrësit.

III. MEDIA E SHKRUAR

LIGJ

Nr.7756, datë 11.10.1993

PËR SHTYPIN

(ndryshuar me ligjin nr.8239, datë 3.9.1997)

Në mbështetje të neneve 16 e 20 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e një grupi deputetësh, Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë,

VENDOSI:

Neni 1

Liria e shtypit

Shtypi është i lirë. Liria e shtypit mbrohet me ligj.

UDHËZIM
Nr.9, datë 15.9.2010

**PËR RREGULLAT THEMELORE NË LIDHJE ME MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE NË MEDIAN E SHKRUAR, VIZIVE DHE
AUDIOVIZIVE, TË NDRYSHUAR**
(ndryshuar me udhëzimin nr. 32, datë 27.12.2012)

Mbështetur në nenet 29 pika 1, 30 pika 1/c, të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

UDHËZON:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1 Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave për të gjithë kontrolluesit publikë dhe privatë, të medias së shkruar, vizive dhe audiovizive në përpunimin e të dhënave personale të shtetasve.

2. Kushdo që përpunon të dhëna personale vetëm për qëllime gazetarie, letrare ose artistike, së pari respekton të drejtën e individit për të mbrojtur të dhënat personale të tij.

3. Ruajtja e konfidencialitetit (fshehtësi, afërsi, familjaritet, besim) si një e drejtë themelore e individit për mbrojtjen e të dhënave të tij, nuk duhet të dalë si një pengesë e dorës së dytë, ndaj të drejtës së lirisë së shprehjes së gazetarit apo çdo subjekti tjetër të parashikuar sipas këtij neni. Është e vërtetë se liria e shprehjes nuk i nënshtrohet censurës paraprake, por kjo censurë nuk ka të bëjë me mospasjen e të drejtës së individit për të mbrojtur të dhënat e tij personale. Duhet pasur parasysh që e drejta e jetës private të përshtatet me rregullat që rregullojnë lirinë e të shprehurit.

4. Ushtrimi i të drejtës së lirisë së shprehjes nuk është i pakufizuar sepse kërkohet të bëhet brenda kontureve të kërkesave të parashikuara në nenet 15, 17, 36, 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë pasi të drejtat themelore të njeriut janë të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik dhe se ato mund të kufizohen vetëm me ligj.

5. Media e shkruar, vizive dhe audiovizive, duhet të kujdeset që të mos publikojë informacione të pasakta, mashtruese ose të shtrembëruar, duke përfshirë edhe fotot. Në momentin kur vihet re një pasaktësi e konsiderueshme, deklaratë mashtruese ose shtrembërim i njohur duhet të korrigjohet, menjëherë dhe me rëndësinë e duhur. Në median e shkruar, duhet të bëhet i qartë dallimi midis komentit, hamendësimit dhe faktit.

6. Kur mblidhen të dhëna personale të tilla që shfaqin bindjet racore dhe etnike, besimet fetare, filozofike apo të tjera, mendimet politike, anëtarësimin partiak, sindikata, filozofike ose politike, si dhe të dhënat që mund të tregojnë statusin e shëndetit dhe sferës seksuale, gazetari garanton të drejtën për të informuar mbi lajmet me interes publik, në respektim të thelbit të informacionit, duke shmangur referencat ndaj të afërmeve apo të tjerëve që nuk lidhen me faktet.

7. Gazetarët duhet të respektojnë të drejtën e personit për mosdiskriminim në bazë të racës, fesë, mendimit politik, seksit, rrethanave personale, fizike ose mendore.

8. Gazetari, përveç thelbit të informacionit, nuk jep lajme apo foto publike ose fotografi të njerëzve të përfshirë në ngjarjet që dëmtojnë dinjitetin e personit, nuk ndalet as në detaje të dhunës, përveçse nëse e konsideron lajm ose imazh të interesit publik. Përveç nëse përbëjnë interes të rëndësishëm publik ose për qëllime drejtësie dhe policie të vërtetuara, gazetari nuk merr as prodhon imazhe dhe fotografi të njerëzve në gjendje arresti pa pëlqimin e tyre. Personat nuk duhen filmuar me hekura dhe pranga në duar.

9. Media e shkruar, vizive dhe audiovizive duhet të mbajnë parasysh parimet e mëposhtme të privatësisë:

- a) Çdo person ka të drejtë për respektimin e jetës së tij apo të saj private dhe familjare, shtëpinë, shëndetin dhe korrespondencën, duke përfshirë komunikimin digjital;
- b) Gazetarët nuk mund të ndërhyjnë në jetën private të çdo individi, pa pëlqimin e tyre;
- c) Është e papranueshme të publikohen fotografi të individëve në vende private¹⁶ pa pëlqimin e tyre.

10. Gazetarët nuk mund të hyjnë me forcë në një shtëpi, apo të marrin imazhe nga një ambient privat, po ashtu nuk mund të marrin imazhe në spital apo burg me kamera pa pëlqimin e subjekteve. Mbrojtja e pronës dhe e vendeve të tjera private shtrihet edhe në vende të tjera të kujdesit, ndalimit ose rehabilitimit.

11. Gazetarët në rastet kur mbledhin informacione nga institucione shtetërore dhe private, si p.sh.: të dhëna personale të pacientëve dhe recetave të shkruara nga mjekët, farmacistë, bankat, shoqëritë e sigurimit, kompanitë e telefonisë, policisë etj., duhet të vlerësojnë vetë, duke mbajtur parasysh rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, se cilat informacione mund të cenojnë dinjitetin dhe personalitetin e subjekteve të të dhënave, për të mos i publikuar. Duhet të mos tejkalohet thelbi i informacionit, përveç kur e kërkon interesi publik. Në çdo rast, përgjegjësia e balancimit të interesave bie mbi gazetarin që publikon të dhënat.

KREU II MBROJTJA E TË MITURIT

1. Të miturit janë subjektet më të prekshme dhe të pambrojtura ndaj rrezikut të cenimit të të drejtave të tyre themelore (dhe në veçanti të drejtën e privatësisë).

2. Të rinjtë duhet të jenë të lirë për të përfunduar aktivitetin shkollor, pa ndërhyrje të panevojshme. Një i mitur nën moshën 16 vjeç nuk duhet të intervistohet ose fotografohet për çështje që përfshijnë mirëqenien (mbarëvajtjen) e tyre ose të një të mituri tjetër vetëm nëse prindi përgjegjës jep miratimin. Nxënësit nuk duhet të fotografohen apo intervistohen në shkollë pa lejen e autoriteteve shkollore.

3. Gazetarët nuk duhet të përdorin famën apo pozitën e një prindi apo kujdestari si justifikim për të botuar detajet e jetës private të të miturit.

4. Me qëllim të mbrojtjes së personalitetit, gazetari nuk publikon emrat e të miturve të përfshirë në raportet e lajmeve apo të japë detaje që mund të çojnë në identifikimin e tyre. Mbrojtja e personalitetit të të miturit shtrihet, duke pasur parasysh cilësinë e lajmit dhe komponentët e saj, për faktet që nuk përbëjnë në mënyrë specifike krime. Ndalohet publikimi dhe përhapja e detajeve, me çdo mjet, të lajmeve apo fotove për të identifikuar një të mitur të përfshirë në një krim.

5. Gazetarët nuk duhet të identifikojnë të mitur nën 16 vjeç, të cilët janë viktimë ose dëshmitarë në rastet e krimeve seksuale. Në çdo raport për shtyp të një rasti që përfshin një krim seksual kundër një të mituri:

- a) I mituri nuk duhet të identifikohet.
- b) Duhet të mbahet parasysh mos nënkuptimi i marrëdhënies në mes të akuzuarit dhe të miturit.

6. E drejta e privatësisë së të miturit, veçanërisht kur kemi të bëjmë me një rast abuzimi është gjithmonë parësore në krahasim me të drejtën e kronikës, dhe kjo vlen edhe në rastin kur identiteti bëhet i ditur nga burime zyrtare apo nga burime pranë familjes.

7. Gazetarët nuk duhet të identifikojnë viktimat e sulmeve seksuale apo të botojnë materiale që mund të kontribuojnë për një identifikim të tillë përveç kur ka një arsyetim të përshtatshëm.

8. Nuk mund të publikohet, pa miratimin e prindërve birësues, lajmi se një i mitur është

¹⁶ Shënim. “*vende private*” janë pronë publike ose private ku ka një besim të arsyeshëm të intimitetit.

adoptuar. Gazetarët nuk duhet të publikojnë të dhëna që cenojnë privatësinë e të birësuarit dhe birësuesve.

9. Të garantohet anonimat i të miturit, i përfshirë në çfarëdo procedurë juridike, mbi të gjitha në procedurat civile që përfshihen të miturit në një çështje divorci apo në raste të tjera delikate për psikologjinë e të miturve.

10. Gazetarët duhet të vënë në radhë të parë interesat e të miturit dhe duhet të marrin parasysh natyrën e marrëdhënieve ndërmjet prindit dhe të miturit, dhe nëse prindi është në një pozitë për të përfaqësuar pozitivisht interesat e të miturit. Jo gjithmonë informacionet e marra nga prindërit e një të mituri mund të përhapen nga ana e gazetarit, pasi është gjithmonë përgjegjësia e tij për të vlerësuar nëse publikimi është në të mirë të interesit të të miturit, i kuptuar si mbrojtja e personalitetit dhe zhvillimi harmonik.

11. Përhapja e të dhënave identifikuese të të miturit dhe ekspozimi i të dhënave që zbulojnë jetën seksuale (informacione që janë objekt i një mbrojtje të veçantë për shkak të natyrës sensitive) janë thelbësore dhe prevalojnë mbi të drejtën e lirisë së shtypit, e drejtë që mund të ushtrohet me të njëjtin efektivitet edhe pa raportuar emrin dhe mbiemrin, apo të dhëna të tjera identifikuese.

12. Nuk duhet të përdoren të miturit e sëmurë me patologji të rënda për qëllime propagandiste ose për çdo arsye tjetër që është në kundërshtim me të drejtat e tyre dhe që nuk merr parasysh dinjitetin.

13. Nuk duhet të intervistohen të mitur në kushtet e një krize të rëndë (për shembull, kur janë larguar nga shtëpia, janë përdorur nga krimi i organizuar, janë përdorur për prostitucion etj.) dhe nëse intervista është e nevojshme për një interes publik, i duhet siguruar anonimiteti.

14. Të mos lejohet pjesëmarrja e të miturve në programet mediatike ku diskutohet ngarkesa emocionale e të miturit.

KREU III MBROJTJA NË PROCEDIMET PENALE

1. Gjatë raportimit të një krimi, të afërmit apo miqtë e personave të dënuar apo të akuzuar për krim nuk duhet të identifikohen, në përgjithësi, pa pëlqimin e tyre.

2. Gazetarët mbajnë përgjegjësi që informacioni i publikuar të jetë i plotë, i saktë dhe i përditësuar. Në çdo rast duhet të respektohen garancitë themelore të të pandehurit, para gjithë dyshimeve për fajësi deri në dënimin përfundimtar (prezumimi i pafajësisë).

3. Gazetarët duhet të raportojnë, kur janë në interes të publikut, akuzat që mund të vijnë nga një palë e tretë edhe kur është e vështirë për të mbështetur pretendimet e saj, nga burime të policisë apo një procedurë e policisë, p.sh. arrestimi. Ato kur publikojnë materiale në këto rrethana nuk duhet të bëjnë identifikimin e të akuzuarit. Gazetarët duhet të respektojnë jetën private të të akuzuarit ose të dënuar, të drejtat e tij, pronën, shëndetin dhe korrespondencën.

4. Respektimi i parimit të prezumimit të pafajësisë është pjesë përbërëse e së drejtës për të pasur një proces gjyqësor pa shkelje ligjore. Nga ky parim rrjedh që mendimet dhe informacionet në lidhje me procedimin penal që është duke u kryer, duhet të komunikohet nga organet e shtypit vetëm në qoftë se nuk paragjykojnë prezumimin e pafajësisë së personit të dyshuar ose të akuzuar për një krim të caktuar.

5. Për dhënien e informacioneve që kanë lidhje me persona të dyshuar, të akuzuar apo të dënuar, ose me subjekte të tjera të lidhura në njëfarë mënyre me këtë proces, duhet të respektohet e drejta e privatësisë së këtyre personave, sipas nenit 8 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në mënyrë të veçantë kjo ruajtje duhet t'i garantohet personave në moshë të vogël, atyre më të dobët qofshin këta viktimë, dëshmitarë, si dhe familjarët e personave të dyshuar, akuzuar apo të dënuar. Në çdo rast, duhen pasur parasysh veçanërisht pasojat e dëmshme që mund t'i vijnë personave në fjalë si rrjedhojë e daljes së informacioneve që mund të çojnë në zbulimin e identitetit të tyre.

6. Nuk duhet zbuluar identiteti i dëshmitarëve, me përjashtim të rastit kur këta persona kanë dhënë më parë miratimin e tyre, kur identifikimi i dëshmitarëve është në interesin e publikut, ose dëshmia ka qenë bërë publike më parë. Në mënyrë të veçantë, nuk duhet të zbulohet identiteti i dëshmitarit kur mund të vijë si pasojë vënia në rrezik e jetës ose e sigurisë së tij. Duhet respektuar masat e parashikuara nga programet e mbrojtjes për dëshmitarët, sidomos në procedimet penale që kanë lidhje me krimin e organizuar ose me vepra penale me karakter ndërfamiljar.

7. Gazetarët lejohen të kenë kontakte me personat që janë duke kryer dënimin në burg, në atë masë që të mos paragjykojë korrektesën e funksionimit të drejtësisë, të drejtat e të dënuarve dhe të personelit të burgut ose sigurinë e institutit të vuajtjes së dënimit.

8. Ndalohet përhapja e emrave të personave të hetuar apo nën gjykim, me qëllim mbrojtjen e privatësisë dhe të drejtës për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me persona të tretë të përfshirë në hetime.

9. Përhapja e emrave të personave të dënuar në krahasim me rastet që kanë të bëjnë me të hetuarit dhe të akuzuarit, mund të kryhet më lirisht duke qenë se është dhënë një gjykim i parë nga ana e gjykatës. Gazetarët duhet të vlerësojnë rast pas rasti publikimin e të dhënave identifikuese të të dënuarit, pasi duhet të merren në konsideratë, ndër të tjera, cilësitë e veçanta të subjekteve të përfshira, për shembull, persona me handicap apo shqetësime psikike, llojin e krimit të verifikuar etj.

10. Gazetarët, me përjashtim kur ekzistojnë pengesa specifike, mund të bëjnë publike të dhëna të familjarëve dhe të njohurve të personave të dyshuar, akuzuar apo të dënuar që rezultojnë drejtpërdrejt të përfshirë në ngjarje.

Nuk lejohet bërja publike e të dhënave të personave të mësipërm vetëm për faktin se kanë marrëdhënie sentimentale dhe të bashkëjetesës me të, apo për shkak të rrethanave të faktit (p.sh. duhet hequr identiteti i atij që rezulton të jetë pronari i banesës ku është kryer një krim).

KREU IV PËRGJIMI

1. Media nuk duhet të përpunojë të dhëna personale apo të botojë materiale të siguruar nga përdorimi i kamerave të fshehura ose pajisjeve të tjera të fshehta për të dëgjuar, ose nga thirrje private apo telefon celular, mesazhe ose e-mail, ose nëpërmjet marrjes së paautorizuar të dokumenteve ose fotografive që përmbajnë informacion personal.

2. Nuk është ushtrim legjitim e drejta e riprodhimit të lajmit, kundër vullnetit të të interesuarit, të fotove të marra me forcë nga policia për qëllime të dokumentimit dhe të hetimit të përhapur pa kushte të veçanta për interes publik.

3. Duhet të shmangen referencat ndaj të afërmeve ose personave të tjerë që nuk janë përfshirë në faktet e ngjarjes. Duhet të mbahet gjithnjë në vëmendje respektimi i plotë i dinjitetit.

4. Edhe në prezencën e një fakti në interes publik, publikimi i të dhënave të përpunuara nga përgjimet telefonike duhet të respektojë parametrat e thelbit të informacionit. Nuk duhet të publikohen pjesë nga aspekte ngushtësisht personale ose që kanë lidhje me sferën seksuale.

5. Gazetarët nuk duhet të publikojnë tekstet e mesazheve, diskutimet telefonike që kanë të bëjnë me jetën private të të interesuarve, raportet e tyre personale ose interesit profesional.

KREU V MBROJTJA E TË DHËNAVE SHËNDETËSORE DHE TË DHËNAVE TË TJERA

1. Gazetarët duhet të identifikojnë veten e tyre dhe të marrin leje nga një përgjegjës ekzekutiv para se të hyjnë në zonat jopublike të spitaleve ose institucioneve të ngjashme për të marrë informacione. Kufizimet në ndërhyrjet në jetën private janë veçanërisht të rëndësishme për shkrimet në lidhje me personat që ndodhen në spitale apo institucione të ngjashme. Të dhënat

shëndetësore janë të dhëna sensitive dhe nuk duhet të publikohen pa marrë pëlqimin e subjektit konkret, vetëm nëse personi nuk identifikohet dhe nuk përshkruhen detaje që çojnë në identifikimin e tij.

2. Gazetarët, duke iu referuar shëndetit të një personi të caktuar, të identifikuar ose të identifikueshëm, duhet të respektojnë dinjitetin e tij dhe të drejtën e privatësisë, veçanërisht në rastet e sëmundjeve të rënda, si dhe të shmangin publikimin me detaje të panevojshme.

3. Ndalohet publikimi i të dhënave të testeve të bëra mbi kampionët biologjikë të marrë me mashtrim, të cilat mund të tregojnë të dhëna delikate mbi shëndetin. Ky publikim është i lejueshëm vetëm në rastet kur ndjek thelbin e informacionit dhe gjithmonë duke respektuar dinjitetin e personit.

4. Gazetarët duhet të qëndrojnë larg përshkrimit të zakoneve seksuale që kanë të bëjnë me përcaktimin e personit të identifikuar dhe të identifikueshëm. Publikimi është i lejueshëm në kuadrin e ndjekjes së thelbit të informacionit dhe në respektim të dinjitetit të personit dhe nëse gëzon një pozicion të një rëndësie sociale ose publike.

5. Gazetarët nuk duhet të publikojnë ato të dhëna që përmbajnë pasuritë aksionere të shoqërive, fitimin financiar etj., të dhëna personale në lidhje me aktivitetin ekonomik pa pasur një interes publik, pasi mund të ndikojnë në interesat ekonomikë të aktivitetit ekonomiko-financiar të subjekteve të përfshira në ngjarje.

6. Përpunimi i pakontrolluar i të dhënave biometrike është i ndaluar për gazetarët dhe persona të tjerë të paautorizuar. Nuk lejohet publikimi i këtyre të dhënave të siguruar në çdo mënyrë nga ana e gazetarëve, kur ato cenojnë dinjitetin e subjektit.

KREU VI PUBLIKIMI I FOTOGRAFIVE

1. Gjatë dokumentimit me fotografi të fakteve të kronikës, të cilat ndodhin në vende publike, gazetari dhe/ose fotografi duhet të vlerësojnë edhe se çfarë tipi fokusimi duhet zgjedhur, duke hequr dorë nga fokusimi i pamjeve vetëm mbi individët apo detajet e personave, nëse përhapja e këtyre të dhënave nuk rezulton se ka lidhje ose e tejkalon qëllimin e artikullit (kronikës).

2. Fotografitë, edhe nëse janë të ekspozuara gjatë një konference për shtyp të mbajtur nga forcat e policisë apo të marra në mënyrë ligjore, nuk mund të përhapen përveç se në ndjekjen e qëllimeve specifike për të cilat janë mbledhur në fillim (verifikim, parandalim e ndalim të krimeve).

3. Pamjet që dokumentojnë veprimet e arrestimit nuk mund të përhapen kur dëmtojnë dinjitetin e të interesuarit. Ndalohet riprodhimi i imazheve të njerëzve në paraburgim, përveç kur kjo është në funksion të “interesit publik” (në kufi të pëlqimit dhe të interesave të personit dhe në funksion të drejtësisë dhe hetimit). Pamjet e fotove të tjera, mbi arrestimin, hetimin dhe procesin (p.sh. fotot e marra nga dokumentet e identifikimit, nga albumet familjare apo të shkrepura në sallën e gjyqit) vlejnë për përdorimin e tyre në mënyrë të ligjshme dhe korrekte dhe për t’i përhapur ato sipas vlerësimit të duhur për të dhënë thelbin e informacionit në lidhje me lajmin.

4. Bërja e një montazhi, korrigjimi i një fotografie nga një metodë elektronike, ose formulimi i një diçiture nuk duhet të kryhet në mënyrë të tillë që të ç’orientojë ose mashtrtojë lexuesin, por gjithmonë duhet të kryhet me formën e afërt me fotografinë, edhe nëse ajo është ndryshuar nga montazhi apo korrigjimi.

5. Fotografia nuk mund të ekspozohet ose të vihet në shitje, kur ekspozimi ose tregtimi do të ndikojë negativisht në nderin, reputacionin, apo edhe dinjitetin e personit të fotografuar.

6. Gjithmonë duhet të tregohet konsiderata më e madhe e mundshme për viktimat e krimit dhe aksidentet duke pasur kujdes për kontrollin e emrave dhe fotove për publikim, larg nga vëmendja për viktimat dhe të afërmit e tyre.

KREU VII PERSONAT PUBLIKË

1. Të dhënat sensitive mund të përpunohen nga gazetarët vetëm kur kanë marrë pëlqimin nga subjektet, të cilat mund të revokohen në çdo çast.

2. Gazetarët mund të shkruajnë për statusin e shëndetit të përgjithshëm të personit publik, pa kaluar në detaje të sëmundjes, veçanërisht në rastet e sëmundjeve të rënda, duke u rezervuar në publikimin e detajeve që janë në mënyrë rigoroze detaje klinike, të cilat nuk i shërbejnë qëllimit të kronikës.

KREU VIII PËLQIMI

1. Në përgjithësi, të dhëna sensitive, domethënë “të dhënat personale që mund të shfaqin mendimet racore ose etnike, fetare, filozofike ose bindje të tjera, politike, anëtarësimin në parti, sindikatat, shoqatat apo organizata fetare, jetën filozofike apo politike, si dhe të dhënat e gjendjes shëndetësore dhe jetës seksuale” mund të përpunohen nga gazetarët vetëm kur kanë marrë pëlqimin nga subjektet, i cili mund të revokohet në çdo çast.

2. Nuk është i nevojshëm pëlqimi, për sa kohë që gazetarët respektojnë kufijtë e lirisë së shtypit, veçanërisht të informacioneve thelbësore në lidhje me ngjarjet me interes publik.

KREU IX KUPTIMI I INTERESIT PUBLIK

1. Rrethanat që përcaktojnë interesin publik përfshijnë:

- a) interesi i sigurisë kombëtare;
- b) integriteti territorial ose siguria publike;
- c) parandalimi i trazirave apo krimit;
- d) parandalimet publike nga të qenit i mashtruar nga një veprim apo deklaratë e një individi;
- e) mbrojtja e shëndetit ose e moralit;
- f) mbrojtja e reputacionit ose të drejtave të të tjerëve;
- g) parandalimi i zbulimit të informacioneve konfidenciale ose për të garantuar paanshmërinë e pushtetit gjyqësor etj.

2. Shfuqizuar.

KREU X BASHKËPUNIMI, DETYRIMI PËR ZBATIM DHE SANKSIONE

1. Gazetarët, duke pasur cilësinë e kontrolluesit, kanë detyrimin ligjor të bashkëpunojnë me Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave që i ngarkon ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

2. Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi, përbën shkelje të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 500.000 lekë .

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjithë kontrolluesit publikë e privatë të medias së shkruar, vizive dhe audiovizive në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI
Flora Çabej (Pogaçe)

VENDIM
Nr.1195, datë 5.8.2008

**PËR BLERJEN, ZHVILLIMIN, PRODHIMIN E BASHKËPRODHIMIN E
PROGRAMEVE A TË REKLAMAVE PËR TRANSMETIM NGA OPERATORËT
RADIOTELEVIZIVË OSE BOTIM NË MEDIAN E SHKRUAR, DHE PËR
KONTRATAT, PËR KOHË TRANSMETIMI, NGA ORGANET E
ADMINISTRATËS SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim vendosjen e rregullave, për realizimin e blerjes, të zhvillimit, prodhimit e të bashkëprodhimit të programeve a të reklamave, për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore.

2. Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptohen:

a) “Programe, reklama dhe spote”, mesazhet apo emisionet televizive, që synojnë të nxisin shitblerjen e një malli ose kryerjen e një shërbimi, duke paraqitur një ide apo të dhëna, për të arritur efektet, që dëshiron reklamuesi, të cilit i është dhënë kohë transmetimi, me pagesë ose me një formë tjetër shpërblimi.

b) “Transmetim” emetimi i parë, me transmetues tokësor, me kablo ose satelit, në formë të koduar a të pakoduar, i shërbimeve programore radio dhe/ose televizive, që i drejtohen publikut, në përgjithësi.

c) “Transmetues” është personi juridik, që ofron rrjetin e transmetimit ose një shërbim transmetimi për publikun, sipas kushteve dhe standardeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

ç) “Media”, të gjitha mjetet e komunikimit për publikim periodik të dhënash, *on line* a *off line*, si gazeta, revista, radio, televizion apo shërbime të reja, bazuar në web-e.

d) “Reklamues”, çdo organ i qeverisjes qendrore e vendore, si dhe çdo institucion tjetër publik, i pavarur.

3. Programi, reklama dhe spoti duhet të bazohen në fakte dhe të jenë në përputhje me interesat shtetërore dhe politike të shtetit shqiptar dhe me rendin kushtetues në Republikën e Shqipërisë.

4. Programi, reklama dhe spoti nuk duhen të përmbajnë të dhëna të rreme apo shqetësuese për shikuesit.

5. Ky vendim zbatohet nga organet e qeverisjes qendrore e vendore, si dhe nga institucionet e tjera publike, të pavarura, për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimit e programeve a të reklamave për transmetim në televizionet ndërkombëtare, kombëtare dhe vendore, në radiot me shtrirje ndërkombëtare, kombëtare apo vendore ose për botim në mediat e shkruara, me shtrirje ndërkombëtare, kombëtare a vendore, dhe për kontrata për kohe transmetimi, nga organet e administratës shtetërore.

II. PROCEDURA PËR REALIZIMIN E NJË PROGRAMI, TË NJË REKLAME APO SPOTI

6. Titullari i institucionit urdhëron, me shkrim, blerjen, zhvillimin, prodhimin apo bashkëprodhimin e programeve a të reklamave, transmetimin nga operatorët radiotelevizivë ose botimin në median e shkruar dhe procedurat për kontratat për kohë transmetimi për çdo rast, duke parashikuar objektin, nevojën e kryerjes së programit/reklamës/spotit, shpeshhtësinë dhe

periudhën e shfaqjes së tij, fondin limit, numrin e televizioneve dhe përbërjen e komisionit, për ndjekjen e procedurave.

7. Në varësi të llojit të programit, reklamës apo spotit, kushtet e veçanta, për përzgjedhjen e organeve të masmedias/agjencive të specializuara, janë:

- a) organi i masmedias/agjencia e specializuar (ndërkombëtar/e, kombëtar/e, vendor/e);
- b) çmimi i ofruar nga organi i masmedias/agjencia e specializuar;
- c) koha e transmetimit.

8. Komisioni për ndjekjen e procedurave dhe hartimin e dokumenteve përbëhet nga 5 anëtarë, tre prej të cilëve specialistë të fushës.

9. Komisioni, brenda një periudhe kohore 5-ditëshe nga data e daljes së urdhrit, u shpërndan, me korrespondencë zyrtare, organeve të masmedias/agjencive të specializuara ftesën për negociata. Ftesa për negociata publikohet edhe në faqen e internetit të institucionit.

10. Ftesa për negociata duhet të përmbajë objektin e programit/reklamës/spotit, nevojën e kryerjes së programit/reklamës/spotit, shpeshtësinë dhe periudhën e shfaqjes së tij, fondin limit dhe datën përfundimtare të paraqitjes së kërkesës nga organet e masmedias.

11. Komisioni pret konfirmimin nga organet e masmedias/të agjencive të specializuara për vazhdimësinë e negociatave, brenda afatit të fundit të paraqitur në ftesën për negociata. Konfirmimi për vazhdimësinë e negociatave shoqërohet me çmimin përkatës për kryerjen e programit, të reklamës apo spotit, nga organet e masmedias/agjencitë e specializuara. Konfirmimet për vazhdimësinë e negociatave vijnë në një ditë të vetme, të mbyllura dhe hapen njëkohësisht, në prani të anëtarëve të komisionit.

12. Pas analizimit të ofertave, të paraqitura nga organet e masmedias/agjencitë e specializuara, komisioni përzgjedh, në bazë të pikëve, organet e masmedias/agjencitë e specializuara, duke u bazuar në kushtet e veçanta, të përcaktuara në pikën 7 të këtij vendimi. Komisioni harton një raport të hollësishëm për të gjithë procedurën e ndjekur dhe ia paraqet titullarit të institucionit.

13. Titullari i institucionit, në bazë të rekomandimit të dhënë nga komisioni i vlerësimit, vendos, brenda 2 ditëve nga data e paraqitjes së rekomandimit, lidhjen e kontratave me organet e masmedias/agjencitë e specializuara, për kryerjen e programit, të reklamës apo spotit.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

14. Ankesat për procedurën e blerjes, zhvillimit, prodhimit a bashkëprodhimit të programeve ose reklamave, transmetimit nga operatorët radiotelevizivë ose botimit në median e shkruar dhe procedurat për kontratat për kohë transmetimi bëhen te drejtuesi i institucionit. Vendimi i tij është përfundimtar.

15. Vendimi nr.623, datë 29.9.2007 i Këshillit të Ministrave “Për prokurimin e prodhimeve/transmetimeve të reklamave dhe spoteve nga organet e administratës shtetërore në media”, shfuqizohet.

16. Ngarkohen organet e qeverisjes qendrore e vendore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.358, datë 25.3.1996

**PËR RREGULLIMIN E KOHËS SË PUNËS DHE TË PUSHIMIT PËR SHTYPIN
E SHKRUAR DHE TË FOLUR**

Në zbatim të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI :

1. Në redaksinë e gazetave periodike, në agjencitë fotografike ose të lajmeve punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë të punuarit natën a të dielën.

Nëse puna e së dielës ka një kohështrirje nga mëngjesi deri pasdreke ose zgjat mbi 5 orë, punëdhënësi duhet ta kompensojë javën pasardhëse apo atë paraardhëse, me një pushim prej të paktën 24 orësh pa ndërprerje, i cili duhet të korrespondojë me një ditë pune.

Redaktorët sportivë duhet të kenë të paktën një të diel pushim çdo 4 javë. Për punëmarrësit e tjerë jepen 2 të diela pushim çdo 4 javë.

2. Puna në radio dhe në televizion mund të fillojë në orën 530 dhe të vazhdojë deri në orën 2400, kur shfrytëzimi i pajisjeve e kërkon një gjë të tillë.

Puna e ditës, me gjithë pushimet, duhet të përfshihet në një interval prej 14 orësh.

Punëmarrësit duhet të kenë një pushim nate prej të paktën 10 orësh pa ndërprerje. Ky pushim mund të reduktohet, në raste të rralla, në 8 orë për disa punëmarrës ose disa kategori punëmarrësish:

a) kur shfrytëzimi i pajisjeve kërkon një gjë të tillë me kusht që ky reduktim të mos përsëritet më tepër se 2 herë radhazi dhe që kohëzgjatja mesatare e pushimit të natës të llogaritur për një javë të jetë të paktën 10 orë;

b) me qëllim që pushimi javor të bëhet 36 orë pa ndërprerje, kjo mund të bëhet vetëm një herë në javë.

Punëdhënësi mund të kërkojë bërjen e orëve shtesë deri në 220 orë në vit për çdo punëmarrës. Në këtë rast paguhet një shtesë page prej 25 për qind. Kjo shtesë nuk jepet, kur orët shtesë janë kompensuar brenda vitit me një pushim të së njëjtës kohëzgjatje.

Punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë të punuarit natën a të dielave përkohësisht, por jo në mënyrë periodike. Për punën e kryer natën jepet një shtesë page prej 50 për qind dhe për punën e kryer të dielave jepet një shtesë page prej 25 për qind.

Punëmarrësi duhet të ketë të paktën një të diel pushim çdo 3 javë.

3. Në gjithë sektorët e mësipërm puna duhet të ndërpritet nga pushime minimumi:

- 15 minuta nëse dita e punës zgjat më shumë se 5 orë e 30 minuta;
- 30 minuta nëse dita e punës zgjat më shumë se 7 orë dhe 60 minuta nëse dita e punës zgjat më shumë se 9 orë.

Pushimet llogariten si kohë pune, në rastin kur punëmarrësi nuk është i autorizuar të largohet nga vendi i punës gjatë këtyre pushimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.176, datë 29.3.2006

PËR BOTIMIN E BULETINIT TË NJOFTIMEVE PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Botimi i njoftimeve publike të bëhet në “Buletini i njoftimeve publike”, një buletin periodik, që botohet nga Agjencia e Prokurimit Publik, çdo 5 ditë.

Në “Buletini i njoftimeve publike” të botohen, pa përjashtim, njoftimet publike, të përcaktuara në pikën 3.i të këtij vendimi, si dhe çdo njoftim tjetër i Këshillit të Ministrave, ministrive, prefektëve, institucioneve qendrore në varësi të tyre, shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror dhe organizatave jofitimprurëse, të krijuara dhe të financuara nga shteti. Në buletin të botohen edhe njoftime të shkollave të larta publike.

2. Në njoftimet publike përfshihet çdo komunikim drejtuar publikut të gjerë apo një grupi të caktuar shoqëror, profesional apo tregtar ekonomik, i cili përmban të dhëna nga institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, për nevoja, kërkesa a oferta dhe që nuk përbëjnë lajm.

Nuk përbëjnë njoftim publik për buletin, mesazhet promovuese me karakter tregtar (reklama) a sensibilizuese të shoqërive me kapital shtetëror, organizatave jofitimprurëse, të krijuara dhe financuara nga shteti, si dhe të enteve publike a organeve të tjera shtetërore.

Njoftimet publike për shtypin dhe njoftimet e tjera, që shpërndahen nëpërmjet mjeteve të masmedias, pa pagesë, nuk publikohen në “Buletini i njoftimeve publike”.

3. “Buletini i njoftimeve publike” në çdo numër duhet të përmbajë këto elemente: datën e shtypjes së buletinit, vitin, numrin e botimit, adresën e kontaktit për publikun, numrin e faqeve dhe treguesin e lëndës. Përmbajtja e buletinit ndahet në krerë, me këtë përmbajtje:

i) Kreu i parë “Buletini i prokurimit publik”, ku botohen të gjitha njoftimet zyrtare për ftesa ofertash dhe njoftime të tjera për prokurimin publik, sipas shkronjës “c” të pikës 2 të nenit 8 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”. Përgatitja e të dhënave dhe e materialeve të këtij kreu është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Agjencisë së Prokurimit Publik.

ii) Kreu i dytë “Buletini i Departamentit të Administratës Publike”, ku botohen të gjitha njoftimet zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, për periudhën e provës dhe pranimin në shërbimin civil të nëpunësve të administratës qendrore, me përjashtim të rastit kur ligji nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” e përcakton ndryshe. Përgatitja e materialeve të këtij kreu është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Departamentit të Administratës Publike, para botimit të materialit në shtypshkronjë.

iii) Kreu i tretë “Buletini i ankandit”, ku botohen të gjitha njoftimet zyrtare për shprehje interesi për ankand, në rast shitjeje të aktiveve a transferim kapitali të ndërmarrjeve shtetërore, mallrash a pasurish të vëna në sekuestro, sipas ligjeve në fuqi apo të vëna në ekzekutim të detyrueshëm, kur në ligj nuk përcaktohet ndryshe. Përjashtim nga procedura e njoftimit në këtë buletin bëhet edhe kur Këshilli i Ministrave në dhënien e lejes për privatizim e përcakton ndryshe. Përgatitja për botim e njoftimeve të këtij kreu është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Agjencisë së Prokurimit Publik.

iv) Kreu i katërt “Buletini i ofertave të qirave”, ku botohen të gjitha njoftimet publike për shprehje interesi për dhënie mjediseshe shtetërore me qira, sipas vendimit nr.315, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien me qira të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”, të ndryshuar. Përgatitja për botim e njoftimeve të këtij kreu është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Agjencisë së Prokurimit Publik.

v) Kreu i pestë “Buletini i shkollave të larta”, ku botohen të gjitha njoftimet publike të shkollave të larta publike, përfshi dhe shprehjet e interesit për rekrutim stafi akademik a personeli punonjës në këto institucione. Përgatitja për botim e njoftimeve të këtij kreu është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Agjencisë së Prokurimit Publik.

vi) Kreu i gjashtë “Njoftime të tjera”, ku botohen të gjitha njoftimet publike, që nuk përfshihen në

krerët e mësipërm, por që institucioni kërkues i vlerëson të nevojshme për t'u publikuar, sipas legjislacionit në fuqi. Përgatitja për botim e njoftimeve të këtij kreu është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Agjencisë së Prokurimit Publik.

Institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi i dorëzojnë njoftimet për botim tek Agjencia e Prokurimit Publik dy ditë para datës së shtypjes së buletinit.

4. Botimi i njoftimeve në “Buletini i njoftimeve publike”, për institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, është pa pagesë. Nuk lejohet përdorimi i fondeve publike për pagesa për kryerje njoftimesh publike në media, me përjashtim të rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.

5. “Buletini i njoftimeve publike” financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme. Agjencia e Prokurimit Publik përgatit materialet për botim për kreun e dytë deri të gjashtë sipas afateve të përcaktuara nga institucioni që bën njoftimin.

6. Agjencia e Prokurimit Publik administron dokumentacionin e ardhur për botim në buletin, sipas ligjit “Për arkivat”, dhe krijon një regjistër të vjetor, të veçantë, ku regjistrat me numër dhe datë çdo njoftim për publikim, i botuar në kreun e dytë deri të gjashtë, të buletinit. Dokumentacioni që botohet në kreun e parë të buletinit të ruhet dhe administrohet nga Agjencia e Prokurimit Publik, sipas rregullave në fuqi.

Subjektet shtetërore, që depozitojnë njoftim për botim në “Buletini i njoftimeve publike”, ruajnë në arkivat e tyre, përkatëse, për 3 vjet, kopje të shkresës dhe të njoftimit të dërguar.

7. Agjencia e Prokurimit Publik në faqen e vet të internetit krijon dhe mban arkivin e buletinit të njoftimeve publike. Numri i ri i çdo botimi të këtij buletini i shtohet arkivit, brenda 24 orëve nga data e botimit të “Buletinit të njoftimit publik”. Të dhënat që administrohen në këtë arkiv elektronik janë të hapura për publikun.

8. Organi a institucioni që bën njoftimin për botim mban përgjegjësi për pasaktësitë, parregullsitë apo gabimet në përmbajtjen e njoftimit ose pengesat ligjore për botim.

Agjencia e Prokurimit Publik ka të drejtë të mos botojë njoftime publike, për të cilat vëren se ka pasaktësi në njoftim dhe i kërkon dërguesit të njoftimit ta saktësojë atë.

Agjencia e Prokurimit Publik mban përgjegjësi kur publikimi nuk i përgjigjet tekstit të njoftimit të organit përkatës. Në çdo kohë, Agjencia e Prokurimit Publik apo institucioni që ka dërguar njoftimin mund të kërkojë ndreqjen e gabimeve materiale dhe të pasaktësive, duke dërguar një kopje të saktë të njoftimit. Kur ndreqja e gabimeve kërkohet pas publikimit të buletinit, njoftimi i saktë botohet në numrin e ri, pasardhës. Kur gabimi a ndreqja nuk prekin thelbin e njoftimit apo të kushteve të tij, në numrin e ri botohet vetëm saktësimi i gabimit.

9. Pranë Agjencisë së Prokurimit Publik ngrihet komisioni mbikëqyrës, i përbërë nga 5 anëtarë, i cili mbikëqyr veprimtarinë e Agjencisë së Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi, dhe raporton me shkrim pranë Kryeministrit çdo 6 muaj. Një kopje e përfundimeve të këtij raporti bëhet publike në internet. Komisioni trajton edhe çështje të etikës së njoftimeve dhe jep rekomandimet përkatëse. Anëtarët e komisionit mbikëqyrës caktohen me urdhër të Kryeministrit dhe mblidhen të paktën 1 herë në 3 muaj. Komisioni harton dhe miraton, brenda 3-mujorit të parë të mbledhjes, rregulloren e funksionimit.

10. Në të gjitha aktet nënligjore në fuqi, që kanë në përmbajtje shprehjen “njoftime publike a zyrtare, në gazeta me tirazh të lartë apo gazeta kombëtare”, nëse ligji, që rregullon marrëdhënien përkatëse, nuk parashikon ndryshe, dhe fjalët “gazeta me tirazh të lartë” a “gazeta kombëtare”, apo emërtime të tjera të ngjashme, të cilat i referohen botimit në gazeta të njoftimeve publike, të zëvendësohen me fjalët “Buletini i njoftimeve publike”.

Zëvendësimi i kësaj shprehjeje në të gjitha aktet nënligjore në fuqi është detyrues dhe i menjëhershëm.

11. Ngarkohen të gjitha institucionet shtetërore, të përmendura në pikën 1, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 336, datë 16.5.2012

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE TË BOTIMIT TË NJOFTIMEVE PUBLIKE, PËR EFEKT TË ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 8561, DATË 22.12.1999 “PËR SHPRONËSIMET DHE MARRJEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM TË PASURISË, PRONË PRIVATE, PËR INTERES PUBLIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministritë kompetente për shpronësimin, në kuptim të nenit 11 e në vijim, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, për botimet e njoftimeve publike për subjektet që preken nga shpronësimi, ngarkohen të zbatojnë kriteret sipas pikave 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij vendimi.

2. Subjektet sipas pikës 1 i drejtojnë kërkesë me shkrim medias së shkruar, gazetave me tirazh kombëtar për botimin e njoftimit respektiv. Kriteret për përzgjedhjen e mediave të shkruara janë ato të përcaktuara në ligj. Kërkesa përmban ditët kalendarike kur institucioni kërkon publikimin e njoftimit respektiv dhe kohëzgjatjen e tij në numrat vijues. Kërkesa përmban tekstin që do të dërgohet, llojin e shkrimit dhe formatin e njoftimit. Subjekti gëzon të drejtën t'i kërkojë medias që njoftimi të mos botohet në faqe gazete që përmbajnë lajme të kronikës së zezë, reklama me natyrë komerciale apo imazhe që cenojnë rëndë shtresat e marxhinalizuara të shoqërisë.

3. Marrësi i kërkesës i konfirmon, me shkrim, subjektit që ndjek shpronësimin, vullnetin për të përmbushur këtë botim, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij vendimi, si dhe çmimin, përfshirë taksat. Në vijim subjekti kërkues ka të drejtë të autorizojë me shkrim botimin e njoftimit. Asnjë botim pa autorizim me shkrim, në kuptim të kësaj pike, nuk është i rimbursueshëm për efekt të njohjes së shpenzimeve për procedurë shpronësimi. Media e shkruar, sipas autorizimit, publikon njoftimet.

4. Subjekti mediatik, jo më vonë se 3 (tri) ditë pune nga përmbushja e botimit, i përcjell me shkrim subjektit kërkues, krahas faturës tatimore e numrit të llogarisë bankare ku do të kryhet pagesa, edhe 3 (tri) kopje të gazetave përkatëse për secilin numër botimi të kërkuar. Kopjet e gazetave dhe fotokopjet e dokumentacionit të përmendur më sipër ruhen dhe administrohen për efekt të procedurës së shpronësimit.

5. Likuidimi i faturës për botimin e njoftimit publik kryhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga plotësimi i kërkesës, sipas pikës 4 të këtij vendimi. Kostot mbulohen nga kërkuesi i procedurës së shpronësimit.

6. Ministritë kompetente për shpronësimin, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të përfshijnë në vendimin e propozuar për miratim në Këshillin e Ministrave për shpronësimin edhe koston e publikimeve në përputhje me faturën, sipas pikës 4 të këtij vendimi.

7. Për të gjitha publikimet në gazeta kombëtare, të kryera për efekt të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kostot e të cilave ende nuk janë likuiduar, të kryhen pagesat respektive, sipas faturave, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike pasi të kenë siguruar kopje të botimeve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Qendra e Botimeve Zyrtare
Përmbledhje legjislacioni për median / Qendra
e Botimeve Zyrtare. - Tiranë : QBZ, 2020
... f. ; ... cm.
ISBN 978-9928-01-116-9

1.Liria e shtypit 2.Liria e informacionit
3.E drejta kushtetuese 4.Ligje 5.Shqipëri

342 .732(496.5)

Tirazhi 50